



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 74

Tiranë – E mërkurë, 18 maj 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 36/2022, datë 14.4.2022	Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit..... 9349
Ligj nr. 46/2022, datë 28.4.2022	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktet dhe dokumentet e Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, Stamboll 2016.. 9356
Dekret i Presidentit nr. 13611, datë 10.5.2022	Për shpallje ligji..... 9446
Vendim i Kuvendit nr. 35/2022, datë 12.5.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, të ndryshuar.. 9446
Vendim i Kuvendit nr. 36/2022, datë 12.5.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, të ndryshuar..... 9448
Vendim i Kuvendit nr. 37/2022, datë 12.5.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, të ndryshuar..... 9451
Dekret i Presidentit nr. 13617, datë 13.5.2022	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 9453
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 289, datë 11.5.2022	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, për Njësinë Administrative Tiranë, të pasurive nr. 6/119, zona kadastrale 8350, nr. 3/576, zona kadastrale 8130, nr. 7/155, zona kadastrale 8380, nr. 7/87, zona kadastrale 8330, dhe nr. 6/459, zona kadastrale 8180..... 9453
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 11.5.2022	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit..... 9461
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 11.5.2022	Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2022..... 9463

Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 227, datë 28.4.2022	Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2022–2023 në sistemin arsimor parauniversitar.....	9493
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 189, datë 4.5.2022	Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së deklaratës tip të nënshkruar prej përkthyesit zyrtar.....	9493
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 190, datë 4.5.2022	Për miratimin e listës së gjuhëve të huaja, të cilat përfshihen në shërbimin e përkthimit zyrtar.....	9495
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 191, datë 4.5.2022	Për përcaktimin e rregullave për mbajtjen e adresës së postës elektronike për përkthyesin zyrtar dhe interpretin e gjuhës së shenjave.....	9495
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 192, datë 4.5.2022	Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, tarifat për pjesëmarrje, organizimin e zhvillimit të provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, si dhe për procedurën e mënyrën e vlerësimit të provimeve.....	9496
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 200, datë 10.5.2022	Për miratimin e formularit të ankesave ndaj përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhës së shenjave.....	9506
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 311, datë 17.5.2022	Për delegim kompetence.....	9508
Urdhër i Komisionerëve Publikë nr. 47, datë 16.5.2022	Për delegim kompetencash.....	9508
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 6539, datë 13.5.2022	Mbi hyrjen në fuqi të Konventës së ILO-s për Dhunën dhe Ngacmimin, 2019 (C190).....	9509
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 163, datë 20.1.2022	Për shpalljen të vdekur të shtetasit Aleksander Gjinaj.....	9509
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Meleq Arapi.....	9509



LIGJ
Nr. 36/2022

**PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E GRUPEVE
VENDORE TË VEPRIMIT¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e parakushteve për krijimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit, të cilat do të mundësojnë përmes partneritetit lokal dhe parimit nga poshtë-lart përfshirjen e komuniteteve lokale në identifikimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit rural të udhëhequra nga vetë komuniteti në varësi të nevojave të tyre, marrjen e vendimeve për alokimin e burimeve financiare dhe

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 dhjetor 2013, “Për përcaktimin e dispozitave të përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit, Fondin Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural dhe Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit dhe për përcaktimin e dispozitave të përgjithshme për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1083/2006”, të ndryshuar. Numri CELEX 32013R1303, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 347, datë 20.12.2013, f. 320–469.

- Rregulloren (BE) nr. 1305/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 dhjetor 2013, “Mbi mbështetjen për zhvillimin rural nga Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural (EAFRD) dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1698/2005”, të ndryshuar. Numri CELEX 32013R1305, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 347, datë 20.12.2013, f. 487–548.

menaxhimin e tyre bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, sigurimin e një mjedisi për investimet në zonat rurale nga vetë komuniteti, ngritjen e kapaciteteve vendore, si dhe zbatimin e strategjive lokale të zhvillimit përmes projekteve lokale.

**Neni 2
Fusha e veprimit**

Ky ligj përcakton parimet bazë, kriteret, përgjegjësitë dhe proceset për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit, hartimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga komuniteti, në harmoni me politikat e zhvillimit bujqësor dhe rural, në nivel qendror e vendor.

**Neni 3
Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aktivitete në rrjet” janë shkëmbimet e arritjeve, përvojave dhe ekspertizave ndërmjet aktorëve ruralë brenda partneritetit lokal dhe GVV-së.

2. “Aktorë lokalë” janë institucionet publike, qendrore apo të decentralizuara, përfaqësuesit e sektorit privat, fermerët, shoqatat, organizatat profesionale që përfaqësojnë fermerët, shoqëritë tregtare, shoqëria civile.

3. “Autoritet publik” është:

a) çdo institucion i qeverisjes qendrore ose vendore, ose institucione të tjera të administratës publike në nivel kombëtar, rajonal ose lokal;

b) çdo person juridik që kryen funksione administrative publike, përfshirë detyra, aktivitete ose shërbime të veçanta lidhur me zhvillimin rural; dhe

c) çdo person juridik që ka përgjegjësi apo funksione publike, ose që ofron shërbime publike në lidhje me zhvillimin rural nën kontrollin e një organi apo personi që i përket grupimeve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike.

4. “Grup vendor i veprimit” (në vijim GVV) është një organizatë jofitimprurëse me bazë partneriteti, e përbërë nga përfaqësues të interesave lokalë socio-ekonomikë, publikë dhe privatë, në të cilën në nivelin e vendimarrjes asnjë autoritet



publik ose grup interesi nuk përfaqëson më shumë se 49% të të drejtave të votës.

5. “Kosto operative” janë kostot e lidhura me menaxhimin e zbatimit të strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti, që kanë të bëjnë me kosto funksionimi, paga personeli, kosto trajnimesh, kosto për veprimtarinë për marrëdhëniet me publikun, kosto financiare, si dhe kosto të lidhura me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë.

6. “LEADER” është metoda për përfshirjen e partnerëve vendorë në drejtimin e zhvillimit të ardhshëm të zonave rurale, mobilizimin dhe arritjet e zhvillimit territorial në komunitetet rurale lokale në përputhje me këto kritere: e fokusuar në zona të veçanta rajonale; e udhëhequr nga grupe vendore të veprimit të përbërë nga përfaqësues të interesave lokalë socio-ekonomikë, publikë dhe privatë; e kryer përmes strategjive të zhvillimit lokal të integruara dhe shumësektoriale, të bazuara në zona; e përshtatur për të marrë në konsideratë nevojat dhe potenciale lokale dhe që përfshin karakteristika inovative në kontekst, rrjet dhe, kur është e përshtatshme, bashkëpunim lokal.

7. “Marrëveshje partneriteti lokal” është një marrëveshje e shkruar dhe e firmosur nga një grup përfaqësuesish të interesave publikë dhe jopublikë, socio-ekonomikë të së njëjtës zonë rurale, me qëllim zhvillimin, promovimin e themelimit dhe regjistrimin e një GVV-je.

8. “Ministria” është ministria përgjegjëse për politikën e zhvillimit bujqësor dhe rural.

9. “Ministri” është ministri përgjegjës për politikën e zhvillimit bujqësor dhe rural.

10. “Politika e zhvillimit bujqësor dhe rural” është perspektiva afatgjatë dhe zbatimi i drejtimeve kryesore të zhvillimit bujqësor e rural të vendit dhe të zonave të tij bujqësore individuale, në koordinim ndërmjet autoriteteve publike qendrore dhe lokale, që synon planifikimin dhe zbatimin e një zhvillimi të ekuilibruar socio-ekonomik bujqësor e rural.

11. “Program zhvillimi bujqësor dhe rural” është programi që mbështet zhvillimin bujqësor e rural, duke zbatuar politikën kombëtare të zhvillimit bujqësor dhe rural.

12. “Projekt bashkëpunimi” është një projekt i përbashkët ndërmjet dy ose më shumë:

a) GVV-ve në nivel kombëtar; ose

b) GVV-ve në nivel ndërkombëtar me GVV, ose një grup të ngjashëm me GVV-në ndërkombëtare.

Projektet e bashkëpunimit përfshijnë veprime konkrete të zbatuara bashkërisht me pritshmëri të identifikuar qartë, që sjellin përfitime për secilin nga territoret e përfshira.

13. “Publik” nënkupton një ose më shumë persona juridikë publikë ose autoritete publike.

14. “Rrjet” është një mjet për transferimin e praktikave të mira dhe shpërndarjen e inovacionit, ndërlidhje ndërmjet njerëzve, projekteve dhe zonave rurale.

15. “Strategji e zhvillimit lokal e udhëhequr nga komuniteti” është tërësia e masave koherente të hartuara dhe të zbatuara nga një GVV, qëllimi i së cilës është të plotësojë objektivat dhe nevojat lokale e që kontribuon në arritjen e objektivave të politikës kombëtare të zhvillimit bujqësor dhe rural.

16. “Struktura përgjegjëse” është njësi në ministri, e cila me urdhrin e ministrit për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e regjistrimit të GVV-ve ngarkohet për këtë qëllim, si dhe me detyra të tjera të caktuara në këtë ligj.

17. “Gjallërimi lokal” është procesi/aktiviteti që mbështet ose promovon takimet dhe dialogun ndërmjet banorëve, konvergencën ndërmjet sektorëve, shkëmbimin e njohurive dhe plotësueshmërinë e aftësive, aspekte të cilat “gjallërimi” synon t'i ndërtojë ndërmjet një shumëllojshmërie grupesh interesi të përfshira apo që mund të përfshihen në GVV.

18. “Zona “LEADER”” është një zonë rurale që përcakton kufijtë brenda të cilëve hartohet dhe zbatohet një strategji e veçantë e zhvillimit lokal e udhëhequr nga komuniteti.

Neni 4

Parimet e funksionimit të GVV-së

Funksionimi dhe zbatimi i GVV-së mbështetet në katër parime kryesore:

1. Parimi i partneritetit.
2. Parimi territorial.
3. Parimi nga poshtë-lart.
4. Parimi i rrjetëzimit e bashkëpunimit.



Neni 5

Parimi i partneritetit

1. GVV-ja është shprehje e një partneriteti lokal, e cila përfshin tipologjitë e mëposhtme të partnerëve që operojnë brenda kufijve të zonës “LEADER” sipas përcaktimeve të këtij ligji:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore, bashkia/bashkitë ose qarku/qarqet dhe institucione të tjera publike në territorin e së cilës shtrihet zona “LEADER”, institucionet e decentralizuara në nivel lokal e rajonal, agjenci rajonale apo degë të enteve publike kombëtare etj.;

b) përfaqësuesit përkatës të sektorit jopublik, fermerë dhe jofermerë, sipërmarrje bujqësore dhe jobujqësore në nivel individual dhe/ose shoqata, organizata dhe unione profesionale që përfaqësojnë fermerët, profesionistët jofermerë dhe mikrosipërmarrjet dhe shoqëritë tregtare;

c) organizatat që përfaqësojnë shoqërinë civile, organizatat e banorëve, shoqatat ambientaliste, shoqatat e grave dhe të të rinjve, ofruesit e shërbimeve kulturore dhe komunitare, si: mediet, organizata të tjera jofitimprurëse dhe organet përgjegjëse për promovimin e përfshirjes sociale, të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të kenë minimumi 20% të së drejtës së votës, por së bashku me autoritete të tjera publike përfaqësojnë jo më shumë se 49% të të drejtave të votës në nivelin më të lartë të vendimmarrjes së GVV-së.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, GVV-ja do të synojë zgjerimin e saj me partnerë të rinj lokalë. GVV-ja mund të përfshijë si partnerë të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të përfshira në zonën e GVV-së.

Neni 6

Parimi territorial

1. Territori i mbuluar nga GVV-ja duhet të ketë një formë të qëndrueshme në terma gjeografikë, socialë e ekonomikë, si dhe të ketë burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe ekonomike për të mbështetur një strategji të zbatueshme të zhvillimit lokal.

2. Aktorët lokalë, në kuptim të këtij ligji, mund të themelojnë një GVV vetëm në një zonë “LEADER”, duke përcaktuar kufijtë më të përshtatshëm për të arritur objektivat e tyre.

3. Kufijtë e zonës “LEADER”, sipas këtij neni, duhet të plotësojnë këto kritere: të jenë të pandërprerë gjeografikisht, të mbulojnë një territor rural me popullsi jo më pak se 10 000 dhe jo më shumë se 150 000 banorë.

4. Kufijtë administrativë të bashkisë apo të qarkut, sipas përcaktimit të ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, nuk kanë rol kufizues në përcaktimin e kufijve të zonës “LEADER”.

Neni 7

Parimi nga poshtë-lart

1. Parimi nga poshtë-lart zbatohet nga aktorët lokalë që marrin pjesë në vendimmarrjen për strategjinë dhe prioritetet e zgjedhura që do të ndiqen në zonën e tyre.

2. Pjesëmarrja e aktorëve lokalë përfshin edhe popullsinë në një masë të madhe, grupet me interesa ekonomikë e socialë dhe përfaqësuesit e institucioneve publike dhe private.

3. Për zbatimin e parimit nga poshtë-lart, GVV-të përfshijnë aktorët lokalë për përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e strategjive të zhvillimit lokal të udhëhequra nga komuniteti dhe, në mënyrë të veçantë, për:

a) analizimin dhe identifikimin e nevojave;

b) përcaktimin e objektivave të përgjithshëm dhe specifikë;

c) përcaktimin e prioritetëve përkatëse të zgjedhura;

c) alokimin e fondeve;

d) përcaktimin e zonës dhe të popullsisë së mbuluar nga strategjia;

dh) një përshkrim të procesit të përfshirjes së komunitetit në zhvillimin e strategjisë;

e) një përshkrim të bashkëveprimit të GVV-ve dhe rregullat e brendshme të vendimmarrjes, përfshirë procedurat për përzgjedhjen e projekteve të vogla;

ë) planin e veprimit, një përshkrim të hapave të ndërmarrë, që tregojnë sesi do të arrihen objektivat nëpërmjet aktiviteteve të pritshme dhe tipi i projekteve të mbështetura;

f) planin financiar të strategjisë, përfshirë shpenzimet për rritje kapacitetesh dhe rritje të kostot operative dhe projekte të vogla;

g) zbatimin e strategjisë;



gj) monitorimin dhe vlerësimin e progresit të zbatimit të strategjisë.

Neni 8

Parimi i rrjetëzimit dhe bashkëpunimit

GVV-të gëzojnë të drejtën e promovimit në aktivitetet në rrjet dhe projektet e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim tejkalimin e izolimit të zonave rurale dhe fuqizimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë të zonave “LEADER” për të ndjekur objektivat e tyre zhvillues përmes shkëmbimeve të dijeve dhe të eksperiencave, bashkëpunimit konkret me territore të tjera, si dhe transferimit të praktikave të mira dhe të përhapjes së risive.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

I GVV-së

Neni 9

Fusha e veprimit të GVV-së

1. Fusha e veprimit të GVV-së është mbështetja e rritjes ekonomike, sociale dhe kulturore të komuniteteve të zonës “LEADER” përmes rritjes së vlerave të burimeve lokale dhe asetëve, përmes hartimit dhe zbatimit të strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti.

2. Për këtë qëllim GVV-ja zhvillon e promovon lloje të ndryshme aktivitetesh, të tilla si:

a) pjesëmarrja në nisma rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare për financimin e iniciativave/projekteve të qëndrueshme;

b) pjesëmarrja në rrjete kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqata ose institucione, veprimtaria e të cilave ndjek objektiva të ngjashëm;

c) promovimi i iniciativave të komunikimit, bashkëpunimit në rrjet dhe projekteve të bashkëpunimit, që kanë si qëllim promovimin e marrëdhënieve fitimprurëse ndërmjet aktorëve lokalë me territore dhe institucione të tjera;

ç) ofrimi i informacioneve, mbështetja teknike dhe trajnimi i promotorëve lokalë potencialë të projekteve;

d) administrimi dhe menaxhimi i asetëve.

Neni 10

Struktura e GVV-së

1. GVV-të krijohen dhe funksionojnë si organizata jofitimprurëse me anëtarësi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.

2. Në përputhje me parimin e barazisë gjinore dhe kërkesat e këtij ligji, një GVV regjistrohet vetëm nëse struktura e tij organizative ka në përbërje të paktën këto organe të brendshme:

a) Asamblenë e Përgjithshme;

b) bordin ekzekutiv;

c) personelin, që do të përfshijë të paktën:

i. drejtorin ekzekutiv, i cili zgjidhet midis anëtarëve të bordit ekzekutiv nga vetë bordi, me propozim të presidentit;

ii. ekspertin kontabël.

3. Asambleja e Përgjithshme e GVV-së është organi më i lartë vendimmarrës në të cilin të gjithë anëtarët e GVV-së thirren në mbledhje të paktën 1 herë në vit dhe është përgjegjëse për zgjedhjen e bordit dhe të presidentit nga radhët e anëtarëve të GVV-së. Këto zgjedhje duhet të ndjekin parimin e partneritetit, të barazisë territoriale, barazisë gjinore dhe të moshës.

4. Funksionet e Asamblesë së Përgjithshme përcaktohen në statutin e GVV-së në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit përkatës në fuqi.

5. Bordi i GVV-së është organi më i lartë ekzekutiv, ku përfaqësohen të gjithë partnerët e zonës “LEADER”, të propozuar nga secila tipologji partnerësh, sipas parimit të partneritetit, i përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji.

6. Bordi i GVV-së është përgjegjës për vendimmarrjen e përditshme të GVV-së dhe për funksionimin ligjor dhe financiar të tij, për autorizimin e kostove operative, të cilat në çdo rast nuk mund të kalojnë 25% të shpenzimeve të fondeve publike të kryera në kuadër të strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti.

7. Presidenti i GVV-së drejton mbledhjet e bordit. Të gjithë anëtarët e bordit duhet të firmosin një deklaratë konfidencialiteti për informacionet me të cilat njihen në pozicionet e tyre gjatë procesit të vendimmarrjes.

8. Bordi mund të ngrejë nënkomitete për të përgatitur dhe vlerësuar materialet që do të paraqiten për vendimmarrjen e bordit, të tilla si:



nënkomitete bashkëpunimi, vlerësimi dhe monitorim projektesh.

9. Personeli i GVV-së mund të përfshijë këshilltarë/koordinatorë projektesh, këshilltarë/koordinatorë komuniteti, këshilltarë/koordinatorë biznesi, asistentë zyre etj., nëse konsiderohet e nevojshme.

10. Bordi i GVV-së duhet të sigurojë:

a) diversifikim të moshës e të barazisë gjinore dhe duhet të përfshijë:

i. të paktën 2 gra;

ii. të paktën 2 persona nën moshën 35 vjeç;

b) të gjithë anëtarët e bordit duhet të jenë rezidentë në territorin e GVV-së.

Neni 11

Funksionet e GVV-së

1. GVV-ja e regjistruar sipas përcaktimit të kreut III të këtij ligji harton dhe miraton strategjinë e zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti për zonën “LEADER” që mbulon, sipas modelit të përcaktuar me udhëzim të ministrit.

2. Strategjia e zhvillimit lokal e udhëhequr nga komuniteti miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e GVV-së dhe konfirmohet nga ministri vetëm pasi vërtetohet se përmban të paktën këto elemente:

a) numrin e banorëve dhe përkufizimin e zonës për të cilën ajo zbatohet;

b) analizën e nevojave të zhvillimit dhe potencialin konkurrues të zonës, përfshirë analizën e aspekteve të forta, dobësive, mundësive dhe risqeve në zhvillimin e zonës;

c) përshkrimin e strategjisë dhe objektivave të saj, përshkrimin e karakteristikave inovative dhe të integruara të saj dhe një hierarki objektivash, duke përfshirë objektivat e matshme për rezultatet. Në lidhje me rezultatet, objektivat mund të shprehën në terma sasiorë ose cilësorë;

ç) përshkrimin e procesit gjithëpërfshirës të komunitetit të zonës “LEADER” gjatë përgatitjes së saj;

d) planin e veprimit, që përcakton veprimet konkrete që zbatohen për realizimin e objektivave të saj;

dh) përshkrimin e rregullave të menaxhimit dhe të monitorimit të strategjisë, aftësinë e strukturës së GVV-së për të zbatuar strategjinë, si dhe

përshkrimin e rregullave të detajuara për vlerësimin e zbatimit të saj;

e) planin financiar për zbatimin e strategjisë, si dhe burimet e financimit të tij.

Ministri mund të rekomandojë rishqyrtimin e strategjisë së miratuar nga Asambleja lidhur me plotësimin e saj me elementet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

3. Gjatë zbatimit të strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti, GVV-ja duhet të jetë në gjendje të kryejë këto funksione:

a) të krijojë kapacitetet e aktorëve lokalë, që përfshijnë përfituesit e mundshëm për të zhvilluar dhe zbatuar masa/aktivitete që përfshijnë fuqizimin e kapaciteteve të tyre të hartimit dhe menaxhimit të projekteve;

b) të hartojë një procedurë përzgjedhjeje jodiskriminuese dhe transparente, e cila shmang konfliktet e interesit dhe siguron që të paktën 50% e votave në vendimet e përzgjedhjes janë nga partnerë që nuk janë autoritete publike dhe lejon përzgjedhjen me procedurë të shkruar;

c) të hartojë dhe miratojë kritere objektive jodiskriminuese për përzgjedhjen e masave/aktiviteteve që sigurojnë koherencë me strategjinë e zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti, duke i prioritetizuar ato masa/aktivitete në bazë të kontributit që ato japin në arritjen e objektivave të asaj strategjie;

ç) të përgatisë dhe të publikojë kërkesa për propozime ose një procedurë të vazhdueshme të paraqitjes së projekteve;

d) të marrë dhe të vlerësojë kërkesën për mbështetje;

dh) të përzgjedhë projektet dhe të përcaktojë masën e mbështetjes dhe, kur është e zbatueshme, të paraqesë propozime tek organi përgjegjës për verifikimin final të të drejtave, para miratimit;

e) të monitorojë dhe të zbatojë strategji dhe projekte të zhvillimit lokal të udhëhequra nga komuniteti, si dhe të kryejë aktivitete specifike vlerësimi që lidhen me atë strategji;

ë) të gjallërojë strategjinë e zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti për të mundësuar shkëmbime ndërmjet aktorëve për sigurimin e informacionit dhe promovimin e strategjisë dhe të mbështesë përfituesit potencialë, duke synuar zhvillimin e projekteve dhe përgatitjen e kërkesave.

4. Gjatë zbatimit të strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti, GVV-ja duhet të



ketë burime njerëzore të mjaftueshme dhe kompetente, veçanërisht për plotësimin e funksioneve të mëposhtme:

- a) gjallërimin lokal;
- b) menaxhimin administrativ dhe financiar;
- c) sisteme të zbatimit dhe realizimit të objektivave të strategjisë.

Neni 12

Organizimi i GVV-së

1. Gjatë realizimit të misionit të tij publik, aktivitetet e GVV-së, që financohen nga fonde publike, kryhen në përputhje me parimet e një prokurimi publik efektiv, transparent e llogaridhënës dhe me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar.

2. Në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin dhe kontrollin financiar, Asambleja e Përgjithshme e GVV-së miraton një rregullore të brendshme, që përcakton procedurat e funksionimit të GVV-së, me qëllim garantimin e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e vendimmarrjes dhe në menaxhimin teknik dhe administrativ të aktiviteteve. Rregullorja e brendshme duhet të rregullojë të paktën këto çështje:

- a) zbatimin e parimit të partneritetit;
- b) zbatimin e parimit nga poshtë-lart;
- c) zbatimin e parimit të rrjetëzimit dhe të bashkëpunimit;
- ç) organizimin e strukturës operationale (stafit);
- d) menaxhimin e burimeve njerëzore;
- dh) prokurimin e mallrave dhe të shërbimeve;
- e) hartimin dhe zbatimin e strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti;
- ë) konfliktin e interesit.

Neni 13

Instrumentet financiare

1. Instrumentet financiare për financimin e GVV-së miratohen nga Asambleja e Përgjithshme, siç përcaktohet në strategjinë e zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti në zonën e dhënë “LEADER”.

2. Instrumentet e financimit përfshijnë:

- a) tarifën e anëtarësimit;

- b) grante nga programi IPARD;
- c) grante nga programe të tjera publike qendrore apo vendore;
- ç) kredi;
- d) skema garancie;
- dh) pjesëmarrje me aksione (në para/në natyrë);
- e) partneritete publike-private;

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore pjesëmarrëse në një GVV të regjistruar siç përcaktohet në këtë ligj mund të mbështesin financiarisht kostot operationale dhe/ose shpenzime të tjera të GVV-së sipas vendimeve të këshillave bashkiakë dhe të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, pavarësisht nga përqindja në fuqinë vendimmarrëse të saj brenda GVV-së.

4. Në rastet kur në një GVV merr pjesë më shumë se një njësi e vetëqeverisjes vendore, përqindja e financimit të tyre në GVV vendoset në raport me përqindjen e territorit të secilës njësi të vetëqeverisjes vendore kundrejt territorit të zonës “LEADER”.

Neni 14

Konflikti i interesit

Përveç sa parashikohet në legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesit, seksioni i rregullores së brendshme të GVV-së për konfliktin e interesit duhet të adresojë edhe këto kriterë:

a) anëtarët e bordit të GVV-së, që kanë interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, ose përfaqësues të subjekteve që kanë interes të drejtpërdrejtë në një projekt të përcaktuar nuk mund të jenë pjesëmarrës në vendimmarrjen për çështjen. Në këtë rast anëtarëve, që janë palë të interesuara, do t'u kërkohet të largohen nga mbledhja në të cilën do të merret vendimi. Procesverbali i mbledhjes së bordit duhet të raportojë daljen e anëtarëve dhe arsyet përkatëse;

b) punonjësit e GVV-së nuk duhet të kryejnë aktivitete të tjera ekonomike, që paraqesin konflikt interesi, veçanërisht lidhur me marrëdhëniet me përfituesit;

c) punonjës dhe konsulentë të jashtëm, që koordinojnë gjallërimin e një territori dhe/ose që janë përgjegjës për menaxhimin dhe koordinimin administrativ të GVV-së nuk mund të jenë përfitues të drejtpërdrejtë të ndërhyrjeve të mbështetura nga GVV-ja;



ç) punonjës dhe konsulentë të jashtëm që janë të afërm deri në shkallë të dytë të një individi kërkues për mbështetje ose të një menaxheri apo një përfaqësuesi të një organizate që bën kërkesë për financim nuk mund:

i. të marrin pjesë në procesin vendimmarrës të GVV-së;

ii. të shqyrtojnë kërkesën e atij kërkuesi;

iii. të përfshihen në monitorimin ose vlerësimin e aktiviteteve që lidhen me kërkuesin.

d) punonjës përgjegjës për menaxhimin dhe të afërm të tyre deri në shkallë të dytë nuk mund të jenë ofrues mallrash ose shërbimesh ndaj GVV-së ose përfituesve publikë ose privatë të saj.

KREU III REGJISTRIMI I GVV-së

Neni 15

Procedurat e njohjes dhe të regjistrimit në ministri

1. Çdo GVV para fillimit të ushtrimit të aktivitetit, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore, pajiset me autorizim nga ministri.

2. Për t'u pajisur me autorizim, GVV-ja paraqet kërkesën, bashkëlidhur së cilës paraqiten:

a) vendimi i gjykatës për regjistrimin në regjistrin e organizatave joqeveritare;

b) kopje e numrit të identifikimit lëshuar nga administrata tatimore;

c) vërtetim regjistrimi lëshuar nga zyra e regjistrit në gjykatë;

ç) statuti dhe akti i themelimit të GVV-së;

d) përcaktimi i zonës "LEADER", ku do të funksionojë GVV-ja;

dh) struktura operationale e GVV-së;

e) rregullorja e brendshme, e cila rregullon marrëdhëniet e organizimit, funksionimit, menaxhimit të riskut, procedurat e komunikimit dhe të informimit të publikut, procedurat e auditit të brendshëm.

3. Ministri, pas verifikimit të dokumentacionit për plotësimin e kushteve formale dhe të ushtrimit të aktivitetit nga struktura përgjegjëse pranë ministrit, miraton autorizimin dhe urdhëron kryerjen e regjistrimit të GVV-së.

4. Në rast të mospërbushjes së kërkesave të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, struktura përgjegjëse për regjistrimin e GVV-së njofton

GVV-në përkatëse për këtë mospërbushje dhe cakton një afat 6-mujor për plotësimin e tij. Në rast se në përfundim të këtij afati konstatohet se nuk janë përmbushur ende kërkesat sipas pikës 2 të këtij neni, ministri refuzon autorizimin dhe urdhëron moskryerjen e regjistrimit në regjistrin e GVV-ve.

5. Kundër refuzimit të autorizimit për regjistrimin e një GVV-je, kërkuesi mund t'i drejtohet gjykatës administrative sipas procedurave të Kodit të Procedurës Administrative.

Neni 16

Regjistri i GVV-së

1. Pranë ministrit krijohet dhe mbahet regjistri i GVV-ve, sipas modelit të miratuar me urdhër të ministrit.

2. Regjistri do të identifikojë GVV-të për çdo zonë, duke ofruar të dhëna për:

a) zonën "LEADER" ku funksionon GVV-ja;

b) strukturën e GVV-së;

c) statutin dhe aktin e themelimit të GVV-së;

ç) rregulloren e brendshme të GVV-së;

d) aktivitetet vjetore të GVV-së;

dh) auditin dhe raportimin në GVV;

e) autorizimin;

ë) urdhrin e shfuqizimit të autorizimit.

Neni 17

Raportimi dhe vlerësimi i GVV-ve

1. GVV-të e regjistruara në regjistrin raportojnë për veprimtarinë e tyre pranë strukturës përgjegjëse në ministri, në baza vjetore, brenda muajit mars të vitit pasardhës.

2. Struktura përgjegjëse në ministri vlerëson aktivitetin e GVV-ve dhe përmbushjen nga ana e tyre të parimeve dhe të kriterëve të përcaktuara nga ky ligj dhe u ofron sugjerime/rekomandime kur e konsideron të nevojshme.

3. Rregullat dhe procedurat për raportimin e veprimtarisë dhe vlerësimin e aktivitetit të GVV-ve lidhur me respektimin e parimeve dhe përmbushjen e kriterëve të përcaktuara nga ky ligj miratohen me urdhër të ministrit.



KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18 Akte nënligjore

Ngarkohet ministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, pika 1; 16, pika 1; dhe 17, pika 3, të këtij ligji.

Neni 19 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 14.4.2022.

LIGJ Nr. 46/2022

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AKTET DHE DOKUMENTET E KONGRESIT TË 26-të TË BASHKIMIT TË PËRLOTSHËM POSTAR, STAMBOLL 2016

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderohet në aktet dhe dokumentet kryesore të Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar (UPU), të mbajtur më 20 shtator–7 tetor 2016, në Stamboll, Turqi, të cilat kanë ndryshuar aktet themeltare të UPU-së bashkëlidhur këtij ligji, si më poshtë:

1. Kushtetuta e Bashkimit të Përbotshëm Postar;

2. Konventa e Përbotshme Postare;

Faqe | 9356

3. Marrëveshja e Shërbimeve të Pagesave Postare;

4. Rregullat e Procedurës së Kongreseve;

5. Rregullorja e Përgjithshme e Bashkimit të Përbotshëm Postar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 28.4.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13611, datë 10.5.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

KUSHTETUTA E BASHKIMIT TË PËRLOTSHËM POSTAR

(E ndryshuar me protokollet shtesë të Tokios më 1969, të Lozanës 1974, të Hamburgut 1984, të Uashingtonit 1989, të Seulit 1994, të Pekinit 1999, të Bukureshtit 2004, të Kongresit të 24-t – 2008 dhe të protokolleve shtesë të Stambollit² 2016).

Pasqyra e lëndës

Hyrje

Seksioni I: Dispozita organike

Kapitulli I: Të përgjithshme

Neni

1. Qëllimi dhe objektivat e Bashkimit

1.bis Përkufizime

² Për protokollin shtesë të Tokios 1969, shihni dokumentet e atij Kongresi, volumi III, faqet 9–12. Për protokollin e dytë shtesë (Lozanë 1974), shihni dokumentet e atij Kongresi, volumi III, faqe 23–25. Për protokollin e tretë shtesë (Hamburg 1984), shihni dokumentet e atij Kongresi, volumi III, faqet 25–28. Për protokollin e katërt shtesë (Uashington 1989), shihni dokumentet e atij Kongresi, volumi III/1, faqet 27–32. Për protokollin e pestë shtesë (Seul 1994), shihni dokumentet e atij Kongresi, volumi III, faqet 25–29. Për protokollin e gjashtë shtesë (Pekin 1999), shihni faqet A3–A6 të dokumentit të publikuar në Bernë në 1999. Për protokollin e shtatë shtesë (Bukuresht 2004), shihni faqet 3–7 të dokumentit të publikuar në Bernë në 2004. Për protokollin e tetë shtesë (Kongresi i 24-t – 2008), shihni faqet 3–7 të dokumentit të publikuar në Bernë më 2008-ën. Për protokollin e nëntë shtesë (Stamboll 2016), shihni faqe 7–13 të këtij dokumenti.



2. Anëtarët e Bashkimit
3. Juridiksioni i Bashkimit
4. Marrëdhënie të jashtëzakonshme
5. Selia e Bashkimit
6. Gjuha zyrtare e Bashkimit
7. Njësia monetare
8. Sindikata të kufizuara. Marrëveshje të

Posaçme

9. Marrëdhëniet me Kombet e Bashkuara
10. Marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare
- Kapitulli II: Anëtarësimi ose pranimi në Bashkim. Tërheqja nga Bashkimi

Procedura

11. Anëtarësimi ose pranimi në Bashkim.
12. Tërheqja nga Bashkimi. Procedura
- Kapitulli III: Organizimi i Bashkimit
13. Organet e Bashkimit
14. Kongresi

15. Kongrese të jashtëzakonshme
16. Konferencat administrative
17. Këshilli drejtues
18. Këshilli i Operacioneve Postare
19. Komitetet speciale
20. Byroja Ndërkombëtare

- Kapitulli IV: Financat e Bashkimit
21. Shpenzimet e Bashkimit. Kontributet e

shteteve anëtare

- Seksioni II: Aktet e Bashkimit
- Kapitulli I: Të përgjithshme
22. Aktet e Bashkimit
23. Zbatimi i akteve të Bashkimit në territoret

për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjës një shtet anëtar

24. Legjislacioni kombëtar
- Kapitulli II: Pranimi dhe denoncimi i akteve të

Bashkimit

25. Nënshkrimi, autentikimi, ratifikimi dhe forma të tjera të miratimit të akteve të Bashkimit
26. Njoftimi i ratifikimeve dhe metodat e tjera të miratimit të akteve të Bashkimit
27. Aderimi në marrëveshje
28. Denoncimi i një marrëveshje

- Kapitulli III: Amendimet e akteve të Bashkimit
29. Paraqitja e propozimeve
30. Amendimi i Kushtetutës
31. Amendimi i rregullores së përgjithshme,

Konventës dhe rregulloreve

- Kapitulli IV: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
32. Arbitrazhi
33. Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Kushtetutës

KUSHTETUTA E BASHKIMIT TË PËRBOTSHËM POSTAR

(E ndryshuar me protokollet shtesë të Tokios më 1969-ën, të Lozanës 1974, të Hamburgut 1984, të Uashingtonit 1989, të Seulit 1994, të Pekinit 1999, të Bukureshtit 2004 dhe të Kongresit të 24-t – 2008 dhe të Protokolleve shtesë, Stamboll 2016).

Preambulë³

Me synimin për të zhvilluar komunikimin midis popujve nëpërmjet funksionimit efikas të shërbimeve postare, dhe për të kontribuar në arritjen e qëllimit fisnik të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushat kulturore, sociale dhe ekonomike, anëtarët e plotfuqishëm të qeverive të vendeve anëtare kanë miratuar këtë Kushtetutë, objekt ratifikimi.

Misioni i Bashkimit është të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm të shërbimeve universale postare efikase dhe të aksesueshme, me qëllim lehtësimin e komunikimit midis popujve nëpërmjet:

- garantimit të qarkullimit të lirë të objekteve postare në një territor të vetëm postar të përbërë nga rrjete të ndërlidhura;
- nxitjes së miratimit të standardeve të përbashkëta dhe përdorimit të teknologjisë;
- sigurimit të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndërmjet palëve të interesuara;
- promovimit të bashkëpunimit teknik efektiv;
- përmbushjes së nevojave në ndryshim të konsumatorëve.

SEKSIONI I
DISPOZITA ORGANIKEKAPITULLI I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat e Bashkimit

1. Vendet që zbatojnë këtë Kushtetutë do të formojnë, sipas organizatës ndërqeveritare Bashkimi i Përbotshëm Postar, një territor të vetëm postar për shkëmbimin reciprok të objekteve postare. Liria e tranzitit duhet të garantohet në të

³ Amenduar nga Kongresi i Bukureshtit, 2004.



gjithë territorin e Bashkimit, sipas kushteve të përcaktuara në aktet e Bashkimit⁴.

2. Qëllimi i Bashkimit është të sigurojë organizimin dhe përmirësimin e shërbimeve postare dhe të promovojë në këtë aspekt zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

3. Bashkimi duhet të marrë pjesë, për sa është e mundur, në sigurimin e ndihmës teknike postare të kërkuar nga shtetet anëtare.

Neni 1.bis⁵ Përkufizime

1. Për qëllimet e akteve të Bashkimit të Përbotshëm Postar, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e përcaktuara në vijim:

1.1 “Shërbim postar” të gjitha shërbimet postare ndërkombëtare qëllimi i të cilave përcaktohet dhe rregullohet nga aktet e Bashkimit. Detyrimet kryesore të shërbimeve postare janë të përmbushin disa objektiva të caktuara sociale dhe ekonomike të shteteve anëtare, duke siguruar, mbledhjen, përpunimin, klasifikimin, transmetimin, dhe shpërndarjen e dërgesave postare.

1.2 “Shtet anëtar” një shtet që përmbush kushtet e nenit 2 të Kushtetutës.

1.3 “Territor i vetëm postar” (një dhe i njëjti territor postar) detyrimi i palëve kontraktuese të akteve të UPU-së për të ofruar për shkëmbimin reciprok të artikujve postarë, duke përfshirë edhe lirinë e tranzitit, dhe trajtimin e dërgesave postare në tranzit nga vende të tjera njëloj me artikujt e tyre postar, pa diskriminim, në bazë të kushteve të specifikuara në aktet e Bashkimit.

1.4 “Liria e tranzitit” detyrimi i një vendi anëtar të ndërmjetëm për të siguruar transportin e dërgesave postare për të kaluar tranzit në të, drejtuar në një tjetër vend anëtar⁶, duke siguruar trajtim të ngjashëm me atë të dhënë për dërgesat e brendshme, në bazë të kushteve të specifikuara në aktet e Bashkimit.

1.5 “Artikull i letrave postare” artikujt e përshkruar në Konventë.

1.6 (Fshirë)⁷.

1.6.bis “Objekt postar” termi i përgjithshëm që i referohet çdo sendi/artikulli të dërguar nga

operatori i caktuar i një shteti anëtar (letër, kolipostë, urdhërpagesë etj.) siç përshkruhet në Konventën e Përbotshme Postare, Marrëveshjen e Shërbimeve të Pagesave Postare dhe Rregulloret e tyre përkatëse⁸.

1.7 “Operator i caktuar” çdo ent shtetëror ose jo, i caktuar zyrtarisht nga shteti anëtar për të kryer shërbimet postare dhe për të përmbushur detyrimet përkatëse që rrjedhin nga aktet e Bashkimit në territorin e tij⁹.

1.8 “Rezervimi” një klauzolë përjashtimi ku një vend anëtar pretendon të përjashtojë ose të modifikojë efektin ligjor të një klauzole të një akti, të ndryshëm nga Kushtetuta dhe rregulloret e përgjithshme, në zbatimin e tij në atë vend anëtar. Çdo rezervim do të jetë në përputhje me objektin dhe qëllimin e Bashkimit, siç përcaktohet në parathënie dhe në nenin 1 të Kushtetutës. Ajo duhet të justifikohet në mënyrë të rregullt dhe të miratohet nga shumica e kërkuar për miratimin e aktit në fjalë, dhe të futet në Protokollin Përfundimtar të tij.

Neni 2 Anëtarët e Bashkimit

1. Do të jenë shtete anëtare të Bashkimit:

1.1 shtetet që kanë statusin e anëtarit në datën kur hyn në fuqi Kushtetuta;

1.2 shtetet e pranuar në përputhje me nenin 11.

Neni 3 Juridiksioni i Bashkimit

1. Bashkimi do të ketë në juridiksionin e tij:

1.1 territoret e shteteve anëtare;

1.2 zyrat e postës të krijuara nga shtetet anëtare në territoret që nuk bëjnë pjesë në Bashkim;

1.3 territoret që nuk janë anëtare të Bashkimit, por përfshihen në të, pasi nga pikëpamja postare ato varen nga shtetet anëtare.

Neni 4 Marrëdhënie të jashtëzakonshme

1. Shtetet anëtare, operatorët e caktuar të të cilave ofrojnë një shërbim me territore që nuk

⁴ Amenduar nga Kongresi i Stambollit, 2016.

⁵ Realizuar në Kongresin e Bukureshtit, 2004.

⁶ Amenduar nga Kongresi i 24-t, 2008.

⁷ Nga Kongresi i Stambollit, 2016.

⁸ Realizuar në Kongresin e Stambollit, 2016.

⁹ Amenduar në Kongresin e 24-t, 2008.



përfshihen në Bashkim, janë të detyruara të veprojnë si ndërmjetës për shtetet e tjera anëtare. Dispozitat e Konventës dhe rregulloret e saj do të jenë të zbatueshme për marrëdhënie të tilla të jashtëzakonshme.

Neni 5

Selia e Bashkimit

1. Selia e Bashkimit dhe e organeve të përhershme të tij është caktuar në Bernë.

Neni 6

Gjuha zyrtare e Bashkimit

1. Gjuha zyrtare e Bashkimit është gjuha franceze.

Neni 7¹⁰

Njësia monetare

1. Njësia monetare e përdorur në aktet e Bashkimit do të jetë njësia e kontabilitetit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Neni 8

Sindikata të kufizuara. Marrëveshje të posaçme

1. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar, nëse i lejohet legjislacioni i atyre shteteve anëtare¹¹, mund të themelojnë sindikata të kufizuara dhe të bëjnë marrëveshje të veçanta në lidhje me shërbimin postar ndërkombëtar, gjithmonë me kusht që ata nuk do të kenë dispozita më pak të favorshme për publikun se ato të parashikuara nga aktet në të cilat shtetet anëtare në fjalë janë palë.

2. Sindikatat e kufizuara mund të dërgojë vëzhgues në Kongrese, në Këshillin Administrativ, në Këshillin e Operacioneve Postare dhe në konferenca dhe takime të organizuara nga Bashkimi¹².

3. Bashkimi mund të dërgojë vëzhgues në Kongreset, konferencat dhe mbledhjet e sindikatave të kufizuara.

¹⁰ Amenduar nga Kongresi i Uashingtonit, 1989.

¹¹ Amenduar nga Kongresi i 24-t – 2008.

¹² Amenduar nga kongreset e Tokios në 1969 dhe Seulit në 1994.

Neni 9

Marrëdhëniet me Kombet e Bashkuara

1. Marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit dhe Kombeve të Bashkuara do të disiplinojnë nga marrëveshjet, tekstet e të cilave i bashkëlidhen Kushtetutës.

Neni 10

Marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare

1. Me qëllim sigurimin e bashkëpunimit të ngushtë në fushën postare ndërkombëtare, Bashkimi mund të bashkëpunojë me organizata ndërkombëtare që kanë interesa dhe veprimtari të lidhura me të.

KAPITULLI II

ANËTARËSIMI OSE PRANIMI NË BASHKIM. TËRHEQJA NGA BASHKIMI

Neni 11¹³

Anëtarësimi ose pranimi në Bashkim. Procedura

1. Çdo shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të aderojë në Bashkim.

2. Çdo shtet sovran i cili nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të aplikojë për pranim si një shtet anëtar i Bashkimit.

3. Aderimi ose kërkesa për pranim në Bashkimin duhet të përfshijë një deklaratë formale të pranimit të Kushtetutës dhe të akteve të detyrueshme të Bashkimit. Ajo do të dërgohet nga qeveria e vendit të interesuar tek drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare, i cili do të njoftojë pranimin ose do të konsultohet me shtetet anëtare në lidhje me aplikimin për pranim, sipas rastit.

4. Një vend i cili nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara do të konsiderohet të pranohet si një vend anëtar nëse kërkesa e tij është miratuar nga të paktën dy të tretat e shteteve anëtare të Bashkimit. Shtetet anëtare të cilat nuk i janë përgjigjur brenda një periudhe kohe prej katër muajsh të llogaritur

¹³ Amenduar nga Kongreset e Tokios 1969 dhe Uashingtonit 1989.



nga data e konsultimeve¹⁴ do të konsiderohet se ka abstenuar.

5. Aderimi ose pranimi në anëtarësim do t'i njoftohet qeverive të shteteve anëtare nga drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare. Ai do të ketë efekt nga data e këtij njoftimi.

Neni 12¹⁵

Tërheqja nga Bashkimi. Procedura

1. Çdo shtet anëtar mund të tërhiqet nga Bashkimi me anë të një njoftimi të denoncimit për Kushtetutë, të dhënë nga qeveria e shtetit të interesuar për drejtorin e përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare dhe nëpërmjet tij, qeverive të shteteve anëtare.

2. Tërheqja nga Bashkimi do të bëhet efektive një vit pas ditës në të cilën njoftimi i denoncimit të dhënë në paragrafin 1 është marrë nga drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare.

KAPITULLI III ORGANIZIMI I BASHKIMIT

Neni 13¹⁶

Organet e Bashkimit

1. Organet e Bashkimit janë Kongresi, Këshilli Drejtues, Këshilli i Operacioneve Postare dhe Byroja Ndërkombëtare.

2. Organet e përhershme të Bashkimit janë Këshilli Drejtues, Këshilli i Operacioneve Postare, dhe Byroja Ndërkombëtare.

Neni 14

Kongresi

1. Kongresi është organi më i lartë i Bashkimit.

2. Kongresi përbëhet nga përfaqësues të shteteve anëtare.

Neni 15

Kongrese të jashtëzakonshme

1. Një Kongres i jashtëzakonshëm mund të mbledhet me kërkesë ose me miratimin e dy të tretave të shteteve anëtare të Bashkimit.

Neni 16

Konferencat administrative

(I fshirë)¹⁷.

Neni 17¹⁸

Këshilli drejtues

1. Ndërmjet dy Kongreseve, Këshilli Drejtues (CA) siguron vazhdimësinë e punëve të Bashkimit, në përputhje me dispozitat e akteve të Bashkimit.

2. Anëtarët e Këshillit Drejtues ushtrojnë funksionet e tyre në emër dhe në interesin e Bashkimit.

Neni 18¹⁹

Këshilli i Operacioneve Postare

1. Këshilli i Operacioneve Postare (POC) do të jetë përgjegjës për çështjet operacionale, tregtare, teknike dhe ekonomike që kanë të bëjnë me shërbimin postar.

2. Anëtarët e Këshillit të Operacioneve Postare i kryejnë funksionet e tyre në emër dhe në interes të Bashkimit të Përbotshëm Postar.

Neni 19

Komitetet speciale

(I fshirë)¹⁷.

Neni 20²⁰

Byroja Ndërkombëtare

1. Një zyrë qendrore, që funksionon në selinë e Bashkimit me emrin Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit të Përbotshëm Postar, e drejtuar nga një

¹⁷ Nga Kongresi i Hamburgut më 1984-ën.

¹⁸ Amenduar nga Kongresi i Seulit më 1994-ën.

¹⁹ Amenduar nga Kongreset e Tokios më 1969-ën dhe të Seulit më 1994-ën.

²⁰ Amenduar nga Kongreset e Hamburgut më 1984-ën dhe Seulit më 1994-ën.

¹⁴ Amenduar nga Kongresi i 24-t – 2008.

¹⁵ Amenduar nga Kongresi i Uashingtonit në 1989.

¹⁶ Amenduar nga Kongreset e Tokios 1969, Hamburgut 1994 dhe Seulit 1994.



drejtor i përgjithshëm dhe nën kontrollin e Këshillit Drejtues, do të shërbejë si organ ekzekutiv, mbështetës, ndërlidhës, informimi dhe konsultimi.

KAPITULLI IV FINANCAT E BASHKIMIT

Neni 21²¹

Shpenzimet e Bashkimit. Kontributet e shteteve anëtare

1. Çdo Kongres cakton shumën maksimale të shpenzimeve të cilën:

1.1 mund të arrijnë çdo vit shpenzimet e Bashkimit;

1.2 mund të arrijnë shpenzimet në lidhje me mbledhjen e Kongresit të ardhshëm.

2. Shuma maksimale për t'u shpenzuar, e parashikuar në pikën 1, mund të tejkalohet, nëse kërkohet nga rrethanat, me kushtin që të respektohen dispozitat përkatëse në lidhje me rregulloren e përgjithshme.

3. Shpenzimet e Bashkimit, duke përfshirë eventalisht shpenzimet e parashikuara në pikën 2, do të mbështeten bashkërisht nga shtetet anëtare të Bashkimit. Me këtë rast, çdo shtet anëtar zgjedh klasën e kontributit në të cilën ai do të përfshihet. Klasat e kontributit janë të caktuara në rregulloren e përgjithshme.

4. Në rast të aderimit ose pranimit në Bashkim, sipas nenit 11, shteti i interesuar do të zgjedhë lirisht klasën e kontributit në të cilën ai dëshiron të vendoset për shpërndarjen e shpenzimeve të Bashkimit.

SEKSIONI II AKTET E BASHKIMIT

KAPITULLI I TË PËRGJITHSHME

Neni 22

Aktet e Bashkimit

1. Kushtetuta do të jetë akti themelor i Bashkimit. Ajo do të përmbajë rregullat organike të

Bashkimit dhe nuk do të jetë subjekt i rezervave²².

2. Rregulloret e përgjithshme do të shprehin dispozitat të cilat sigurojnë zbatimin e Kushtetutës dhe punën e Bashkimit. Ato do të jenë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare dhe nuk do të jenë subjekt i rezervave²¹.

3. Konventa e Përbotshme Postare dhe rregulloret e saj²³ do të shprehin rregullat e zbatueshme në të gjithë shërbimin ndërkombëtar postar dhe dispozitat në lidhje me shërbimet e postës së letrave dhe kolipostës. Këto akte do të jenë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare²⁴. Shtetet anëtare duhet të sigurohen se operatorët e tyre të caktuar do të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga Konventa dhe rregulloret e saj²⁵.

4. Marrëveshjet e Bashkimit dhe rregulloret e tyre do të disiplinojnë shërbimet e ndryshme nga ato të postës së letrave dhe kolipostës ndërmjet shteteve anëtare, të cilat janë palë në to. Ato do të jenë të detyrueshme vetëm për këto shtete anëtare. Shtetet nënshkruese anëtare duhet të sigurohen se operatorët e tyre të caktuar do të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet dhe rregulloret e tyre²⁵.

5. Rregulloret, të cilat do të përmbajnë rregullat e aplikimit, të nevojshme për zbatimin e Konventës dhe të marrëveshjeve, do të hartohen nga Këshilli i Operacioneve Postare duke pasur parasysh vendimet e marra nga Kongresi²⁶.

6. Protokollet përfundimtare të bashkëlidhura me aktet e Bashkimit referuar në paragrafët 3, 4 dhe 5, do të përmbajnë rezervimet në lidhje me këto akte.

Neni 23²⁷

Zbatimi i akteve të Bashkimit në territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjës një shtet anëtar

1. Çdo shtet mund të deklarojë në çdo moment që pranimi i akteve të Bashkimit nga ai do të përfshijë të gjitha territoret, për marrëdhëniet

²² Amenduar nga Kongresi i Bukureshtit më 2004-ën.

²³ Amenduar nga Kongresi i Stambollit, 2016.

²⁴ Amenduar nga Kongresi i Pekinit, 1999.

²⁵ Amenduar nga Kongresi i 24-t, 2008.

²⁶ Amenduar nga Kongreset e Uashingtonit më 1989-ën, Seulit më 1994-ën dhe Pekinit më 1999-ën.

²⁷ Amenduar nga Kongresi i Uashingtonit, 1989.

²¹ Amenduar nga Kongreset e Tokios më 1969-ën, Lozanës më 1974-ën dhe Uashingtonit më 1989-ën.



ndërkombëtare të të cilëve ose disa prej tyre është përgjegjës.

2. Deklarata e parashikuar në paragrafin 1, duhet t'i drejtohet drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare.

3. Çdo shtet anëtar mund t'i drejtojë në çdo kohë drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare një njoftim për të kundërshtuar zbatimin e akteve të Bashkimit, për të cilat ai ka bërë deklaratën e parashikuar në paragrafin 1. Ky njoftim do të fillojë efektet e saj, një vit pas datës së marrjes së tij nga drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare.

4. Deklaratat dhe njoftimet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 3, do t'i komunikohen shteteve anëtare nga drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare.

5. Paragrafët 1 deri në 4, nuk do të zbatohen në territoret që kanë cilësinë e anëtarit të Bashkimit dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës një shtet anëtar.

Neni 24

Legjislacioni kombëtar

1. Dispozitat e akteve të Bashkimit nuk do të devijojnë nga legjislacioni i secilit prej shteteve anëtare në lidhje me çka nuk është parashikuar në këto akte.

KAPITULLI II

PRANIMI DHE DENONCIMI I AKTEVE TË BASHKIMIT

Neni 25²⁸

Nënshkrimi, autentikimi, ratifikimi dhe forma të tjera të miratimit të akteve të Bashkimit

1. Aktet e Bashkimit që rrjedhin nga Kongresi duhet të nënshkruhen nga të plotfuqishmit e shteteve anëtare.

2. Rregulloret duhet të autentikohen nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Operacioneve Postare²⁹.

3. Kushtetuta do të ratifikohet sa më shpejt të jetë e mundur nga shtetet nënshkruese.

4. Miratimi i akteve të Bashkimit të ndryshme nga Kushtetuta do të disiplinohej nga rregullat kushtetuese të secilit prej shteteve nënshkruese.

5. Kur një shtet anëtar³⁰ nuk ratifikon Kushtetutën ose nuk i miraton aktet e tjera të cilat i ka nënshkruar, Kushtetuta dhe aktet tjera, do të jenë njëllë të vlefshme për shtetet e tjera anëtare³⁰ që i kanë ratifikuar ose miratuar ato.

Neni 26³¹

Njoftimi i ratifikimeve dhe metodat e tjera të miratimit të akteve të Bashkimit

1. Instrumentet e ratifikimit të Kushtetutës dhe të protokolleve shtesë të saj dhe, kur është rasti, të miratimit të akteve të tjera të Bashkimit do të depozitohen në afatin më të shkurtër pranë drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare, e cila do të njoftojë qeveritë e shteteve anëtare për këto depozitime.

Neni 27

Aderimi në marrëveshje

1. Shtetet anëtare mund të aderojnë në çdo kohë në një ose në disa marrëveshje të parashikuara në nenin 22.4.

2. Aderimi i shteteve anëtare në marrëveshje do të njoftohet në përputhje me nenin 11.3.

Neni 28

Denoncimi i një marrëveshje

1. Çdo shtet anëtar mund të vendosë për të pushuar pjesëmarrjen në një ose disa marrëveshje, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 12.

KAPITULLI III

AMENDIMET E AKTEVE TË BASHKIMIT

Neni 29

Paraqitja e propozimeve

1. Një³² shtet anëtar ka të drejtë të paraqesë, në

³⁰ Amenduar nga Kongresi i 24-t – 2008.

³¹ Amenduar nga Kongreset e Tokios më 1969-ën dhe Uashingtonit më 1989-ën.

³² Amenduar nga Kongresi i Tokios më 1969-ën dhe Kongresi i Uashingtonit më 1989-ën.

²⁸ Amenduar nga Kongreset e Uashingtonit më 1989-ën dhe Seulit më 1994-ën.

²⁹ Amenduar nga Kongresi i Pekinit më 1999-ën.



Kongres ose midis Kongreseve, propozime në lidhje me aktet e Bashkimit në të cilin ai është palë.

2. Megjithatë, propozimet në lidhje me Kushtetutën dhe rregulloret e përgjithshme mund të paraqiten vetëm në Kongres.

3. Për më tepër, propozimet në lidhje me rregulloret duhet të paraqiten drejtpërsëdrejti në Këshillin e Operacioneve Postare, por së pari duhet të transmetohen nga Byroja Ndërkombëtare për të gjitha shtetet anëtare dhe të gjithë operatorët e caktuar^{32,33}.

Neni 30

Amendimi i Kushtetutës

1. Për miratimin e propozimeve të paraqitura në Kongres dhe që kanë të bëjnë me këtë Kushtetutë, është i nevojshëm miratimi nga dy të tretat e shteteve anëtare të Bashkimit, që kanë të drejtën e votës³⁴.

2. Amendimet e miratuara nga një Kongres do të jenë subjekt i një protokolli shtesë dhe, me përjashtim të rastit kur është vendosur ndryshe nga Kongresi, do të hyjnë në fuqi në të njëjtën kohë me aktet e përditësuara gjatë të njëjtit Kongres. Ato do të ratifikohen sa më shpejt të jetë e mundur nga shtetet anëtare dhe instrumentet e këtij ratifikimi do të trajtohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 26.

Neni 31³⁵

Amendimi i rregullores së përgjithshme, Konventës dhe rregulloreve

1. Rregullorja e përgjithshme, konventa dhe rregulloret do të përcaktojnë kushtet që duhet të përmbushen për miratimin e propozimeve në lidhje me to.

2. Konventa dhe marrëveshjet e referuara në paragrafin 1 do të hyjnë në fuqi njëkohësisht dhe do të kenë të njëjtën kohëzgjatje. Që nga dita e vendosur nga Kongresi për hyrjen në fuqi të këtyre akteve, aktet përkatëse të kongresit të mëparshëm do të abrogohen³⁶.

³³ Amenduar nga Kongresi i Pekinit më 1999-ën dhe nga Kongresi i 24-t, 2008.

³⁴ Amenduar nga Kongresi i Bukureshtit më 2004-ën.

³⁵ Amenduar nga Kongresi i Hamburgut më 1984-ën.

³⁶ Amenduar nga Kongresi i Bukureshtit më 2004-ën.

KAPITULLI IV ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 32

Arbitrazhi

1. Në rast të një mosmarrëveshje midis dy ose më shumë shteteve anëtare³⁷, në lidhje me interpretimin e akteve të Bashkimit ose përgjegjësitë e vendosura mbi shtetin anëtar nga zbatimi i këtyre akteve, çështja në fjalë do të zgjidhet me arbitrazh.

SEKSIONI III

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 33

Hyryrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Kushtetutës

1. Kjo Kushtetutë do të hyjë në fuqi duke filluar nga data 1 janar 1996 dhe do të jetë në fuqi për një kohë të papërcaktuar.

Në dëshmi të sa më sipër, të plotfuqishmit e qeverive të shteteve anëtare kanë nënshkruar këtë Kushtetutë, në një kopje të vetme origjinale, e cila do të depozitohet në arkivat e qeverisë së shtetit në të cilin është vendosur selia e Bashkimit. Një kopje e tij do t'i dërgohet secilës palë nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit të Përbotshëm Postar³⁷.

Realizuar në Vjenë, 10 korrik 1964.

KONVENTA E PËRLOTSHME POSTARE

Pasqyra e lëndës

Seksioni I: Rregulla të përbashkëta, të aplikueshme për shërbimin postar ndërkombëtar

Neni

1. Përkufizime

2. Përcaktimi i njësive ose i njësive përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga aderimi në këtë Konventë

3. Shërbimi postar universal

4. Liria e tranzitit

5. Pronësia e artikujve postarë. Tërheqja nga posta. Ndryshimi ose korrigjimi i adresës dhe/ose emri i marrësit (emri i personit juridik, ose emri i familjes, emri i dhënë ose patronimi (nëse ka)).

³⁷ Amenduar nga Kongresi i 24-t – 2008.



Riadresimi. Kthimi te dërguesi i artikujve të pashpërndarë

6. Pulla postare

7. Zhvillimi i qëndrueshëm

8. Siguria postare

9. Shkeljet

10. Përpunimi i të dhënave personale

11. Shkëmbimi i postës së mbyllur me njësitë ushtarake

12. Postimi jashtë vendit i objekteve të postës së letrave

13. Përdorimi i formave të UPU-së

Seksioni II: Cilësia e standardeve të shërbimit dhe objektivat

14. Cilësia e standardeve të shërbimit dhe objektivat

Seksioni III: Tarif, tarifat shtesë dhe përjashtimi nga tarifat postare

15. Tarif

16. Përjashtimet nga tarifat postare

Seksioni IV: Shërbimet bazë dhe plotësuese

17. Shërbimet bazë

18. Shërbimet plotësuese

Seksioni V: Ndalimet dhe çështjet doganore

19. Objektet që nuk pranohen. Ndalimet

20. Kontrolli doganor. Tarifat doganore dhe tarifa të tjera

Seksioni VI: Detyrimet

21. Kërkesat

22. Detyrimet e operatorëve të caktuar. Dëmshpërblimet

23. Mospërgjegjësia e shteteve anëtare dhe operatorëve të caktuar

24. Detyrimi i dërguesit

25. Pagesa e dëmshpërblimit

26. Shlyerja e mundshme e dëmshpërblimit nga dërguesi ose i adresuari

Seksioni VII: Pagesat

A. Tarif e tranzitit

27. Tarif e tranzitit

B. Detyrimet përfundimtare

28. Detyrimet përfundimtare. Dispozita të përgjithshme

29. Detyrimet përfundimtare. Dispozitat e zbatueshme për flukset e postës ndërmjet operatorëve të caktuar të vendeve në sistemin e synuar

30. Detyrime përfundimtare. Dispozita të zbatueshme për fluksin e letrave drejt, nga dhe midis operatorëve të caktuar të sistemit tranzit

31. Fondi i cilësisë së shërbimit

C. Tarifat për kolipostën

32. Tarifat për postës tokësore dhe detare

D. Tarifat e transportit ajror

33. Tarifat bazë dhe dispozitat lidhur me tarifat e transportit ajror

E. Shlyerja e detyrimeve

34. Dispozitat specifike për shlyerjen e llogarive dhe pagesat për shkëmbimet postare ndërkombëtare

F. Rregullimi i normës së tarifave

35. Autoriteti i Këshillit të Operacioneve Postare për të përcaktuar tarifat dhe çmimet

Seksioni VIII: Shërbimet operacionale

36. EMS-ja dhe logjistika e integruar

37. Shërbimet postare elektronike

Seksioni IX: Dispozita përfundimtare

38. Kushtet e miratimit të propozimeve në lidhje me Konventën dhe rregulloret

39. Rezervime në Kongres

40. Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Konventës

KONVENTA E PËRBOSSHME POSTARE

Ne nënshkruesit, të plotfuqishëm të qeverive të shteteve anëtare të Bashkimit, në bazë të nenit 22.3 të Konventës së Bashkimit të Përbotshtëm Postar të miratuar në Vjenë, më 10 korrik 1964, me një marrëveshje të përbashkët, dhe subjekt të nenit 25.4 të Kushtetutës, kemi miratuar në këtë marrëveshje rregullat e zbatueshme për të gjithë shërbimin postar ndërkombëtar.

SEKSIONI I

RREGULLAT E PËRBASHKËTA TË ZBATUESHME PËR SHËRBBIMIN POSTAR NDËRKOMBËTAR

Neni 1

Përkufizime

1. Për qëllimet e Konventës së Përbotshme Postare, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e përcaktuar më poshtë:

1.1 “Objekt i postës së letrave” objekt i përshkruar dhe i përcjellë sipas kushteve të Konventës dhe rregulloreve të përbotshme postare;

1.2 “Objekt i kolipostës” objekt i përshkruar dhe i përcjellë sipas kushteve të Konventës dhe rregulloreve të përbotshme postare;



1.3 “Objekte EMS-je” Objekt i përshkruar dhe i përcjellë sipas kushteve të Konventës dhe rregulloreve të përbotshme postare dhe instrumenteve shoqëruese të EMS-së;

1.4 “Dokumentet” një letër postare, kolipostë ose objekt EMS-je që përmban informacion të shkruar, të pikturuar, të printuar ose digjital, duke përjashtuar mallrat, specifikimet fizike të të cilave përfshihen brenda përcaktimeve të rregulloreve;

1.5 “Mallra” një letër postare, kolipostë ose objekt EMS-je që përbëhet nga çdo send tjetër i prekshëm dhe i luajtshëm, përveç parave, duke përfshirë mallrat, të cilat nuk përfshihen në përkufizimin e “dokumenteve” siç parashikohet në paragrafin 1.4 më sipër dhe specifikimet fizike të të cilëve përfshihen brenda përcaktimeve të rregulloreve;

1.6 “Postë e mbyllur” një ose disa çanta ose të tjera pako të etiketuara, të mbyllura me dyllë, që përmbajnë artikuj postar;

1.7 “Postë e humbur” pako të mbërritura në një zyrë shkëmbimi të ndryshme nga ajo e shënuar në etiketën në kuti;

1.8 “Të dhënat personale” informacioni i nevojshëm për të identifikuar një përdorues të shërbimit postar;

1.9 “Artikuj të dërguar gabim” artikuj të marrë në një zyrë shkëmbimi por që duhet të mbërrinin në një zyrë shkëmbimi të një shteti tjetër anëtar;

1.10 “Tarifa tranziti” pagesa për shërbimet e bëra nga një organizëm transportues i vendit nga i cili kalon (operatori i caktuar, ndonjë shërbim tjetër ose kombinim i këtyre të dyjave), për tranzit tokësor, detar dhe/ose ajror të objekteve të postës së letrave;

1.11 “Tarifa përfundimtare” pagesa që duhet t'i bëhet operatorit të caktuar të shtetit të destinacionit nga operatori i caktuar i shtetit dërgues, si kompensim për kostot e përballuara në shtetin e destinacionit për artikujt e postës së letrave të marra;

1.12 “Operator i caktuar” çdo njësi shtetërore ose jo e emëruar zyrtarisht nga shteti anëtar për të kryer shërbimet postare dhe për të përmbushur detyrimet përkatëse që rrjedhin nga aktet e Bashkimit në territorin e tij;

1.13 “Pako e vogël” artikuj të transportuar sipas kushteve të Konventës dhe të rregulloreve;

1.14 “Taksa e drejtimit tokësor” pagesa që duhet t'i paguhet operatorit të caktuar të shtetit të

destinacionit nga operatori i caktuar i shtetit dërgues, si kompensim i kostove të trajtimit të një pakoje në vendin e destinacionit;

1.15 “Taksa e tranzitit tokësor” pagesa për shërbimet e kryera nga transportuesi i shtetit nga i cili kalohet (operatori i caktuar; ndonjë shërbim tjetër ose kombinim i këtyre të dyjave), lidhur me tranzitin tokësor dhe/ose ajror të një pakoje postare në territorin e këtij shteti;

1.16 “Taksa detare” pagesa për shërbimet e kryera nga transportuesi i shtetit nga i cili kalohet (operatori i caktuar; ndonjë shërbim tjetër ose kombinim i këtyre të dyjave), që marrin pjesë në transportin e pakove;

1.17 “Kërkesë” një ankesë ose pyetje lidhur me përdorimin e një shërbimi postar të dorëzuar në përputhje me kushtet e Konventës dhe rregulloreve të saj;

1.18 “Shërbimi universal postar” ofrimi i vazhdueshëm i shërbimeve themelore postare në të gjitha pikat e territorit të një shteti anëtar, të gjitha doganat, me çmimin e përballueshëm;

1.19 “Tranzit *à découvert* (i hapur)” tranzit i hapur në një shtet ndërmjetës i artikujve, numri ose pesha e të cilëve nuk justifikon postën e mbyllur për në shtetin e destinacionit.

Neni 2

Caktimi i një ose disa njërive përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga aderimi në Konventë

1. Shtetet anëtare do të bëjnë me dije Byronë Ndërkombëtare, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e punimeve të Kongresit, emërtimin dhe adresën e organit qeveritar të ngarkuar me mbikëqyrjen e çështjeve postare. Gjithashtu, shtetet anëtare i transmetojnë Byrosë Ndërkombëtare, në 6 muajt pas mbylljes së punimeve të Kongresit, emërtimin dhe adresën e operatorit ose operatorëve të caktuar zyrtarisht për të siguruar kryerjen e shërbimeve postare, dhe që do të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga aktet e Bashkimit në territorin e tyre. Midis dy Kongreseve, shtetet anëtare duhet të njoftojnë sa më parë Byronë Ndërkombëtare për çdo ndryshim që ka të bëjë me organet qeveritare sa më shpejt të jetë e mundur. Çdo ndryshim, në lidhje me operatorët e caktuar zyrtarisht, duhet të njoftohet sa më parë të jetë e mundur te Byroja



Ndërkombëtare, mundësisht të paktën tre muaj para hyrjes në fuqi të ndryshimit.

2. Kur një shtet anëtar cakton zyrtarisht një operator të ri, ai duhet të informojë për synimin e tij fushën e shërbimeve postare që ky i fundit do të ofrojë sipas akteve të Bashkimit, si dhe mbulimin gjeografik të operatorit në territorin e tij.

Neni 3

Shërbimi postar universal

1. Me qëllim mbështetjen e konceptit të një territori të vetëm postar të Bashkimit, shtetet anëtare duhet të sigurohen që të gjithë përdoruesit/klientët do të gëzojnë të drejtën e shërbimit postar universal që përfshin një ofertë shërbimesh postare bazë, me cilësi në çdo pikë të territorit të tyre, me çmime të arsyeshme.

2. Për këtë qëllim, shtetet anëtare do të vendosin, në kuadrin e legjislacionit postar kombëtar ose me mjete të tjera, qëllimin e shërbimeve postare të ofruara, si dhe kushtet për cilësinë dhe çmimet e arsyeshme, duke pasur parasysh në të njëjtën kohë nevojat e popullsisë, si dhe kushtet kombëtare.

3. Shtetet anëtare duhet të kujdesen që shërbimet postare dhe normat e cilësisë do të respektohen nga operatorët përgjegjës për dhënien e shërbimeve postare universale.

4. Shtetet anëtare duhet të kujdesen që shërbimi postar universal të sigurohet në baza të zbatueshme duke garantuar qëndrueshmërinë e tij.

Neni 4

Liria e tranzitit

1. Parimi i lirisë së tranzitit është cituar në nenin 1 të Kushtetutës. Ai shpreh detyrimin, për çdo shtet anëtar, të sigurojë që operatorët e tij të caktuar do të dërgojnë me rrugët më të shpejta dhe mjetet më të sigurta që ata përdorin për artikujt e tyre, postën e mbyllur dhe artikujt e postës së letrave të hapura që i dërgohen nga operatorët e tjerë të caktuar. Ky parim zbatohet gjithashtu për artikujt e dërguar gabim ose postën e devijuar.

2. Shtetet anëtare që nuk bëjnë pjesë në shkëmbimin e objekteve postare që përmbajnë substanca të infektuara ose lëndë radioaktive, kanë të drejtën të mos i pranojnë këto artikuj në tranzitin e hapur në territorin e tyre. Kjo vlen edhe për

artikujt e postës së letrave të ndryshme nga letrat, kartolinat dhe objektet postare të cekogrameve (letrat dhe pakot për të verbrit). Kjo zbatohet gjithashtu për letrat e shtypura, gazetatat, revistat, pakot e vogla dhe “thasët M” përmbajtja e të cilave nuk i përmbush kërkesat ligjore që rregullojnë kushtet e publikimit ose të qarkullimit të tyre në shtetin ku ato kalojnë.

3. Liria e tranzitit për kolipostën do të garantohet në të gjithë territorin e Bashkimit.

4. Nëse një shtet anëtar nuk respekton dispozitat lidhur me lirinë e tranzitit, shtetet e tjera anëtare mund të ndërpresin ofrimin e shërbimeve postare me atë vend.

Neni 5

Pronësia e objekteve postare. Tërheqja. Ndryshimi ose korrigjimi i adresës dhe/ose emri i marrësit (emri i personit juridik ose mbiemri, emri ose patronimi (nëse ka)). Ridrejtimi. Kthimi te dërguesi i sendeve të padërguara

1. Çdo artikull postar do të mbetet në pronësi të dërguesit për aq kohë sa nuk i është dorëzuar atij që i përket, me përjashtim të rastit kur artikulli është konfiskuar në zbatim të legjislacionit kombëtar të vendit të origjinës ose të destinacionit dhe, në rast të zbatimit të neneve 19.2.1.1 ose 19.3, sipas legjislacionit kombëtar të shtetit të tranzitit.

2. Dërguesi i një objekti postar mund ta ketë tërhequr atë nga shërbimi ose të ketë ndryshuar ose korrigjuar adresën e tij dhe/ose emrin e marrësit (emri i personit juridik, ose mbiemri, emri ose patronimi (nëse ka)). Tarifat dhe kushtet e tjera janë të përcaktuara në rregullore.

3. Shtetet anëtare do të sigurojnë se operatorët e tyre të caktuar do të riadresojnë artikujt postarë, në rast se marrësi ka ndryshuar adresën e tij, dhe do të kthejnë artikujt e pashpërndarë. Tarifat dhe kushtet e tjera janë të përcaktuara në rregullore.

Neni 6

Pullat postare

1. Emërtimi “pullë postare” është i mbrojtur nga kjo Konventë dhe i rezervuar ekskluzivisht për pullat që plotësojnë kushtet e këtij neni dhe të rregulloreve.

2. Pulla postare:



2.1 do të nxirret dhe vihet në qarkullim ekskluzivisht nga një autoritet kompetent i një shteti anëtar ose territori, në përputhje me aktet e UPU-së;

2.2 është një atribut sovraniteti dhe përbën provë të parapagimit të tarifës së postës që i korrespondon vlerës së tyre të caktuar kur vendosen në artikuj postarë, në përputhje me aktet e Bashkimit;

2.3 duhet të jetë në qarkullim në territorin e shtetit anëtar ose territorit që e nxjerr, me qëllim përdorimin për parapagimin e shpenzimeve postare ose për filateli, në përputhje me legjislacionin kombëtar;

2.4 duhet të jetë e aksesueshme për të gjithë shtetasit brenda shtetit anëtar ose territorit që e emeton.

3. Pulla postare përmban:

3.1 emrin e shteteve anëtare ose të territorit emetues, me shkronja romake; ose, nëse Byrosë Ndërkombëtare të UPU-së i kërkohet nga shteti ose territori i lëshimit, shkurtësia ose inicialet që përfaqësojnë zyrtarisht vendin ose territorin e lëshimit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregulloret³⁸;

3.2 vlerën nominale, të shprehur:

3.2.1 në parim, në monedhën zyrtare të shtetit ose territorit emetues, ose si shkronjë ose simbol;

3.2.2 nëpërmjet karaktereve të tjera identifikuese.

4. Emblemat e shtetit, shenjat zyrtare të kontrollit, si dhe logot e organizatave ndërqeveritare që figurojnë në pullat e postës do të jenë të mbrojtura, në kuptimin e Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

5. Temat dhe motivet e pullave të postës duhet:

5.1 të jenë në përputhje me frymën e parathënies së Kushtetutës së UPU-së dhe vendimeve të marra nga organet e Bashkimit;

5.2 të jetë në marrëdhënie të ngushtë me identitetin kulturor të shtetit anëtar ose territorit, ose të kontribuojë në promovimin e kulturës ose të ruajtjes së paqes;

5.3 të ketë, në rast kremitimi të personaliteteve ose ngjarjeve të huaja për shtetin anëtar ose

territorin, një lidhje të ngushtë me shtetin ose territorin në fjalë;

5.4 të jetë e zhveshur nga karakteri politik ose nga çështje me natyrë fyese për një personalitet ose një shtet;

5.5 të ketë një kuptim të madh për një shtet anëtar ose territor.

6. Vulat e pagimit të shpenzimeve postare, vulat e makinave të pullave, vulat e bëra me shtyp ose të tjera procedura printimi ose shtypi në përputhje me aktet e UPU-së mund të përdoren vetëm me autorizimin e shtetit anëtar ose territorit.

7. Para emetimit të pullave postare që përdorin materiale ose teknologji të reja, shtetet anëtare duhet të informojnë Byronë Ndërkombëtare në lidhje me përputhshmërinë e tyre me makineritë e përpunimit postar. Byroja Ndërkombëtare do të informojë shtetet e tjera anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar në përputhje me rrethanat.

Neni 7

Zhvillimi i qëndrueshëm

1. Shtetet anëtare dhe/ose operatorët e tyre të caktuar do të miratojnë dhe zbatojnë një strategji proaktive të zhvillimit të qëndrueshëm duke u përqendruar te veprimi mjedisor, social dhe ekonomik në të gjitha nivelet e operacioneve postare dhe do të promovojnë ndërgjegjësimin e zhvillimit të qëndrueshëm në shërbimet postare.

Neni 8

Siguria postare

1. Shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar do të respektojnë kërkesat e sigurisë, të përcaktuara në standardet e sigurisë së UPU-së dhe do të miratojnë dhe zbatojnë një strategji sigurie në të gjitha nivelet e operacioneve postare dhe do të ruajnë dhe rrisin besimin e publikut të gjerë në shërbimet postare, ofruar nga operatorët e caktuar, në interesin e të gjithë zyrtarëve të përfshirë. Kjo strategji në veçanti do të përfshijë objektivat e përcaktuara në rregulloret, si dhe parimin e përputhjes me kërkesat për sigurimin e të dhënave paraprake elektronike për objektet postare të identifikuar në zbatim të dispozitave (duke përfshirë llojin e, dhe kriteret për, dërgesat postare) të miratuara nga Këshilli i Administrimit dhe Këshilli Operacional Postar, në përputhje me

³⁸ Përfshirë do të ketë për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, vendi i cili ka shpikur pullën postare.



standardet e mesazheve teknike të UPU-së. Një strategji e tillë do të sjellë shkëmbimin e informacioneve që kanë lidhje me ruajtjen e sigurisë së transportit dhe të tranzitit të dërgesave midis shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar.

2. Çdo masë sigurie e zbatuar në zinxhirin postar ndërkombëtar të transportit duhet të jetë në raport me rreziqet apo kërcënimet që ata kërkojnë të trajtojnë, dhe duhet të zbatohen pa penguar flukset postare në të gjithë botën, ose të tregtisë, duke marrë në konsideratë specifikat e rrjetit të postës. Masat e sigurisë që kanë një ndikim potencial global mbi operacionet postare duhet të zbatohen në nivel ndërkombëtar të koordinuar dhe të balancuar, me përfshirjen e palëve të interesuara.

Neni 9 Shkeljet

1. Artikujt postarë

1.1 Shtetet anëtare do të angazhohen të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar, ndjekur dhe ndëshkuar autorët e gjetur fajtorë për veprimet e mëposhtme:

1.1.1 futja në dërgesat postare e drogave, substancave psikotrope, si dhe mallra të rrezikshme kur futja e tyre nuk autorizohet shprehimisht nga Konventa dhe rregulloret;

1.1.2 futja në dërgesat postare e objekteve me karakter pedofilie ose pornografike që reklamojnë fëmijë.

2. Mjete të parapagimit postar dhe vetë pagesën postare

2.1 Shtetet anëtare angazhohen për të marrë të gjithë masat e nevojshme për të parandaluar, ndjekur dhe ndëshkuar çdo shkelje që ka të bëjë me mjetet e parapagimeve postare të parashikuara nga kjo Konventë, të tilla si:

2.1.1 pullat e postës, në qarkullim ose të tërhequra nga qarkullimi;

2.1.2 vulat e parapagimit;

2.1.3 vulat e makinerive të pullave ose të shtypit;

2.1.4 kuponë të përgjigjes ndërkombëtare.

2.2 Në këtë Konventë, një shkelje që ka të bëjë me mjetet e parapagesës së shpenzimeve postare i referohet secilit nga aktet e mëposhtme, të kryera nga çdo person, me qëllimin e përfitimit për vete ose për palë të tretë. Aktet vijuese do të dënohen:

2.2.1 çdo akt falsifikimi, imitimi ose ndryshimi i mjeteve të parapagesës postare, ose çdo veprim i paligjshëm ose i dënueshëm, i lidhur me prodhimin e paautorizuar të këtyre artikujve;

2.2.2 prodhimi, përdorimi, hedhja në qarkullim, tregtimi, shpërndarja, transporti, paraqitja ose ekspozimi (gjithashtu në formën e katalogëve dhe për qëllime reklamimi) të çdo mjeti parapagimi, të cilat janë të falsifikuara, imituara, ose të ndryshuara;

2.2.3 çdo akt përdorimi ose hedhje në qarkullim me qëllime postare të mjeteve të parapagesës të cilat kanë qenë të përdorura më parë;

2.2.4 çdo tentativë që ka për qëllim kryerjen e një nga shkeljet e lartpërmendura.

3. Reciprociteti

3.1 Për sa i përket sanksioneve, nuk do të bëhet asnjë dallim midis akteve të parashikuara nga pika 2, qoftë për mjetet e parapagesës postare kombëtare ose të huaja; kjo dispozitë nuk do t'i nënshtrohet asnjë kushti ligjor ose konvencional të reciprocitetit.

Neni 10

Përpunimi i të dhënave personale

1. Të dhënat personale të përdoruesve mund të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë mbledhur, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm kombëtar.

2. Të dhënat personale të përdoruesve mund të aksesohen prej palëve të treta vetëm nëse janë të autorizuar nga legjislacioni kombëtar në fuqi.

3. Shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar do të garantojnë fshehtësinë dhe sigurinë e të dhënave personale për përdoruesit, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

4. Operatorët e caktuar do të informojnë konsumatorët e tyre për përdorimin që u është bërë të dhënave të tyre personale, dhe për qëllimin për të cilin janë mbledhur.

5. Pa cenuar masat e mësipërme, operatorët e caktuar mund të transferojnë të dhëna personale elektronike për operatorët e caktuar të vendeve të destinacionit ose të tranzitit që kanë nevojë për këto të dhëna, për të përmbushur shërbimin.



Neni 11

Shkëmbimi i dërgesave të mbyllura, me njësitë ushtarake

1. Dërgesat e mbyllura mund të shkëmbehen me ndërmjetësinë e shërbimeve territoriale, detare, ajrore të shteteve të tjera:

1.1 ndërmjet zyrave të postës të çdonjërit prej shteteve anëtare dhe të oficerëve të komandës së njërive ushtarake në dispozicion të Organizatës së Kombeve të Bashkuara;

1.2 ndërmjet oficerëve të komandës së njërive ushtarake;

1.3 ndërmjet zyrave të postës të çdonjërit prej shteteve anëtare dhe oficerëve të komandës së njërive detare, ajrore ose tokësore, anijeve të luftës ose avionëve të të njëjtut shtet, të vendosura në vend të huaj;

1.4 ndërmjet oficerëve të komandës të njërive detare, ajrore ose tokësore, anijeve të luftës ose avionëve ushtarakë të të njëjtut shtet.

2. Artikujt e postës së letrave të përfshira në dërgesat e referuara në pikën 1, do të kufizohen në artikuj të adresuar ose dërguar anëtarëve të njërive ushtarake ose oficerëve dhe ekuipazhit të anijeve ose të avionëve, për ose nga të cilët janë dërguar artikujt. Kushtet dhe tarifat e dërgimit të aplikueshme për to do të vendosen nga operatori i caktuar i shtetit anëtar që ka vënë në dispozicion njësinë ushtarake ose të cilit i përket anijet apo avionët, në përputhje me rregulloret e tij.

3. Me përjashtim të rastit kur ka një marrëveshje, operatori i caktuar i shtetit anëtar që ka vënë në dispozicion njësinë ushtarake ose të cilit i përket anijet e luftës ose avionët ushtarakë, do të jetë përgjegjës kundrejt operatorëve të caktuar të interesuar për shpenzimet e tranzitit, shpenzimet përfundimtare dhe shpenzimet e transportit ajror të dërgesave.

Neni 12

Postimi i artikujve të postës së letrave jashtë shtetit

1. Asnjë operator i caktuar nuk është i detyruar të dërgojë ose shpërndajë për marrësit artikujt e postës së letrave që dërguesit që jetojnë në territorin e shtetit të tij anëtar postojnë ose shkaktajnë postimin në një shtet të huaj, me qëllim

përfitimin e kushteve më të favorshme të tarifave që zbatohen atje.

2. Dispozitat e parashikuara në pikën 1, do të zbatohen pa dallim, si për artikujt e postës së letrave të përgatitura në shtetin e rezidencës së dërguesit dhe të transportuara pastaj nëpërmjet kufijve, edhe për artikujt e postës së letrave të përgatitura në një shtet të huaj.

3. Operatori i caktuar i destinacionit mund të pretendojë, nga operatori i caktuar dërgues, pagesën e çmimeve të brendshme. Nëse operatori i caktuar dërgues nuk pranon të paguajë këto tarifa brenda afatit të caktuar nga operatori i caktuar i destinacionit, ky i fundit mund t'i kthejë artikujt tek operatori i caktuar dërgues dhe do të ketë të drejtën për t'u rimbursuar për kostot e riadresimit, ose t'i trajtojë ato në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar.

4. Një operator i caktuar nuk do të jetë i detyruar të dërgojë ose shpërndajë tek marrësi, artikujt e postës së letrave që dërguesit kanë postuar ose për të cilat kanë shkaktuar postimin në një sasi të madhe në një shtet të ndryshëm nga ai ku jetojnë, nëse shumica e shpenzimeve përfundimtare për t'u marrë është më e vogël se shumica që do të kishte marrë nëse dërgesa do të ishte postuar në shtetin ku jeton dërguesi. Operatori i caktuar i destinacionit do të ketë të drejtën të kërkojë nga operatori i caktuar i origjinës pagesa në përputhje me shpenzimet e shkaktuara dhe të cilat nuk mund të kalojnë më të lartën prej dy shumave të mëposhtme: 80% e tarifës së brendshme të aplikueshme për artikujt të ngjashëm, ose tarifat e zbatueshme sipas neneve 29.5 deri në 29.11, 29.12 deri në 29.15, ose 30.9, sipas rastit. Nëse operatori i caktuar i origjinës nuk pranon të paguajë shumën e reklamuar brenda afatit të përcaktuar nga operatori i caktuar i destinacionit, operatori i caktuar i destinacionit mund t'i kthejë artikujt tek operatori i caktuar i origjinës, duke pasur të drejtën të rimbursohet për shpenzimet e riadresimit, ose t'i trajtojë ata në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar.

Neni 13

Përdorimi i formularëve të UPU-së

1. Përveç nëse parashihet ndryshe nga aktet e Bashkimit, vetëm operatorët e caktuar do të përdorin formularët dhe dokumentacionin e UPU-



së për funksionimin e shërbimeve postare dhe shkëmbimin e artikujve postarë në përputhje me aktet e Bashkimit.

2. Operatorët e caktuar mund të përdorin formularët dhe dokumentacionin e UPU-së për funksionimin e zyrove ekstraterritoriale të shkëmbimit (ETOE), si dhe qendrat ndërkombëtare të përpunimit të postës (IMPCs) të krijuara nga operatorët e caktuar jashtë territorit të tyre përkatës kombëtar, siç përcaktohet më tej në paragrafin 6, për të lehtësuar funksionimin e shërbimeve të lartpërmendura postare dhe shkëmbimin e objekteve postare.

3. Ushtrimi i mundësisë së përshkruar në paragrafin 2 do t'i nënshtrohet legjislacionit ose politikës kombëtare të shtetit ose territorit anëtar në të cilin është themeluar ETOE ose IMPC. Në këtë drejtim dhe pa cenuar detyrimet e përcaktuara në nenin 2, operatorët e caktuar do të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të detyrimeve të tyre sipas Konventës dhe do të jenë plotësisht përgjegjës për të gjitha marrëdhëniet e tyre me operatorët e tjerë të caktuar dhe me Byronë Ndërkombëtare.

4. Kërkesa e përcaktuar në paragrafin 3 do të zbatohet në mënyrë të barabartë për shtetin anëtar të destinacionit për pranimin e artikujve postarë nga ETOE-të dhe IMPC-të.

5. Shtetet anëtare do të informojnë Byronë Ndërkombëtare për politikën e tyre në lidhje me objektet postare të transmetuara ose të marra nga ETOE-të ose IMPC-të. Ky informacion do të vihet në dispozicion në faqen e internetit të Bashkimit.

6. Në mënyrë rigoroze për qëllimet e këtij neni, ETOE-të do të përcaktohen si zyra ose ambiente të krijuara për qëllime tregtare dhe të operuara nga operatorët e caktuar ose nën përgjegjësinë e operatorëve të caktuar në territorin e një shteti anëtar ose territor tjetër të ndryshëm nga i tyri, me qëllim tërheqjen e biznesit në tregjet jashtë territorit të tyre kombëtar përkatës. IMPC-të do të përcaktohen si ambiente ndërkombëtare për përpunimin e postës ndërkombëtare të shkëmbyer ose me qëllim të gjenerimit ose marrjes së dërgimeve me postë, ose me qëllim veprimin si qendra tranziti për postat ndërkombëtare të shkëmbyera midis operatorëve të tjerë të caktuar.

7. Asgjë në këtë nen nuk do të interpretohet për të nënkuptuar se ETOE-të ose IMPC-të (përfshirë

operatorët e caktuar përgjegjës për krijimin dhe funksionimin e tyre jashtë territorit të tyre kombëtar përkatës) janë në të njëjtën situatë, sipas akteve të Bashkimit, si operatorët e caktuar të vendit pritës, dhe as të vendosë një detyrim ligjor për shtetet e tjera anëtare për të njohur ETOE-në ose IMPC-në si operatorë të caktuar në territorin ku janë themeluar dhe po operojnë.

SEKSIONI II CILËSIA E SHËRBIMIT, STANDARDET DHE OBJEKTIVAT

Neni 14

Cilësia e shërbimit, standardet dhe objektivat

1. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar duhet të përcaktojnë dhe të publikojnë standardet dhe objektivat e tyre në lidhje me shpërndarjen e artikujve të postës së letrave dhe kolitë postare që mbërrijnë.

2. Këto standarde dhe objektiva, të rritura nga koha normale e nevojshme për procedurat e zhdoganimit, nuk duhet të jenë më pak të favorshme se ato të aplikuara për artikujt e krahasueshëm në shërbimin e tyre të brendshëm.

3. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar duhet të përcaktojnë dhe publikojnë plotësisht standardet për artikujt prioritar dhe për artikujt e transportuar me rrugë ajrore, si edhe për kolitë ekonomike/tokësore.

4. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar duhet të vlerësojnë zbatimin e standardeve të cilësisë së shërbimit.

SEKSIONI III TARIFAT, TARIFAT SHITESË DHE PËRJASHTIMI NGA TARIFAT POSTARE

Neni 15

Tarifat

1. Tarifat e shërbimeve të ndryshme postare të përcaktuara në Konventë do të vendosen nga shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar, në varësi të legjislacionit kombëtar, në përputhje me Konventën dhe rregulloret e saj. Në parim, ato duhet të jenë të lidhura me kostot e kryerjes së këtyre shërbimeve.



2. Shteti anëtar i origjinës ose operatori i tij i caktuar, në varësi të legjislacionit kombëtar, do të caktojë tarifën postare për transportin e artikujve të postës së letrave dhe kolive postare. Tarifën postare do të mbulojnë dërgimin e artikujve në adresën e marrësve, me kusht që shërbimi i shpërndarjes të jetë i organizuar në shtetet e destinacionit për artikujt në fjalë.

3. Tarifën e mbledhura, duke përfshirë edhe ato të përmendura si shembull në akte, duhet të jenë të paktën të barabarta me ato që zbatohen për artikujt e shërbimit të brendshëm që kanë të njëjtat karakteristika (kategori, sasi, afat të trajtimit etj.).

4. Shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar, në varësi të legjislacionit kombëtar, do të jenë të autorizuar të tejkalojnë tarifën indikative që figurojnë në akte.

5. Përtej kufirit minimal të tarifave të vendosura në pikën 3, shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar kanë të drejtën të reduktojnë tarifën në bazë të legjislacionit të tyre kombëtar për artikujt e postës dhe kolive postare të dërguara në territorin e shtetit anëtar. Ato, për shembull, mund të akordojnë tarifa preferenciale për klientët më të mëdhenj të postës.

6. Është e ndaluar të merren nga klientët tarifa postare të çfarëdo natyre përveç atyre që janë të parashikuara nëpër akte.

7. Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në akte, çdo operator i caktuar do të mbajë tarifën që ka vjelë.

Neni 16

Përfshirja nga tarifa postare

1. Parime

1.1 Rastet e përfshirjes nga tarifën postare, sipas kuptimit të përfshirjes nga parapagesa postare, janë parashikuar shprehimisht në Konventë. Megjithatë, rregulloret mund të caktojnë për përfshirje nga tarifën postare, pagesat e tarifave të tranzitit, të kostove përfundimtare, si dhe të kuotave të mbërritjes për artikujt e postës së letrave dhe kolive postare të lidhura me shërbimin postar, të dërguara nga shtetet anëtare, operatorët e caktuar dhe sindikatat e kufizuara dhe në lidhje me shërbimet postare. Përveç kësaj, artikujt e postës së letrave dhe kolive postare të dërguara nga Zyra Ndërkombëtare e UPU-së me destinacion sindikatat e kufizuara, shtetet anëtare dhe

operatorët e caktuar, do të konsiderohen si artikuj të lidhur me shërbimin postar dhe do të jenë të përjashtuara nga çdo tarifë postare. Megjithatë, shteti anëtar i origjinës ose operatori i tij i caktuar ka të drejtën e marrjes së taksave shtesë ajrore për dërgesat e mësipërme.

2. Të burgosurit e luftës dhe të internuarit civilë

2.1 Artikujt e postës së letrave, koltë postare dhe artikujt e shërbimeve postare (pagesat) financiare të drejtuara ose dërguara nga të burgosurit e luftës, qoftë drejtpërdrejtë apo nëpërmjet zyrave të përmendura në rregulloren e Konventës dhe në Marrëveshjen e Shërbimeve të Pagesave Postare, do të përjashtohen nga të gjitha tarifën postare, me përjashtim të shpenzimit të transportit ajror. Palët kundërshtarë në luftë, të kapur dhe internuar në një vend neutral, do të klasifikohen me të burgosurit e luftës për aq sa i përket zbatimit të dispozitave të mësipërme.

2.2 Dispozitat e parashikuara në pikën 2.1 do të zbatohen edhe për artikujt e postës së letrave, koltë postare dhe artikujt e shërbimeve financiare - pagesat postare që vijnë nga shtete të tjera dhe që u drejtohen personave civilë të internuar, siç përkufizohet nga Marrëveshja e Gjenevës, datë 12 gusht 1949, në lidhje me mbrojtjen e personave civilë në kohë lufte, ose të dërguara nga këta të fundit në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose me ndërmjetësinë e zyrave të përmendura në rregulloren e Konventës dhe Rregulloren e Shërbimit të Pagesave Postare.

2.3 Zyrat e përmendura në rregulloren e Konventës dhe Rregulloren e Shërbimit të Pagesave Postare do të përfitojnë gjithashtu nga përfshirja nga tarifën postare për artikujt e postës së letrave, kolive postare dhe artikujt e shërbimeve të pagesave financiare postare për personat e parashikuar në pikat 2.1 dhe 2.2 në rastin kur dërgojnë ose marrin, qoftë direkt qoftë me ndërmjetësi.

2.4 Koltë do të pranohen të përjashtuara nga tarifën postare deri në peshën 5 kg. Kufizimi i peshës do të rritet deri në 10 kg për artikujt përmbajtja e të cilave është e pandashme dhe për ato që i dërgohen një kampi ose njerëzve të besuar për t'ju shpërndarë të burgosurve.

2.5 Në kuadrin e rregullimit të llogarive midis operatorëve të caktuar, shërbimi i kolive dhe pakot e të burgosurve të luftës ose të internuarve civilë nuk i lënë vend dhënies së asnjë çmimi, me



përfshirje të shpenzimeve të transportit ajror të aplikuar për kolitë e transportuara me rrugë ajrore.

3. Objektet postare për të verbrit:

3.1 Çdo objekt postar për të verbrit i dërguar nga ose një organizatë për të verbër, ose i dërguar nga ose një person i verbër do të përfshihet nga të gjitha tarifat postare, me përjashtim të tarifave shtesë të transportit ajror në masën që këto objekte janë të pranueshme si të tilla në shërbimin e brendshëm të operatorit dërgues të caktuar.

3.2 Në këtë nen:

3.2.1 një i verbër do të thotë personi i cili është regjistruar si i verbër ose me probleme shikimi në vendin e tij ose të saj, ose që plotëson përkufizimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për një person të verbër ose një person me shikim të ulët;

3.2.2 një organizatë për të verbrit do të thotë një institucion apo shoqatë që shërben ose përfaqëson zyrtarisht personat e verbër;

3.2.3 artikujt për të verbrit do të përfshijnë korrespondencën, literaturën në çfarëdo formati, përfshirë regjistrime zanore, pajisje ose materiale të çfarëdo lloji të realizuara apo të përshtatura për të ndihmuar personat e verbër në tejkalimin e problemeve të verbërisë sipas rregulloreve.

SEKSIONI IV

SHËRBIMET BAZË DHE PLOTËSUESE

Neni 17

Shërbimet bazë

1. Shtetet anëtare do të sigurohen se operatorët e tyre të caktuar do të pranojnë, përpunojnë, transportojnë dhe shpërndajnë artikujt e postës së letrave.

2. Artikujt e postës së letrave që përmbajnë vetëm dokumente janë:

2.1 artikujt prioritar dhe të zakonshëm deri në 2 kilogramë;

2.2 letrat, kartolinat dhe letrat e shtypura, deri në 2 kilogramë;

2.3 objektet postare të cekogramet (literatura për të verbër) deri në 7 kilogramë;

2.4 thasë speciale që përmbajnë gazeta, shkrime periodike, libra dhe dokumente të printuar për të njëjtin marrës dhe në të njëjtën adresë, të quajtura “thasë M”, deri në 30 kilogramë.

3. Artikujt e postës së letrave që përmbajnë mallra janë:

3.1 pako të vogla prioritare dhe joprioritare, deri në 2 kilogramë;

3.2 objektet postare të cekogramet (literatura për të verbër) deri në 7 kilogramë, sipas përcaktimeve në rregullore;

3.3 thasë speciale që përmbajnë gazeta, shkrime periodike, libra dhe dokumente të printuar për të njëjtin marrës dhe në të njëjtën adresë, të quajtura “thasë M”, deri në 30 kilogramë, sipas përcaktimeve në rregullore.

4. Artikujt e postës së letrave klasifikohen sipas shpejtësisë së trajtimit të tyre ose sipas përmbajtjes së tyre në përputhje me rregulloren.

5. Sipas sistemit të klasifikimit, referuar në pikën 4, artikujt e postës së letrave mund të klasifikohen edhe në bazë të formatit të tyre si: letra të vogla (P), letra të mëdha (G), letra të mëdha (E) ose pako të vogla (E). Limitet e përmasave dhe të peshës përcaktohen në rregullore.

6. Limite më të larta të peshës se ato të caktuara në pikën 2 do të aplikohen në mënyrë fakultative në disa kategori të artikujve të postës së letrave, sipas kushteve të caktuara në rregullore.

7. Çdo shtet anëtar duhet të sigurojë që operatorët e tyre të caktuar të pranojnë, trajtojnë, përcjellin dhe dorëzojnë objekte të kolipostës deri në 20 kilogramë.

8. Limitet e peshës më të madhe se 20 kg do të aplikohen në mënyrë fakultative për disa kategori të kolive postare, sipas kushteve të përcaktuara në rregullore.

Neni 18

Shërbimet plotësuese

1. Shtetet anëtare do të sigurojnë ofrimin e shërbimeve plotësuese të detyrueshme vijuese:

1.1 shërbimet rekomandë për artikujt në dalje prioritare dhe të postës së letrave;

1.2 shërbimet rekomandë për të gjithë artikujt e regjistruar të postës së letrave në hyrje.

2. Shtetet anëtare mund të sigurojnë ofrimin e shërbimeve fakultative plotësuese të mëposhtme në marrëdhëniet mes atyre operatorëve të caktuar që kanë rënë dakord t'i ofrojnë këto shërbime:

2.1 sigurimin për artikujt e postës së letrave dhe kolive;

2.2 shërbime me pagesë nga marrësi për artikujt e postës së letrave dhe kolive;



2.3 shërbime të dorëzimit ekspres për artikujt e postës së letrave;

2.4 dorëzimi tek marrësi personalisht të artikujve rekomande, me dorëzim të regjistruar dhe të siguruar të postës së letrave;

2.5 shërbimi i dorëzimit të artikujve të postës së letrave dhe kolive pa tarifë dhe taksë;

2.6 shërbimi i kolive delikate dhe kolive të rënda;

2.7 shërbimi i dorëzimit për artikujt kolektivë me një dërgues të vetëm, të destinuara për jashtë vendit;

2.8 shërbimi i kthimit të mallrave, i cili përfshin kthimin e mallrave nga i adresuari tek shitësi fillestar, me një letër autorizimi.

3. Tre shërbimet plotësuese në vijim kanë pjesë të detyruar dhe pjesë fakultative:

3.1 shërbimi i përgjigjes ndërkombëtare të biznesit (IBRS), i cili është kryesisht fakultativ. Të gjitha shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar do të jenë të detyruar të kryejnë shërbimin e “kthimit” për IBRS;

3.2 kuponët e përgjigjes ndërkombëtare, të cilët mund të shkëmbehen në të gjitha shtetet anëtare. Shitja e kuponëve të përgjigjes ndërkombëtare është, megjithatë, fakultative;

3.3 njoftimi i dërgimit për objektet e regjistruara të postës së letrave, artikujt rekomande ose me dërgim të regjistruar të postës së letrave, kolive ose artikujve të siguruar. Të gjitha shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar do të pranojnë njoftimet e dërgimit hyrës. Ofrimi i shërbimit të njoftimit të dërgimit dalës është, megjithatë, fakultativ.

4. Përshkrimi i këtyre shërbimeve dhe tarifave të tyre janë të vendosura në rregullore.

5. Kur karakteristikat e shërbimit në vijim janë subjekt i tarifave të posaçme në regjimin e brendshëm, operatorët e caktuar janë të autorizuar të marrin të njëjtat tarifa për artikujt ndërkombëtarë, sipas kushteve të përcaktuara në rregullore:

5.1 shpërndarja e pakove të vogla me peshë më të madhe se 500 gramë;

5.2 postimi i artikujve të postës së letrave pas orarit të postimit;

5.3 postimi i artikujve jashtë orëve normale të funksionimit të sporteleve;

5.4 marrja në adresën e dërguesit;

5.5 tërheqja e një artikulli të postës së letrave jashtë orëve normale të funksionimit të sporteleve;

5.6 postë restante;

5.7 magazinimi i artikujve të postës së letrave të cilët peshojnë mbi 500 gram (me përjashtim të artikujve për të verbrit) dhe të kolive postare;

5.8 dërgimi i pakove me përgjigje në momentin e mbërritjes;

5.9 mbulimi ndaj rreziqeve nga forcat madhore;

5.10 dërgimin e artikujve të postës së letrave jashtë orarit normal të hapjes së sportelit.

SEKSIONI V

NDALIMET DHE ÇËSHTJET DOGANORE

Neni 19

Artikuj që nuk pranohen. Ndalimet

1. Të përgjithshme

1.1 Artikujt që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Konventa dhe rregullorja, nuk do të pranohen. Artikujt e dërguar në mbështetje të një akti të paligjshëm ose me qëllim për të shmangur pagesën e plotë të tarifave të përshtatshme nuk do të pranohen.

1.2 Përjashtimet nga ndalimet e caktuara në këtë nen janë të përcaktuara në rregullore.

1.3 Të gjitha shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar do të kenë mundësinë të zgjerojnë ndalimet e caktuara në këtë nen, të cilat mund të jenë të aplikueshme menjëherë pas përfshirjes së tyre në përmbledhje.

2. Ndalimet në të gjithë llojet e artikujve

2.1 Futja e objekteve të referuara në vijim do të ndalohen në të gjitha kategoritë e artikujve:

2.1.1 drogat dhe substancat psikotrope, siç janë përcaktuar nga Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve, ose droga të tjera të paligjshme të cilat ndalohen në shtetin e destinacionit;

2.1.2 objekte të pamoralshme;

2.1.3 objekte të falsifikuara ose piraterike;

2.1.4 objekte të tjera, importi ose qarkullimi i të cilave është i ndaluar në shtetin e destinacionit;

2.1.5 objektet që, për shkak të natyrës ose ambalazhimit të tyre, mund të ekspozojë agjentët ose publikun e gjerë, ose tokën, ose të dëmtojnë artikujt e tjerë, pajisjet postare ose të mirat që iu përkasin të tretëve;

2.1.6 dokumentet që kanë një karakter të korrespondencës aktuale dhe personale të



shkëmbyer mes personave që nuk janë as dërgues dhe as pritës, ose që banojnë me ta;

3. Mallra të rrezikshme:

3.1 Futja e mallrave të rrezikshme, siç përshkruhet në Konventë dhe në rregullore, do të ndalohet për çdo kategori artikujsh.

3.2 Futja e pajisjeve të lëndëve plasëse inerte dhe mjeteve ushtarake dhe imitimeve, duke përfshirë granatat inerte dhe imitimet e tyre, predhat inerte dhe të ngjashme, do të jenë të ndaluara për çdo kategori artikujsh.

3.3 Në mënyrë të jashtëzakonshme, mallrat e rrezikshme mund të pranohen në marrëdhëniet midis shteteve anëtare që kanë deklaruar gatishmërinë e tyre për t'i pranuar ato reciprokisht ose në një drejtim, me kusht që të jenë në përputhje me rregullat dhe rregulloret e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar.

4. Kafshët e gjalla:

4.1 Futja e kafshëve të gjalla është e ndaluar në të gjitha kategoritë e artikujve.

4.2 Në mënyrë të jashtëzakonshme, do të pranohen në artikujt e postës së letrave të ndryshme nga artikujt e siguruar, kafshët si më poshtë:

4.2.1 bletët, shushunjat dhe krimbat e mëndafshit;

4.2.2 parazitët dhe shkatërruesit e insekteve të dëmshme, të destinuara për kontrollin e këtyre insekteve dhe të shkëmbyer mes institucioneve zyrtarisht të njohura;

4.2.3 mizat e familjes së *Drosophilidae* të përdorur për kërkime biomjekësore, të shkëmbyera mes institucioneve zyrtarisht të njohura.

4.3 Në mënyrë të jashtëzakonshme, do të pranohen kafshët e përmendura më poshtë:

4.3.1 kafshët e gjalla, transporti me postë i të cilave është i autorizuar nga rregullorja e postave të shteteve të interesuara. Kafshët e gjalla të cilat transportohen me postë të autorizuar nga rregulloret postare dhe/ose legjislacioni kombëtar i vendeve në fjalë.

5. Futja e korrespondencave në koli

5.1 Është e ndaluar futja e objekteve të përmendura më poshtë në kutitë postare:

5.1.1 korrespondenca, me përjashtim të materialeve të arkivuara, të shkëmbyera midis personave të ndryshëm nga dërguesi dhe marrësi ose personat që jetojnë me ta.

6. Monedha, kartëmonedha, dhe objekte të tjera me vlerë

6.1 Është e ndaluar futja e monedhave, kartëmonedhave, valutë ose letra me vlerë të çfarëdolloj të pagueshme prurësit, çeqeve të udhëtimit, platini, ari, argjendi, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjerë me vlerë:

6.1.1 në artikujt e postës së letrave të pasiguruara:

6.1.1.1 megjithatë, nëse legjislacioni i brendshëm i shteteve të origjinës dhe të destinacionit e lejon, këto objekte mund të dërgohen me zarf të mbyllur si dërgesa rekomandë;

6.1.2 në pakot e pasiguruara, me përjashtim të rastit kur legjislacioni i brendshëm i shteteve të origjinës dhe të destinacionit e lejon;

6.1.3 në pakot e pasiguruara, të shkëmbyera mes shteteve që pranojnë deklarimin e vlerës;

6.1.3.1 për më shumë, çdo shtet anëtar ose operator i caktuar mund të ndalojë përfshirjen e shufrave të arit në kolitë e siguruar ose të pasiguruara që nisen ose i adresohen territorit të tij, ose janë dërguar në tranzit *à découvert* nëpër territorin e tij; ai mund ta kufizojë vlerën reale të këtyre artikujve.

7. Letra të printuara dhe cekograme (posta e të verbërve). Letra të printuara dhe objekte për të verbërit.

7.1 Letrat e printuara dhe cekogramet

7.1.1 nuk mund të përmbajnë asnjë mbishkrim ose artikull korrespondence;

7.1.2 nuk do të mbajnë asnjë pullë poste ose formular parapagimi, të anuluar ose jo, ose ndonjë letër që përfaqëson ndonjë vlerë, me përjashtim të rasteve kur artikulli përfshin si shtojcë një kartolinë, zarf ose ambalazh që ka adresën e printuar të dërguesit të artikullit ose agjentit të tij në shtetin e postimit ose të destinacionit të artikullit origjinal, kthimi i të cilit është parapaguar.

8. Trajtimi i artikujve të pranuar gabim

8.1 Trajtimi i artikujve të pranuar gabimisht përcaktohet në rregullore. Megjithatë, artikujt që përmbajnë objektet e caktuara në pikat 2.1.1, 2.1.2 dhe 3.1 dhe 3.2, nuk do të dërgohen në asnjë rrethanë në destinacionin e tyre, nuk do t'i dorëzohen marrësit, ose kthehen në origjinë. Nëse objektet e përcaktuara në pikën 2.1.1 janë zbuluar në tranzit, këto artikuj do të trajtohen në përputhje me legjislacionin kombëtar të shtetit të tranzitit. Në



rastin e artikujve të përmendur në pikat 3.1 dhe 3.2, të zbuluar gjatë transportit, operatori përkatës i caktuar ka të drejtë të heqë artikullin nga objekti dhe ta asgjësojë atë. Operatori i caktuar mund të dërgojë pjesën tjetër të objektit në destinacionin e tij, së bashku me informacionin në lidhje me asgjësimin e artikullit të papranueshëm.

Neni 20

Kontrolli doganor. Detyrimet doganore dhe tarifa të tjera

1. Operatorët e caktuar të shteteve të origjinës dhe të destinacionit do të jenë të autorizuar të nënshtrojnë artikujt ndaj kontrollit doganor, sipas legjislacionit të këtyre shteteve.

2. Artikujt që i nënshtrohen kontrollit doganor mund të jenë subjekt i tarifës së paraqitjes në doganë, shuma e udhëzuar e së cilës është e përcaktuar në rregullore. Kjo taksë merret vetëm për paraqitjen në doganë dhe zhdoganimin e artikujve që i nënshtrohen pagesave doganore ose çdo pagese tjetër të këtij lloji.

3. Operatorët e caktuar që kanë marrë autorizimin për të bërë zhdoganimin në emër të klientëve, nëse në emër të klientit ose të operatorit të caktuar në vendin e destinacionit, do të jenë të autorizuar të marrin nga klientët një tarifë bazë të kostos reale. Kjo tarifë mund të vihet për të gjithë artikujt e deklaruar në doganë sipas legjislacionit kombëtar, duke përfshirë ato të përjashtuara nga detyrimet doganore. Klientët do të informohen në mënyrë të qartë dhe paraprakisht për tarifën e kërkuar.

4. Operatorët e caktuar do të jenë të autorizuar të marrin nga dërguesit ose marrësit e artikujve, sipas rastit, tarifën doganore ose çdo pagesë tjetër të mundshme.

SEKSIONI VI DETYRIMET

Neni 21

Reklamimet

1. Çdo operator i caktuar duhet të pranojë reklamimet në lidhje me kolitë ose artikujt rekomandë (ose objektet postare të siguruar), të siguruar ose me dërgim të regjistruar të postuara në shërbimin e tij ose në atë të një operatori tjetër të

caktuar, me kusht që këto reklamime të paraqiten nga klientët në një periudhë prej gjashtë muajsh, duke nisur nga e nesërmeja e ditës së postimit të artikullit. Transmetimi dhe përpunimi i reklamimeve ndërmjet operatorëve të caktuar mund të kryhet sipas kushteve të përcaktuara në rregullore. Periudha prej 6 muajsh ka të bëjë me marrëdhëniet mes reklamuesve dhe operatorëve të caktuar dhe nuk do të përfshijë transmetimin e reklamimeve ndërmjet operatorëve të caktuar.

2. Trajtimi i reklamimeve do të bëhet falas. Megjithatë, shpenzimet shtesë që rrjedhin nga kërkesa e transmetimit me anë të shërbimit EMS, në parim, do të jenë në ngarkim të personit që bën kërkesën.

Neni 22

Përgjegjësia e operatorëve të caktuar. Dëmshpërblimet

1. Të përgjithshme

1.1 Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 23, operatorët e caktuar do të jenë përgjegjës:

1.1.1 për humbjen, vjedhjen ose dëmtimet e artikujve rekomandë, të kolive të zakonshme (me përjashtim të kolipostës në kategorinë e shpërndarjes së tregtisë elektronike (ECOMPRO kolipostë), specifikimet e të cilave përcaktohen më tej në rregullore)) dhe të artikujve të siguruar;

1.1.2 për kthimin e artikujve rekomandë, artikujve të siguruar dhe kolive të zakonshme për të cilat nuk është dhënë arsyeja e mosdërgimit.

1.2 Operatorët e caktuar nuk do të jenë përgjegjës për artikuj të ndryshëm nga ata të treguar në pikat 1.1.1 dhe 1.1.2, as për kolipostën ECOMPRO.

1.3 Në çdo rast tjetër të paparashikuar në këtë Konventë, operatorët e caktuar nuk do të mbajnë përgjegjësi.

1.4 Kur humbja ose dëmtimi total i një artikulli rekomandë, një kolie të zakonshme ose të një artikulli të siguruar, ndodh për shkak të një force madhore për të cilin nuk aplikohen dëmshpërblime dërguesi do të ketë të drejtën e kthimit të tarifave të paguara për postimin e artikullit me përjashtim të tarifës së sigurimit.

1.5 Shumat e dëmshpërblimit për t'u paguar nuk mund të jenë më të larta se shumatat e treguara në rregulloren e postës së letrave dhe në rregulloret.



1.6 Në rast të përgjegjësisë, humbja ose humbjet e fitimeve ose dëmi moral nuk do të merren në konsideratë në shumën e dëmshpërblimit që do të paguhet.

1.7 Të gjitha dispozitat në lidhje me përgjegjësinë e operatorëve të caktuar do të jenë të sakta, të detyrueshme dhe të plota. Operatorët e caktuar nuk do të jenë përgjegjës, në asnjë rast, jashtë kufizimeve të përcaktuara në Konventë dhe në rregullore, edhe në rast të gabimit të rëndë.

2. Artikujt rekomande

2.1 Në rast humbjeje, vjedhjeje ose dëmtimi total të një artikulli rekomande, dërguesi do të ketë të drejtën e një dëmshpërblimi të përcaktuar në rregullore. Nëse dërguesi kërkon një shumë më të vogël se shuma e përcaktuar në rregullore, operatorët e caktuar kanë lirinë të paguajnë këtë shumë më të vogël, dhe të rimbursohen mbi këtë bazë, nga operatorët e tjerë të përfshirë;

2.2 Në rast të vjedhjes së pjesshme ose të dëmtimit të pjesshëm të një artikulli rekomande, dërguesi do të ketë të drejtën e një dëmshpërblimi që, në parim, korrespondon, me vlerën reale të vjedhjes ose dëmit.

3. Kollitë e zakonshme

3.1 Në rast të humbjes, vjedhjes ose dëmtimit total të një kolie, dërguesi do të ketë të drejtën e një dëmshpërblimi të përcaktuar në rregullore. Nëse dërguesi kërkon një shumë më të vogël se shuma e përcaktuar në rregullore, operatorët e caktuar mund të paguajnë këtë shumë më të vogël dhe të rimbursohen mbi këtë bazë nga operatorët e tjerë të caktuar të interesuar;

3.2 Në rast të vjedhjes ose dëmtimit të pjesshëm të një kolie, dërguesi do të ketë të drejtën e një dëmshpërblimi që korrespondon, në parim, me shumën reale të vjedhjes ose të dëmit;

3.3 Operatorët e caktuar mund të bien dakord të aplikojnë në marrëdhëniet e tyre reciproke shumën e përcaktuar në rregullore, në lidhje me kollitë postale, pavarësisht nga pesha e kolisë.

4. Artikujt e siguruar

4.1 Në rast të vjedhjes ose dëmtimit të pjesshëm të një kolie të siguruar, dërguesi do të ketë të drejtën të marrë dëmshpërblimin që korrespondon, në parim, me shumën në SDR të vlerës së siguruar;

4.2 Në rast të vjedhjes ose dëmtimit të pjesshëm të një kolie të siguruar, dërguesi do të ketë të drejtën të marrë një dëmshpërblim që korrespondon, në parim, me shumën reale të

vjedhjes ose të dëmit. Ajo nuk mund ta kalojë shumën në SDR të vlerës së siguruar;

5. Nëse një artikull i postës së letrave rekomande ose i siguruar kthehet dhe arsyeja e mosdërgimit nuk jepet, dërguesi do të ketë të drejtën e rimbursimit vetëm për tarifën e paguar për postimin e artikullit.

6. Nëse një koli kthehet dhe arsyeja e mosdërgimit nuk jepet, dërguesi do të ketë të drejtën e rimbursimit vetëm për tarifën e paguar për postimin e kolisë në shtetin e origjinës dhe shpenzimet e shkaktuara nga kthimi i kolisë nga shteti i destinacionit.

7. Në rastet e përmendura në pikat 2, 3 dhe 4, dëmshpërblimi do të llogaritet në bazë të çmimit real, të konvertuar në SDR, të artikujve dhe mallrave të të njëjtit lloj, në vendin dhe në kohën në të cilën artikulli është pranuar për transport. Kur mungon ky çmim, dëmshpërblimi do të llogaritet sipas vlerës së zakonshme të artikujve dhe mallrave të vlerësuar me të njëjtat baza.

8. Kur jepet një dëmshpërblim për humbjen, vjedhjen ose dëmtimin total të një artikulli rekomande, një kolie të zakonshme ose artikulli të siguruar, dërguesi, ose, sipas rastit, marrësi do të ketë të drejtën e kthimit të tarifave të paguara për postimin e tyre, me përjashtim tarifës së rekomandesë ose sigurimit. E njëjta gjë do të zbatohet për artikujt rekomande, kollitë e zakonshme dhe artikujt e siguruar, të refuzuar nga ana e marrësve, për shkak të gjendjes së tyre të keqe, nëse kjo është për faj të operatorit të caktuar dhe sjell përgjegjësinë e tij.

9. Pavarësisht nga dispozitat e parashikuara në pikat 2, 3, dhe 4, marrësi do të ketë të drejtën e dëmshpërblimit pas dorëzimit të një artikulli rekomande, një kolie të zakonshme ose një kolie të siguruar, të vjedhur ose të dëmtuar, nëse dërguesi heq dorë nga të drejtat e tij me shkrim në favor të marrësit. Kjo heqje dorë nuk është e nevojshme në rastet kur dërguesi dhe marrësi janë të njëjtë.

10. Operatori i caktuar i origjinës do të ketë të drejtën e pagesës së dërguesve në shtetin e tij, dëmshpërblimet e parashikuara nga legjislacioni kombëtar për artikujt rekomande dhe kollitë e pasiguruar, me kusht që të mos jenë më të ulëta se ato të caktuara në pikat 2.1 dhe 3.1. E njëjta gjë do të zbatohet edhe për operatorin e caktuar të destinacionit, kur dëmshpërblimi i paguhet



marrësit. Megjithatë shumat e caktuara në pikat 2.1 dhe 3.1, do të mbeten të aplikueshme:

10.1 në rast ankese ndaj operatorit të caktuar përgjegjës; ose

10.2 nëse dërguesi heq dorë nga të drejtat e tij në favor të marrësit ose e kundërta.

11. Për këtë nen nuk do të aplikohet asnjë rezervë që ka të bëjë me tejkalimin e afateve për reklamimet dhe pagesat e dëmshpërblimeve ndaj operatorëve të caktuar, duke përfshirë periudhat dhe kushtet e vendosura në rregullore, me përjashtim të rastit të marrëveshjeve dypalëshe.

Neni 23

Mungesa e përgjegjësisë së shteteve anëtare dhe operatorëve të caktuar

1. Operatorët e caktuar nuk do të kenë më përgjegjësi për artikujt rekomandë, artikujt me dërgim të regjistruar, kolipostën dhe artikujt e siguruar, të cilat janë dërguar në përputhje me kushtet e parashikuara në rregulloret e tyre për artikujt të të njëjtut lloj. Megjithatë do të mbetet përgjegjësia:

1.1 kur konstatohet një vjedhje ose dëmtim para ose gjatë dërgimit të artikullit;

1.2 kur, nëse lejohet nga rregulloret kombëtare, marrësi ose dërguesi, nëse ka ridërgim në origjinë, ka rezerva për marrjen në dorëzim të një artikulli të vjedhur ose të dëmtuar;

1.3 kur, nëse lejohet nga rregulloret kombëtare, artikulli rekomandë është shpërndarë në një kuti postare private dhe marrësi deklaron se nuk e ka marrë artikullin;

1.4 kur marrësi ose dërguesi, në rast të ridërgimit në origjinë, i një kolie ose një artikulli të siguruar, pavarësisht se ka dhënë shkarkimin nga përgjegjësia, njofton pa vonesa operatorin e caktuar që ka dërguar artikullin se ka konstatuar vjedhje ose dëmtim. Ai duhet të japë provën se kjo vjedhje ose dëmtim nuk është bërë pas dorëzimit. Termi “pa vonesë” duhet të interpretohet në përputhje me legjislacionin kombëtar.

2. Shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar nuk do të jenë përgjegjëse:

2.1 në rastet e forcës madhore, subjekt i nenit 18.5.9;

2.2 kur ata nuk mund të llogarisin artikujt për shkak të shkatërrimit të dokumentacionit të shërbimit si rezultat i forcës madhore, me kusht që

të mos jetë dhënë ndonjë provë tjetër për përgjegjësinë e tyre;

2.3 kur humbja, vjedhja ose dëmi është shkaktuar nga një gabim ose neglizhencë e dërguesit ose rrjedh nga natyra e përmbajtjes;

2.4 kur artikujt bëjnë pjesë në ndalimet e parashikuara në nenin 19;

2.5 kur artikujt janë sekuestruar sipas legjislacionit kombëtar të shtetit të destinacionit, sipas njoftimit të shtetit anëtar ose operatorit të caktuar të këtij shteti;

2.6 në rastin e artikujve të siguruar të cilët janë siguruar në mënyrë të paligjshme për një vlerë më të madhe se vlera reale e përmbajtjes;

2.7 kur dërguesi nuk ka bërë asnjë reklamim brenda 6 muajve, duke filluar nga dita e nesërme e ditës së postimit të artikullit;

2.8 kur bëhet fjalë për koli të të burgosurve ose të internuarve civilë;

2.9 kur veprimet e dërguesit dyshohen të kenë qëllim të paligjshëm, me qëllim marrjen e dëmshpërblimit.

3. Shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar nuk do të pranojnë asnjë përgjegjësi për deklaratat doganore, pavarësisht nga forma e tyre ose për vendime të marra nga shërbimet e doganës gjatë verifikimit të artikujve që i nënshtrohen kontrollit doganor.

Neni 24

Përgjegjësia e dërguesit

1. Dërguesi i një artikulli është përgjegjës për dëmtimet fizike që i shkaktohen punonjësve të postës dhe çdo dëmtim tjetër që i shkaktohet artikujve të tjerë postarë, si edhe të pajisjeve postare, si rezultat i dërgimit të një objekti të papranueshëm për transport ose nga mosrespektimi i kushteve të pranimit.

2. Në rast të dëmtimit të artikujve të tjerë postarë, dërguesi është përgjegjës në të njëjtin nivel si edhe operatorët e caktuar, për çdo artikull.

3. Dërguesi do të mbetet përgjegjës edhe nëse zyra e postimit e pranon këtë artikull.

4. Megjithatë, kur kushtet e pranimit janë respektuar nga dërguesi, ky nuk do të jetë përgjegjës, deri sa ka një gabim ose neglizhencë nga operatorët e caktuar ose të transportuesit në përpunimin e artikullit pas pranimit të tyre.



Neni 25

Pagesa e dëmshpërblimit

1. Me përjashtim të rastit kur ka një ankesë ndaj operatorit të caktuar përgjegjës, detyrimi për pagesën e dëmshpërblimit dhe të kthimit të tarifave dhe pagesave do të jetë, sipas rastit, i operatorit të caktuar të origjinës ose operatorit të caktuar të destinacionit.

2. Dërguesi mund të heqë dorë nga të drejtat e tij për t'u dëmshpërblyer, në favor të marrësit. Nga ana tjetër, marrësi mund të heqë dorë nga e drejta e dëmshpërblimit në favor të dërguesit. Dërguesi ose marrësi, në rast të heqjes dorë, mund të autorizojnë një person të tretë të marrë dëmshpërblimin nëse legjislacioni kombëtar e lejon këtë.

Neni 26

Rikuperimi i mundshëm i dëmshpërblimit nga dërguesi ose marrësi

1. Nëse, pas pagimit të dëmshpërblimit, një artikull rekomandë, një koli ose një artikull i siguruar ose një pjesë e përmbajtjes së konsideruar më parë si e humbur është gjetur, dërguesi ose marrësi, sipas rastit, do të njoftohen se artikulli do të mbahet në dispozicion të tij për një periudhë prej tre muajsh pas rimbursimit të paguar më parë si dëmshpërblim. Në të njëjtën kohë, ai do të pyetet se kujt do t'i dërgohet artikulli. Në rast të refuzimit ose moskthimit të përgjigjes brenda afatit të caktuar, e njëjta përjasje do të bëhet për marrësin ose dërguesin, sipas rastit, duke i dhënë të njëjtin afat për përgjigje.

2. Nëse dërguesi dhe marrësi refuzojnë të marrin në dorëzim artikullin ose nuk përgjigjen në afatet e caktuara në pikën 1, artikulli do të bëhet pronë e operatorit të caktuar, ose sipas rastit, e operatorëve të caktuar që kanë përballuar humbjen.

3. Në rast se pas gjetjes së një artikulli të siguruar, konstatohet se përmbajtja e tij ka një vlerë më të vogël se pagesa e dëmshpërblimit, dërguesi ose pritësi, sipas rastit, duhet të rimbursojë shumën e këtij dëmshpërblimi kundrejt dhënies së artikullit, pa cenuar pasojat që mund të rrjedhin nga sigurimi i paligjshëm.

SEKSIONI VII
SHPËRBLIMI**A. Tarifat e trazitit**

Neni 27

Tarifat e tranzitit

1. Dërgesat e mbyllura dhe artikujt në tranzit *à découvert* të shkëmbyera mes dy operatorëve të caktuar ose dy zyrave të të njëjtit shtet anëtar, me anë të shërbimeve të një ose të shumë operatorëve të tjerë të caktuar (shërbimet nga palë të treta), i nënshtrohen pagesës së tarifave të tranzitit. Këto do të përbëjnë shpërblimin për shërbimet e dhëna në lidhje me tranzitin tokësor, detar dhe ajror. Ky parim do të aplikohet edhe për artikuj e dërguar gabim dhe të devijuar.

B. Shpenzimet përfundimtare

Neni 28

Shpenzimet përfundimtare. Dispozita të përgjithshme

1. Subjekt i përjashtimeve të parashikuara nga rregullorja, çdo operator i caktuar që merr nga një tjetër operator i caktuar artikuj të postës së letrave, do të ketë të drejtën të marrë nga operatori i caktuar dërgues një pagesë për kostot e shkaktuara nga posta ndërkombëtare e marrë.

2. Për aplikimin e dispozitave në lidhje me pagesën e shpenzimeve përfundimtare nga operatorët e tyre të caktuar, shtetet dhe territoret do të klasifikohen në përputhje me listat e hartuara për këtë qëllim nga Kongresi në rezolutën e tij C 7/2016, si në vijim:

2.1 shtetet dhe territoret në sistemin objektiv para 2010-ës (grupi I);

2.2 shtetet dhe territoret në sistemin objektiv midis 2010-ës dhe 2012-ës (grupi II);

2.3 shtete dhe territore në sistemin objektiv nga 2016-a (grupi III);

2.4 shtete dhe territore në sistemin e tranzicionit (grupi IV).

3. Dispozitat e kësaj Konvente, në lidhje me pagesat e shpenzimeve përfundimtare, përbëjnë masa tranzitore që çojnë në përshtatjen e një sistemi që merr parasysh elemente në lidhje me çdo shtet në përfundim të periudhës së tranzicionit.



4. Aksesit në shërbimet e brendshme. Aksesit i drejtpërdrejtë

4.1 Në parim, çdo operator i caktuar i një shteti, që ka qenë në sistemin objektiv para 2010-ës, do të vendosë në dispozicion të operatorëve të tjerë të caktuar të gjitha çmimet, afatet dhe kushtet e ofruara në shërbimin e tij të brendshëm me kushte të njëjta me ato të propozuara për klientët vendas. I takon operatorit të caktuar të destinacionit të vendosë nëse operatori i caktuar i origjinës ka përmbushur afatet dhe kushtet e aksesit të drejtpërdrejtë.

4.2 Operatorët e caktuar të shteteve në sistemin objektiv para vitit 2010-ës do të vendosin në dispozicion të operatorëve të tjerë të caktuar të shteteve, që kanë qenë në sistemin objektiv para vitit 2010-ës, çmimet, afatet dhe kushtet e ofruara në shërbimin e tyre të brendshëm, me kushte të njëjta me ato të propozuara për klientët e tyre.

4.3 Operatorët e caktuar të shteteve të reja të sistemit objektiv, që i janë bashkuar sistemit objektiv, mund të zgjedhin të mos vendosin në dispozicion të operatorëve të tjerë të caktuar çmimet, afatet dhe kushtet e ofruara në shërbimin e tyre të brendshëm, me kushte të njëjta me ato të propozuara për klientët e shtetit të tyre. Këta operatorë të caktuar, megjithatë, mund të zgjedhin të vendosin në dispozicion të një numri të limituar të operatorëve të caktuar aplikimin e kushteve të brendshme, në bazë të reciprocitetit, për një periudhë prove prej dy vjetësh. Pas kësaj periudhe, ata duhet të zgjedhin të pushojnë disponibilitetin e kushteve të brendshme ose të vazhdojnë të vendosin në dispozicion të të gjithë operatorëve të tjerë të caktuar kushtet e brendshme. Megjithatë, nëse operatorët e caktuar të shteteve të reja të sistemit objektiv nga viti 2010-a u kërkojnë operatorëve të caktuar të shteteve të sistemit objektiv para vitit 2010-ës aplikimin e kushteve të brendshme, ata duhet të vendosin në dispozicion të të gjithë operatorëve të caktuar çmimet, afatet dhe kushtet e ofruara në shërbimin e tyre të brendshëm, me kushte të njëjta me ato të propozuara për klientët e tyre.

4.4 Operatorët e caktuar të shteteve në sistemin e tranzicionit mund të zgjedhin të mosvendosin në dispozicion të operatorëve të tjerë të caktuar çmimet, afatet dhe kushtet e ofruara në

shërbimin e tyre të brendshëm, me kushte të njëjta me ato të propozuara për klientët e shtetit të tyre. Këta operatorë të caktuar, megjithatë, mund të zgjedhin të vendosin në dispozicion të një numri të limituar të operatorëve të caktuar aplikimin e kushteve të brendshme, në bazë të reciprocitetit, për një periudhë prove prej dy vjetësh. Pas kësaj periudhe, ata duhet të zgjedhin të pushojnë disponibilitetin e kushteve të brendshme ose të vazhdojnë të vendosin në dispozicion të të gjithë operatorëve të tjerë të caktuar kushtet e brendshme.

5. Shpërblimi për shpenzimet përfundimtare do të bazohet në cilësinë e performancës së shërbimit në shtetin e destinacionit. Këshilli i Operacioneve Postare do të jetë i autorizuar të shtojë shpërblimin e neneve 28.bis, 29 dhe 30 për të inkurajuar pjesëmarrjen në sistemet e monitorimit dhe për të shpërblyer operatorët e caktuar për arritjen e objektivave të tyre të cilësisë. Këshilli i Operacioneve Postare, gjithashtu, mund të vendosë gjoba në rast të cilësisë së pamjaftueshme, por shpërblimi nuk do të jetë më i ulët se shpërblimi minimal në përputhje me nenet 29 dhe 30.

6. Çdo operator i caktuar mund të heqë dorë totalisht ose pjesërisht nga pagesa e parashikuar në pikën 1.

7. “Thasët M” që peshojnë më pak se 5 kg do të konsiderohen që peshojnë 5 kg për qëllime të detyrimeve fundore. Shkalla e detyrimeve fundore që do të zbatohet për “thasët M” do të jetë:

7.1 për vitin 2018, 0.909 SDR për kilogram;

7.2 për vitin 2019, 0.935 SDR për kilogram;

7.3 për vitin 2020, 0.961 SDR për kilogram;

7.4 për vitin 2021, 0.988 SDR për kilogram.

8. Për artikujt rekomandë do të ketë një pagesë shtesë prej 1.100 SDR për objektet për 2018-ën, 1.200 SDR për objektet për 2019-ën, 1.300 SDR për objektet për 2020-ën dhe 1.400 SDR për 2021-shin. Për artikujt e siguruar do të ketë një pagesë shtesë prej 1.400 SDR për objektet për 2018-ën, 1.500 SDR për objektet për 2019-ën, 1.600 SDR për objektet për 2020-ën dhe 1.700 SDR për vitin 2021. Këshilli i Operacioneve Postare do të jetë i autorizuar të plotësojë shpërblimin për këtë dhe për shërbime të tjera shtesë, kur shërbimet e ofruara përmbajnë karakteristika shtesë që duhet të specifikohen në rregullore.

9. Për objektet e regjistruara dhe të siguruar që nuk kanë një numër identifikues (barkod) ose kanë



një numër identifikues, por që nuk është në përputhje me standardet teknike S10 të UPU-së, do të ketë një pagesë shtesë prej 0.5 SDR për objekt, nëse nuk është rënë dakord në marrëveshje dypalëshe.

10. Për qëllime të detyrimeve terminale, objektet postare (letër) të postuara me shumicë, në përputhje me kushtet e specifikuar në rregullore, do të referohen si “objekte postare me shumicë”. Pagesa për “objekte postare me shumicë” do të jetë siç përcaktohet në nenet 28bis, 29 dhe 30, sipas rastit.

11. Çdo operator i caktuar, me një marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, mund të aplikojnë sisteme të tjerë pagese për shlyerjen e çmimit të detyrimeve përfundimtare.

12. Operatorët e caktuar mund të shkëmbejnë postë joprioritare në bazë fakultative, duke aplikuar një zbritje prej 10% në tarifën e detyrimeve përfundimtare prioritare.

13. Dispozitat e aplikueshme ndërmjet operatorëve të caktuar të shteteve në sistemin objektiv do të aplikohen edhe për operatorët e caktuar të një shteti në sistemin e tranzicionit, i cili deklaron se dëshiron të anëtarësohet në sistemin objektiv. Këshilli i Operacioneve Postare mund të vendosë masa tranzicioni në rregullore. Dispozitat e plota të sistemit objektiv mund të zbatohen për operatorin e ri objektiv të caktuar, i cili deklaron se dëshiron të aplikojë këto dispozita të plota pa masa tranzicioni.

Neni 28.bis

Detyrimet përfundimtare. Vetëdeklarimi i tarifave për objektet e postës së letrës me shumicë (E) dhe pako të vogla (E)

1. Duke filluar me tarifën në fuqi për vitin 2021 e në vijim dhe pavarësisht nga nenet 29 dhe 30, operatorët e caktuar mund të njoftojnë Byroën Ndërkombëtare deri më 1 qershor të vitit paraardhës, vit në të cilin tarifën e vetëdeklaruar do të zbatohen për një tarifë të vetëdeklaruar për objekt dhe për një tarifë të vetëdeklaruar për kilogram, e shprehur në monedhën vendase, e cila do të zbatohet për objekte të postës së letrave me shumicë (E) dhe pako të vogla (E) në vitin kalendarik në vijim. Byroja Ndërkombëtare do të konvertojë çdo vit tarifën e vetëdeklaruar në vlerën e shprehur në SDR. Për të llogaritur tarifën në SDR,

Byroja Ndërkombëtare do të përdorë kursin mesatar mujor të këmbimit të periudhës nga 1 janari deri më 31 maj të vitit paraardhës, vit për të cilin do të ishin të zbatueshme tarifën e vetëdeklaruar. Tarifën e llogaritura do të njoftohen me anë të një qarkoreje të Byrosë Ndërkombëtare, jo më vonë se data 1 korrik e vitit paraardhës të vitit në të cilin do të zbatohen tarifën e vetëdeklaruar. Tarifën e vetëdeklaruar për objekte të postës së letrave me shumicë (E) dhe pako të vogla (E) do të zëvendësohen, sipas rastit, në çdo llogaritje referuese ose tarifë që lidhet me objekte të postës së letrave me shumicë (E) dhe pako të vogla (E), kudo në Konventë ose rregullore. Gjithashtu, çdo operator i caktuar do t'i sigurojë Byrosë Ndërkombëtare tarifën e tij të brendshme për shërbime ekuivalente, me qëllim llogaritjen e tarifave tavan/maksimale përkatëse.

1.1 Sipas 1.2 dhe 1.3, tarifën e vetëdeklaruar duhet:

1.1.1 me peshën mesatare të formatit E prej 0.158 kilogramë, të mos jenë më të larta se tarifën tavan/maksimale specifike për vendin, të llogaritura në përputhje me paragrafin 1.2;

1.1.2 të bazohen në 70%, ose në përqindjen e zbatueshme në paragrafin 6.ter, të tarifës vendase për një pjesë, për objekte ekuivalente me objekte të postës së letrave me shumicë (E) dhe pako të vogla (E) të ofruara nga operatorin i caktuar në shërbimin e tij vendas, që hyjnë në fuqi më 1 qershor të vitit paraardhës, vit për të cilin do të zbatohen tarifën e vetëdeklaruar;

1.1.3 të bazohen në tarifën vendase për një pjesë të vetme për objektet brenda shërbimit vendas të operatorit të caktuar që kanë përmasat dhe formën maksimale të specifikuar për objekte të postës së letrave me shumicë (E) pakot e vogla (E);

1.1.4 të vihen në dispozicion për të gjithë operatorët e caktuar;

1.1.5 do të zbatohen vetëm për objektet e postës së letrave me shumicë (E) dhe pakot e vogla (E);

1.1.6 do të zbatohen për të gjitha flukset e objekteve të postës së letrave me shumicë (E) dhe pakove të vogla (E), përveç flukseve të objekteve të postës së letrave me shumicë (E) dhe pakove të vogla (E) nga vendet në sistemin tranzit në vendet në sistemin objektiv, dhe midis vendeve në sistemin tranzit, nëse flukset e postës nuk kalojnë 100 tonë në vit;



1.1.7 do të zbatohen për të gjitha flukset e objekteve të postës së letrave me shumicë (E) dhe pakove të vogla (E), përveç flukseve të objekteve të postës së letrave me shumicë (E) dhe pakove të vogla (E) midis vendeve në sistemin objektiv që nga viti 2010, 2012 dhe 2016, dhe nga ato vende në vendet në sistemin objektiv përpara vitit 2010, nëse flukset e postës nuk kalojnë 25 tonë në vit.

1.2 Tarifat e vetëdeklaruarra për artikull dhe për kilogram, për objektet e postës së letrave me shumicë (E) dhe pakot e vogla (E), nuk duhet të jenë më të larta se tarifën tavan specifike për vendin, të përcaktuara nga një regresion linear prej 11 pikësh që korrespondon me 70%, ose përqindja e zbatueshme në paragrafin 6.ter, të tarifave prioritare të objekteve me një pjesë të shërbimeve të brendshme ekuivalente të objekteve të postës së letrave me shumicë (E) dhe pakove të vogla (E) për: 20 gramë, 35 gramë, 75 gramë, 175 gramë, 250 gramë, 375 gramë, 500 gramë, 750 gramë, 1000 gramë, 1.500 gramë dhe 2.000 gramë, të përjashtuara nga çdo taksë.

1.2.1 Përcaktimi nëse tarifën tavan duhet të testohet me të ardhurat mesatare duke përdorur përbërjen mesatare më aktuale në të gjithë botën për një kilogram postë në të cilin një objekt i formatit E peshon 0.158 kilogramë. Në rastet kur tarifën tavan të vetëdeklaruarra tejkalojnë tarifën tavan në peshën mesatare të formatit E prej 0.158 kilogramë, do të zbatohen tarifën tavan për artikull dhe për kilogram; ndryshe, operatori i caktuar në fjalë mund të zgjedhë të reduktojë tarifën tavan të vetëdeklaruarra në një nivel që përputhet me paragrafin 1.2.

1.2.2 Kur janë të disponueshme tarifa për paketa të shumëfishta bazuar në trashësi, tarifa më e vogël vendase do të zbatohet për objekte deri në 250 gramë dhe tarifa më e lartë vendase do të aplikohet për objekte mbi 250 gramë.

1.2.3 Kur tarifën zonale zbatohet në shërbimin ekuivalent vendas, do të përdoret tarifa e pikës së mesme, siç përcaktohet në rregullore, dhe tarifën vendase për zonat jokonkurrese përjashtohen për përcaktimin e tarifës së pikës së mesme. Përndryshe, përcaktimi i tarifës zonale që do të përdoret mund të bazohet në distancën mesatare të ponderuar për objektet e postës së letrave me shumicë (E) dhe pakot e vogla (E) hyrëse (për vitin kalendarik më të fundit).

1.2.4 Kur shërbimi dhe tarifa ekuivalente vendase përfshijnë shërbimet shtesë që nuk janë pjesë e shërbimit bazë, d.m.th. shërbimet e ndjekjes, nënshkrimit dhe sigurimit, dhe shërbime të tilla shtrihen në të gjitha ngritjet e peshave të renditura në paragrafin 1.2, niveli më i ulët i tarifës vendase plotësuese, tarifa shtesë, ose tarifa e sugjeruar në udhëzimet për tarifën në aktet e UPU-së do të zbriten nga tarifa e brendshme. Zbritja totale për të gjitha shërbimet shtesë nuk mund të kalojë 25% të tarifës së brendshme.

1.3 Kur tarifën tavan specifike për vendin, të llogaritura në përputhje me paragrafin 1.2, rezultojnë në të ardhura të llogaritura për një objekt të formatit E, me 0.158 kilogram, që është më i ulët se të ardhurat e llogaritura për të njëjtin objekt me të njëjten peshë në bazë të tarifave të specifikuarra më poshtë, tarifën tavan të vetëdeklaruarra nuk do të jenë më të larta se tarifën tavan mëposhtme:

1.3.1 për vitin 2020, 0.614 SDR për artikull dhe 1.381 SDR për kilogram;

1.3.2 për vitin 2021, 0.645 SDR për artikull dhe 1.450 SDR për kilogram;

1.3.3 për vitin 2022, 0.677 SDR për artikull dhe 1.523 SDR për kilogram;

1.3.4 për vitin 2023, 0.711 SDR për artikull dhe 1.599 SDR për kilogram;

1.3.5 për vitin 2024, 0.747 SDR për artikull dhe 1.679 SDR për kilogram;

1.3.6 për vitin 2025, 0.784 SDR për artikull dhe 1.763 SDR për kilogram.

1.4 Çdo kusht dhe procedurë shtesë për vetëdeklarimin e tarifave të zbatueshme për objektet e postës së letrave me shumicë (E) dhe pakot e vogla do të përcaktohen në rregullore. Të gjitha dispozitat e tjera të rregullores, që lidhen me objektet e mësipërme, do të zbatohen edhe për tarifën tavan të vetëdeklaruarra, përveç rastit kur nuk janë në kundërshtim me këtë nen.

1.5 Operatorët e caktuar të vendeve në sistemin tranzitor/të përkohshëm mund të aplikojnë tarifën tavan të vetëdeklaruarra në bazë të modeleve të fluksit të tyre hyrës.

2. Përveç tarifave tavan të parashikuara në pikën 1.2, tarifën tavan të vetëdeklaruarra të njoftuara nuk duhet të jenë më të larta se të ardhurat maksimale të përcaktuara për vitet 2021–2025, si në vijim:

2.1 2021: të ardhurat e llogaritura në bazë të tarifave të vetëdeklaruarra, do të vendosen në nivelin më të ulët midis tarifës tavan specifike për



shtetin dhe të ardhurave në vitin 2020, për një artikull të formatit E, në 0.158 kilogramë, me rritje prej 15%;

2.2 2022: të ardhurat e llogaritura në bazë të tarifave të vetëdeklaruar do të vendosen në nivelin më të ulët midis tarifave tavan specifike për shtetin dhe të ardhurave në vitin 2021, për një artikull të formatit E, në 0.158 kilogramë, me rritje prej 15%;

2.3 2023: të ardhurat e llogaritura në bazë të tarifave të vetëdeklaruar do të vendosen në nivelin më të ulët midis tarifave tavan specifike për shtetin dhe të ardhurave në vitin 2022, për një artikull të formatit E, në 0.158 kilogramë, me rritje prej 16%;

2.4 2024: të ardhurat e llogaritura në bazë të tarifave të vetëdeklaruar do të vendosen në nivelin më të ulët midis tarifave tavan specifike për shtetin dhe të ardhurave në vitin 2023, për një artikull të formatit E, në 0.158 kilogramë, me një rritje prej 16%;

2.5 2025: të ardhurat e llogaritura në bazë të tarifave të vetëdeklaruar do të vendosen në nivelin më të ulët midis tarifave tavan specifike për shtetin dhe të ardhurave në vitin 2024, për një artikull të formatit E, në 0.158 kilogramë, me një rritje prej 17%.

3. Për tarifatat në fuqi në vitin 2021 dhe vitet pasuese, raporti midis tarifës së vetëdeklaruar për artikull dhe për kilogram, nuk do të ndryshojë me më shumë se pesë pikë përqindje rritjeje ose rënieje, në krahasim me raportin e një viti më parë. Për operatorët e caktuar që vetëdeklarojnë tarifatat sipas paragrafit 6.bis ose zbatojnë tarifa të vetëdeklaruar mbi bazë reciprociteti sipas paragrafit 6.quer, raporti në fuqi për vitin 2020 do të bazohet në tarifën e vetëdeklaruar për artikull dhe për kilogram të përcaktuar për t'u zbatuar nga data 1 korrik 2020.

4. Operatorët e caktuar që nuk vendosin të vetëdeklarojnë tarifatat e tyre, në përputhje me këtë nen, duhet të zbatojnë plotësisht dispozitat e parashikuara në nenet 29 dhe 30.

5. Për operatorët e caktuar që kanë zgjedhur të vetëdeklarojnë tarifatat e tyre për objektet e postës së letrave me shumicë (E) dhe pakot e vogla (E), në një vit kalendarik të mëparshëm, dhe që nuk komunikojnë ndryshime të këtyre tarifave për vitin pasardhës, do të zbatohen tarifatat e vetëdeklaruar ekzistuese, përjashtuar rastet kur këto tarifa nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë nen.

6. Byroja Ndërkombëtare duhet të informohet nga operatori i caktuar në lidhje me çdo ulje të tarifës së brendshme të përmendur në këtë artikull.

6.bis Me hyrjen në fuqi që nga 1 korriku 2020 dhe pavarësisht nga paragrafët 1 dhe 2, një operator i caktuar i një shteti anëtar që në vitin 2018 ka marrë një vëllim total vjetor hyrës të postës së letrave mbi 75,000 tonë (sipas informacionit zyrtar të deklaruar pranë Byrosë Ndërkombëtare ose çdo informacioni tjetër të disponueshëm zyrtarisht të vlerësuar nga Byroja Ndërkombëtare) mund të vetëdeklarojë tarifa për objektet e postës së letrave me shumicë (E) dhe pakove të vogla (E), të ndryshme nga ato të fluksit të postës së letrave të përcaktuara në paragrafët 1.1.6 dhe 1.1.7. Gjithashtu, operatori i caktuar në fjalë ka të drejtë të moszbatojë kufijtë maksimalë të rritjes së të ardhurave të përcaktuara në paragrafin 2, për fluksin e postës drejt, nga dhe ndërmjet vendit të tij dhe cilitdo vendi tjetër.

6.ter Nëse një autoritet kompetent i cili mbikëqyr operatorin e caktuar që ushtron opsionin e përmendur në paragrafin 6.bis përcakton që, në mënyrë që të mbulojë të gjitha kostot për trajtimin dhe shpërndarjen e objekteve të postës së letrave me shumicë (E) dhe pakove të vogla (E), tarifa e vetëdeklaruar e operatorit të caktuar çdo vit pas vitit 2020, duhet të bazohet në një raport kosto-tarifë që tejkalon 70% të tarifës vendase për një objekt, atëherë raporti kosto-tarifë për atë operator të caktuar mund të kalojë 70%, duke iu nënshtruar një kufizimi që ky raport që do të përdoret nuk duhet të kalojë një pikë përqindjeje më të lartë se 70% ose raporti kosto-tarifë i përdorur në llogaritjen e tarifave të vetëdeklaruar aktualisht në fuqi të mos tejkalojë 80%, dhe me kusht që operatori i caktuar në fjalë të deklarojë të gjitha këto informacione shtesë me anë të njoftimit të tij pranë Byrosë Ndërkombëtare, sipas dispozitave të paragrafit 1. Nëse ndonjë operator i caktuar e rrit raportin e tij kosto-tarifë bazuar në një përcaktim të tillë të një autoriteti kompetent, atëherë ai do të njoftojë Byronë Ndërkombëtare për atë raport, për ta publikuar deri më 1 mars të vitit paraardhës, vit në të cilin ky raport do të aplikohet. Specifikimet e mëtejshme në lidhje me kostot dhe të ardhurat që do të përdoren për llogaritjen e raportit specifik kosto-tarifë do të jepen në rregullore.

6.quer Kur një operator i caktuar i një shteti anëtar zgjedh të zbatojë paragrafin 6.bis, të gjithë



operatorët e tjerë të caktuar përkatës, përveç atyre që kanë flukset e përmendura në paragrafët 1.1.6 dhe 1.1.7, mund të bëjnë të njëjtën gjë në lidhje me operatorin e lartpërmendur.

6.quinquies Çdo operatori të caktuar që zgjedh të zbatojë opsionet e përshkruara në paragrafin 6.bis, në vitin kalendarik të hyrjes në fuqi të tarifave fillestare, do t'i kërkohet të paguajë një tarifë për UPU-në, për pesë vjet të njëpasnjëshëm (duke filluar me vitin kalendarik të zbatimit të opsionit të përmendur më lart sipas 6.bis), në shumën prej 8 milionë CHF në vit, për një total prej 40 milionë CHF. Asnjë pagesë e mëtejshme nuk pritet për vetëdeklarimin e tarifave, në përputhje me këtë paragraf, pas përfundimit të periudhës pesëvjeçare.

6.quinquies.1 Tarifa e lartpërmendur do të alokohet ekskluzivisht në përputhje me metodologjinë e mëposhtme: 16 milionë CHF do të alokohen në një fond të lidhur të UPU-së për zbatimin e projekteve që synojnë të dhënat elektronike të avancuara dhe sigurinë postare, sipas kushteve të një marrëveshjeje midis operatorit të caktuar në fjalë dhe UPU-së; dhe 24 milionë CHF do të alokohen në një fond të lidhur për qëllime të financimit të detyrimeve afatgjata të UPU-së, siç përcaktohet më tej nga Këshilli i Administrimit, sipas kushteve të një marrëveshjeje midis këtij operatori të caktuar dhe UPU-së.

6.quinquies.2 Tarifa e përcaktuar në këtë paragraf nuk do të zbatohet për ata operatorë të caktuar të shteteve anëtare që zbatojnë tarifa të vetëdeklaruar reciprokisht, sipas paragrafit 6.quater, si pasojë e një operatori tjetër të caktuar që ushtron mundësinë e vetëdeklarimit të tarifave, në përputhje me paragrafin 6.bis.

6.quinquies.3 Operatori i caktuar që paguan tarifën duhet të informojë Byronë Ndërkombëtare çdo vit sesi do të ndahet shuma prej 8 milionë CHF në vit, me kusht që pesë alokimet vjetore në total të shpërndahen siç përcaktohen më sipër, në përputhje me marrëveshjen e lartpërmendur. Një operatori të caktuar që ushtron mundësinë e vetëdeklarimit të tarifave, në përputhje me paragrafin 6.bis, do t'i sigurohet raportimi i duhur i shpenzimeve që lidhen me tarifën e dërguar, në zbatim të këtij paragrafi, nën kushtet e një marrëveshjeje ndërmjet këtij operatori të caktuar dhe UPU-së.

6.sexies Nëse një operator i caktuar ushtron mundësinë e vetëdeklarimit të tarifave, në

përputhje me paragrafin 6.bis, ose nëse një operator i caktuar reciprokisht zbaton një tarifë të vetëdeklaruar sipas paragrafit 6.quater, atëherë njëkohësisht me hyrjen në fuqi të tarifave të vetëdeklaruar, operatori në fjalë duhet të marrë në konsideratë dërgimin tek operatorët e caktuar të shteteve anëtare të UPU-së, mbi baza jodiskriminuese, të tarifave të rregulluara në mënyrë proporcionale për vëllimin dhe distancën, në masën që mund të jetë e mundur dhe e disponueshme në shërbimin e publikuar të vendit pranues për shërbime të ngjashme, nën një marrëveshje tregtare dypalëshe të dakordësuar, në kuadrin e rregullave të autoritetit rregullator kombëtar.

7. Për këtë nen nuk mund të bëhet asnjë rezervë.

Neni 29

Detyrimet përfundimtare. Dispozitat e aplikueshme për flukset e postës midis operatorëve të caktuar të shteteve të sistemit objektiv

1. Pagesat për artikujt e postës së letrave, duke përfshirë edhe postën me sasi, por duke përjashtuar “thasët M” dhe artikujt IBRS, do të vendoset në bazë të aplikimit të çmimeve për artikull ose për kilogram, duke reflektuar kostot e përpunimit në shtetin e destinacionit. Tarifat përkatëse të objekteve prioritare në shërbimin e brendshëm, të cilat janë pjesë e ofrimit të shërbimit universal do të përdoren si bazë për llogaritjen e shkallës së detyrimeve përfundimtare. Këto kosto duhet të përshtaten me tarifën e brendshme. Llogaritja e çmimeve do të bëhet në përputhje me kushtet e parashikuara në Rregulloren e Postës së Letrave.

2. Shkalla e detyrimeve përfundimtare në sistemin objektiv do të llogaritet duke marrë parasysh, kur është e zbatueshme në shërbimin e brendshëm, klasifikimin e objekteve bazuar në formatin e tyre, siç është përcaktuar në nenin 17.5 të Konventës.

3. Operatorët e caktuar në sistemin objektiv do të shkëmbejnë postën në formate të ndara në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregullore.

4. Pagesa për artikujt IBRS do të jetë ajo e përshkruar në rregulloret.

5. Tarifat për objektet dhe për kilogram janë të ndara për objekte të postës së letrave të vogla (P)



dhe të mëdha (G), dhe objekte të postës së letrave me shumicë (E) dhe pako të vogla (E). Ato do të llogariten mbi bazën e 70% të tarifës për një postë letër të vogël 20 gram (P) dhe për një objekt postar letër të madh (G) 175 gram, duke përfshirë TVSH-në ose taksa të tjera. Për artikujt me shumicë (E) dhe pako të vogla (E), ato do të llogariten nga vija e formatit P/G në 375 gramë, pa përfshirë TVSH-në ose taksa të tjera.

6. Këshilli i Operacioneve Postare do të përcaktojë kushtet për llogaritjen e tarifave, si dhe procedurat e nevojshme operationale, statistikore dhe të kontabilitetit për shkëmbimin e postës në formate të ndara.

7. Përveç tarifave të detyrimeve përfundimtare të zbatueshme, objektet e postës së letrave me shumicë (E) dhe pakove të vogla (E) për vitin 2020, tarifatat e zbatuara për flukset ndërmjet shteteve në sistemin objektiv në një vit të caktuar nuk duhet të çojnë në një rritje prej më shumë se 13% të të ardhurave të detyrimeve terminale për një objekt të postës së letrave në formatin P/G prej 37.6 gram dhe në formatin E prej 375 gram, krahasuar me një vit më parë.

8. Tarifatat e aplikuara për flukset ndërmjet shteteve në sistemin objektiv para vitit 2010, për objektet e vogla (P) dhe të mëdha (G) të postës së letrave nuk duhet të jenë më të larta se:

8.1 për vitin 2018, 0.331 SDR për artikull dhe 2.585 SDR për kilogram;

8.2 për vitin 2019, 0.341 SDR për artikull dhe 2.663 SDR për kilogram;

8.3 për vitin 2020, 0.351 SDR për artikull dhe 2.743 SDR për kilogram;

8.4 për vitin 2021, 0.362 SDR për artikull dhe 2.825 SDR për kilogram.

9. Tarifatat e zbatuara për flukset ndërmjet shteteve në sistemin objektiv para vitit 2010, për objektet e vogla (P) dhe të mëdha (G) të postës së letrave nuk duhet të jenë më të larta se:

9.1 për vitin 2018, 0705 SDR për artikull dhe 1.584 SDR për kilogram;

9.2 për vitin 2019, 026 SDR për artikull dhe 1.632 SDR për kilogram;

9.3 për vitin 2020, 0762 SDR për artikull dhe 1.714 SDR për kilogram;

9.4 për vitin 2021, 0.785 SDR për artikull dhe 1.765 SDR për kilogram.

10. Tarifatat e aplikuara për flukset ndërmjet shteteve në sistemin objektiv si përpara vitit 2010

ose nga 2010-a, 2012-a dhe 2016-a, për objektet e vogla (P) dhe të mëdha (G) të postës së letrave nuk mund të jenë më të larta se:

10.1 për vitin 2018, 0.227 SDR për objekt dhe 1.774 SDR për kilogram;

10.2 për vitin 2019, 0.233 SDR për objekt dhe 1.824 SDR për kilogram;

10.3 për vitin 2020, 0.240 SDR për objekt dhe 1.875 SDR për kilogram;

10.4 për vitin 2021, 0.247 SDR për objekt dhe 1.928 SDR për kilogram.

11. Tarifatat e zbatuara për flukset ndërmjet shteteve në sistemin objektiv para vitit 2010 ose nga 2010-a, 2012-a dhe 2016-a, për objektet me shumicë (E) dhe pakot e vogla (E) të postës së letrave nuk mund të jenë më të ulëta se:

11.1 për vitin 2018, 0.485 SDR për artikull dhe 1.089 SDR për kilogram;

11.2 për vitin 2019, 0.498 SDR për artikull dhe 1.120 SDR për kilogram;

11.3 për vitin 2020, 0.614 SDR për artikull dhe 1.381 SDR për kilogram;

11.4 për vitin 2021, 0.645 SDR për artikull dhe 1.450 SDR për kilogram;

11.5 për vitin 2022, 0.677 SDR për artikull dhe 1.523 SDR për kilogram;

11.6 për vitin 2023, 0.711 SDR për artikull dhe 1.599 SDR për kilogram;

11.7 për vitin 2024, 0.747 SDR për artikull dhe 1.679 SDR për kilogram;

11.8 për vitin 2025, 0.784 SDR për artikull dhe 1.763 SDR për kilogram.

12. Tarifatat e aplikuara për flukset ndërmjet shteteve në sistemin objektiv që nga 2010-a dhe 2012-a, si dhe ndërmjet këtyre vendeve dhe vendeve në sistemin objektiv përpara vitit 2010, për objektet e vogla (P) dhe të mëdha (G) të postës së letrave mund të mos jenë më të larta se:

12.1 për vitin 2018, 0.264 SDR për artikull dhe 2.064 SDR për kilogram;

12.2 për vitin 2019, 0.280 SDR për artikull dhe 2.188 SDR për kilogram;

12.3 për vitin 2020, 0.297 SDR për artikull dhe 2.319 SDR për kilogram;

12.4 për vitin 2021, 0.315 SDR për artikull dhe 2.458 SDR për kilogram.

13. Tarifatat e zbatuara për flukset ndërmjet vendeve në sistemin objektiv që nga viti 2010 dhe 2012, si dhe ndërmjet këtyre vendeve dhe vendeve në sistemin objektiv përpara vitit 2010, për objektet



me shumicë (E) dhe pakot e vogla (E) të postës së letrave nuk mund të jenë më të larta se:

13.1 për vitin 2018, 0.584 SDR për artikull dhe 1.313 SDR për kilogram;

13.2 për vitin 2019, 0.640 SDR për artikull dhe 1.439 SDR për kilogram;

13.3 për vitin 2020, 0.762 SDR për artikull dhe 1.714 SDR për kilogram;

13.4 për vitin 2021, 0.785 SDR për artikull dhe 1.765 SDR për kilogram.

14. Tarifat e zbatuara për flukset ndërmjet vendeve në sistemin objektiv që nga viti 2016, si dhe ndërmjet këtyre vendeve dhe vendeve në sistemin objektiv para vitit 2010 ose që nga 2010 dhe 2012, për objektet me shumicë (E) dhe pakot e vogla (E) për postën e letrave nuk mund të jenë më të larta se:

14.1 për vitin 2018, 0.234 SDR për artikull dhe 1.831 SDR për kilogram;

14.2 për vitin 2019, 0.248 SDR për artikull dhe 1.831 SDR për kilogram;

14.3 për vitin 2020, 0.263 SDR për artikull dhe 2.057 SDR për kilogram;

14.4 për vitin 2021, 0.279 SDR për artikull dhe 2.180 SDR për kilogram.

15. Tarifat e zbatuara për flukset ndërmjet vendeve në sistemin objektiv që nga viti 2016, si dhe ndërmjet këtyre vendeve dhe vendeve në sistemin objektiv para vitit 2010 ose që nga viti 2010 dhe 2012, për objektet me shumicë (E) dhe pakot e vogla (E) nuk mund të jenë më të larta se:

15.1 për vitin 2018, 0.533 SDR për artikull dhe 1.198 SDR për kilogram;

15.2 për vitin 2019, 0.602 SDR për artikull dhe 1.35 për kilogram;

15.3 për vitin 2020, 0.762 SDR për artikull dhe 1.714 SDR për kilogram;

15.4 për vitin 2021, 0.785 SDR për artikull 1.765 SDR për kilogram.

16. Për flukset e postës nën 50 tonë në vit ndërmjet vendeve që iu bashkuan sistemit objektiv në vitin 2010 dhe 2012, si dhe midis këtyre vendeve dhe vendeve që ishin në sistemin objektiv përpara vitit 2010, komponentët për kilogram dhe për objekt do të konvertohen në një tarifë totale për kilogram në bazë të një mesatareje botërore prej një kilogram postë, ku objektet e formatit P dhe G përbëjnë 8.16 objekte me peshë 0.31 kilogram dhe objektet e formatit E, përbëjnë 2.72 objekte me peshë 0.69 kilogram.

17. Për flukset e postës nën 75 tonë në vit në 2018 dhe 2019 dhe nën 50 tonë në vit në 2020–ën dhe në 2021–shin, ndërmjet vendeve që iu bashkuan sistemit objektiv në 2016–ën ose pas kësaj date, si dhe midis këtyre vendeve dhe vendeve që ishin në sistemin objektiv para vitit 2010 ose që nga viti 2010 dhe 2012, komponentët për kilogram dhe për objekt do të konvertohen në një tarifë totale për kilogram në bazë të një mesatareje botërore për një kilogram postë, siç referohet në paragrafin 16.

17.bis Detyrimet përfundimtare të tarifave të zbatueshme për artikujt me shumicë (E) dhe pako të vogla (E) të postës së letrave që janë vetëdeklaruar në bazë të nenit 28.bis do të zëvendësojnë tarifën që i përket artikujve me shumicë (E) dhe pako të vogla (E) të postës së letrave, në këtë nen; për rrjedhojë, dispozitat e përcaktuara në paragrafët 7, 9, 11, 13 dhe 15 nuk do të zbatohen.

18. Pagesa për “objektet postare me shumicë” të dërguar në vendet e sistemit objektiv para vitit 2010 do të përcaktohet duke aplikuar çmimet për objekt dhe kilogram të parashikuara në paragrafin 5 deri 11 ose nenin 28.bis, sipas rastit.

19. Pagesa për “objektet postare me shumicë” e dërguar në vendet e sistemit objektiv si për vitin 2010, 2012 dhe 2016, do të përcaktohet duke aplikuar çmimet për objekt dhe për kilogram të parashikuara në paragrafët 5 dhe 10 deri 15 ose nenin 28.bis, sipas rastit.

20. Nuk do të bëhet asnjë rezervë për këtë nen.

Neni 30

Shpenzimet përfundimtare. Dispozita të aplikueshme për fluksin e letrave për, nga dhe midis operatorëve të caktuar të shteteve të sistemit të tranzicionit

1. Në përgatitjen për të hyrë në sistemin objektiv të operatorëve të caktuar të shteteve në sistemin e tranzicionit të shpenzimeve përfundimtare, pagesat për postën e letrave, duke përfshirë postën në sasi, por duke përjashtuar “thasët M” dhe artikujt IBRS, do të vendosen në bazë të çmimit për objekt dhe çmimit për kilogram.

1.bis Gjithashtu, për sa i përket tarifave të detyrimeve përfundimtare të zbatueshme për objektet e postës së letrave me shumicë (E) dhe pakove të vogla (E) që janë vetëdeklaruar në bazë



të nenit 28.bis, dispozitat e nenit 29, paragrafët 1 deri 3 dhe 5 deri 7, do të zbatohen për llogaritjen e tarifave për artikull dhe për kilogram, të zbatueshëm për këto objekte nga viti 2020 e në vazhdim.

2. Pagesat për artikujt IBRS do të përshkruhen në rregullore.

3. Tarifat e aplikuara për flukset për, nga dhe ndërmjet shteteve në sistemin e tranzicionit për objekte të vogla (P) dhe të mëdha (G) të postës së letrave do të jenë:

3.1 për vitin 2018, 0.227 SDR për artikull dhe 1.774 SDR për kilogram;

3.2 për vitin 2019, 0.233 SDR për artikull dhe 1.824 SDR për kilogram;

3.3 për vitin 2020, 0.240 2 SDR për artikull dhe 1.875 SDR për kilogram;

3.4 për vitin 2021, 0.247 SDR për artikull dhe 1.928 SDR për kilogram.

4. Tarifat e zbatuara për flukset, drejt dhe ndërmjet vendeve në sistemin tranzit për objekte me shumicë (E) dhe pako të vogla (E) për postën e letrave, do të jenë:

4.1 për vitin 2018, 0.485 SDR për artikull dhe 1.089 SDR për kilogram;

4.2 për vitin 2019, 0.498 SDR për artikull dhe 1.120 SDR për kilogram.

4.bis Përveç tarifave të detyrimeve përfundimtare të zbatueshme për objektet me shumicë (E) dhe pako të vogla (E) të postës së letrave që janë vetëdeklaruar në bazë të nenit 28.bis dhe në përputhje me pikën 1.bis më lart, tarifat e zbatuara për flukset, drejt dhe ndërmjet vendeve në sistemin tranzit për objektet me shumicë (E) dhe pako të vogla (E) të postës së letrave, mund të mos jenë më të ulëta se:

4.bis.1 për vitin 2020, 0.614 SDR për artikull dhe 1.381 SDR për kilogram;

4.bis.2 për vitin 2021, 0.645 SDR për artikull dhe 1.450 SDR për kilogram;

4.bis.3 për vitin 2022, 0.677 SDR për artikull dhe 1.523 SDR për kilogram;

4.bis.4 për vitin 2023, 0.711 SDR për artikull dhe 1.599 SDR për kilogram;

4.bis.5 për vitin 2024, 0.747 SDR për artikull dhe 1.679 SDR për kilogram;

4.bis.6 për vitin 2025, 0.784 SDR për artikull dhe 1.763 SDR për kilogram.

4.ter Gjithashtu, për sa i përket tarifave të detyrimeve përfundimtare të zbatueshme për

Faqe|9386

objektet me shumicë (E) dhe pako të vogla (E) për postën e letrave që janë vetëdeklaruar në bazë të nenit 28.bis dhe në përputhje me pikën 1.bis më lart, tarifat e zbatuara për flukset ndërmjet vendeve në sistemin tranzit për këto objekte mund të mos jenë më të larta se:

4.ter.1 për vitin 2020, 0.762 SDR për artikull dhe 1.714 SDR për kilogram;

4.ter.2 për vitin 2021, 0.785 SDR për artikull dhe 1.765 SDR për kilogram.

5. Gjithashtu, për sa i përket tarifave të detyrimeve përfundimtare të zbatueshme për objektet me shumicë (E) dhe pako të vogla (E) për objektet e postës së letrave që janë vetëdeklaruar në bazë të nenit 28.bis, për flukset nën nivelin e fluksit të specifikuar në nenin 29.16 ose 29.17, në vitin 2018 dhe 2019, dhe nën nivelin e fluksit prej 100 tonë në vitin 2020 dhe 2021, komponentët për kilogram dhe për objekt do të konvertohen në një tarifë totale për kilogram në bazë të një mesatare botërore për kilogram dhe postë, si më poshtë:

5.1 për vitin 2018, 4.472 SDR për kilogram;

5.2 për vitin 2019, 4.592 SDR për kilogram;

5.3 për vitin 2020, jo më i ulët se 5.163 SDR për kilogram dhe jo më i lartë se 5.795 SDR për kilogram;

5.4 për vitin 2021, jo më i ulët se 5.368 SDR për kilogram dhe jo më i lartë se 5.967 SDR për kilogram.

6. Gjithashtu, për tarifat e detyrimeve përfundimtare të zbatueshme për objektet e postës së letrave me shumicë (E) dhe pakove të vogla (E) që janë vetëdeklaruar në përputhje me nenin 28.bis për flukset e postës mbi nivelin e përcaktuar në nenin 29.17, në vitin 2018 dhe 2019, dhe mbi 100 tonë në vitin 2020 dhe 2021, do të aplikohet çmimi i fiksuar për kilogramë siç është renditur më sipër, nëse as operatori i caktuar i origjinës dhe as operatori i caktuar i destinacionit nuk kërkojnë mekanizmin e rishikimit me qëllim rishikimin e çmimit në bazë të numrit real të artikujve për kilogramë, të ndryshëm nga mesatarja vjetore. Marrja e kampionëve për mekanizmin e rishikimit do të zbatohet në përputhje me kushtet e caktuara në rregulloren.

6.bis Për fluksin e postës nga dhe ndërmjet vendeve në sistemin tranzit nën 100 tonë dhe ku tarifat e detyrimeve përfundimtare të zbatueshme për objektet e postës së letrave me shumicë (E) dhe pakot e vogla (E) janë vetëdeklaruar në bazë të



nenit 28.bis nga operatori i caktuar i destinacionit, tarifa totale prej 5.368 SDR për kilogram do të zbatohet në vitin 2021.

6.ter Për fluksin e postës nga dhe ndërmjet vendeve në sistemin tranzit mbi 100 tonë, ku tarifën e detyrimeve përfundimtare të zbatueshme për objekte të postës së letrave me shumicë (E) dhe pakot e vogla (E) janë vetëdeklaruar në përputhje me nenin 28.bis dhe ku vendi i destinacionit vendos që të mos e marrë për kampion postën hyrëse, komponentët për kilogram dhe për objekt do të konvertohen në një tarifë totale për kilogram në bazë të një përbërjeje mesatare botërore për kilogram postë, siç përmendet në nenin 29.16.

6.quer Me përjashtim të flukseve postare të përshkruara në paragrafin 6.bis, tarifën e detyrimeve përfundimtare të zbatueshme për objektet e postës së letrave me shumicë (E) dhe pakot e vogla (E) që janë vetëdeklaruar në bazë të nenit 28.bis, do të zëvendësojnë tarifën që i përkasin këtyre objekteve në këtë nen; për rrjedhojë, dispozitat e përcaktuara në paragrafët 4.bis, 4.ter dhe 5 nuk do të zbatohen.

7. Nuk mund të kërkohej rishikimi në rënie i çmimit total të paragrafit 4 nga një shtet në sistemin objektiv ndaj një shteti në sistemin e tranzicionit, me përjashtim të rastit kur ky i fundit kërkon një rishikimin në drejtim të kundërt.

8. Për fluksin e postës drejt, nga dhe ndërmjet vendeve në sistemin tranzit, operatorët e caktuar mund të dërgojnë dhe marrin postë të ndarë me format, mbi baza opsionale, në përputhje me kushtet e specifikuar në rregulloret. Në rastin e shkëmbimeve të ndara me format, tarifën në paragrafët 3 dhe 4 do të zbatohen nëse operatori i caktuar i destinacionit vendos të mosvetëdeklarojë tarifën në përputhje me nenin 28.bis.

9. Paga për postën në sasi, për operatorët e caktuar në shtetet në sistemin objektiv, do të vendoset duke aplikuar çmimet për artikuj dhe për kilogramë, të dhëna në nenin 28.bis ose 29. Për postën në sasi të marrë, operatorët e caktuar në sistemin e tranzicionit mund të kërkojnë pagesën në përputhje me paragrafin 3 dhe 4, më sipër dhe nenin 28.bis, sipas rastit.

10. Nuk do të zbatohet asnjë rezervë për këtë nen.

Neni 31

Fondi për Cilësinë e Shërbimit

1. Detyrimet përfundimtare që paguhen nga të gjitha vendet dhe territoret për vendet e klasifikuara si vende më pak të zhvilluara dhe të përfshira në grupin IV, për qëllime të detyrimeve përfundimtare dhe të Fondit për Cilësinë e Shërbimit (QSF), me përjashtim të “thasëve M”, objekteve IBRS dhe objekteve postare me shumicë, do të rriten me 20% të tarifave të parashikuara në nenin 28.bis ose 30, për pagesa në QSF, për të përmirësuar cilësinë e shërbimit në ato vende. Nuk do të ketë pagesa të tilla nga një vend i grupit IV drejt një vendi tjetër të grupit IV.

2. Detyrimet përfundimtare, me përjashtim të “thasëve M”, objekteve IBRS dhe objekteve postare me shumicë, të pagueshme nga vendet dhe territoret e klasifikuara si vendet e grupit I, ndaj vendeve të klasifikuara si vende të grupit IV, përveç vendeve më pak të zhvilluara të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, do të rritet me 10% të tarifave të parashikuara në nenin 28.bis ose 30, për pagesa në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në ato vende.

3. Detyrimet përfundimtare, me përjashtim të “thasëve M”, objekteve IBRS dhe objekteve postare me shumicë, që paguhen nga vendet dhe territoret e klasifikuara si vende të grupit II, ndaj vendeve të klasifikuara si vendet e grupit IV, përveç vendeve më pak të zhvilluara, të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, do të rritet me 10% të tarifave të parashikuara në nenin 28.bis ose 30, për pagesa në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në ato vende.

4. Detyrimet përfundimtare, me përjashtim të “thasëve M”, objekteve IBRS dhe objekteve postare me shumicë, të cilat paguhen nga vendet dhe territoret e klasifikuara si vendet e grupit III ndaj vendeve të klasifikuara si vende të grupit IV, përveç vendeve më pak të zhvilluara të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, do të rriten me 5% të tarifave të parashikuara në nenin 28.bis ose 30, për pagesa në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në ato vende.

5. Një rritje prej 1%, e llogaritur në bazë të detyrimeve përfundimtare që paguhen nga vendet dhe territoret e klasifikuara si vendet e grupit I, II dhe III, për vendet e klasifikuara si vendet e grupit III, me përjashtim të “thasëve M”, objekteve IBRS



dhe objekteve postare me shumicë, do të paguhen në një fond të përbashkët që do të themelohet për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në vendet e klasifikuara në grupet II, III dhe IV, dhe do të menaxhohet në përputhje me procedurat përkatëse të përcaktuara nga Këshilli i Operacioneve Postare.

6. Gjithashtu, në bazë të procedurave përkatëse të përcaktuara nga Këshilli i Operacioneve Postare, çdo shumë e papërdorur që ka ardhur si kontribut sipas paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4, të këtij neni, dhe të grumbulluara gjatë katër viteve të kaluara të referencës së ngritjes së QSF-së (me vitin 2018 si vitin më të hershëm të referencës), do të transferohen në fondin e përbashkët të përmendur në paragrafin 5 të këtij neni. Për qëllimet e këtij paragrafi, vetëm fondet që nuk janë përdorur për projekte, në lidhje me cilësinë e shërbimit të miratuar nga QSF-ja, brenda dy viteve pas marrjes së pagesës së fundit të shumës së kontributit, për çdo periudhë katërvjeçare të përcaktuar, siç përcaktohet më sipër, do të transferohen në fondin e përbashkët të përmendur më lart.

7. Detyrimet e kombinuara përfundimtare që paguhen në QSF për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të vendeve në grupin IV do t'i nënshtrohen minimumit prej 20,000 SDR në vit për secilin vend përfitues. Fondet shtesë të nevojshme për arritjen e kësaj shume minimale do të faturohen, në përpjesëtim me vëllimet e shkëmbyera, në vendet e grupeve I, II dhe III.

8. Këshilli i Operacioneve Postare do të miratojë ose përditësojë, në vitin 2018, më së voni, procedurat për financimin e projekteve të QSF-së.

C. Tarifat e kolipostës

Neni 32

Tarifat e kolipostës tokësore dhe detare

1. Me përjashtim të kolive postare ECOMPRO, kolitë e shkëmbyera ndërmjet dy operatorëve të caktuar, do të jenë subjekt i çmimeve tokësore në hyrje, të llogaritura duke kombinuar çmimin bazë për koli dhe çmimin bazë për kilogram të përcaktuar nga rregullorja.

1.1 Duke pasur parasysh çmimet bazë të mësipërme, operatorët e caktuar mund të jenë të autorizuar të kërkojnë çmime shtesë për koli dhe për kilogramë, sipas dispozitave të parashikuara në rregullore.

1.2 Çmimet e përmendura në pikat 1 dhe 1.1, do të jenë të pagueshme nga operatori i caktuar i shtetit të origjinës, me përjashtim të rastit kur rregulloret parashikojnë përjashtime për këtë parim.

1.3 Çmimet tokësore për kolitë në hyrje duhet të jenë të njëjta për të gjithë territorin e çdo shteti.

2. Kolitë e shkëmbyera ndërmjet dy operatorëve të caktuar ose ndërmjet dy zyrave të të njëjtit shtet me anë të mjeteve të shërbimit tokësor të një ose të disa operatorëve të caktuar, do të jenë subjekt i çmimeve të tranzitit tokësor, të pagueshme operatorëve të caktuar të cilët marrin pjesë në transportin në tokë, të caktuara nga rregullorja në përputhje me hapin e distancës të aplikueshëm.

2.1 Për kolitë në tranzit *à découvert*, operatorët e caktuar ndërmjetës do të jenë të autorizuar të kërkojnë çmimin unik për artikull, të caktuar në rregullore.

2.2 Pagesat tokësore të tranzitit do të jenë të pagueshme nga operatori i caktuar i shtetit të origjinës, me përjashtim të rastit kur rregulloret parashikojnë përjashtime për këtë parim.

3. Çdo operator i caktuar, i cili merr pjesë në transportin detar të kolive, do të jetë i autorizuar të kërkojë çmimin e transportit detar. Këto çmime do të jenë të pagueshme nga operatori i caktuar i shtetit të origjinës, me përjashtim të rastit kur rregulloret parashikojnë përjashtime për këtë parim.

3.1 Për çdo transport detar të përdorur, çmimi detar do të caktohet nga rregulloret sipas hapit të distancës të aplikueshëm.

3.2 Operatorët e caktuar mund të rrisin me maksimumi 50% çmimin detar të llogaritur sipas pikës 3.1. Nga ana tjetër, ato mund ta reduktojnë atë sipas vullnetit të tyre.

D. Detyrimet e transportit ajror

Neni 33

Tarifat bazë dhe dispozitat në lidhje me detyrimet e transportit ajror

1. Çmimi bazë i zbatueshëm për shlyerjen e llogarive ndërmjet operatorëve të caktuar për transportet ajrore do të miratohet nga Këshilli i Operacioneve Postare. Ai do të llogaritet nga Byroja Ndërkombëtare sipas formulës së specifikuar në rregulloret. Tarifat e aplikueshme në transportin e kolive nëpërmjet shërbimit të kthimit



të mallrave do të llogariten sipas dispozitave të rregulloreve.

2. Llogaritja e detyrimeve të transportit ajror për dërgesat e mbyllura, artikujt prioritarë dhe artikujt e postës ajrore të dërguara në tranzit *à découvert*, artikujve të dërguar gabim dhe dërgesave të devijuara, si edhe mënyrat përkatëse të kontabilizimit do të përcaktohen në rregulloren e postës së letrave dhe në rregulloren e kolipostës.

3. Detyrimet e transportit ajror për të gjithë distancën do të paguhen:

3.1 në rastin e dërgesave të mbyllura, nga operatorët e caktuar të shtetit të origjinës, duke përfshirë edhe rastin kur dërgesat tranzitojnë në një ose më shumë operatorë të caktuar ndërmjetës;

3.2 në rastin e dërgesave prioritare dhe dërgesave me rrugë ajrore në tranzit *à découvert*, nga operatorët e caktuar të cilët dërgojnë artikujt tek një operator tjetër i caktuar.

4. Këto rregullore do të jenë të aplikueshme edhe për artikujt e përjashtuar nga tarifat e tranzitit tokësor dhe detar, nëse ata janë transportuar me rrugë ajrore.

5. Çdo operator i caktuar i destinacionit që ofron transportin ajror të postës ndërkombëtare brenda shtetit të tij, do të ketë të drejtën të rimbursohet për kostot shtesë të transportit, edhe pse mesatarja e ponderuar e udhëtimeve të bëra i kalon 300 kilometra. Këshilli i Operacioneve postare mund të zëvendësojë distancën mesatare të ponderuar me një kriter tjetër të qëndrueshëm. Me përjashtim të rastit të marrëveshjeve që parashikojnë shërbimin falas, shpenzimet duhet jenë të njëjta për të gjitha dërgesat prioritare dhe për dërgesat me avion, që vijnë nga jashtë shtetit, pavarësisht nëse ato dërgohen me transport ajror ose jo.

6. Megjithatë, kur detyrimet përfundimtare të vëna nga operatori i caktuar i destinacionit bazohet specifikisht mbi kostot ose çmimet e brendshme, ose tarifat e vetëdeklaruar sipas nenit 28.bis, nuk do të bëhet asnjë rimbursim plotësues për shpenzimet e transportit ajror.

7. Operatorët e caktuar të destinacionit do të përjashtojnë, për qëllimet e llogaritjes së distancës mesatare të ponderuar, peshën e të gjithë dërgesave për të cilat llogaritja e shpenzimeve përfundimtare bazohet specifikisht në kostot ose në çmimet e brendshme, ose tarifat e vetëdeklaruar sipas nenit 28.bis të operatorit të caktuar të destinacionit.

E. Përcaktimi i llogarive

Neni 34

Dispozita specifike për përcaktimin e llogarive dhe pagesave për shkëmbimet postare ndërkombëtare

1. Shlyerjet/pagesat, në lidhje me operacionet e mbartura në përputhje me këtë Konventë (duke përfshirë pagesat/shlyerjet për transportin (përcjelljen) e objekteve postare, pagesat/shlyerjet për trajtimin e objekteve postare në shtetin e destinacionit dhe pagesat e kompensimit në rast humbjeje, vjedhjeje ose dëmtimi, në lidhje me objektet postare), do të bazohen në dhe në përputhje me dispozitat e Konventës dhe akteve të tjera të Bashkimit, dhe nuk do të kërkojnë përgatitjen e ndonjë dokumenti nga operatorët e caktuar, përveç rasteve të përcaktuara në aktet e Bashkimit.

F. Caktimi i çmimeve dhe tarifave

Neni 35

Autoriteti i Këshillit të Operacioneve Postare për të caktuar tarifat dhe çmimet

1. Këshilli i Operacioneve Postare do të ketë autoritetin të caktojë çmimet dhe tarifat e mëposhtme, të cilat janë të pagueshme nga operatorët e caktuar sipas kushteve të caktuara në rregullore:

1.1 tarifat e tranzitit për përpunimin dhe transportin e dërgesave të letrave nëpërmjet një ose më shumë shteteve ndërmjetës;

1.2 çmimet bazë dhe detyrimet e transportit ajror të zbatueshme për postën me rrugë ajrore;

1.3 çmimet tokësore të të gjithë postës në hyrje për përpunimin e kolive të mbërritura, përveç kolive ECOMPRO;

1.4 çmimet tokësore të kolive të mbërritura për përpunimin dhe transportin e kolive nga një shtet ndërmjetës;

1.5 çmimet detare për transportin detar të kolive;

1.6 tarifat e jashtme tokësore për ofrimin e shërbimit të kthimit të kolive.

2. Çdo rishikim që mund të bëhet, në përputhje me metodologji që siguron shpërblim të barabartë për operatorët e caktuar që kryejnë këto shërbime,



duhet të mbështeten mbi të dhënat ekonomike dhe financiare të besueshme dhe përfaqësuese. Ndryshimi i mundshëm që mund të vendoset, do të hyjë në fuqi në një datë të caktuar nga Këshilli i Operacioneve Postare.

SEKSIONI VIII SHËRBIMET OPSIONALE

Neni 36

EMS-ja dhe logjistika e integruar

1. Shtete anëtare ose operatorët e caktuar mund të bien dakord me njëri-tjetrin për të marrë pjesë në shërbimet e mëposhtme, të cilat janë përshkruar në rregullore:

1.1 EMS-ja, i cili është një shërbim postar ekspres për dokumentet dhe mallrat, dhe sa herë të ketë mundësi, do të jetë shërbimi më i shpejtë postar me mjete fizike. Ky shërbim mund të ofrohet mbi bazën e një Marrëveshjeje Standarde Shumëpalëshe EMS ose të marrëveshjeve dypalëshe;

1.2 logjistika e integruar, e cila është një shërbim që i përgjigjet plotësisht kërkesave logjistike të klientelës dhe përfshin etapat që paraprijnë dhe ndjekin transmetimin fizik të mallrave dhe të dokumenteve.

Neni 37

Shërbimet elektronike postare

1. Shtetet anëtare ose operatorët e caktuar mund të bien dakord midis tyre për të marrë pjesë në shërbimet e mëposhtme elektronike të cilat janë përshkruar në rregullore:

1.1 posta elektronike, e cila është një shërbim elektronik që lidhet me transmetimin elektronik të mesazheve dhe informacionin nga operatorët e caktuar;

1.2 posta elektronike postare e regjistruar, e cila është një shërbim i sigurt elektronik postar që ofron dëshminë e dërgimit dhe provën e dërgimit të një mesazhi elektronik, dhe një kanal të sigurt komunikimi për përdoruesit e vërtetuar;

1.3 marka elektronike e certifikimit postar, e cila jep prova vërtetuese të një fakti elektronik, në një format të dhënë, në një moment të caktuar, në të cilën kanë marrë pjesë një ose disa palë;

1.4 kuti postare elektronike, e cila mundëson dërgimin e mesazheve elektronike nga një postues i certifikuar, shpërndarjen dhe ruajtjen e mesazheve elektronike dhe informacion për të adresuarit e autorizuar.

SEKSIONI IX DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 38

Kushtet për miratimin e propozimeve në lidhje me Konventën dhe rregulloren

1. Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet e paraqitura në Kongres, në lidhje me këtë Konventë, duhet të miratohen nga shumica e shteteve anëtare të pranishme dhe që votojnë duke pasur të drejtën e votës. Të paktën gjysma e shteteve anëtare të përfaqësuara në Kongres, që kanë të drejtën e votës, duhet të jenë të pranishëm në momentin e votimit.

2. Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet në lidhje me rregulloret duhet të miratohen nga shumica e anëtarëve të Këshillit të Operacioneve Postare, që kanë të drejtën e votës.

3. Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet e paraqitura midis dy Kongreseve në lidhje me këtë Konventë dhe protokollin përfundimtar të saj duhet të marrë:

3.1 dy të tretat e votave, ku të kenë marrë pjesë në votim të paktën gjysma e shteteve anëtare të Bashkimit, që kanë të drejtën e votës, nëse përfshihen amendime;

3.2 shumicë të votave, nëse përfshihen interpretime të dispozitave.

4. Pavarësisht nga dispozitat e parashikuara në pikën 3.1, çdo shtet anëtar, legjislacioni i brendshëm i të cilit është ende i papajtueshëm me amendimin e propozuar, mund të bëjë një deklarament me shkrim për drejtorin e përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare duke deklaruar pamundësinë për të pranuar këtë amendim, brenda 90 ditëve duke filluar nga data e njoftimit të tij.

Neni 39

Rezerva të paraqitura në Kongres

1. Nuk do të lejohen rezervat që nuk janë në përputhje me objektin dhe qëllimin e Bashkimit.



2. Si rregull i përgjithshëm, çdo shtet anëtar, pikëpamjet e të cilit nuk janë të njëjta me ato të shteteve të tjera, duhet të bëjë përpjekje, brenda mundësive, të përputhet me opinionin e shumicës. Rezervat do të bëhen vetëm në rast të nevojës absolute dhe duhen të jepet një motiv i përshtatshëm për to.

3. Rezervat për ndonjë nen të kësaj Konvente duhet të paraqiten në Kongres, në formën e propozimit për Kongres, të shkruar në një gjuhë pune të Byrosë Ndërkombëtare dhe në përputhje me dispozitat e rregullave të procedurës së Kongresit.

4. Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet që kanë të bëjnë me rezervat duhet të miratohen nga shumica e kërkuar për amendimin e nenit me të cilin lidhet rezerva.

5. Në parim, rezerva do të zbatohet në bazën e një reciprociteti midis shtetit anëtar që e paraqet atë dhe shteteve të tjera anëtare.

6. Rezervat e këtij Kongresi, do të përfshihen në protokollin përfundimtar të kësaj Konvente, mbi bazën e propozimeve të miratuara nga Kongresi.

Neni 40

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Konventës

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi nga 1 janari 2018 dhe do të jetë në fuqi deri në ardhjen në fuqi të akteve të Kongresit të ardhshëm.

Në dëshmi të sa më sipër, të plotfuqishmit e qeverive të shteteve anëtare kanë nënshkruar këtë Konventë në një kopje, e cila do të depozitohet pranë drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare. Një kopje do t'i jepet çdo pale nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit të Përbotshëm Postar.

Realizuar në Stamboll, më 6 tetor 2016.

PROTOKOLLI PËRFUNDIMTAR I KONVENTËS SË PËRBOTSHME POSTARE

Pasqyra e lëndës

Neni

I. Pronësia e objekteve postare. Tërheqja nga posta. Ndryshimi ose korrigjimi i adresës

II. Pullat postare

III. Postimi jashtë vendit i objekteve të postës së letrave

IV. Tarifat

V. Përjashtimi i objekteve për të verbrit nga pagesat postare

VI. Shërbimet postare

VII. Njoftimi i dërgimit

VIII. Ndalimet (posta e letrave)

IX. Ndalimet (koliposta)

X. Artikujt që i nënshtrohen taksës doganore

XI. Tarifa e paraqitjes në doganë

XII. Reklamacionet

XIII. Çmime tokësore të veçanta për postën në hyrje

XIV. Çmimet dhe dispozitat themelore në lidhje me detyrimet e transportit ajror

XV. Tarifat e posaçme

XVI. Autoriteti i Këshillit të Operacioneve Postare për rregullimin e tarifave

PROTOKOLLI PËRFUNDIMTAR I KONVENTËS SË PËRBOTSHME POSTARE

Në momentin e nënshkrimit të Konventës Postare Universale të përfunduar në këtë ditë, të plotfuqishmit ranë dakord, si më poshtë:

Neni I

Pronësia e artikujve postarë. Tërheqja nga posta. Ndryshimet ose korrigjimi i adresave

1. Dispozitat e nenit 5.1 dhe 2, nuk do të zbatohen në Antigua dhe Barbuda, Bahrein (Mbretëria), Barbada, Belize, Botsvana, Brunei Darusalam, Kanada, Hong Kong, Kinë, Domenika, Egjipt, Fixhi, Gambia, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, territoret e varura jashtë Mbretërisë së Bashkuar, Grenada, Guajanë, Irlandë, Xhamajkë, Kenia, Kiribati, Kuvait, Lesoto, Malavi, Malajzi, Mauricius, Noru, Zelandë e Re, Nigeri, Ugandë, Guine e Re, Shën Kristof dhe Nevis, Shën Lucia, Shën Vinsent dhe Grenadine, Samoa, Seishel, Sierra Leone, Singapor, Ishujt Solomon, Svaziland, (Republika e Bashkuar e) Tanzani, Trinidad dhe Tobago, Tuvalu, Ugandë, Vanuatu, Zambia.

2. Dispozitat e nenit 5.1 dhe 2 nuk do të zbatohen në Austri, Danimarkë, (Republika Islamike) Iran, legjislacionet e të cilit nuk lejojnë tërheqjen nga posta ose ndryshimin e adresave të korrespondencës sipas kërkesës së dërguesit, duke



filluar nga momenti kur marrësi është informuar për mbërritjen e një artikulli në adresën e tij.

3. Neni 5.1 nuk do të zbatohet në Australi, Ganë dhe Zimbabve.

4. Neni 5.2 nuk do të zbatohet në Bahamas, Belgjikë, Irak, në Republikën Popullore Demokratike të Koresë, Myanmar legjislacioni i të cilave nuk lejojnë tërheqjen nga posta ose ndryshimin e adresës së artikujve të postës së letrave, sipas kërkesës së dërguesit.

5. Neni 5.2 nuk do të zbatohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

6. Neni 5.2 nuk do të zbatohet në Australi, vetëm për aq sa ky nen është në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm.

7. Pavarësisht nga neni 5.2, El Salvadori, Panamaja, Filipinet, Republika Demokratike e Kongos, Venezuela, (Republika Boliviane) do të jenë të autorizuar të moskthejnë koltë pasi marrësi të ketë kërkuar zhdoganimin e tyre, duke qenë se legjislacioni doganor i vendit e kundërshton këtë.

Neni II Pullat postare

1. Pavarësisht nga neni 8.7, Australia, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Malajzia dhe Zelanda e Re do të përpunojnë objektet e postës së letrave dhe kolipostës që mbartin pulla postare, duke përdorur materiale ose teknologji të reja që nuk janë në përputhje me makinat e tyre përkatëse të përpunimit postar vetëm pas marrëveshjes paraprake me operatorin e caktuar.

Neni III Postimi jashtë shtetit të objekteve të postës së letrave

1. Australia, Austria, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Greqia, Zelanda e Re dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës rezervojnë të drejtën të marrin një tarifë, të barabartë me koston e punës që kërkohet, ndaj çdo operatori të caktuar, i cili sipas dispozitave të nenit 28.4, i dërgojnë artikuj që nuk janë dërguar si artikuj postarë nga shërbimet e tyre.

2. Pavarësisht nga neni 28.4, Kanadaja rezervon të drejtën të marrë nga operatorët e caktuar të

originës një shumë që do të sigurojë të paktën mbulimin e kostove të përballura nga ajo për përpunimin e këtyre artikujve.

3. Neni 28.4 autorizon operatorët e caktuar të destinacionit të kërkojnë nga operatori i caktuar dërgues, një shpërblim të përshtatshëm për dërgesën e artikujve të postës së letrave jashtë shtetit në sasi të mëdha. Australia dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut rezervojnë të drejtën të kufizojnë këtë pagesë në shumën korresponduese me tarifën e brendshme për artikuj të ngjashëm në shtetin e destinacionit.

4. Neni 28.4 autorizon operatorin e caktuar të destinacionit të kërkojë nga operatori i caktuar dërgues një shpërblim të përshtatshëm për shpërndarjen e artikujve të postës së letrave të postuara jashtë shtetit në sasi të mëdha. Shtetet anëtare të mëposhtme rezervojnë të drejtën për të kufizuar këtë pagesë në limitet e autorizuar në rregulloren për postën në sasi: Bahamas, Barbados, Brunei Darusalam, Kina (Republika Popullore), Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, territoret jashtë shtetit të varura nga Mbretëria e Bashkuar, Grenada, Gujana, India, Malajzia, Nepali, Zelanda e Re, Holanda, Antilet e Holandës dhe Aruba, Shën Lucia, Shën Vinsent dhe Grenadina, Singapor, Sri Lanka, Surinami, Tajlanda dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

5. Pavarësisht nga rezervat e pikës 4, shtetet anëtare të mëposhtme kanë të drejtën të zbatojnë të plota dispozitat e nenit 12 të Konventës për postën që marrin nga shtetet anëtare të Bashkimit: Argjentina, Australia, Austria, Azerbajxhani, Benini, Brazili, Burkina Faso, Kameruni, Kanadaja, Qipro, Bregu i Fildishtë (Republika), Qipro, Danimarka, Egjipti, Franca, Gjermania, Greqia, Guineja, Irani (Republika Islamike), Izraeli, Italia, Japonia, Jordania, Libani, Luksemburgu, Mali, Mauricius, Monako, Maroku, Norvegjia, Pakistani, Portugalia, Federata Ruse, Senegali, Zvicra, Republika Arabe e Sirisë, Togo dhe Turqia.

6. Në zbatim të nenit 28.4, Gjermania rezervon të drejtën të kërkojë nga shteti dërgues pagesën e një shume që është ekuivalente e asaj që do merrej nga shteti ku është rezident dërguesi.

7. Pavarësisht nga rezervat e bëra në nenin XII, Kina (Republika Popullore) rezervon të drejtën të kufizojë çdo pagesë për shpërndarjen e artikujve të postës së letrave të postuara jashtë shtetit në sasi të



mëdha nga limitet e autorizuar në Konventën e UPU-së dhe në rregulloret për postën në sasi.

8. Pavarësisht nga neni 12.3, Austria, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Lihtenshtajni dhe Zvicra rezervojnë të drejtën për të kërkuar nga dërguesi ose nga operatori i caktuar i postimit pagimin e tarifave të brendshme.

Neni IV

Tarifat

1. Pavarësisht nga neni 15, Australia, Bjellorusia, Kanadaja dhe Zelanda e Re, do të jenë të autorizuar të marrin tarifa postare të ndryshme nga ato të parashikuara në rregullore, kur këto tarifa janë në përputhje me legjislacionin e shtetit të tyre.

2. Pavarësisht nga neni 15, Brazili do të autorizohet të mbledhë një tarifë shtesë nga adresuesit e objekteve të zakonshme që përmbajnë mallra të cilat duhet të shndërroheshin në objekte të gjurmara si rezultat i kërkesave doganore dhe sigurisë.

Neni V

Përfshirja nga tarifat postare i objekteve për të verbrit

1. Pavarësisht nga neni 16, Indonezia, Shën Vinsenti dhe Grenadine, Turqia, të cilat nuk lejojnë përfshirjen nga tarifat postare të objekteve postare (cekogrameve) në shërbimin e tyre të brendshëm, mund të marrin tarifa postare dhe tarifa për shërbime speciale të cilat nuk do të tejkalojnë tarifën e aplikuar në shërbimin e tyre të brendshëm.

2. Franca do të aplikojë dispozitat e nenit 16, në lidhje me objektet për të verbrit që janë subjekt i rregullimit të tij kombëtar.

3. Pavarësisht nga neni 16.3, dhe në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar, Brazili rezervon të drejtën për të konsideruar si objekte për të verbrit ato objekte të cilat i dërgon ose adresohen për personat e verbrit ose organizatat për të verbrit. Objektet që nuk i plotësojnë këto kushte i nënshtrohen pagesës postare.

4. Pavarësisht nenit 16, Zelanda e Re do të pranojë si objekte për të verbrit, për t'u dërguar në Zelandën e Re, vetëm ato objekte që janë të përfshirë nga pagesat postare në shërbimin e tij të brendshëm.

5. Pavarësisht nga neni 16, Finlanda, e cila nuk siguron përfshirjen nga pagesat postare për objektet për të verbrit në shërbimin e tij të brendshëm, sipas përcaktimeve në nenin 7 të miratuar nga Kongresi, mund të mbledhë tarifën e brendshme për objektet për të verbrit të destinuar për vendet e tjera.

6. Pavarësisht nenit 16, Kanadaja, Danimarka dhe Suedia lejojnë përfshirjen nga tarifat postare për të verbrit vetëm në masën e përcaktuar në legjislacionin e tyre të brendshëm.

7. Pavarësisht nga neni 16, Islanda pranon përfshirjen nga tarifat postare për të verbrit vetëm në masën e parashikuar në legjislacionin e saj të brendshëm.

8. Pavarësisht nga neni 16, Australia do të pranojë si objekte për të verbrit, për t'u dërguar në Australi, vetëm ato objekte që janë përfshirë nga pagesat postare në shërbimin e tij të brendshëm.

9. Pavarësisht nga neni 16, Australia, Azerbajxhani, Austria, Kanadaja, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Japonia, Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund të mbledhin tarifa për shërbimet speciale të cilat zbatohen për objektet si literaturën për të verbrit në shërbimin e tyre të brendshëm.

Neni VI

Shërbimet bazë

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 17, Australia nuk miraton që shtrirja e shërbimeve bazë të përfshijë edhe koltë postare.

2. Dispozitat e nenit 17.2.4, nuk do të zbatohen në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, legjislacioni kombëtar i së cilës kërkon një limit më të ulët të peshës. Legjislacioni për shëndetin dhe sigurinë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut kufizon peshën e thasëve të postës deri në 20 kilogramë.

3. Pavarësisht nga neni 17.2.4, Azerbajxhani, Kazakistani, Kirgistani dhe Uzbekistani do të jenë të autorizuar të kufizojnë në 20 kilogramë peshën maksimale të "thasëve M" në hyrje dhe në dalje.

4. Pavarësisht nga neni 17, Islanda pranon objekte për të verbrit vetëm në masën e parashikuar në legjislacionin e saj kombëtar.



Neni VII Njoftimi i dërgimit

1. Kanadaja dhe Suedia do të jenë të autorizuar të mos zbatojnë nenin 18.3.3 për sa i përket kolive, me kusht që të mos ofrojnë shërbimin e njoftimit të dërgimit për koltë në shërbimin e tyre të brendshëm.

2. Pavarësisht nga neni 18.3.3, Danimarka dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut rezervojnë të drejtën të mospranojnë njoftimin e dërgimit të brendshëm, duke pasur parasysh që ato nuk ofrojnë njoftime të dërgimit në shërbimin e tyre të brendshëm.

3. Pavarësisht nga neni 18.3.3, Brazili do të autorizohet të pranojë njoftimet e dërgimit të brendshëm vetëm kur ato mund të kthehen në mënyrë elektronike.

Neni VIII Ndalimet (posta e letrave)

1. Në mënyrë të jashtëzakonshme, Republika Popullore Demokratike e Koresë dhe Libani nuk do të pranojnë artikuj rekomande që përmbajnë monedha ose kartëmonedha, letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi ose platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjera me vlerë. Ato nuk do të jenë rreptësisht të detyruara nga dispozitat e rregulloreve, për sa i përket përgjegjësisë së tyre në rast vjedhjeje dhe dëmtimi të artikujve rekomande, ose të artikujve që përmbajnë objekte prej qelqi ose delikate.

2. Në mënyrë të jashtëzakonshme, Bolivia, (Republika Popullore) e Kinës, me përjashtim të krahinës administrative speciale të Hong Kongut, Irakut, Nepalit, Pakistanit, Arabisë Saudite, Sudanit dhe Vietnamit nuk do të pranojnë artikuj rekomande që përmbajnë monedha ose kartëmonedha, letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi ose platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjera me vlerë.

3. Mianmar rezervon të drejtën të mospranojë artikujt e siguruar që përmbajnë objektet e çmuara të renditura në nenin 19.6, sepse kjo është në kundërshtim me legjislacionin e saj të brendshëm.

4. Nepali rezervon të drejtën të mospranojë artikujt rekomande ose të siguruar që përmbajnë

kartëmonedha ose monedha, me përjashtim të rasteve kur ka një marrëveshje të posaçme për këtë.

5. Uzbekistani nuk do të pranojë artikujt rekomande ose të siguruar që përmbajnë monedha, kartëmonedha, çeqe, pulla të postës dhe monedha të huaja, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

6. Irani (Republika Islamike) nuk do të pranojë dërgesat që përmbajnë objekte në kundërshtim me fenë Islame dhe rezervon të drejtën të mos pranojë objekte të postës së letrave (të zakonshme, të regjistruara ose të siguruar), që përmbajnë monedha, kartëmonedha, njoftim krediti ose letra me vlerë të pagueshme prurësit, çeqet e udhëimit, platin, ar ose argjend, nëse janë prodhuar apo jo, gurë të çmuar, bizhuteri apo artikuj të tjerë të vlefshëm dhe nuk do të pranojnë përgjegjësi në rastet e humbjes ose dëmtimit të sendeve të tilla.

7. Filipinet rezervojnë të drejtën të mospranojnë dërgesat e postës së letrave (të zakonshme, rekomande ose të siguruar), monedha, kartëmonedha, letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi ose platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar ose objekte të tjera me vlerë.

8. Australia nuk do të pranojë asnjë artikull postar që përmban lingota ose kartëmonedha. Përveç kësaj, ajo nuk do të pranojë artikujt rekomande me destinacion Australinë, as dërgesat në tranzit *à découvert* që përmbajnë objekte me vlerë, si: bizhuteri, metale të çmuara, gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar, kartëmonedha ose objekte të tjera financiare të negociueshme. Ajo largon çdo përgjegjësi në lidhje me artikujt e postuar, të cilat janë në kundërshtim me këtë rezervë.

9. Kina (Republika Popullore), me përjashtim të Krahinës Speciale Administrative të Hong Kongut, nuk do të pranojë artikujt të siguruar, që përmbajnë monedha, kartëmonedha, letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit dhe çeqe udhëtimi në përputhje me rregulloret e saj të brendshme.

10. Letonia dhe Mongolia, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm, rezervojnë të drejtën të mospranojnë postë të zakonshme, rekomande, ose të siguruar, që përmbajnë monedha, kartëmonedha, letra me vlerë të pagueshme prurësit dhe çeqe udhëtimi.

11. Brazili rezervon të drejtën të mospranojë postë të zakonshme, rekomande ose të siguruar, që përmban monedha, kartëmonedha në qarkullim



ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit.

12. Vietnami rezervon të drejtën të mospranojë letra që përmbajnë objekte ose mallra.

13. Indonezia nuk do të pranojë artikuj rekomande ose të siguruar që përmbajnë monedha, kartëmonedha, çeqe, pulla postare, monedha të huaja, ose çfarëdo lloj letrash me vlerë të pagueshme prurësit për t'u dorëzuar në Indonezi, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rastet e humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

14. Kirgistani rezervon të drejtën të mospranojë artikuj të postës së letrave (të zakonshëm, rekomande, të siguruar, pako të vogla) që përmbajnë monedha ose kartëmonedha, letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi ose platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjera me vlerë, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

15. Azerbajxhani dhe Kazakistani nuk do të pranojë artikuj rekomande ose të siguruar që përmbajnë monedha ose kartëmonedha, njoftim krediti ose letra me vlerë të pagueshme prurësit, çeqe, metale të çmuara, të përpunuara ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjera me vlerë ose monedha të huaja, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

16. Moldavia dhe Federata Ruse nuk do të pranojnë artikuj rekomande ose të siguruar që përmbajnë kartëmonedha në qarkullim, letra me vlerë (çeqe) të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit ose monedhë të huaj, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

17. Pavarësisht nga neni 19.3, Franca rezervon të drejtën për të mospranuar objektet që përmbajnë mallra në rastet kur këto objekte nuk përputhen me rregullat e saj kombëtare, ose rregullat ndërkombëtare, ose udhëzimet teknike për paketimin e transportit ajror.

18. Kuba rezervon të drejtën të mospranojë, trajtojë, përcjellë ose dërgojë objekte të postës së letrës që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe, metale dhe gurë të çmuar, stoli dhe artikuj të tjerë me vlerë, ose ndonjë lloj dokumenti, malli ose objekti në rastet kur këta artikuj nuk përputhen me rregulloret kombëtare të vendit, ose

rregulloret ndërkombëtare, ose udhëzimet teknike të paketimit për transportin ajror, dhe nuk pranojnë asnjë përgjegjësi në rastet e vjedhjes, humbjes ose dëmtimit të objekteve të tilla. Kuba rezervon të drejtën të mospranojë objekte të postës së letrave që i nënshtrohen detyrimeve doganore që përmbajnë mallra të cilat importohen në vend, nëse vlera e tyre nuk përputhet me rregulloret kombëtare të vendit.

Neni IX

Ndalimet (kollitë postare)

1. Mianmari dhe Zambia do të jenë të autorizuar të mospranojnë koli të siguruar që përmbajnë objekte të çmuara, të përmendura në nenin 19.6.1.3.1, duke qenë se është në kundërshtim me rregulloret.

2. Në mënyrë të jashtëzakonshme, Libani dhe Sudani nuk do të pranojnë kollitë, që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi, platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar dhe objekte të tjera të çmuara, ose që përmbajnë lëndë të lëngëta ose elemente të tjera lehtësisht të lëngëzueshme, ose objekte prej qelqi ose të ngjashme delikate. Ato nuk do të jenë të detyruara të respektojnë dispozitat përkatëse të rregulloreve.

3. Brazili do të jetë i autorizuar të mospranojë kollitë e siguruar që përmbajnë monedha dhe kartëmonedha në qarkullim, si edhe çfarëdo lloj letrë me vlerë të pagueshme prurësit, duke qenë se kjo është në kundërshtim me rregulloren e tij të brendshme.

4. Gana do të jetë e autorizuar të mospranojë kollitë e siguruar që përmbajnë monedha dhe kartëmonedha në qarkullim, duke qenë se kjo është në kundërshtim me rregulloren e saj të brendshme.

5. Përveç objekteve të përcaktuara në nenin 19, Arabia Saudite do të jetë e autorizuar të mospranojë kollitë që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi, platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar dhe objekte të tjerë të çmuara. Ajo nuk do të pranojë edhe kollitë që përmbajnë ilaçe të çdo lloji, me përjashtim të rastit kur shoqërohen me një recetë mjekësore të lëshuar nga një autoritet zyrtar kompetent, produkte të destinuara për fikjen e



zjarreve, lëngje kimike ose objekte të tjera, kundër parimeve të fesë Islame.

6. Përveç objekteve të referuara në nenin 19, Oman-i nuk pranon artikujt që përmbajnë:

6.1 ilaçe të çdo lloji, me përjashtim të rastit kur shoqërohen me një recetë mjekësore, e lëshuar nga një autoritet zyrtar kompetent;

6.2 produkte të destinuara për fikjen e zjarrit dhe lëngje kimike;

6.3 objekte që janë në kundërshtim me parimet e fesë Islame.

7. Përveç objekteve të cituara në nenin 19, Irani (Republika Islamike) do të jetë e autorizuar të mospranojë kolitë që përmbajnë artikuj në kundërshtim me parimet e fesë Islame dhe rezervon të drejtën të mospranojë kolipostë të zakonshme ose të siguruar, që përmbajnë monedha, kartëmonedha, njoftim krediti ose letra me vlerë të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi, platin, ar ose argjend, nëse janë prodhuar apo jo, gurë të çmuar, bizhuteri apo artikuj të tjerë të vlefshëm dhe nuk do të pranojnë përgjegjësi në rastet e humbjes ose dëmtimit të sendeve të tilla.

8. Filipinet do të jenë të autorizuar të mospranojnë koli që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi, platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar dhe objekte të tjera të çmuara, ose që përmbajnë lëngje dhe elemente lehtësisht të lëngzueshme, apo objekte prej qelqi ose të ngjashme, ose delikate.

9. Australia nuk pranon asnjë artikull postar që përmban lingota apo kartëmonedha.

10. Kina (Republika Popullore) nuk do të pranojë pakot e zakonshme që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit, çeqe udhëtimi, platin, ar, argjend, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar dhe objekte të tjerë të çmuara. Përveç kësaj, vetëm me përjashtim të Krahinës Speciale Administrative të Hong Kongut, nuk do të pranohen kolitë e siguruar që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit dhe çeqe udhëtimi.

11. Mongolia rezervon të drejtën të mospranojë, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar, kolitë që përmbajnë kartëmonedha, letra me vlerë të pagueshme prurësit dhe çeqe udhëtimi.

12. Letonia nuk pranon kolitë e zakonshme dhe të siguruar që përmbajnë kartëmonedha, letra me vlerë (çeqe) të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit ose monedha të huaja, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast humbjeje ose dëmtimi të këtyre artikujve.

13. Moldavia, Federata Ruse, Ukraina dhe Uzbekistani nuk pranojnë koli të zakonshme ose të siguruar që përmbajnë kartëmonedha në qarkullim, letra me vlerë (çeqe) të çfarëdo lloji të pagueshme prurësit ose monedhë të huaj, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

14. Azerbajxhani dhe Kazakistani do nuk do të pranojnë koli të zakonshme ose të siguruar që përmbajnë monedha ose kartëmonedha, njoftim krediti ose letra me vlerë të pagueshme prurësit, çeqe, metale të çmuara, të përpunuar ose jo, gurë të çmuar, bizhuteri dhe objekte të tjera me vlerë ose monedha të huaja, dhe nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi në rast të humbjes ose dëmtimit të këtyre artikujve.

15. Kuba rezervon të drejtën të mospranojë, trajtojë, përcjellë ose dërgojë objekte të postës së letrës që përmbajnë monedha, kartëmonedha ose letra me vlerë të çfarëdo lloji të pagueshme për prurësit, çeqe, metale dhe gurë të çmuar, stoli dhe artikuj të tjerë me vlerë, ose ndonjë lloj dokumenti, malli ose objekti në rastet kur këta artikuj nuk përputhen me rregulloret kombëtare të vendit, ose rregulloret ndërkombëtare, ose udhëzimet teknike të paketimit e transportit ajror dhe nuk pranojnë asnjë përgjegjësi në rastet e vjedhjes, humbjes ose dëmtimit të objekteve të tilla. Kuba rezervon të drejtën të mospranojë objekte të postës së letrave që i nënshtrohen detyrimeve doganore që përmbajnë mallra të cilat importohen në vend, nëse vlera e tyre nuk përputhet me rregulloret kombëtare të vendit.

Neni X

Objekte subjekt i detyrimeve doganore

1. Duke iu referuar nenit 19, Bangladeshi dhe El Salvadori nuk pranojnë artikuj të siguruar që përmbajnë objekte që ju nënshtrohen detyrimeve doganore.

2. Duke iu referuar nenit 19, Afganistani, Shqipëria, Azerbajxhani, Bjellorusia, Kamboxhia, Kili, Kolumbia, Kuba, Republika Popullore



Demokratike e Koresë, El Salvadori, Estonia, Italia, Kazakistani, Letonia, Moldavia, Nepali, Peruja, Federata Ruse, San Marino, Turkmenistani, Ukraina, Uzbekistani, Venezuela nuk pranojnë letrat e zakonshme dhe rekomande që përmbajnë objekte që ju nënshtrohen detyrimeve doganore.

3. Duke iu referuar nenit 19, Benini, Burkina Faso, (Republika) Bregu i Fildishtë, Xhibuti, Mali dhe Mauritania nuk pranojnë letra të zakonshme që iu nënshtrohen detyrimeve doganore.

4. Pavarësisht nga dispozitat e parashikuara në pikat 1 deri tek 3, dërgimi i serumeve, vaksinave, si edhe ilaçeve të kërkuara urgjent, të cilat është e vështirë të gjenden në vend, do të lejohen në të gjitha rastet.

Neni XI

Tarifa e paraqitjes në doganë

1. Gaboni rezervon të drejtën të marrë nga klientët e saj një tarifë të paraqitjes në doganë në lidhje me koltë.

2. Pavarësisht nga neni 20.2, Australia, Brazili, Kanadaja, Qiproja dhe Federata Ruse rezervojnë të drejtën të marrin nga klientët e tyre një tarifë të paraqitjes në doganë për çdo objekt që i nënshtrohet kontrollit doganor.

3. Pavarësisht nga neni 20.2, Azerbajxhani, Greqia, Pakistani dhe Turqia rezervojnë të drejtën të marrin nga klientët e tyre një tarifë për paraqitjen në doganë për të gjitha objektet që paraqiten pranë autoriteteve doganore.

4. Kongo (Republika) dhe Zambia rezervojnë të drejtën të marrin nga klientët e tyre një tarifë për paraqitjen në doganë në lidhje me koltë.

Neni XII

Reklamimet

1. Pavarësisht nga neni 21.2, Kepi i gjelbër, Çadi, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Egjipti, Gaboni, territoret jashtë vendit të varura nga Mbretëria e Bashkuar, Greqia, Irani (Republika Islamike), Kirgistani, Mongolia, Mianimari, Filipinet, Arabia Saudite, Sudani, Republika Arabe e Sirisë, Turkmenistani, Ukraina, Uzbekistani dhe Zambia rezervojnë të drejtën të marrin nga klientët tarifa mbi reklamimet e bëra në lidhje me artikujt e postës së letrave.

2. Pavarësisht nga neni 21.2, Argjentina, Austria, Azerbajxhani, Hungaria, Lituania, Moldavia, Norvegjia dhe Sllovakia, rezervojnë të drejtën të marrin një taksë speciale kur, pas hetimit të kryer në përgjigje të reklamimit, kjo e fundit konstatohet se ky i fundit nuk ishte i justifikuar.

3. Afganistani,, Kepi i Gjelbër, Kongo (Republika), Egjipti, Gaboni, Irani (Republika Islamike), Kirgistani, Mongolia, Mianmari, Arabia Saudite, Sudani, Surinami, Republika Arabe e Sirisë, Ukraina, Uzbekistani dhe Zambia rezervojnë të drejtën të marrin nga klientët e tyre një tarifë reklamimi në lidhje me koltë.

4. Pavarësisht nga neni 21.2, Brazili, Panamaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës rezervojnë të drejtën të marrin nga klientët e tyre një tarifë për reklamimet e bëra në lidhje me artikujt e postës së letrave dhe koltë e postuara në shtetet që aplikojnë këtë lloj tarife, në përputhje me paragrafët 1 deri në 3 të këtij neni.

Neni XIII

Çmime tokësore të jashtëzakonshme për postën në hyrje

1. Pavarësisht nga neni 32, Afganistani rezervon të drejtën të marrë një çmim tokësor të jashtëzakonshëm shtesë prej 7.50 SDR për koli.

Neni XIV

Tarifat dhe dispozitat themelore në lidhje me detyrimet e transportit ajror

1. Pavarësisht nga sa parashikohet në nenin 33, Australia rezervon të drejtën të aplikojë çmimet e transportit ajror për kolipostën e dërguar jashtë vendit nëpërmjet shërbimit të kthimit të mallrave, jo vetëm të parashikuara në rregullore, por edhe me mjete të tjera, duke përfshirë marrëveshjet dypalëshe.

Neni XV

Tarifa të posaçme

1. Belgjika, Norvegjia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund të marrin për koltë ajrore çmime më të larta se për koltë tokësore.

2. Libani do të jetë i autorizuar të marrë për koltë deri në 1 kilogram tarifën e aplikueshme për koltë mbi 1 dhe deri në 3 kilogramë.



3. Panamaja (Republika), do të jetë e autorizuar të marrë 0.20 SDR për kilogramë, për kolitë e transportuara me rrugë ajrore (S.A.L) në tranzit.

Neni XVI

Autoriteti i Këshillit të Operacioneve Postare për të rregulluar tarifat

1. Pavarësisht parashikimeve të nenit 36.1.6, Australia rezervon të drejtën të aplikojë tarifa tokësore të jashtme për ofrimin e shërbimit të kthimit të kolipostave, si të parashikuara në rregullore, ashtu edhe me mjete të tjera, duke përfshirë marrëveshjet dypalëshe.

Në dëshmi të sa më sipër, të plotfuqishmit si më poshtë, kanë hartuar këtë protokoll që do të ketë të njëjtën fuqi dhe vlefshmëri që do të kishin sikur këto dispozita të ishin përfshirë në tekstin e Konventës, dhe ata kanë nënshkruar në një kopje të vetme, e cila është dorëzuar pranë drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare. Një kopje do t'i jepet çdo pale nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit Postar Universal.

Realizuar në Stamboll, më 6 tetor 2016.

MARRËVESHJE E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE POSTARE

Pasqyra e lëndës

Pjesa I: Parime të përbashkëta që aplikohen për shërbimet e pagesave postare

Kapitulli I: Dispozita të përgjithshme

Neni:

1. Qëllimi i marrëveshjes
2. Përkufizime
3. Caktimi i subjektit ose subjekteve përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga respektimi i kësaj marrëveshjeje
4. Funkcionet e shteteve anëtare
5. Funksione operative
6. Pronësia e fondeve të shërbimeve të pagesave postare
7. Parandalimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit ekonomik
8. Konfidencialiteti dhe përdorimi i të dhënave personale
9. Neutraliteti teknologjik
- Kapitulli II: Parime të përgjithshme dhe cilësia e shërbimit
10. Parime të përgjithshme

11. Cilësia e shërbimit

Kapitulli III: Parime për shkëmbimin e të dhënave elektronike

12. Ndërveprueshmëria

13. Garantimi i sigurisë së shkëmbimeve elektronike

14. Gjurmimi dhe gjetja

Pjesa II: Rregullat që disiplinojnë shërbimet e pagesave postare

Kapitulli I: Përpunimi i urdhërpagesave postare

15. Depozitimi, regjistrimi dhe transmetimi i urdhërpagesave postare

16. Kontrolli dhe lëshimi i fondeve

17. Shuma maksimale

18. Rimbursimi

Kapitulli II: Reklamimet dhe përgjegjësitë

19. Reklamimet

20. Përgjegjësia e operatorëve të caktuar ndaj përdoruesve

21. Detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorëve të caktuar ndaj njëri-tjetrit

22. Mungesa e përgjegjësisë së operatorëve të caktuar

23. Rezerva në lidhje me përgjegjësinë

Kapitulli III: Marrëdhënie financiare

24. Rregullat e kontabilitetit dhe ato financiare

25. Shlyerja dhe kompensimi

Pjesa III: Dispozita tranzitore dhe përfundimtare

26. Rezerva të paraqitura në Kongres

27. Dispozita përfundimtare

28. Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare

MARRËVESHJE E SHËRBIMIT TË PAGESAVE POSTARE

Të nënshkruarit, të plotfuqishmit e qeverive të shteteve anëtare të Bashkimit, në përputhje me nenin 22.4, të Kushtetutës së Bashkimit Universal Postar, të realizuar në Vjenë, më 10 korrik 1964, me miratim të përbashkët dhe subjekt i nenit 25.4 të Kushtetutës, kanë hartuar marrëveshjen vijuese, e cila është në përputhje me parimet e Kushtetutës, në veçanti për të nxitur përfshirjen financiare dhe për zbatimin e një shërbimi të pagesave postare të sigurt dhe të arritshme nga numri më i lartë i përdoruesve në bazë të një sistemi që mundëson ndërveprueshmërinë e rrjeteve të operatorëve të caktuar.



PJESA I
PARIME TË PËRBASHKËTA QË
APLIKOHEN PËR SHËRBIMET E
PAGESAVE POSTARE

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

1. Çdo shtet do të garantojë, në bazë të përpjekjeve më të mira, se do të ofrojë ose pranojë të paktën një nga shërbimet e mëposhtme në territorin e tij:

1.1 Mandatpagesë në *cash*: dërguesi dorëzon fondet në pikën e aksesit të shërbimit të operatorit të caktuar dhe kërkon që e gjithë shuma t'i paguhet marrësit të pagesës në *cash*, pa asnjë mbajtje.

1.2 Pagesë me urdhërpagesë postare: dërguesi jep udhëzime që llogaria e tij e mbajtur nga operatori i caktuar të debitohet dhe kërkon që marrësi i pagesës të paguhet për shumën e plotë në *cash*, pa asnjë mbajtje.

1.3 Derdhje me urdhërpagesë postare: dërguesi dorëzon fondet në pikën e aksesit të shërbimit të operatorit të caktuar dhe kërkon që e gjithë shuma të paguhet në llogarinë e marrësit të pagesës, pa asnjë mbajtje.

1.4 Transferte postare: dërguesi jep udhëzime që llogaria e tij e mbajtur nga operatori i caktuar të debitohet dhe kërkon që llogaria e marrësit të pagesës me operatorin e caktuar pagues të kreditohet me shumë ekuivalente, pa asnjë mbajtje.

1.5 Mandatpagesë në para në dorë (*cash*): dërguesi i një objekti COD dorëzon fondet në pikën e aksesit të shërbimit të operatorit të caktuar ose jep udhëzime që llogaria e tij të debitohet, dhe kërkon që e gjithë shuma e specifikuar nga dërguesi i objektit COD të paguhet më vonë, pa asnjë zbritje.

1.6 Mandatpagesë urgjente: dërguesi dorëzon urdhërpagesat postare në pikën e aksesit të shërbimit të operatorit të caktuar dhe kërkon që t'i transferohen brenda 30 minutave dhe t'i paguhet të plotë të paguarit, pa asnjë zbritje, me kërkesën e të paguarit, në çdo pikë aksesi të vendit të destinacionit, në përputhje me listën e pikave të aksesit të shërbimeve të vendit të destinacionit.

2. Rregullorja do të përcaktojë procedurat për ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 2
Përkufizime

1. Autoriteti kompetent - çdo autoritet kombëtar i një shteti anëtar i cili, në bazë të kompetencave të dhëna nga ligji ose rregullorja, mbikëqyr aktivitetet e operatorit të caktuar ose të personave të referuar në këtë nen. Autoriteti kompetent mund të kontaktojë autoritetet administrative ose ligjore të angazhuara në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe në veçanti çdo njësi kombëtare të inteligjencës financiare dhe autoritetet e mbikëqyrjes.

2. Këstpagesë e pjeshme paraprake e kryer nga operatori i caktuar lëshues për të lehtësuar situatën e *cash*-it të shërbimeve të pagesave postare të operatorit të caktuar pagues.

3. Pastrimi i parave - konvertimi ose transferimi i fondeve në dijeni se këto fonde rrjedhin nga një veprimtari kriminale ose pjesëmarrja në këtë lloj veprimtarie, me qëllim fshehjen ose mbulimin e paligjshëm të origjinës së fondeve apo për të ndihmuar ndonjë person që ka marrë pjesë në të tilla aktivitete për t'i shpëtuar pasojave ligjore të veprimit të tij; pastrimi i parave do të konsiderohet si i tillë kur aktivitetet që prodhojnë fondet që do të pastrohen janë subjekt i ndjekjes penale në territorin e një shteti tjetër anëtar të UPU-së ose në një shtet të tretë.

4. Kufizim – ndarja e detyruar e fondeve të përdoruesit nga ato të operatorit të caktuar që ndalon përdorimin e fondeve të përdoruesit për qëllime të ndryshme nga ekzekutimi i operacioneve të shërbimit të pagesave postare.

5. Zyrë kompensimi – brenda kuadrit të shkëmbimeve shumëpalëshe, një zyrë kompensimi menaxhon debitë dhe kërkesat reciproke që rrjedhin nga shërbimet e ofruara nga një operatori një operatori tjetër. Roli i saj është të konsiderojë shkëmbimet ndërmjet operatorëve nëse janë shlyer me anë të bankës dhe të marrë hapat e nevojshëm në rast të parregullsive në shlyerje.

6. Kompensim – një sistem që mundëson mbajtjen në minimum të numrit të pagesave që do të kryhen duke hartuar një bilanc periodik debikredi për palët e përfshira. Kompensimi përfshin



dy faza: përcaktimin e bilanceve bilaterale dhe, duke shtuar këto bilance, llogaritjen e pozicionit të përgjithshëm të çdo njësie duke konsideruar të gjithë komunitetin, me qëllim për të kryer vetëm një shlyerje në bazë të pozicionit debitor ose kreditor të njësisë në fjalë.

7. Llogari e përqendrimit – një agregat i fondeve nga burime të ndryshme të kombinuara në një llogari.

8. Llogari ndërlidhëse – llogari rrjedhëse e hapur reciprokisht nga operatorët e caktuar si pjesë e marrëdhënieve dypalëshe, me anë të të cilës shlyhen debitë dhe kreditë e përbashkëta janë të vendosur.

9. Veprimtari kriminale – çdo lloj pjesëmarrjeje, ose kryerje e një krimi ose keqbërje, sipas përkufizimit në legjislacionin kombëtar.

10. Depozita e sigurisë – shuma e depozituar, në formë *cash*-i ose të letrave me vlerë, për të garantuar pagesat ndërmjet operatorëve të caktuar.

11. Marrësi i pagesës – person fizik ose juridik i caktuar nga dërguesi si përfitues i urdhërpagesave ose transfertave të llogarive rrjedhëse postare.

12. Monedhë e tretë – monedhë e ndërmjetme e përdorur në raste të pamundësisë së konvertimit ndërmjet dy monedhave ose për kompensimin / shlyerjen e llogarive.

13. Kontrolli i duhur profesional në lidhje me përdoruesit – detyrim i përgjithshëm nga ana e operatorëve të caktuar, duke përfshirë detyrat e mëposhtme:

13.1 identifikimin e përdoruesve;

13.2 marrjen e informacionit mbi qëllimin e urdhërpagesës postare;

13.3 monitorimin e urdhërpagesave postare;

13.4 kontrollin për përditësimin e informacionit në lidhje me përdoruesit;

13.5 raportimin e transaksioneve të dyshimta tek autoritetet kompetente.

14. Të dhëna elektronike në lidhje me urdhërpagesat postare - të dhënat e transmetuara në mënyrë elektronike, nga një operator i caktuar tek një tjetër, në lidhje me ekzekutimin e urdhrave, kërkesat për të dhëna, ndryshimin ose korrigjimin e adresave apo rimbursimin, të cilat janë të aktivizuar ose nga operatorët e caktuar, ose janë gjeneruar automatikisht nga sistemi i tyre i informacionit, dhe të cilat tregojnë një ndryshim ose kërkesë për statusin e urdhrit.

15. Të dhëna personale – informacion i nevojshëm me qëllim identifikimin e dërguesit, të dhëna të identifikimit personal që i referohen dërguesit ose marrësit të pagesës, të cilat mund të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin ato janë marrë.

16. Të dhëna postare – të dhëna që nevojiten për itinerarin dhe gjurmimin e urdhërpagesës ose për qëllime statistikore, si edhe për sistemin e centralizuar të kompensimit.

17. Shkëmbim i të dhënave elektronike (EDI) – shkëmbime të dhënash në lidhje me operacionet nga kompjuteri në kompjuter, me anë të rrjeteve dhe formateve standarde, të përputhshme me sistemin e Bashkimit.

18. Dërgues – person fizik ose juridik që i jep operatorit të caktuar urdhrin për të ekzekutuar një shërbim të pagesave postare në përputhje me aktet e Bashkimit.

19. Financimi i terrorizmit – mbulon financimin e akteve të terrorizmit, të terroristëve dhe të organizatave terroriste.

20. Fonde të përdoruesit – shuma të dërguara nga dërguesi tek operatori i caktuar lëshues në *cash* ose të debituar në llogarinë e dërguesit të shkruar në librat e operatorit të caktuar lëshues ose me anë të ndonjë metode tjetër të sigurt të veprimeve bankare elektronike, të vëna në dispozicion të operatorit të caktuar lëshues ose ndonjë operatori tjetër financiar nga dërguesi, që t'i paguhen marrësit të pagesës, të specifikuar nga dërguesi në përputhje me këtë marrëveshje dhe rregulloren e saj.

21. Mandat – pagesë në mandatpagesën për paratë në dorë (*cash*) COD (pagesa e mallrave pas dorëzimit) – term operacional i përdorur për të caktuar një urdhërpagesë postare të dhënë në shkëmbim për shpërndarjen e një objekti COD, siç është përcaktuar në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje.

22. Monedha e lëshimit – monedha e vendit të destinacionit ose monedha të treta të autorizuar nga vendet e destinacionit në të cilin urdhërpagesa postare është lëshuar.

23. Operator i caktuar lëshues – operatori i caktuar i cili transmeton një urdhërpagesë postare tek operatori i caktuar pages, në përputhje me aktet e Bashkimit.

24. Operator i caktuar pages – operatori i caktuar përgjegjës për ekzekutimin e urdhërpagesës postare në shtetin e destinacionit, në përputhje me aktet e Bashkimit.



25. Periudha e vlefshmërisë – periudha e kohës gjatë së cilës mund të ekzekutohet ose të anulohet një urdhërpagesë postare.

26. Pikë aksesi e shërbimit – vend fizik ose virtual ku përdoruesi mund të depozitojë ose marrë një urdhërpagesë postare.

27. Shpërblim – shumë që duhet t'i paguhet operatorit të caktuar pages nga operatori i caktuar lëshues për pagesës e marrësit të pagesës.

28. Revokueshmëria – aftësia e dërguesit për të tërhequr urdhrin e tij të pagesës postare (mandate pagese ose transferte) deri në momentin e pagesës ose në përfundim të periudhës së vlefshmërisë nëse nuk është bërë pagesa.

29. Risku i palës tjetër – risku që një nga palët e një kontrate të dështojë, të çojë në humbje apo risk të likuiditetit.

30. Risk i likuiditetit – risku që një sistem shlyerjeje pjesëmarrës ose një palë të jetë përkohësisht e paafte të përmbushë një detyrim në tërësi në momentin e kërkuar.

31. Raportimi i transaksioneve të dyshimta – detyrimi i operatorit të caktuar, në bazë të legjislacionit kombëtar dhe vendimeve të UPU-së për t'u siguruar autoriteteve të tyre kompetente kombëtare informacion mbi transaksionet e dyshimta.

32. Gjurmim dhe gjetje – sistem që mundëson monitorimin e progresit të urdhërpagesës postare dhe identifikimin e vendndodhjes dhe statusit të saj në çdo moment.

33. Çmimi – shuma e paguar nga dërguesi për operatorin e caktuar lëshues për një shërbim të pagesave postare.

34. Transaksion i dyshimtë – një urdhërpagesë postare ose e përsëritur, ose kërkesë për rimbursim për një pagesë postare, të lidhura me një vepër të pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit.

35. Përdorues – një person fizik ose juridik, dërgues ose marrës i pagesës, i cili përdor shërbimet e pagesave postare në përputhje me këtë marrëveshje.

Neni 3

Caktimi i subjektit ose subjekteve përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga respektimi i kësaj marrëveshjeje

1. Shtetet anëtare do të njoftojnë Byroën Ndërkombëtare për emrin dhe adresën e organit

shtetëror kompetent i cili do të ushtrojë veprimtarinë shtetërore rregullatore dhe kontrolluese, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave postare, për mbikëqyrjen e shërbimeve të pagesave postare brenda gjashtë muajve nga përfundimi i Kongresit.

2. Brenda gjashtë muajve nga përfundimi i Kongresit, shtetet anëtare do t'i japin Byrosë Ndërkombëtare emrin dhe adresën e operatorit/ëve të caktuar zyrtarisht për të operuar shërbimet e pagesës postare me anë të rrjetit të tyre, duke ofruar ose pranuar të paktën një shërbim pagese postare dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga aktet e Bashkimit në territoret e tyre.

3. Në mungesë të një njoftimi të tillë brenda periudhës së caktuar prej gjashtë muajsh, Byroja Ndërkombëtare do t'i dërgojë një letër kujtese shtetit anëtar.

4. Midis Kongreseve, ndryshimet në lidhje me organet qeveritare dhe operatorët e caktuar zyrtarisht do t'i njoftohen Byrosë Ndërkombëtare sa më shpejt që të jetë e mundur.

5. Operatorët e caktuar do të ofrojnë shërbimet e pagesave postare në përputhje me këtë marrëveshje.

Neni 4

Funksionet e shteteve anëtare

1. Shtetet anëtare do të ndërmarrin hapat e nevojshëm për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve të pagesave postare në rast të dështimit të operatorit/operatorëve të tyre të caktuar, pa cenuar përgjegjësinë e atij/atyre operatorëve ndaj operatorëve të tjerë të caktuar sipas akteve të Bashkimit.

2. Në rast të dështimit të operatorit të tij të caktuar, një shtet anëtar do të informojë, me anë të Byrosë Ndërkombëtare, shtetet e tjera anëtare palë të marrëveshjes:

2.1 për ndërprerjen e shërbimeve të tij të pagesave postare, që nga data e treguar dhe deri në njoftimin tjetër;

2.2 për masat e marra për të rifilluar shërbimet e tij nën përgjegjësinë e një operatori të ri të caktuar.

Neni 5

Funksione operative

1. Operatorët e caktuar do të jenë përgjegjës ndaj operatorëve të tjerë dhe përdoruesve për



ekzekutimin e shërbimeve të pagesave postare.

2. Ata do të jenë përgjegjës për risqe si: risqet operacionale, risqet e likuiditetit dhe të palës tjetër, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

3. Me qëllim zbatimin e shërbimeve të pagesave postare, dhënia e të cilave u është besuar nga shteti përkatës anëtar, operatori i caktuar do të lidhë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me operatorët e caktuar të zgjedhur prej tij.

4. Pa cenuar detyrimet e mësipërme, një operator i caktuar do të ketë mundësinë e nënkontraktimit, pjesërisht, ndërlidhjen dhe funksionimin e shërbimeve të pagesave postare, të përcaktuara më poshtë, të besuara nga shteti i tij anëtar, ndaj subjekteve të tjera, të lidhura me operator të caktuar nëpërmjet një kontrate dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar. Në këtë drejtim, operatori i caktuar duhet të garantojë përmbushjen e vazhdueshme të detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshjeje dhe do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha marrëdhëniet e tij me operatorët e caktuar të shteteve të tjera anëtare dhe me Byronë Ndërkombëtare.

Neni 6

Pronësia e fondeve të shërbimeve të pagesave postare

1. Çdo shumë të hollash, e dhënë në *cash* ose e debituar në llogari për ekzekutimin e një urdhërpagese postare, do t'i përkasë dërguesit deri në momentin kur i paguhet marrësit të pagesës ose kreditohet në llogarinë e marrësit të pagesës, përveç rastit të urdhërpagesave COD.

2. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së urdhërpagesës postare, dërguesi mund ta tërheqë këtë urdhërpagesë postare deri në momentin e pagesës së tij marrësit të pagesës ose kreditimit në llogarinë e tij, përveç rastit të urdhërpagesave COD.

3. Çdo shumë të hollash, e dhënë në *cash* ose e debituar në llogari për ekzekutimin e një urdhërpagese COD, do t'i përkasë dërguesit të objektit COD pasi të jetë lëshuar urdhri. Atëherë, urdhërpagesa është e pakthyeshme.

Neni 7

Parandalimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit ekonomik

1. Operatorët e caktuar do të ndërmarrin të gjitha hapat për të përmbushur detyrimet e tyre që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar për qëllimet e luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit ekonomik.

2. Ata duhet të informojnë autoritetet kompetente të shtetit të tyre për transaksionet e dyshimta, në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare.

3. Rregullorja do të përcaktojë detyrimet e detajuara të operatorëve të caktuar në lidhje me identifikimin e përdoruesit, kontrollin e duhur profesional dhe procedurat për zbatimin e rregulloreve kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit ekonomik.

Neni 8

Konfidencialiteti dhe përdorimi i të dhënave personale

1. Shtetet anëtare dhe operatorët e caktuar do të sigurojnë konfidencialitetin dhe sigurinë, si dhe përdorimin e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe të detyrimeve ndërkombëtare, kur ato janë të zbatueshme, dhe të rregullores. Dispozitat e këtij neni nuk do të kufizojnë dhënien e të dhënave personale me kërkesë të bazuar në ligjet kombëtare të çdo shteti anëtar.

2. Të dhënat e kërkuara për ekzekutimin e një urdhërpagese postare do të jenë konfidenciale. Të dhënat personale mund të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë mbledhur, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe detyrimet ndërkombëtare.

3. Të dhënat personale do të njoftohen vetëm për palët e treta të autorizuar nga legjislacioni kombëtar në fuqi për të pasur akses në të dhënat.

4. Operatorët e përcaktuar do të informojnë konsumatorët e tyre për përdorimin e të dhënave të tyre personale, dhe për qëllimin për të cilin janë mbledhur.

5. Të dhënat e kërkuara për të ekzekutuar urdhërpagesat postare duhet të jenë konfidenciale.



6. Për qëllime statistikore, dhe ndoshta edhe për qëllime të matjes së cilësisë së shërbimit dhe shlyerjes së centralizuar, operatorëve të caktuar do t'u kërkohet t'i japin të paktën një herë në vit të dhënat postare Byrosë Ndërkombëtare të Bashkimit Postar Universal. Byroja Ndërkombëtare do të trajtojë të gjitha të dhënat individuale postare në mënyrë konfidenciale.

Neni 9

Neutraliteti teknologjik

1. Shkëmbimi i të dhënave të nevojshme për dhënien e shërbimeve të përkufizuara në këtë marrëveshje do të disiplinohet nga parimi i neutralitetit teknologjik, çka domethënë se dhënia e këtyre shpenzimeve nuk varet nga përdorimi i një teknologjie të veçantë.

2. Procedurat për ekzekutimin e urdhërpagesave postare, duke përfshirë kushtet për depozitimin, regjistrimin, dërgimin, urdhrat e pagesës dhe rimbursimit dhe për përpunimin e reklamimeve, si dhe afatet për bërjen e fondeve të disponueshme për marrësin e pagesës, mund të ndryshojnë në bazë të teknologjisë së përdorur për transmetimin e urdhrit.

3. Shërbimet e pagesave postare mund të ofrohen në bazë të kombinimit të teknologjive të ndryshme.

KAPITULLI II

PARIME TË PËRGJITHSHME DHE CILËSIA E SHËRBIMIT

NENI 10

PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Aksesit me anë të rrjetit dhe përfshirja financiare

1.1 Shërbimet e pagesave postare do të ofrohen nga operatorët e caktuar me anë të rrjetit/rrjeteve të tyre ose me anë të rrjetit të një partneri me qëllim garantimin e aksesit për numrin më të madh të klientëve në këto shërbime dhe me qëllim sigurimin e qasjes në, dhe përdorimin e një game të gjerë shërbimesh të pagesave postare me çmim të përballueshëm.

1.2 Të gjithë përdoruesit do të kenë akses në shërbimet e pagesave postare pavarësisht nga marrëdhëniet kontraktore ose tregtare që ekzistojnë me operatorin e caktuar.

2. Ndarja e fondeve

2.1 Fondet e përdoruesve do të jenë të ndara. Këto fonde dhe flukset që ato gjenerojnë do të ndahen nga fondet dhe flukset e tjera të operatorëve, veçanërisht nga fondet e vetë operatorëve.

2.2 Shlyerjet në lidhje me shpërblimin ndërmjet operatorëve të caktuar janë të ndara nga shlyerjet që lidhen me fondet e përdoruesve.

3. Monedha e lëshimit dhe monedha e pagesës në lidhje me urdhërpagesat postare

3.1 Shuma e urdhërpagesës postare do të shprehet dhe paguhet në monedhën e shtetit të destinacionit ose në ndonjë monedhë tjetër të autorizuar nga shteti i destinacionit.

4. Pranimi

4.1 Transmetimi i urdhërpagesave postare me anë të mjeteve elektronike do të jetë subjekt i parimit të pranimit, në kuptimin që operatori i caktuar lëshues nuk do të verë në dyshim këto urdhra dhe operatori i caktuar pages nuk do të mohojë marrjen e urdhrit, për sa kohë që mesazhi përputhet me standardet teknike të aplikueshme.

4.2 Pranimi i urdhërpagesave postare do të garantohet me mjete teknologjike, pavarësisht nga sistemi i përdorur nga operatorët e caktuar.

5. Ekzekutimi i urdhërpagesave postare

5.1 Urdhërpagesat postare të transmetuara ndërmjet operatorëve të caktuar duhet të ekzekutohen, subjekt i dispozitave të kësaj marrëveshje dhe legjislacionit kombëtar.

5.2 Në rrjetin e operatorëve të operatorëve të caktuar, nëse të dyja shtetet anëtare përdorin të njëjtën monedhë, shumën e dërguar nga dërguesi tek operatori i caktuar lëshues do të jetë e njëjtë me shumën e paguar marrësit të pagesës nga operatori i caktuar pages. Nëse monedha nuk është e njëjtë, shumën do të konvertohet në bazë të një kursi këmbimi të vendosur, të këmbimit për lëshimin dhe/ose pagesën, sipas rastit.

5.3 Pagesa me para në dorë e marrësit të pagesës nuk do të jetë e kushtëzuar nga marrja e fondeve përkatëse të dërguesit nga operatori i caktuar pages. Ajo do të jetë subjekt i përmbushjes së detyrimeve të tij nga operatori i caktuar lëshues, ndaj operatorit të caktuar pages në lidhje me këstet, shlyerjen e rregullt të llogarive, vënien në dispozicion të një llogarie lidhëse ose shlyerjes nëpërmjet sistemit të centralizuar të kleringut dhe shlyerjes.



5.4 Pagesa në llogarinë e përfituesit nga operatori i caktuar që paguan do të jetë e kushtëzuar nga marrja e fondeve përkatëse nga dërguesi, të cilat do të vihen në dispozicion nga operatori i caktuar lëshues për operatorin e caktuar që paguan. Këto fonde mund të vijnë nga llogaria lidhëse e operatorit të caktuar lëshues ose nga një sistem i centralizuar i kleringut dhe shlyerjes.

6. Vendosja e çmimeve

6.1 Operatori i caktuar lëshues do të vendosë çmimin e shërbimeve të pagesave postare.

6.2 Këtij çmimi mund t'i shtohen tarifa për çdo shërbim shtesë ose plotësues të kërkuar nga dërguesi.

7. Përrjashtimi nga tarifat

7.1 Dispozitat e Konventës Universale Postare, në lidhje me përrjashtimin nga tarifat postare për të burgosurit e luftës dhe të internuarit civilë, do të aplikohen për artikujt e shërbimeve të pagesave postare për këtë kategori të marrësve të pagesës.

8. Shpërblimi i operatorit të caktuar pages

8.1 Operatori i caktuar pages do të shpërblehet nga operatori i caktuar lëshues për ekzekutimin e urdhërpagesave postare.

9. Intervalet për shlyerjen ndërmjet operatorëve të caktuar

9.1 Frekuenca e shlyerjeve ndërmjet operatorëve të caktuar, e shumave të paguara ose të kredituara marrësve të pagesave në emër të dërguesve, mund të jetë e ndryshme nga ajo në lidhje me shlyerjen e shpërblimeve ndërmjet operatorëve të caktuar. Shumat e paguara ose të kredituara duhet të shlyhen të paktën një herë në muaj.

10. Detyrimi për të informuar përdoruesit

10.1 Përdoruesit do të kenë të drejtë për të marrë informacionin vijues, i cili do të publikohet ose të vihet në dispozicion të të gjithë dërguesve: kushtet që mbulojnë dhënien e shërbimeve të pagesave postare, çmimet, tarifat, kurset e këmbimit dhe marrëveshjet, kushtet e zbatimit të përgjegjësisë dhe adresat e shërbimeve të informacionit dhe reklamimit.

10.2 Aksesit në këtë informacion do të sigurohet papagesë.

Neni 11

Cilësia e shërbimit

1. Operatorët e caktuar mund të vendosin të identifikojnë shërbimet e pagesave postare me anë të një marke kolektive.

Faqe | 9404

2. Këshilli i Operacioneve Postare do të përcaktojë objektivat e cilësisë së shërbimit, elementet dhe standardet për urdhërpagesat postare të transmetuara në mënyrë elektronike.

3. Operatorët e përcaktuar duhet të aplikojnë një numër minimal të elementeve të cilësisë së shërbimit dhe standardeve për urdhërpagesat postare të transmetuara në mënyrë elektronike.

KAPITULLI III

PARIMET PËR SHKËMBIMET E TË DHËNAVE ELEKTRONIKE

NENI 12

NDËRVEPRUESHMËRIA

1. Rrjetet

1.1 Me qëllim për të shkëmbyer të dhënat e nevojshme për të ekzekutuar shërbimet e pagesave postare ndërmjet të gjithë operatorëve të caktuar dhe për të monitoruar cilësinë e shërbimit, operatorët e caktuar do të përdorin sistemin e shkëmbimit të të dhënave elektronike të Bashkimit (EDI) ose ndonjë sistem tjetër që garanton ndërveprueshmërinë e shërbimeve të pagesave postare në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 13

Garantimi i sigorisë së shkëmbimeve elektronike

1. Operatorët e caktuar do të jenë përgjegjës për funksionimin e mirë të pajisjeve të tyre.

2. Transmetimi elektronik i të dhënave do të bëhet i sigurt, me qëllim garantimin e autenticitetit dhe integritetit të të dhënave të transmetuara.

3. Operatorët e caktuar do t'i bëjnë transaksionet të sigurta sipas standardeve ndërkombëtare.

Neni 14

Gjurmimi dhe gjetja

1. Sistemet e përdorura nga operatorët e caktuar do të mundësojnë monitorimin e procedimit të urdhrit dhe revokimin e tij nga dërguesi, deri në momentin kur shuma përkatëse i paguhet marrësit të pagesës ose kreditohet në llogarinë e tij, ose, nëse është rasti, i rimbursohet dërguesit.



PJESA II
RREGULLAT QË DISIPLINOJNË
SHËRBIMET E PAGESAVE POSTARE

KAPITULLI I
PËRPUNIMI I URDHËRPAGESAVE
POSTARE

Neni 15

**Depozitimi, regjistrimi dhe transmetimi i
urdhërpagesave postare**

1. Kushtet për depozitimin, regjistrimin dhe transmetimin e urdhërpagesave postare janë vendosur në rregullore.

2. Periudha e vlefshmërisë për urdhërpagesat postare nuk mund të zgjatet dhe është vendosur në rregullore.

Neni 16

Kontrolli dhe lëshimi i fondeve

1. Pas konfirmimit të identitetit të marrësit të pagesës, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe saktësinë e informacionit që ai ka dhënë, operatori i caktuar do të bëjë pagesën në *cash*. Për një urdhërderdhje ose transfertë, kjo pagesë do të kreditohet në llogarinë e marrësit të pagesës.

2. Limitet kohore për lëshimin e fondeve do të vendosen në marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërmjet operatorëve të caktuar.

Neni 17

Shuma maksimale

1. Operatorët e caktuar do të informojnë Byronë Ndërkombëtare të Bashkimit Postar Universal për shumat maksimale për dërgimin ose marrjen, të vendosura në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

Neni 18

Rimbursimi

1. Shtirja e rimbursimit

1.1 Rimbursimi brenda kuadrit të shërbimeve të pagesave postare do të mbulojë shumën e plotë të urdhërpagesave postare në monedhën e shtetit lëshues. Shuma që do të rimbursohet do të jetë e njëjtë me shumën e paguar nga dërguesi ose

shumën e ngarkuar në llogarinë e tij. Çmimi i shërbimit të pagesës postare do të shtohet në shumën e rimbursuar në rast të një gabimi nga operatori i caktuar.

1.2 Nuk do të ketë rimbursim për urdhërpagesat COD.

KAPITULLI II

REKLAMIMET DHE PËRGJEGJËSIA

NENI 19

REKLAMIMET

1. Reklamimet do të merren brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga dita pas asaj në të cilën është pranuar urdhërpagesa postare.

2. Operatorët e caktuar, subjekt i legjislacionit të tyre kombëtar, do të kenë të drejtën e marrjes së tarifave mbi reklamimet në lidhje me urdhërpagesat postare nga klientët.

Neni 20

**Përgjegjësia e operatorëve të caktuar ndaj
përdoruesve**

1. Trajtimi i fondeve

1.1 Me përjashtim të rastit të urdhërpagesave COD, operatori i caktuar lëshues do të jetë përgjegjës ndaj dërguesit për shumat e dorëzuara në arkë ose të debituar në llogarinë e dërguesit deri në momentin kur urdhërpagesa postare është paguar sipas rregullave ose është kredituar në llogarinë e marrësit të pagesës, ose deri sa fondet t'i jenë rimbursuar dërguesit në formë të *cash*-it ose si kredi në llogarinë e tij.

1.1.1 Urdhërpagesa postare është paguar në mënyrë të rregullt; ose

1.1.2 Llogaria e të paguarit është kredituar; ose

1.1.3 Fondet janë rimbursuar për dërguesin në formën e parave në dorë (*cash*) ose si një kredi në llogarinë e tij.

1.2 Për mandatpagesat COD, operatori lëshues i përcaktuar do të jetë përgjegjës për të paguarin për shumat “e dorëzuara nën dorë” ose të debituar në llogarinë e dërguesit derisa mandatpagesat COD të jenë paguar rregullisht ose llogaria e të paguarit të jetë kredituar.



Neni 21

Detyrimet dhe përgjegjësia e operatorëve të caktuar ndaj njëri-tjetrit

1. Çdo operator i caktuar do të jetë përgjegjës për gabimet e tij.
2. Kushtet dhe kohëzgjatja e përgjegjësisë janë vendosur në rregullore.

Neni 22

Mungesa e përgjegjësisë së operatorëve të caktuar

1. Operatorët e caktuar nuk do të jenë përgjegjës:
 - 1.1 në rast të vonesës në ekzekutimin e shërbimit;
 - 1.2 kur ata nuk mund të shpjegojnë në lidhje me ekzekutimin e një urdhërpagese për shkak të shkatërrimit të të dhënave të shërbimit të pagesave postare nga forca madhore, me përjashtim të rastit kur është dhënë ndonjë provë tjetër e përgjegjësisë së tyre;
 - 1.3 kur dëmtimi është shkaktuar nga gabimi ose neglizhenca e dërguesit, veçanërisht për sa i përket përgjegjësisë së tij për të dhënë informacion të saktë, në mbështetje të urdhrat të tij të pagesës, duke përfshirë faktin se fondet e dërguara janë nga një burim legjitim dhe se urdhërpagesa postare ka një qëllim legjitim;
 - 1.4 nëse fondet e dërguara janë sekuestruar;
 - 1.5 në rastin e fondeve të të burgosurve të luftës ose të internuarve civilë;
 - 1.6 kur përdoruesi nuk ka paraqitur reklamim brenda periudhës së vendosur në marrëveshjen aktuale;
 - 1.7 kur ka përfunduar koha e lejuar për rekurs, në lidhje me shërbimet e pagesave postare në shtet të lëshimit.

Neni 23

Rezerva në lidhje me përgjegjësinë

1. Përveç rasteve të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, nuk mund të bëhen rezerva për dispozitat që kanë të bëjnë me përgjegjësinë, të përshkruara në nenet 20 deri në 22.

KAPITULLI III

MARRËDHËNIE FINANCIARE

Neni 24

Rregullat e kontabilitetit dhe ato financiare

1. Rregulla të kontabilitetit
 - 1.1 Operatorët e caktuar do të përputhen me rregullat e kontabilitetit të vendosura në rregullore.
 2. Përgatitja e llogarive mujore dhe të përgjithshme
 - 2.1 Operatori i caktuar pages do të përgatisë për çdo operator të caktuar lëshues një llogari mujore, duke treguar shumat e paguara për urdhërpagesat postare. Llogaritë mujore do të përfshihen, me intervale të njëjta, në një llogari kompensimi duke përfshirë këstet dhe duke krijuar një bilanc.
 3. Kësti
 - 3.1 Në rast të mosbalancimit në shkëmbimet midis operatorëve të caktuar, të paktën një herë në muaj, në fillim të periudhës së shlyerjes, do të paguhet një këst nga operatori i caktuar lëshues tek operatori i caktuar pages. Në rastet kur rritja e frekuencës së shkëmbimeve redukton periudhën në më pak se një javë, operatorët mund të bien dakord të heqin dorë nga ky këst.
 4. Llogari të përqendruar
 - 4.1 Në parim, çdo operator i caktuar do të ketë një llogari të përqendruar për fondet e përdoruesve. Këto fonde do të përdoren vetëm për shlyerjen e urdhrave të paguara marrësve të pagesës ose për rimbursimin e dërguesve për urdhrat e paekzekutuar.
 - 4.2 Çdo këst i paguar nga operatori i caktuar lëshues do të kreditohet në llogarinë e përqendrimit për operatorin e caktuar pages. Këto këste do të përdoren ekskluzivisht për pagesat e marrësve.
 5. Depozita e sigurisë
 - 5.1 Pagesa e një depozite të sigurisë mund të kërkohej në përputhje me kushtet e parashikuara në rregullore.

Neni 25

Shlyerja dhe kompensimi

1. Shlyerja e centralizuar
 - 1.1 Shlyerjet ndërmjet operatorëve të caktuar mund të kalojnë nëpërmjet një zyre qendrore të kompensimit, në përputhje me procedurat e



vendosura në rregullore, dhe do të kryhen nga llogaritë e përqendruara të operatorëve të caktuar.

2. Shlyerje dypalëshe

2.1 Faturimi në bazë të bilancit të llogarisë së përgjithshme

2.1.1 Në përgjithësi, operatorët e caktuar që nuk janë anëtarë të një sistemi të përqendruar të kompensimit do të shlyejnë llogaritë në bazë të bilancit të llogarisë së përgjithshme.

2.2 Llogaria ndërlidhëse

2.2.1 Kur operatorët e caktuar kanë një institucion të llogarive rrjedhëse, secili prej tyre mund të hapë një llogari ndërlidhëse me anë të së cilës të shlyejnë debitë dhe kërkesat përkatëse që rrjedhin nga shërbimet e pagesave postare.

2.2.2 Kur operatori i caktuar pagues nuk ka një sistem të llogarive rrjedhëse, llogaria ndërlidhëse mund të hapet në një institucion tjetër financiar.

2.3 Monedha e shlyerjes

2.3.1 Shlyerjet do të kryhen në monedhën e shtetit të destinacionit ose në një monedhë të tretë të rënë dakord midis operatorëve të caktuar.

PJESA III DISPOZITA TRANZITORE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 26

Rezerva të paraqitura në Kongres

1. Nuk do të lejohet asnjë rezervë që nuk është në përputhje me objektin dhe qëllimin e Bashkimit.

2. Si rregull i përgjithshëm, çdo shtet anëtar, pikëpamjet e të cilit nuk janë të njëjta me ato të shteteve të tjera, duhet të bëjë përpjekje, brenda mundësive, të përputhet me opinionin e shumicës. Rezervat do të bëhen vetëm në rast të nevojës absolute dhe duhen të jepet një motiv i përshtatshëm për to.

3. Rezervat për ndonjë nen të kësaj marrëveshjeje duhet të paraqiten në Kongres, në formën e propozimit për Kongres të shkruar në një gjuhë pune të Byrosë Ndërkombëtare dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të rregullave të procedurës së Kongresit.

4. Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet që kanë të bëjnë me rezervat duhet të miratohen nga shumica e kërkuar për amendimin e nenit me të cilin lidhet rezerva.

5. Në parim, rezerva do të zbatohet në bazën e një reciprociteti midis shtetit anëtar që e paraqet atë dhe shteteve të tjera anëtare.

6. Rezervat e kësaj marrëveshjeje, do të përfshihen në protokollin e saj përfundimtar, mbi bazën e propozimeve të miratuara nga Kongresi.

Neni 27

Dispozita përfundimtare

1. Konventa do të jetë e zbatueshme, sipas rastit, me analogji, në të gjitha rastet e padisiplinuara shprehimisht nga kjo marrëveshje.

2. Neni 4 i Kushtetutës nuk do të zbatohet për këtë marrëveshje.

3. Kushtet për miratimin e propozimeve në lidhje me këtë marrëveshje dhe rregulloren

3.1 Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet e paraqitura në Kongres, në lidhje me këtë marrëveshje, duhet të miratohen nga shumica e shteteve anëtare të pranishme dhe votuese të cilat janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe që kanë të drejtën e votës. Të paktën gjysma e këtyre shteteve anëtare të përfaqësuara në Kongres dhe që kanë të drejtën e votës duhet të jenë të pranishme në momentin e votimit.

3.2 Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet në lidhje me rregulloren e kësaj marrëveshjeje duhet të miratohen nga shumica e anëtarëve të Këshillit të Operacioneve Postare të cilët janë palë e marrëveshjes dhe kanë të drejtën e votës. Të pranishëm dhe që votojnë, të cilat kanë të drejtën e votës, dhe nënshkrues ose kanë pranuar këtë marrëveshje.

3.3 Në mënyrë që të bëhen efektive, propozimet e paraqitura midis dy Kongreseve, në lidhje me këtë marrëveshje, duhet të marrin:

3.3.1 dy të tretat e votave, ku të kenë marrë pjesë në votim të paktën gjysma e shteteve anëtare të cilat janë palë e marrëveshjes, që kanë të drejtën e votës, nëse ato përfshijnë shtesën e dispozitave të reja;

3.3.2 të paktën shumicën e votave, ku të kenë marrë pjesë në votim të paktën gjysma e shteteve anëtare të cilat janë palë e marrëveshjes dhe që kanë të drejtën e votës, nëse ato përfshijnë amendimin e dispozitave të marrëveshjes;

3.3.3 shumicën e votave, nëse përfshihen interpretime të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.



3.4. Pavarësisht nga dispozitat e parashikuara në pikën 3.3.1, çdo shtet anëtar, legjislacioni i brendshëm i të cilit është ende i papajtuashëm me amendimin e propozuar, mund të bëjë një deklaram me shkrim për drejtorin e përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare, duke deklaruar pamundësinë për të pranuar këtë amendim, brenda 90 ditëve duke filluar nga data e njoftimit të tij.

Neni 28

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi më 1 janar 2018 dhe do të mbeten në fuqi deri në hyrjen në fuqi të akteve të Kongresit të ardhshëm.

Në dëshmi të sa më sipër, të plotfuqishmit e qeverive të shteteve anëtare kanë nënshkruar këtë marrëveshje në një kopje, e cila do të depozitohet pranë drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare. Një kopje do t'i jepet çdo pale nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit Postar Universal.

Realizuar në Stamboll, më 6 tetor 2016.

PROTOKOLLI PËRFUNDIMTAR I MARRËVESHJES SË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE POSTARE

Në momentin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare, të lidhur këtë ditë, nënshkruesi i plotfuqishëm ka rënë dakord si më poshtë:

Neni I

Funksionet operacionale

1. Duke iu referuar nenit 5.4 dhe në zbatim të neneve 3 dhe 4, të Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare, çdo operator i caktuar nga Franca do të hapë shërbime të pagesave postare vetëm me operatorët e shteteve anëtare që janë nënshkrues të marrëveshjes.

2. Në rastet kur një prej këtyre operatorëve nuk është operator i caktuar, ai do të jetë në gjendje të paguajë porositë e marra nga operatori i caktuar francez. Për të lidhur një kontratë shkëmbimi me një operator të caktuar francez, ky operator duhet fillimisht të sigurojë një kopje të deklaratës së

pjesëmarrjes së tij në ekzekutimin ekskluziv të urdhrave të shërbimit të pagesës postare, të bëra për autoritetet kompetente të shtetit anëtar në fjalë, të cilat, sipas gjykimit të tij, mund ta kombinojnë atë me një autorizim.

3. Të njëjtat dispozita do të zbatohen reciprokisht në territorin kombëtar të Francës, për çdo operator në Francë që dëshiron të hyjë në një partneritet ekskluzivisht me operatorët e caktuar të shteteve të tjera anëtare që janë nënshkrues të Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesave Postare.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e mëposhtëm kanë hartuar këtë protokoll, i cili do të ketë të njëjtën fuqi dhe të njëjtën vlefshmëri sikur dispozitat e tij të ishin përfshirë në tekstin e vetë Konventës, dhe ata e kanë nënshkruar në një kopje të vetme origjinale, e cila do të depozitohet pranë drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare. Një kopje e saj do t'i dorëzohet secilës palë nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit të Përbotshëm Postar.

Realizuar në Stamboll, më 6 tetor 2016.

DEKLARATAT PËR NËNSHKRIMIN E AKTEVE

I

Në emër të Republikës Socialiste të Vietnamit,

Delegacioni i Republikës Socialiste të Vietnamit deklaron se:

- rezervon të drejtën e qeverisë vietnameze për të ndërmarrë çdo veprim ose masë të konsideruar të nevojshme, për të ruajtur interesat kombëtare nëse ndonjë shtet tjetër anëtar i UPU-së dështon në përmbushjen e dispozitave të akteve të Kongresit UPU ose nëse deklaratat ose rezervat nga shtete e tjera anëtare të UPU-së rrezikojnë sovranitetin, të drejtat, interesat dhe shërbimet postare të Republikës Socialiste të Vietnamit;

- Vietnami rezervon të drejtën për të bërë rezerva të tjera, nëse është e nevojshme, mbi ratifikimin/miratimin e akteve të Kongresit të UPU-së.

(Kongresi – dok. 34. Shtojca 1)

II

Në emër të Republikës së Turqisë,

Delegacioni i Republikës së Turqisë bën deklaratën e mëposhtme në lidhje me pjesëmarrjen



e delegacionit të Administratës Qipriote Greke të Qipros Jugore në Kongresin e 26-të të Bashkimit Të Përbotshëm Postar të supozuar në emër të “Republikës së Qipros”:

“Nuk ka asnjë autoritet të vetëm, ligjor ose faktik që është kompetent për të përfaqësuar së bashku qipriotët turq dhe qipriotët grekë dhe, rrjedhimisht, Qipron si një e tërë. Turqia, në lidhje me autoritetet qipriote greke si autoritete ekzekutuese, kontrollojnë dhe kanë në juridiksion vetëm në territorin në jug të zonës së çmilitarizuar, si në rastin aktual, dhe duke mos përfaqësuar qipriotët turq, dhe do t’i trajtojë aktet e tyre në përputhje me rrethanat.

Sa më sipër, Turqia deklaron se prania dhe pjesëmarrja e saj në punimet e Bashkimit të Përbotshëm Postar, nënshkrimi i Akteve Finale dhe miratimi nga ana e saj e Strategjisë Postare të Stambollit nuk përbën asnjë formë njohjeje të pretendimeve të Administratës Qipriote Greke për të ashtuquajturën “Republika e Qipros”, as nuk nënkupton ndonjë detyrim nga ana e Turqisë për të lidhur çdo lloj marrëveshjeje me të ashtuquajturën “Republika e Qipros” brenda kuadrit të aktiviteteve të Bashkimit të Përbotshëm Postar.

(Kongresi – dok. 34. Shtojca 2)

III

Në emër të Republikës së Gjeorgjisë,

në Kongresin e 26-të të Përbotshëm Postar (Stamboll, Turqi, 2016), delegacioni i Gjeorgjisë bën deklaratën e mëposhtme:

Abkhazia, Gjeorgjia dhe Rajoni i Tskhinvalit (Ossetia e Jugut), Gjeorgjia, janë rajone gjeorgjiane dhe paraqesin pjesë të pandashme të territorit gjeorgjian. Integriteti territorial i Gjeorgjisë është mbështetur dhe njohur nga rezolutat e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara. Çdo veprim për çfarëdolloj arsyeje në këto rajone gjeorgjiane, për sa i përket shërbimeve postare, mund të ndërmerret vetëm në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi në Gjeorgji, aktet e Bashkimit të Përbotshëm Postar dhe legjislacionin ndërkombëtar. Rastet e tjera përbëjnë veprime të jashtëligjshme dhe shkelje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Gjeorgjisë.

Gjeorgjia rezervon të drejtën e saj, në kuadër të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të shtetit, për të ndërmarrë çdo lloj veprimi ligjor të

nevojshëm, në rastin kur ndonjë shtet anëtar i UPU-së nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga aktet e UPU-së, dhe nëpërmjet deklaratave dhe veprimeve që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë rrezikojnë funksionimin normal të sektorit postar në të gjithë territorin e Gjeorgjisë dhe dëmtojnë interesat dhe sovranitetin kombëtar.

Gjeorgjia rezervon të drejtën, në rast nevojë, që të bëjë deklaratë shtesë në lidhje me aktet e miratuara në këtë Kongres, nëse ndonjë dispozitë do të kundërshtojë drejtpërdrejt ose tërthorazi të drejtën ndërkombëtare, si dhe Kushtetutën dhe ligjet e Gjeorgjisë.

(Kongresi – dok. 34. Shtojca 3)

IV

Në emër të Republikës së Qipros,

Delegacioni i Republikës së Qipros, në Kongresin e 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, përsërit deklaratën që ka bërë në Kongreset e mëparshme të UPU-së dhe refuzon pa rezerva deklaratën dhe rezervën e bërë nga Republika e Turqisë, më 20 shtator 2016, (Kongresi – dok. 34. Shtojca 2) në Kongresin e 26-të në Stamboll, në lidhje me pjesëmarrjen, të drejtat dhe statusin e Republikës së Qipros si anëtare e UPU-së;

pozicionet turke janë tërësisht në kundërshtim me dispozitat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare dhe dispozitat specifike të rezolutave të detyrueshme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Qipron. Duhet theksuar se në rezolutat e saj 541(1983) dhe 550 (1984), ndër të tjera, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dënoi shkëputjen e një pjese të Republikës së Qipros, duke e konsideruar “Deklaratën e njëanshme të pavarësisë” si ‘juridiksht të pavlefshme’ dhe bëri thirrje për tërheqjen e saj. Gjithashtu, u bëri thirrje të gjitha shteteve të mosnjohin asnjë shtet tjetër qipriot të ndryshëm nga ai i Republikës së Qipros dhe “të mos lehtësojnë apo ndihmojnë në ndonjë mënyrë subjektin e sipërpërmendur separatist”. Së fundi, i bëri thirrje të gjithë shteteve që të respektojnë sovranitetin, pavarësinë, integritetin territorial dhe unitetin e Republikës së Qipros;

Republika e Qipros ka qenë shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara që nga pavarësia e saj në vitin 1960 dhe shtet anëtar i Bashkimit Evropian nga data 1 maj 2004. Ajo ka qenë gjithashtu anëtare



e Bashkimit të Përbotshëm Postar që nga nëntori i vitit 1961 dhe, në këtë cilësi, merr pjesë në të gjitha aktivitetet e organizatës. Qeveria e Republikës së Qipros është qeveri e njohur botërisht, në Qipro, me kompetencën dhe autoritetin për të përfaqësuar shtetin, pavarësisht ndarjes *de facto* të ishullit si rezultat i Pushtimit Turk të vitit 1974;

që nga 1 maji 2004, Republika e Qipros ka qenë anëtare me të drejta të plota në Bashkimin Evropian, duke theksuar faktin se është vetëm një shtet në Qipro. Në njohjen e problemeve të shkaktuara nga pushtimi i një pjese të territorit të saj në zbatimin e ligjeve të Komunitetit, Protokolli 10 i Aktit të Aderimit të Republikës së Qipros në Bashkimin Evropian parashikon se zbatimi i *acquis communautaire* do të pezullohet në zonën e Republikës së Qipros mbi të cilën qeveria e saj nuk ushtron kontroll efektiv;

duke pasur parasysh sa më sipër, deklarata dhe rezervat e bëra nga Republika e Turqisë në kundërshtim të dokumenteve dhe frymës së Kushtetutës, Konventës dhe Marrëveshjeve të UPU-së. Delegacioni i Republikës së Qipros, si rrjedhojë, e konsideron çdo deklaratë apo rezervë të tillë të paligjshme dhe të pavlefshme, si dhe rezervon të drejtat e veta në përputhje me rrethanat.

(Kongresi – dok 34. Shtojca 4)

V

Në emër të Zelandës së Re,

Zelanda e Re do të zbatojë aktet dhe vendimet e tjera të miratuara nga ky Kongres vetëm në masën që janë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare të saj dhe në veçanti, me Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve.

(Kongresi – dok 34. Shtojca 5)

VI

Në emër të Republikës së Argjentinës,

Republika e Argjentinës kujton rezervën e bërë në ratifikimin e Kushtetutës së Bashkimit të Përbotshëm Postar të nënshkruar në Vjenë, Austri, më 10 korrik 1964, dhe rikonfirmon sovranitetin e saj ndaj Ishujve të Malvinas, Gjeorgjisë së Jugut, dhe Ishujve Jugorë Sandwich dhe sektorit të

Antarktidës së Argjentinës që janë pjesë përbërëse e territorit të saj kombëtar;

ajo gjithashtu kujton, në lidhje me 'Çështjen e Ishujve Malvinas, se Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka miratuar rezolutat: 2065 (XX), 3160 (XXVIII), 31/49, 37/9, 38/12, 39/6, 40/21, 41/40, 42/19 dhe 43/25, me anë të së cilës ajo njeh ekzistencën e mosmarrëveshjeve të sovranitetit dhe i kërkon Qeverisë së Republikës së Argjentinës dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut të rifillojnë negociatat për të zgjidhur këto mosmarrëveshje;

Republika e Argjentinës thekson gjithashtu se Komiteti i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për Shkolonizimin ka paraqitur në mënyrë të përsëritur gjykimin në të njëjtin kuptim, së fundi me anë të rezolutës së miratuar më 23 qershor 2016, dhe se Asambleja e Përgjithshme e Organizimit të Shteteve të Amerikës ka miratuar një rezolutë të re në miratimin e kushteve të ngjashme, më 15 qershor 2016.”.

(Kongresi – dok. 34. Shtojca 6)

VII

Të tjerë të Republikës së Islandës, Principatës së Lihtenshtajnit, dhe Mbretërisë së Norvegjisë,

Delegacionet e Republikës së Islandës, Principatës së Lihtenshtajnit, dhe Mbretërisë së Norvegjisë deklarojnë se shtetet e tyre do të zbatojnë aktet e miratuara nga Kongresi në përputhje me detyrimet e tyre ndaj marrëveshjes themeluese të Zonës Ekonomike Evropiane dhe Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve (GATS) të Organizatës Botërore të Tregtisë.

(Kongresi – dok. 34. Shtojca 7)

VIII

Në emër të Republikës së Indonezisë,

Indonezia pranon të zbatojë aktet e Bashkimit të nënshkruara në Kongresin e 26-të të UPU-së (Stamboll, 2016) dhe:

- rezervon të drejtën e qeverisë së saj për të ndërmarrë çdo veprim ose masë që i gjykon të nevojshme për të ruajtur interesin e saj kombëtar, nëse ndonjë dispozitë e Konventës, Protokolli Final ose Marrëveshjes për Shërbimet e Pagesave Postare ose çdo vendim i Kongresit të 26^{-të} të



UPU-së (Stamboll, 2016), në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndikon në sovranitetin e saj ose shkel Kushtetutën, ligjet ose rregulloret e Republikës së Indonezisë, si dhe të drejtat e fituara nga Republika e Indonezisë si palë e traktateve dhe konventave të tjera, dhe të çdo parimi të së drejtës ndërkombëtare;

- rezervon më tej të drejtën e qeverisë së saj për të ndërmarrë çdo veprim ose masë që i gjykon të nevojshme për të ruajtur interesin e saj kombëtar, në rastin kur ndonjë shtet anëtar nuk përmbush dispozitat e Akteve e UPU-së (Stamboll, 2016), ose pasojat nga rezervat rrezikojnë sektorin postar ose rezultojnë në rritje të papranueshme të pjesës së kontributit për të mbuluar shpenzimet e UPU-së.

(Kongresi – dok. 34. Shtojca 8)

IX

Në emër të Australisë,

Australia do të zbatojë aktet dhe vendimet e tjera të miratuara nga ky Kongres vetëm nëse ato janë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare dhe, në veçanti, me Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve (GATS) të Organizatës Botërore të Tregtisë.

(Kongresi – dok. 34. Shtojca 9)

X

Në emër të Republikës Orientale të Uruguait,

me rastin e nënshkrimit të akteve finale të Kongresit të 26-të të Përbotshëm Postar (Stamboll, 2016), delegacioni i Republikës Orientale të Uruguait deklaron se qeveria e tij rezervon të drejtën që:

- të miratojë masat që çmon të nevojshme për të mbrojtur interesat e saj në rastet kur anëtarë të tjerë të UPU-së nuk përmbushin aktet finale, shtojcat e tyre dhe protokollet, ose kur rezervat e bëra nga anëtarët e tjerë rrezikojnë funksionimin e duhur të shërbimeve postare të saj ose përmbushjen e të drejtave të sovranitetit;

- të formulojë rezerva shtesë për aktet finale të Kongresit të 26-të të Përbotshëm Postar (Stamboll, 2016), në përputhje me Konventën e Vjenës mbi Legjislacionin e Traktateve të 1969, sipas nevojës, midis datës së nënshkrimit të akteve finale dhe datave të ratifikimit.

(Kongresi – dok. 34. Shtojca 10)

XI

Në emër të Republikës së Austrisë, Mbretërisë së Belgjikës, Republikës së Bullgarisë, Republikës Çeke, Republikës së Kroacisë, Republikës së Qipros, Mbretërisë së Danimarkës, Republikës së Estonisë, Republikës së Finlandës, Republikës Franceze, Republikës Federale të Gjermanisë, Republikës Greke, Hungarisë, Republikës së Irlandës, Republikës Italiane, Republikës së Letonisë, Dukatit të Madh të Luksemburgut, Mbretërisë së Holandës, Republikës së Polonisë, Republikës Portugeze, Rumanisë, Republikës Sllovaqe, Republikës së Sllovenisë, Mbretërisë së Spanjës, Mbretërisë së Suedisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut,

delegacionet e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian deklarojnë se shtetet e tyre do të zbatojnë aktet e miratuara nga Kongresi, në përputhje me detyrimet e tyre sipas marrëveshjes themeluese të Bashkimit Evropian dhe Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve (GATS) të Organizatës Botërore të Tregtisë.

(Kongresi – dok. 34. Shtojca 1100)

XII

Në emër të Kanadasë,

me nënshkrimin e akteve finale të Kongresit të 26-të të UPU-së (Stamboll, 2016), Kanadaja deklaron se do të zbatojë aktet dhe vendimet e tjera të miratuara nga ky Kongres, në përputhje të plotë me të gjithë ligjet e zbatueshme dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat është palë nënshkruese.

(Kongresi – dok. 34. Shtojca 12)

XIII

Në emër të Republikës së Azerbajxhanit,

Republika e Azerbajxhanit është një nga anëtarët e UPU-së me autoritet të plotë dhe ka të drejtë të ofrojë shërbime postare në territorin e vendit të njohur ndërkombëtarisht, në përputhje me Konventën e UPU-së dhe të dokumenteve të tjera ndërkombëtare. Megjithatë, 20 përqind e territorit të Azerbajxhanit, të njohur ndërkombëtarisht, përfshirë rajonin Nagorno-Karabakh dhe shtatë rajone administrative rrethuese, janë nën pushtimin e Armenisë dhe për rrjedhojë shfaqin pengesa në lidhje me ofrimin e shërbimeve postare;



rezolutat nr. 822 (30 prill 1993), 853 (29 qershor 1993), 874 (14 tetor 1993) dhe 884 (12 nëntor 1993), të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara, si dhe vendimet dhe rezolutat e organizatave të tjera ndërkombëtare mbi lirin e menjëhershëm, të plotë dhe pa kushte të territoreve të pushtuara të Azerbajxhanit nga Armenia, kanë mbetur të pazbatuara;

pushtimi ka rezultuar në dëme të mëdha në ekonominë e vendit, duke përfshirë dhe sektorin postar. Grupi i punës, i ngritur me qëllim vlerësimin e humbjeve dhe dëmeve në Republikën e Azerbajxhanit, po kryen vlerësimet;

është e pamundur përmbushja e nenit 6 të Konventës së UPU-së, në lidhje me qarkullimin e pullës postare në territoret e Republikës së Azerbajxhanit të pushtuara nga Republika e Armenisë. Prodhimi i pullave postare dhe veprimet e paligjshme postare në territorin e të ashtuquajturës “Republika Nagorno-Karabakh” po ndërmerren nga regjimi i jashtëligjshëm, në kundërshtim me nenin 23 të Kushtetutës së UPU-së;

sa më sipër, Republika e Azerbajxhanit deklaroi edhe një herë se sipas rregullave të UPU-së, Qeveria e Republikës së Azerbajxhanit është e vetmja strukturë ligjore, e cila ka të drejtë të prodhojë dhe të nxjerrë në qarkullim pullat postare, si dhe të kryejë veprime postare në të gjitha territoret e Azerbajxhanit të njohura në nivel ndërkombëtar, përfshirë edhe territoret e pushtuara. Asnjë veprim postar nuk mund të kryhet në territoret e pushtuara pa autorizimin e Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit. Këto operacione nuk kanë fuqi ligjore dhe bien ndesh me legjislacionin kombëtar të Republikës së Azerbajxhanit, si dhe me normat juridike ndërkombëtare që ekzistojnë në këtë fushë;

me keqardhje iu informojmë që do të jetë e pamundur përmbushja e dispozitave të Konventës së UPU-së dhe e Protokollit Final, derisa territoret e pushtuara nga Republika e Armenisë të lirohen dhe pasojat e pushtimit të eliminohen;

Republika e Azerbajxhanit rezervon të drejtën të moszbatojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Konventa e UPU-së dhe Protokollit Final në lidhje me Republikën e Armenisë.

(Kongresi – dok 34. Shtojca 13)

XIV

Në emër të Republikës së Afrikës së Jugut,

Delegacioni i Republikës së Afrikës së Jugut deklaroi se Afrika e Jugut do të zbatojë aktet e miratuara nga Kongresi i 26-të i UPU-së, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin kombëtar të Republikës së Afrikës së Jugut dhe në vijim të detyrimeve sipas traktateve, konventave dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare, në bazë të ratifikimit të akteve finale. Afrika e Jugut rezervon të drejtën që të bëjë deklarata shtesë, nëse është e nevojshme, pas ratifikimit të akteve të Bashkimit;

Delegacioni i Republikës së Afrikës së Jugut rezervon të drejtën që të ndërmarrë veprime ose masa nëse i çmon të nevojshme për të ruajtur interesin kombëtar, nëse anëtarë të tjerë të UPU-së nuk përmbushin Kushtetutën, Konventën ose aktet e UPU-së, ose kur rezervat e bëra nga anëtarët e tjerë ndikojnë negativisht në shërbimet postare të vendit.

(Kongres – dok 34. Shtojca 14)

XV

Në emër të Malajzisë,

Delegacioni i Malajzisë deklaroi se Malajzia do të zbatojë aktet e miratuara nga Kongresi i 26-të i UPU-së, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin kombëtar të Malajzisë dhe në vijim të detyrimeve sipas traktateve, konventave dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare, në bazë të ratifikimit të akteve finale. Malajzia rezervon të drejtën e qeverisë së saj për të bërë deklarata shtesë, nëse është e nevojshme, pas ratifikimit të akteve të Bashkimit.

Delegacioni i Malajzisë rezervon të drejtën që qeveria e saj të ndërmarrë veprime ose masa, nëse i çmon të nevojshme, për të ruajtur interesin kombëtar, nëse anëtarë të tjerë të UPU-së nuk përmbushin Kushtetutën, Konventën ose aktet e UPU-së, ose kur rezervat e bëra nga anëtarët e tjerë ndikojnë negativisht në shërbimet postare të vendit.

(Kongres – dok 34. Shtojca 15)

XVI

Në emër të Republikës së Kubës,

me nënshkrimin e akteve finale të Kongresit të Përbotshëm Postar (Stamboll, 2016), delegacioni i



Republikës së Kubës deklararon se qeveria e saj rezervon të drejtën e marrjes së çfarëdo mase ose veprimi nëse i çmon të nevojshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe të drejtën ndërkombëtare, për të ruajtur interesin kombëtar, nëse anëtarë të tjerë të UPU-së nuk përmbushin aktet finale dhe rregulloret e UPU-së, ose kur deklaratat ose rezervat e bëra nga anëtarët e tjerë cenojnë sovranitetin, sigurinë, të drejtat ose interesat e saj, ose funksionimin normal të shërbimeve postare kombëtare.

(Kongres – dok 34. Shtojca 16)

XVII

Në emër të Republikës Demokratike dhe Popullore të Algjerisë,

Delegacioni i Republikës Demokratike dhe Popullore të Algjerisë deklararon se rezervon të drejtën e qeverisë së saj për të zbatuar aktet e miratuara nga ky Kongres, për sa kohë që janë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret kombëtare algjeriane dhe me politikën e saj të jashtme;

deklaron gjithashtu se nënshkrimi i këtyre akteve nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga Algjeria e ndonjë të drejtë që ajo mban ose mund të mbajë në bazë të konventave dhe traktateve në të cilat është pjesë;

Delegacioni Algjerian gjithashtu rezervon të drejtën e qeverisë së saj për të bërë, kur të jetë e nevojshme, deklarata shtesë në lidhje me ratifikimin e akteve të Kongresit të UPU-së.

(Kongres – dok 34. Shtojca 17)

XVIII

Në emër të Republikës së Armenisë,

kohët e fundit komuniteti ndërkombëtar ka dëshmuar një ngritje të konsiderueshme të propagandës së rreme dhe fushatave anti-armene të kryera nga autoritetet azerbajxhaniane, duke paraqitur një panoramë të shtrembëruar të arsyeve dhe motiveve të konfliktit të Nagorno–Karabakhut dhe të situatës të krijuar si rezultat i këtij territori. Armenia çmon se një sjellje e tillë është e papranueshme dhe pengon përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për të promovuar bashkëpunimin e ndërsjellë;

meqë Kongresi i Përbotshëm Postar nuk është forumi i duhur për të diskutuar çështje që lidhen me zgjidhjen e konflikteve, delegacioni i Armenisë do të kufizohet në deklaratën e mëposhtme:

më 10 dhjetor 1991, popullsia e Nagorno–Karabakhut shpalli pavarësinë e Republikës së Nagorno–Karabakhut pas një referendumi, në përputhje të plotë me ligjin ndërkombëtar, si dhe me dokumentin dhe frymën e ligjeve të Bashkimit Sovjetik në atë kohë. Kështu, Nagorno–Karabakhut është një republikë sovraane, në përputhje me nenin RL 116 të rregulloreve të Postës së Letrave;

interpretimi arbitrar i rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe akuzat e pabaza ndaj Republikës së Armenisë janë praktikë e zakonshme për autoritetet e Azerbajxhanit, me qëllim mbulimin e krimeve të tyre të rënda në të kaluarën. Autoritetet e Azerbajxhanit përdorin çdo forum ndërkombëtar për të ndjekur politikën e tyre shkatërruese në vend që të marrin pjesë në përpjekjet paqësore të komunitetit ndërkombëtar. Fatkeqësisht, Kongresi i Përbotshëm Postar nuk ishte përjashtim;

deklaratat e dhëna në emër të Republikës së Azerbajxhanit përmbajnë shtrembërime të konsiderueshme dhe janë thjesht për qëllime propagandistike, përveç që shërbejnë si shpërqendrim nga programi i punës së Kongresit të 26-të të UPU-së;

deklarata të tilla janë dëshmi e qartë e politikës dhjetëvjeçare të Azerbajxhanit që synon privimin e popullatës së Nagorno–Karabakhut nga të drejtat e tyre themelore të njeriut, përfshirë edhe të drejtën e komunikimit që është mjeti për realizimin e të gjitha të drejtave të tjera. Siç jemi në dijeni, instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut përcaktojnë shumë aspekte të së drejtës për të komunikuar; kjo e drejtë është e lidhur drejtpërdrejt me lirinë e shprehjes, e cila është përfshirë në të gjitha instrumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe shumë të tjerë;

Nagorno–Karabakhu nuk ka qenë asnjëherë pjesë e Azerbajxhanit të pavarur. Referencat e Azerbajxhanit ndaj nenit 23 të Kushtetutës dhe përpjekjet për ta paraqitur Nagorno–Karabakhun si “pjesë integrale të territorit të Republikës së



Azerbajxhanit” nuk janë as të justifikuara, as të ligjshme;

statusi i ardhshëm i Nagorno–Karabakhut duhet të përcaktohet përmes negociatave paqësore në kuadër të Procesit të Minskut të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe mbi bazën e parimeve themelore të OSBE-së. Fakti që Republika e Nagorno–Karabakhut ende nuk është njohur zyrtarisht nga komuniteti ndërkombëtar nuk mund të ndalojë që popullata e saj të komunikojë lirshëm, përfshirë edhe përmes shërbimit postar;

deklarata e Azerbajxhanit është në kundërshtim me dispozitat themelore të Kushtetutës dhe nuk mbështet parimet themelore të UPU-së;

Si anëtare e Bashkimit të Përbotshëm Postar, Armenia detyrimisht deklaron se operatori postar i Republikës së Armenisë shërben si ndërmjetës për operatorin postar të Republikës së Nagorno–Karabakhut, në përputhje me nenet 3 dhe 4 të Konventës së UPU-së dhe vazhdon të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga nenet e lartpërmendura.

(Kongres – dok 34. Shtojca 18)

RREGULLAT E PROCEDURËS SË KONGRESEVE

Pasqyra e lëndës

Neni

1. Dispozita të përgjithshme
2. Delegacionet
3. Kredencialet e delegatëve
4. Rregulli i vendeve
5. Vëzhguesit dhe vëzhguesit *ad hoc*
6. Kryesitë dhe zëvendëskryesitë e Kongresit dhe komiteteve
7. Byroja e Kongresit
8. Anëtarësimi i komiteteve
9. Grupet e punës
10. Sekretariati i Kongresit dhe komiteteve
11. Gjuha e debateve
12. Gjuhët e përdorura për hartimin e dokumenteve të Kongresit
13. Propozimet
14. Shqyrtimi i propozimeve në Kongres dhe në komitete
15. Debatet
16. Mocionet për pikat e rendit dhe mocionet procedurale

Faqe | 9414

17. Kuorumi
18. Parimi dhe procedura e votimit
19. Kushtet për miratimin e propozimeve
20. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues ose Këshillit të Operacioneve Postare
21. Zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare
22. Raportet
23. Apelimi i vendimeve të marra nga komitetet dhe nga Kongresi
24. Miratimi i draftvendimeve nga Kongresi (akte, rezoluta, etj.)
25. Caktimi i studimeve për Këshillin Drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare
26. Rezervimi për aktet
27. Nënshkrimi i akteve
28. Amendimi i rregullave

RREGULLAT E PROCEDURËS SË KONGRESEVE

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Këto rregulla të procedurës, në vijim të quajtura “Rregullat”, janë hartuar në bazë të akteve të Bashkimit dhe janë të varura prej tyre. Në rast të mospërputhjeve midis njërës nga këto dispozita dhe një dispozite të akteve, kjo e fundit do të mbizotërojë.

Neni 2

Delegacionet

1. Termi “delegacion” përfshin personin ose tërësinë e personave të caktuar nga shtetet anëtare për të marrë pjesë në Kongres. Delegacioni përbëhet nga një kryetar delegacioni dhe, nëse është e arsyeshme, nga zëvendësi i tij, një ose më shumë të deleguar, dhe brenda mundësive, nga një ose më shumë funksionarë të atashuar (duke përfshirë ekspertë, sekretarë etj.).

2. Kryetarët e delegacioneve, zëvendësit e tyre, dhe të deleguarit do të jenë përfaqësues të shteteve anëtare, sipas nenit 14.2 të Kushtetutës, nëse ata kanë kredencialet sipas kushteve të nenit 3, të kësaj rregulloreje.

3. Funksionarët e atashuar do të pranohen në seanca dhe do të kenë të drejtën të marrin pjesë në



shqyrtime dhe diskutime, por ata zakonisht nuk do të kenë të drejtën e votës. Megjithatë, ata mund të autorizohen nga kryetari i delegacionit të tyre të votojnë në emër të shtetit të tyre në mbledhjet e Komisioneve. Këto autorizime, me shkrim, duhet t'i dorëzohen, para fillimit të mbledhjes, kryetarit të komisionit të interesuar.

Neni 3

Kredencialet e të deleguarve

1. Kredencialet e të deleguarve duhet të nënshkruhen nga kryetari i shtetit, kryetari i qeverisë ose nga ministri i punëve të jashtme të shtetit të interesuar. Ato duhet të hartohen në formën e duhur dhe të përshtatshme. Kredencialet e të deleguarve me të drejtë për të nënshkruar aktet (të plotfuqishëm), duhet të specifikojnë qëllimin e këtij nënshkrimi (nënshkrimi i subjektit të ratifikimit ose miratimit, nënshkrimi *ad referendum*, nënshkrimi përfundimtar). Në mungesë të një këtij informacioni specifik, nënshkrimi do të konsiderohet si subjekt i aktet, do të përfshijnë edhe të drejtën e fjalës dhe të votës. Të deleguarit, të cilëve autoritetet kompetente ju kanë dhënë të drejta të plota, pa specifikuar qëllimin e tyre, do të kenë të drejtë të debatojnë, të votojnë dhe të nënshkruajnë aktet, me përjashtim kur hartimi i kredencialeve është shprehimisht kundër kësaj. Kredencialet që autorizojnë mbajtësin për të marrë pjesë në emër të vendit në fjalë ose përfaqësojnë këtë të fundit, do të përfshijnë të drejtën e fjalës dhe të votës.

2. Kredencialet do të depozitohen në hapje të Kongresit, pranë autoritetit të caktuar për këtë.

3. Të deleguarit që nuk disponojnë kredencialet, dhe ata që nuk i kanë depozituar kredencialet e tyre mund të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë që nga momenti i pjesëmarrjes së tyre në punimet e Kongresit, me kusht që emrat e tyre të jenë komunikuar nga qeveritë e tyre të Byroja Ndërkombëtare. E njëjta procedurë do të zbatohet edhe për ata, kredencialet e të cilëve kanë parregullsi. Këta të deleguar nuk do të jenë të autorizuar të votojnë derisa Kongresi të miratojë raportin e fundit të Komitetit të Kredencialeve duke vendosur se kredencialet e tyre nuk janë marrë ose nuk janë të rregullta dhe deri sa situata e tyre të rregullohet. Raporti i fundit duhet të miratohet nga Kongresi para çfarëdo zgjedhje të

ndryshme nga ajo e kryetarit të Kongresit dhe para miratimit të projektakteve.

4. Kredencialet e një shteti anëtar që përfaqësohet në Kongres nga delegacioni i një shteti tjetër anëtar (me prokurë) duhet të kenë të njëjtën formë si ato të përshkruara në paragrafin 1.

5. Kredencialet dhe prokurat e dërguara me telegram nuk do të pranohen. Megjithatë, do të pranohen telegramet e dërguara si përgjigje të një kërkesë për informacion në lidhje me kredencialet.

6. Një delegacion i cili, pasi ka depozituar kredencialet e tij, pengohet të marrë pjesë në një ose në disa seanca, mund të përfaqësohet nga një delegacion i një shteti tjetër anëtar, me kusht që të njoftojë me shkrim kryetarin e mbledhjes në fjalë. Megjithatë, një delegacion mund të përfaqësojë vetëm një shtet tjetër, përveç shtetit të tij.

7. Të deleguarit e shteteve anëtare që nuk janë palë në një marrëveshje mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet e Kongresit, në lidhje me këtë marrëveshje.

Neni 4

Rregulli i vendeve

1. Në mbledhjet e Kongresit dhe të komisioneve, delegacionet do të vendosen sipas rendit alfabetik francez të shteteve anëtare të përfaqësuara.

2. Kryetari i këshillit drejtues tërheq me short, në kohën e duhur, emrin e shtetit që do jetë në krye, pranë tribunës së kryesisë, gjatë seancave të Kongresit dhe të komisioneve.

Neni 5

Vëzhguesit dhe vëzhguesit *ad hoc*

1. Vëzhguesit e përmendur në nenin 105.1 të rregullores së përgjithshme do të ftohen të marrin pjesë në seancat plenare dhe mbledhjet e komitetit të Kongresit.

2. Vëzhguesit *ad hoc* të përmendur në nenin 105.2 të rregullores së përgjithshme mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e veçanta të Kongresit dhe komisioneve të tij kur është në interes të Bashkimit apo punës së Kongresit.

3. Vëzhguesit dhe vëzhguesit *ad hoc* nuk kanë të drejtë të votojnë por mund të marrin fjalën me lejen e kryesuesit të takimit.



4. Në rrethana të jashtëzakonshme, mund të kufizohen të drejtat e vëzhguesve dhe të vëzhguesve *ad hoc* të referuar në pikën 4, për të marrë pjesë në disa mbledhje ose në disa pjesë mbledhjeje, nëse konfidencialiteti i çështjes së trajtuar e kërkon këtë. Ata duhet të informohen sa më shpejt të jetë e mundur. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti, nga organi i interesuar ose kryetari. Këto vendime do të ekzaminohen nga Byroja e Kongresit, e cila do të ketë të drejtën të konfirmojë ose kundërshtojë me një shumicë të thjeshtë të votave.

Neni 6

Kryesitë dhe zv/kryesitë e Kongresit dhe komiteteve

1. Në seancën e tij të parë plenare, Kongresi zgjedh, me propozimin e vendit anëtar pritës të Kongresit, kryetarin e Kongresit dhe pastaj miraton, me propozim të këshillit drejtues, emërimin e shteteve anëtare që do të marrin nën kryesimin e Kongresit, si edhe kryesimin dhe nën kryesimin e komisioneve. Këto poste jepen duke marrë parasysh, për sa është e mundur, një ndarje gjeografike të barabartë mes shteteve anëtare.

2. Kryetarët hapin dhe mbyllin seancat që ata kryesojnë, dretojnë diskutimet, u japin fjalën oratorëve, vendosin votimin e propozimeve dhe bëjnë të ditur shumicën që duhet për miratimin e tyre, shpallin vendimet dhe, subjekt i miratimit të Kongresit, interpretojnë këto vendime nëse është e nevojshme.

3. Kryetarët do të kujdesen që kjo rregullore të respektohet dhe mbajnë rregullin gjatë seancave.

4. Çdo delegacion mund të apelojë, para Kongresit ose komisionit, kundër një vendimi të marrë nga kryetari, sipas një dispozite ose interpretimi të rregullores. Pavarësisht nga kjo, vendimi i kryetarit do të jetë i vlefshëm, me përjashtim të rastit kur shfuqizohet vota e shumicës së anëtarëve të pranishëm.

5. Nëse shteti anëtar i ngarkuar për kryesimin nuk është më në gjendje të përmbushë këtë funksion, një nga nënkryetarët do të caktohet nga Kongresi ose nga komisioni për ta zëvendësuar atë.

Neni 7

Byroja e Kongresit

1. Byroja është organi qendror përgjegjës për drejtimin e punës së Kongresit. Ai do të përbëhet nga kryetari dhe zëvendëskryesuesit e Kongresit dhe kryetarit të komiteteve. Ai mblidhet periodikisht për të shqyrtuar progresin e punës së Kongresit dhe të komisioneve të tij dhe për të bërë rekomandime për të lehtësuar një progres të tillë. Ajo ndihmon kryetarin në hartimin e agjendës së çdo mbledhjeje plenare dhe në koordinimin e punës së komisioneve. Ajo do të bëjë rekomandime në lidhje me mbylljen e Kongresit.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kongresit dhe ndihmësekreteri i përgjithshëm, të përmendura në nenin 10.1, do të marrin pjesë në mbledhjet e Byrosë.

Neni 8

Anëtarësia e komiteteve

1. Shtetet anëtare të përfaqësuara në Kongres, sipas të drejtës, do të jenë anëtarë të komiteteve përgjegjëse për shqyrtimin e propozimeve në lidhje me Kushtetutën, rregulloren e përgjithshme dhe Konventën.

2. Shtetet anëtare të përfaqësuara në Kongres, që janë palë e një ose më shumë marrëveshjeve opsionale, do të jenë anëtarë të një ose disa komiteteve të ngarkuara me rishikimin e këtyre marrëveshjeve. E drejta e votës së anëtarëve të këtij ose të këtyre komiteteve do të kufizohet në marrëveshjen ose marrëveshjet në të cilat ata janë palë.

3. Delegacionet që nuk janë anëtarë të komiteteve që merren me marrëveshjet mund të marrin pjesë në seancat e këtyre komiteteve dhe të marrin pjesë në diskutime, pa të drejtë vote.

Neni 9

Grupet e punës

1. Kongresi dhe çdo komitet mund të organizojnë grupe pune për studimin e çështjeve të veçanta.



Neni 10

Sekretariati i Kongresit dhe i komiteteve

1. Drejtori i përgjithshëm dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare kryejnë edhe funksionet e sekretarit të përgjithshëm dhe të asistentit të sekretarit të përgjithshëm të Kongresit.

2. Sekretari i përgjithshëm dhe asistenti i sekretarit të përgjithshëm marrin pjesë në seancat e Kongresit dhe të zyrës së Kongresit, dhe marrin pjesë edhe në debatet pa të drejtë vote. Ata mund të marrin pjesë, me të njëjtat kushte, në seancat e komiteteve ose të përfaqësohen nga një funksionar tjetër i Byrosë Ndërkombëtare.

3. Punimet e Sekretariatit të Kongresit, Byrosë Ndërkombëtare dhe të komiteteve bëhen nga personeli i Byrosë Ndërkombëtare, në bashkëpunim me shtetin anëtar pritës.

4. Funksionarët e lartë të Byrosë Ndërkombëtare kanë edhe funksionet e sekretarëve të Kongresit, Byrosë së Kongresit dhe të komiteteve. Ata ndihmojnë kryetarin gjatë seancave dhe janë përgjegjës për hartimin e raporteve.

5. Sekretarët e Kongresit dhe komisioneve do të asistohen nga asistentët e sekretarëve.

Neni 11

Gjuha e diskutimeve

1. Subjekt i paragrafit 2, gjuha franceze, angleze, spanjolle dhe ruse mund të përdoren gjatë diskutimeve, me anë të një sistemi të përkthimit simultan ose konsektiv.

2. Debatet e Komitetit të hartimit do të bëhen në gjuhën franceze.

3. Gjuhë të tjera mund të përdoren në diskutimet e përmendura në paragrafin 1. Gjuha e shtetit pritës do të ketë një të drejtë prioritare. Delegacionet përdorin gjuhë të tjera, duhet të marrin akorde për përkthimin simultan në një nga gjuhët e përmendura në paragrafin 1, qoftë me anë të sistemit të përkthimit simultan, kur bëhet fjalë për ndryshime teknike, ose me përkthyes të veçantë.

4. Shpenzimet e instalimit dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve teknike janë në ngarkim të Bashkimit.

5. Shpenzimet e shërbimeve të përkthimit do të ndahen midis shteteve anëtare, që përdorin të njëjtën gjuhë, në proporcion me kontributin e tyre në shpenzimet e Bashkimit.

Neni 12

Gjuha e përdorur për hartimin e dokumenteve të Kongresit

1. Dokumentet e përgatitura gjatë Kongresit, duke përfshirë edhe projektvendimet e paraqitura për miratim në Kongres, do të publikohen në gjuhën franceze nga sekretariati i Kongresit.

2. Për këtë qëllim, dokumentet që vijnë nga delegacionet e shteteve anëtare, duhet të paraqiten pranë sekretariatit të Kongresit në gjuhën frënge, qoftë direkt, qoftë me ndërmjetësinë e shërbimeve të përkthimit.

3. Shërbimet e mësipërme, të organizuara me shpenzimet e vetë grupeve gjuhësore të krijuara sipas dispozitave korresponduese të rregullores së përgjithshme, mund të përkthejnë gjithashtu dokumente të Kongresit në gjuhët e tyre përkatëse.

Neni 13

Propozimet

1. Të gjitha çështjet e paraqitura para Kongresit, do të konsiderohen si propozime.

2. Të gjitha propozimet e publikuara nga Byroja Ndërkombëtare para hapjes së Kongresit do të konsiderohen si të paraqitura në Kongres.

3. Dy muaj para hapjes së punimeve të Kongresit, nuk do të merret në konsideratë asnjë propozim, me përjashtim të atyre që amendojnë propozime të mëparshme.

4. Në rastin specifik të propozimeve nga Këshilli i Administrimit ose Këshilli i Operacioneve Postare, ndryshimet do të merren nga Byroja Ndërkombëtare të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit. Pas kësaj pike, vendet anëtare mund të paraqesin ndryshimet e tyre në seanca.

5. Më poshtë do të konsiderohen si ndryshime: çdo propozim, i cili, pa ndryshuar përmbajtjen e propozimit origjinal, përfshin një fshirje, shtesë ose rishikim të një pjese të propozimit origjinal. Asnjë ndryshim i propozuar nuk do të konsiderohet si një ndryshim nëse nuk është në përputhje me kuptimin ose qëllimin e propozimit origjinal. Në rast dyshimi, Kongresi ose komiteti do të vendosin për çështjen.

6. Amendamentet e paraqitura në Kongres, në lidhje me propozimet e bëra, duhet të dorëzohen në sekretariat me shkrim, në gjuhën franceze, para mesditës, një ditë para diskutimit, në mënyrë që t'u



shpërndahet në të njëjtën ditë delegatëve. Ky afat nuk zbatohet për amendamentet që vijnë drejtpërdrejt nga diskutimet në Kongres ose në një komitet. Në rastin e fundit, nëse kjo kërkohet, autori i amendamentit duhet të paraqesë tekstin e tij me shkrim në gjuhën franceze, ose në rast vështirësie, në çdo gjuhë tjetër të përdorur për debate. Kryetari duhet ta lexojë me zë të lartë ose ta japë për lexim me zë të lartë.

7. Procedura e parashikuar në paragrafin 5 do të zbatohet gjithashtu për paraqitjen e propozimeve, që nuk kanë si qëllim mendimin e tekstit të akteve (projektrezoluta, projekt rekomandime, projekte të opinionëve formale) kur këto propozime rezultojnë nga puna e Kongresit.

8. Çdo propozim ose amendament duhet të ketë formën përfundimtare të tekstit, që duhet të integrohet në aktet e Bashkimit, subjekt, sigurisht, i rishikimit nga komiteti i hartimit.

Neni 14

Shqyrtimi i propozimeve në Kongres dhe në komitete

1. Hartimi i propozimeve (numri i të cilave do të ndiqet nga shkronja R), do t'i atribuohen Komisionit të hartimit, qoftë direkt, nëse Byroja Ndërkombëtare nuk ka dyshime për natyrën e tyre (një listë e këtyre propozimeve hartohet nga Byroja Ndërkombëtare për komisionin e hartimit), ose, nëse Byroja Ndërkombëtare ka dyshime mbi natyrën e tyre, pasi komitetet e tjera e kanë konfirmuar se ato kanë karakter thjesht hartues (një listë e këtyre propozimeve do të hartohet për komitetet e interesuara). Megjithatë, nëse këto propozime janë të lidhura me propozime të tjera që do të trajtohen nga Kongresi ose nga komitetet e tjera, komiteti i hartimit do të shtyjë marrjen në konsideratë të tyre deri sa Kongresi ose komitetet e tjera të kenë marrë një vendim mbi propozimet përkatëse të përmbajtjes. Propozimet, numri i të cilave nuk ndiqet nga shkronja R, por të cilat sipas mendimit të Byrosë Ndërkombëtare janë propozime hartuese, i kalohen menjëherë komisioneve të interesuara, së bashku me propozimet që i korrespondojnë. Kur këto komitete fillojnë punën, ato do të vendosin cilat nga këto propozime do t'i jepen komitetit të hartimit. Një listë e këtyre propozimeve hartohet

nga Byroja Ndërkombëtare komiteteve të interesuara.

2. Nëse e njëjta çështje është objekt i shumë propozimeve, kryetari do të vendosë për rendin në të cilin ato do të diskutohen, duke filluar si rregull me propozimin që largohet më shumë nga teksti bazë dhe që përmban ndryshimet më të mëdha në raport me *status quo*-në.

3. Nëse një propozim mund të ndahet në shumë pjesë, secila prej tyre, me pëlqimin e autorit të propozimit ose të asamblesë, mund të ekzaminohet dhe të shprehet veçmas.

4. Çdo propozim i tërhequr në Kongres ose komitet nga autori i saj mund të paraqitet sërish nga delegacioni i një shteti tjetër anëtar. Në mënyrë të ngjashme, nëse një amendament për një propozim pranohet nga autori i propozimit, një delegacion tjetër mund të paraqesë sërish propozimin origjinal të amenduar.

5. Çdo amendament për një propozim, i cili është pranuar nga delegacioni që e ka paraqitur këtë propozim, do të përfshihet menjëherë në tekstin e propozimit. Nëse autori i propozimit origjinal nuk e pranon amendamentin, kryetari do të vendosë nëse do të votohet më parë amendamenti apo propozimi, duke u nisur nga ai që largohet më shumë nga kuptimi ose qëllimi i tekstit bazë dhe që sjell ndryshimin më të thellë në raport me *status quo*-në.

6. Procedura e përshkruar në paragrafin 5 do të zbatohet edhe kur janë paraqitur më shumë se një amendament për një propozim.

7. Kryetari i Kongresit dhe kryetarët e komiteteve kujdesen që komiteti i hartimit, të marrë me shkrim, pas çdo seance, tekstin e shkruar të propozimeve, amendamenteve ose vendimeve të miratuara.

Neni 15

Diskutime

1. Të deleguarit nuk mund ta marrin fjalën deri sa të lejohen nga kryetari i mbledhjes. Ata do të rekomandohen të flasin pa nxitim dhe qartë. Kryetari duhet t'ju sigurojë të deleguarve mundësinë e shprehjes së lirë dhe të plotë të mendimit të tyre mbi subjektin në diskutim, për sa është e pajtueshme me zhvillimin normal të diskutimeve.



2. Me përjashtim të rastit kur shumica e anëtarëve të pranishëm dhe votues vendosin ndryshe, fjalimet nuk mund të jenë më të gjata se 5 minuta. Kryetari do të jetë i autorizuar të ndërpresë çdo orator që tejkalon kohën e diskutimit. Ai, gjithashtu, mund t'i kërkojë të deleguarit të moslargohet nga tema.

3. Gjatë një debati, kryetari, me pëlqimin e pjesës më të madhe të anëtarëve të pranishëm dhe votues, mund të deklarojë të mbyllur listën e diskutantëve, pas leximit të saj me zë të lartë. Kur lista shterohet, ai shpall mbylljen e debatit, megjithatë edhe pas mbylljes së listës ai mund t'i japë autorit të propozimit në diskutim të drejtën të përgjigjet ndaj çdo fjalimi të mbajtur.

4. Kryetari, me pëlqimin e pjesës më të madhe të anëtarëve të pranishëm dhe votues, mund, gjithashtu, të kufizojë numrin e ndërhyrjeve të të njëjtit delegacion mbi një propozim ose një grup propozimesh të caktuar; por autorit të propozimit do t'i jepet mundësia të paraqesë propozimin dhe, nëse e kërkon, të flasë më pas për të sjellë elemente të reja në përgjigje të fjalës së delegacioneve të tjera, pra, nëse ai dëshiron, mund të jetë folësi i fundit.

5. Me pëlqimin e pjesës më të madhe të anëtarëve të pranishëm dhe votues, kryetari mund të kufizojë numrin e ndërhyrjeve mbi një propozim ose një grup propozimesh të caktuara; por, ky kufizim nuk mund të jetë më pak se 5 pro dhe 5 kundër propozimit në fjalë.

Neni 16

Mocionet mbi rendin e ditës dhe mocionet e procedurës

1. Gjatë diskutimit të çdo çështjeje, edhe kur gjykohet e përshtatshme, pas mbylljes së debatit, një delegacion mund të ngrejë një mocion mbi rendin e ditës për qëllime të kërimit të:

- 1.1 shpjegimeve për drejtimin e debateve;
- 1.2 respektimin e rregullave të procedurës;
- 1.3 ndryshimin e rendit të bisedimeve dhe propozimet e sugjeruara nga kryetari.

Mocioni për rendin e ditës ka prioritet mbi të gjitha çështjet, duke përfshirë edhe mocionet e procedurës, të përcaktuara në paragrafin 3.

2. Kryetari do të japë menjëherë shpjegimet e dëshiruara ose do të marrë vendimin që ai e gjykon të arsyeshëm për çështjen e mocionit mbi rendin e

ditës. Në rast të kundërshtimeve, vendimi i kryetarit do të vihet menjëherë në votim.

3. Përveç kësaj, gjatë diskutimit të një çështjeje, një delegacion mund të propozojë një mocion procedure për propozimin e:

- 3.1 ndërprerjes së mbledhjes;
- 3.2 mbylljes së mbledhjes;
- 3.3 shtyrjen e debatit për çështjen në diskutim;
- 3.4 mbylljen e debatit për çështjen në diskutim.

Mocionet e procedurës do të kenë prioritet, në rendin e përcaktuar më sipër, mbi të gjitha propozimet, me përjashtim të rastit të mocioneve mbi rendin e ditës të referuara në paragrafin 1.

4. Mocionet për ndërprerjen ose mbylljen e mbledhjes nuk do të diskutohen, por do të vendosen menjëherë në votë.

5. Kur një delegacion propozon shtyrjen ose mbylljen e debatit mbi çështje në diskutim, fjala ju jepet vetëm dy oratorëve që kundërshtojnë shtyrjen ose mbylljen e debatit, më pas mocioni vihet në votë.

6. Delegacioni që paraqet një mocion mbi rendin e ditës ose procedurën, gjatë ndërhyrjes së tij, nuk mund të trajtojë përmbajtjen e çështjes në diskutim. Autori i një mocioni të procedurës mund ta tërheqë atë para se ajo të votohet dhe çdo mocion i këtij lloji, i amenduar ose jo, i cili është tërhequr, mund të paraqitet përsëri nga një delegacion tjetër.

Neni 17

Kuorumi

1. Subjekt i paragrafëve 2 dhe 3, kuorumi i nevojshëm për hapjen e mbledhjeve dhe votimin përbëhet nga gjysma e shteteve anëtare, të përfaqësuara në Kongres dhe që kanë të drejtën e votës.

2. Për votimin e amendimeve të Kushtetutës dhe të rregullores së përgjithshme, kuorumi i kërkuar përbëhet nga dy të tretat e shteteve anëtare të Bashkimit, që kanë të drejtën e votës.

3. Në rastin e marrëveshjeve, kuorumi i kërkuar për hapjen e mbledhjeve dhe për votimin përbëhet nga gjysma e shteteve anëtare të përfaqësuara në Kongres, të cilat janë palë e marrëveshjes për të cilën bëhet fjalë dhe që kanë të drejtën e votës.

4. Delegacionet të cilat janë të pranishme por që nuk marrin pjesë në një votim të caktuar ose që deklarojnë se nuk duan të marrin pjesë, do të



konsiderohen si të pranishëm për qëllimet e përcaktimit të kuorumit të kërkuar sipas paragrafëve 1, 2 dhe 3.

Neni 18

Parimi dhe procedura e votës

1. Çështjet që nuk mund të rregullohen me një pëlqim të përbashkët, hidhen në votë.

2. Votimet bëhen me sistemin tradicional ose me anë të mjeteve elektronike të votimit. Normalisht ato do të bëhen me mjete elektronike, kur ky sistem është i disponueshëm në Asamble. Megjithatë, në rast të një votimi të fshehtë, mund të përdoret sistemi tradicional, nëse një delegacion, i mbështetur nga shumica e delegacioneve të pranishme dhe votuese, e kërkon këtë.

3. Për sistemin tradicional, procedurat e votimit do të jenë si më poshtë:

3.1 me ngritje dore, nëse ka ndonjë dyshim për rezultatin e këtij votimi, kryetari, me vullnetin e tij ose kërkesën e një delegacioni, mund të procedojë menjëherë në një votim me apel për të njëjtën çështje;

3.2 me apel, me kërkesë të një delegacioni ose nëse kështu vendoset nga kryetari; apeli do të bëhet duke ndjekur rendin alfabetik francez të shteteve të përfaqësuara, duke filluar nga shteti emri i të cilit tërhiqet me short nga kryetari; rezultati i votimit, së bashku me listën e shteteve të grupuara sipas mënyrës në të cilën ata kanë votuar, do të përfshihet në raportin e mbledhjes;

3.3 me votim të fshehtë: duke përdorur fletët e votimit, nëse kërkohet nga dy delegacione; kryetari i mbledhjes përcakton në këtë rast tre numërues votash, duke pasur parasysh përfaqësimin në ndarje të barabartë gjeografike dhe nivelin e zhvillimit ekonomik të shteteve anëtare, dhe do të marrë masat e nevojshme për zhvillimin e votimit të fshehtë.

4. Për sistemin elektronik, metodat e votimit janë si më poshtë:

4.1 votim i paregjistruar, zëvendëson votimin me ngritje dore;

4.2 votim i regjistruar: zëvendëson votimin me apel; megjithatë, nuk procedohet me apelin e emrave të shteteve, me përjashtim të rastit kur kërkohet nga një delegacion me mbështetjen e pjesës më të madhe të delegacioneve të pranishme dhe votuese;

4.3 votim sekret: zëvendëson votimin e fshehtë me fletë votimi.

5. Pavarësisht nga sistemi i përdorur, votimi i fshehtë do të ketë prioritet mbi çdo procedurë tjetër votimi.

6. Pasi ka filluar një votim, asnjë delegacion nuk mund ta ndërpresë atë, me përjashtim të ngritjes së një mocioni të rendit të ditës në lidhje me mënyrën me të cilën kryhet votimi.

7. Pas votimit, kryetari mund të lejojë të deleguarit të shpjegojnë përse kanë votuar siç kanë votuar.

Neni 19

Kushtet e miratimit të propozimeve

1. Për t'u miratuar, propozimet që përfshijnë amendimin e akteve duhet:

1.1 në rastin e Kushtetutës: do të miratohen nga dy të tretat e shteteve anëtare të Bashkimit, që kanë të drejtën e votës;

1.2 në rastin e rregullores së përgjithshme: do të miratohen nga shumica e shteteve anëtare të përfaqësuara në Kongres, që kanë të drejtën e votës;

1.3 në rastin e Konventës: do të miratohen nga shumica e shteteve anëtare të pranishme dhe votuese, që kanë të drejtën e votës;

1.4 në rastin e marrëveshjeve: do të miratohen nga shumica e shteteve anëtare të pranishme dhe votues, që janë palë në marrëveshjet dhe që kanë të drejtën e votës.

2. Çështjet procedurale të cilat nuk mund të zgjidhen me një marrëveshje do të vendosen nga shumica e shteteve anëtare të pranishme dhe votuese, që kanë të drejtën e votës. E njëjta procedurë do të ndiqet edhe për vendimet që nuk kanë të bëjnë me ndryshimet e akteve, me përjashtim të rastit kur Kongresi vendos ndryshe me shumicë të shteteve anëtare të pranishëm dhe votues, që kanë të drejtën e votës.

3. Subjekt i paragrafit 5, “shtetet anëtare të pranishme dhe votuese” do të nënkuptojnë shtetet të cilat kanë të drejtën e votës “pro” ose “kundër”, abstenimet nuk do të merren në konsideratë në numrin e votave të nevojshme për të formuar shumicën, dhe fletët e votimit të bardha ose të pavlefshme, në rastin e votimit të fshehtë.

4. Në rast barazimi, propozimi do të konsiderohet i refuzuar.



5. Kur numri i abstenimeve dhe fletëve të votimit të bardha ose të pavlefshme e kalon gjysmën e numrit të votave të shprehura (pro, kundër, abstenime) ekzaminimi i çështjes shtyhet në një seancë të mëvonshme gjatë së cilës abstenimet dhe fletët e votimit të bardha ose të pavlefshme, nuk merren në konsideratë.

Neni 20

Zgjedhja e anëtarëve të këshillit drejtues dhe Këshillit të Operacioneve postare

1. Me qëllim për të vendosur midis vendeve që kanë marrë të njëjtin numër votash në zgjedhjet e anëtarëve të këshillit drejtues dhe të Këshillit të Operacioneve Postare, kryetari procedon me zgjedhjen me short.

Neni 21

Zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm dhe e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtar

1. Zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm dhe e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare do të realizohet me votim të fshehtë, pas një ose disa mbledhjeve që mbahen në të njëjtën ditë. Do të zgjidhet kandidati që merr shumicën e votave të dhëna nga shtetet anëtare të pranishme dhe votuese. Procedohet me aq votime sa bëhet e nevojshme që një kandidat të mund të marrë shumicën.

2. “Shtete anëtare të pranishme dhe votuese” do të konsiderohen ato shtete anëtare që votojnë për një nga kandidatët aplikimi i të cilëve është shpallur në formën e duhur dhe të përshtatshme, abstenimet dhe fletët e bardha dhe të pavlefshme nuk merren në konsideratë në numërimin e votave të nevojshme për të llogaritur shumicën.

3. Nëse numri i abstenimeve dhe i fletëve të bardha apo të pavlefshme e kalon gjysmën e numrit të votave të dhëna në përputhje me dispozitat e parashikuara në paragrafin 2, zgjedhja do të shtyhet në një seancë tjetër gjatë së cilës abstenimet, fletët e bardha, votat e pavlefshme nuk merren në konsideratë.

4. Kandidati që në një raund të zgjedhjeve ka marrë më pak vota, eliminohet.

5. Në rast të një barazimi të votave, procedohet në një votim shtesë, dhe më pas, nëse është e

nevojshme, edhe me një votim të dytë, në përpjekje për të vendosur midis dy kandidatëve në barazim, me votë vetëm në lidhje me këta kandidatë. Nëse rezultati është negativ, zgjedhja do të vendoset me short. Shorti do të hidhet nga Presidenti.

6. Kandidatët për drejtor të përgjithshëm dhe zëvendës drejtor të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare, me kërkesën e tyre, mund të përfaqësohen në numërimin e votave.

Neni 22

Raportet

1. Raportet e seancave plenare të Kongresit do të regjistrojnë zhvillimin e seancave, përmbledhin shkurt fjalimet dhe përmendin propozimet dhe rezultatin e debateve.

2. Debatet e mbledhjeve të komiteteve do të jenë subjekt i raporteve për Kongres. Si rregull i përgjithshëm, grupet e punës do të përgatisin një raport për organet që i kanë krijuar ato.

3. Megjithatë, çdo i deleguar ka të drejtë të kërkojë që çdo deklaratë e bërë prej tij të përfshihet në raporte, tekstualisht ose në formë të përmbledhur, me kusht që teksti në gjuhën frënge ose angleze të dorëzohet në sekretariat jo më vonë se dy orë pas fundit të mbledhjes.

4. Të deleguarit do të kenë një afat prej 24 orësh nga momenti kur shpërndahet drafraporti, për vëzhgimet e tyre në sekretariat, që, nëse është e nevojshme, të veprojnë si ndërmjetës midis palës së interesuar dhe kryetarit të mbledhjes në fjalë.

5. Si rregull i përgjithshëm dhe subjekt i dispozitave të paragrafit 4, në fillim të çdo seance të Kongresit, kryetari do të paraqesë për miratim raportin e seancës së mëparshme. E njëjta procedurë do të zbatohet edhe për raportet e komisioneve. Raportet e seancave të fundit për të cilat nuk ka qenë e mundur të miratoheshin në Kongres ose në komision, do të miratohen nga kryetarët përkatës të këtyre mbledhjeve. Byroja Ndërkombëtare do të marrë gjithashtu parasysh edhe komentet e marra nga të deleguarit e shteteve anëtare brenda një afati prej 40 ditësh pas dërgimit të raporteve.

6. Byroja Ndërkombëtare do të jetë e autorizuar të korrigjojë gabimet materiale në raportet e seancave të Kongresit dhe të komiteteve, të cilat nuk janë zbuluar kur janë miratuar procesverbalet në përputhje me paragrafin 5.



Neni 23

Apeli kundër vendimeve të marra nga komitetet dhe nga Kongresi

1. Çdo delegacion mund të apelojë kundër një vendimi në lidhje me propozimet (aktet, rezolutat etj.) të cilat janë miratuar ose hedhur poshtë në komitetet. Kryetari i Kongresit duhet të informohet me shkrim për apelin, brenda një afati prej 48 orësh pas mbylljes së seancës së komitetit ku propozimi është miratuar ose hedhur poshtë. Apeli ekzaminohet në seancën e ardhshme plenare.

2. Kur një propozim është miratuar ose hedhur poshtë nga Kongresi, nuk mund të ekzaminohet përsëri nga ai, me përjashtim të rastit kur apeli mbështetet nga të paktën 10 delegacione. Ky apel duhet të miratohet nga shumica prej dy të tretash e anëtarëve të pranishëm dhe votues, që kanë të drejtën e votës. Kjo mundësi do të kufizohet te propozimet që paraqiten drejtpërdrejt në seancat plenare, duke marrë parasysh se për një çështje nuk mund të ketë më shumë se një apel.

Neni 24

Miratimi nga Kongresi i projektvendimeve (aktet, rezolutat, etj.)

1. Si rregull i përgjithshëm, çdo projektakt i paraqitur nga komiteti i hartimit do të ekzaminohet nën për nen. Kryetari, me pëlqimin e shumicës, mund të ndjekë një procedurë më të shpejtë, p.sh. kapitull për kapitull. Çdo akt mund të konsiderohet i miratuar vetëm pas një votimi të përgjithshëm të favorshëm. Për këtë votim do të zbatohet neni 21.1.

2. Byroja Ndërkombëtare do të jetë e autorizuar të korrigjojë në aktet përfundimtare gabimet materiale që nuk janë zbuluar gjatë ekzaminimit të projektakteve, numërtimin e neneve dhe të paragrafëve, si edhe referencat.

3. Si rregull i përgjithshëm, projektvendimet e ndryshme nga ato që amendojnë aktet, të paraqitura nga komiteti i hartimit, do të ekzaminohen në bllok. Dispozitat e paragrafit 2, do të zbatohen edhe për këto projektvendime.

Neni 25

Caktimi i studimeve për këshillin drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare

1. Me rekomandim të Byrosë, Kongresi do të caktojë studimet për këshillin drejtues dhe Këshillin e Operacioneve Postare, në përputhje me përbërjet dhe përgjegjësitë e këtyre dy organeve, siç janë vendosur në nenet 106, 107, 112 dhe 113, të rregullores së përgjithshme.

Neni 26

Rezervimi për aktet

1. Rezervimet duhet të paraqiten në sekretariat në formën e një propozimi me shkrim, në një nga gjuhët e punës së Byrosë Ndërkombëtare (propozimet në lidhje me protokollin përfundimtar) sa më shpejt të jetë e mundur, pas miratimit të propozimit në lidhje me nenin të cilit i referohet rezervimi.

2. Në mënyrë që të ketë mundësi të shpërndajë propozimet në lidhje me rezervimin tek të gjithë shtetet anëtare, para miratimit të protokollit përfundimtar nga Kongresi, Sekretariati i Kongresit do të vendosë një afat për paraqitjen e rezervimeve dhe do të njoftojë shtetet anëtare për të.

3. Rezervimet për aktet e Bashkimit të paraqitura pas afatit të vendosur nga sekretariati nuk do të konsiderohen nga sekretariati dhe as nga Kongresi.

Neni 27

Nënshkrimi i akteve

1. Aktet e miratuara përfundimisht nga Kongresi do t'i paraqiten të plotfuqishmëve për nënshkrim.

Neni 28

Amendimi i rregullave

1. Secili Kongres mund të amendojë rregullat e procedurës. Me qëllim që të pranohen për diskutim, propozimet për amendim të këtyre rregullave duhet të mbështeten nga të paktën 10 delegacione në Kongres, me përjashtim të rastit kur ato paraqiten nga një organ i Bashkimit të Përbotshëm Postar.



2. Miratimi i propozimeve për amendim të këtyre rregullave duhet të bëhet me të paktën dy të tretat e shteteve anëtare të përfaqësuara në Kongres dhe që kanë të drejtën e votës.

RREGULLORE E PËRGJITHSHME E BASHKIMIT TË PËRBOTSHËM POSTAR (Ndryshuar nga protokoll i shtesë i Stambollit 2016)

Pasqyra e lëndës

Kapitulli I: Organizimi, funksionimi dhe funksionet e Kongresit, të Këshillit Administrativ, të Këshillit të Operacioneve Postare dhe Komitetit Konsultativ

Seksioni 1: Kongresi

Neni:

101. Organizimi dhe mbledhja e Kongresit dhe e jashtëzakonshme

102. E drejta e votës në Kongres

103. Funksionet e Kongresit

104. Rregullat e procedurës së kongreseve

105. Vëzhguesit e organeve të Bashkimit

Seksioni 2: Këshilli Administrativ (CA)

106. Përbërja dhe funksionimi i Këshillit Administrativ

107. Funksionet e CA-së

108. Organizimi i sesioneve të CA-së

109. Vëzhguesit

110. Rimbursimi i shpenzimeve të udhëtimit

111. Informacion mbi aktivitetet e CA-së

Seksioni 3: Këshilli i Operacioneve Postare (POC)

112. Përbërja dhe funksionimi i POC-së

113. Funksionet e POC-së

114. Organizimi i sesioneve të POC-së

115. Vëzhguesit POC

116. Rimbursimi i shpenzimeve të udhëtimit

117. Informacion mbi aktivitetet e POC-së

117.bis. Komiteti Koordinues për Organet e Përhershme të Bashkimit

Seksioni 4: Komiteti Konsultativ (CC)

118. Qëllimi i CC-së

119. Përbërja e CC-së

120. Anëtarësimi në CC

121. Funksionet e CC-së

122. Organizimi i CC-së

123. Përfaqësues të Komitetit Konsultativ në Këshillin e Administrimit, në Këshillin e Operacioneve Postare dhe Kongres

124. Vëzhguesit CC

125. Informacion mbi aktivitetet e CC-së

Kapitulli II: Byroja Ndërkombëtare

Seksioni 1: Zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare

126. Zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare

127. Detyrat e drejtorit të përgjithshëm

128. Detyrat e zëvendës drejtorit të përgjithshëm

Seksioni 2: Sekretariati i Organeve të Bashkimit dhe Komiteti Këshillues

129. Shënime të përgjithshme

130. Përgatitja dhe shpërndarja e dokumenteve të organeve të Bashkimit

131. Lista e shteteve anëtare

132. Informacioni. Opinionet. Kërkesat për interpretim dhe amendim të akteve. Reklamimet. Roli në shlyerjen e llogarive

133. Bashkëpunimi teknik

134. Formularët e dhënë nga Byroja Ndërkombëtare

135. Aktet e sindikatave të kufizuara dhe marrëveshje të posaçme

136. Botimet periodike të Bashkimit

137. Raporti vjetor për punën e Bashkimit

Kapitulli III: Paraqitja, shqyrtimi i propozimeve, njoftimi i vendimeve të miratuara dhe hyrja në fuqi e rregullores dhe vendimeve të tjera të miratuara

138. Procedura për paraqitjen e propozimeve në Kongres

138.bis. Procedura për amendimin e propozimeve të paraqitura në përputhje me nenin 138

139. Procedura për paraqitjen e propozimeve që amendojnë Konventën ose marrëveshjet ndërmjet kongreseve

140. Marrja në konsideratë e propozimeve që amendojnë Konventën ose marrëveshjet ndërmjet kongreseve

141. Procedura për paraqitjen e propozimeve në Këshillin e Operacioneve Postare, në lidhje me përgatitjen e rregulloreve të reja në kuadrin e vendimeve të marra nga Kongresi

142. Amendimi i rregullores nga Këshilli i Operacioneve Postare

143. Njoftimi i vendimeve të miratuara ndërmjet kongreseve



144. Hyrja në fuqi e rregulloreve dhe vendimeve të tjera të miratuara ndërmjet kongreseve

Kapitulli IV: Financa

145. Vendosja dhe rregullimi i shpenzimeve të Bashkimit

146. Rregullimi i kontributeve të shteteve anëtare

147. Mangësitë në financim

148. Mbikëqyrja e mbajtjes së llogarive dhe kontabilitetit

149. Sanksione automatike

150. Klasat e kontributeve

151. Pagesa për furnizime nga Byroja Ndërkombëtare

152. Organizimi i organeve ndihmëse të përdorues – financuesve

Kapitulli V: Arbitrazhi

153. Procedura e arbitrazhit

Kapitulli VI: Përdorimi i gjuhëve brenda Bashkimit

154. Gjuha zyrtare e Byrosë Ndërkombëtare

155. Gjuhët e përdorura për dokumentacion, për debate dhe për korrespondencë zyrtare

Kapitulli VII: Dispozita të fundit

156. Kushtet për miratimin e propozimeve në lidhje me rregulloren e përgjithshme

157. Propozimet në lidhje me marrëveshjet me Kombet e Bashkuara

158. Amendimi, hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e rregullores së përgjithshme

RREGULLORE E PËRGJITHSHME E BASHKIMIT TË PËRBOTSHËM POSTAR (Ndryshuar nga protokollin shtesë i Stambollit 2016³⁹)

Të nënshkruarit, të plotfuqishmit e qeverive të shteteve anëtare të Bashkimit, duke pasur parasysh nenin 22.2 të Kushtetutës së Bashkimit të Përbotshëm Postar të përfunduar në Vjenë, më datë 10 korrik 1964, me marrëveshje të përbashkët dhe subjekt i nenit 25.4 të Kushtetutës, kanë hartuar në këtë rregullore të përgjithshme dispozitat e mëposhtme, duke siguruar zbatimin e Kushtetutës dhe funksionimin e Bashkimit.

KAPITULLI 1

ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE FUNKSIONET E KONGRESIT, TË KËSHILLIT ADMINISTRATIV, TË KËSHILLIT TË OPERACIONEVE POSTARE DHE KOMITETIT KONSULTATIV

SEKSIONI 1

KONGRESI

Neni 101

Organizimi dhe mbledhja e Kongreseve dhe Kongreseve të Jashtëzakonshëm (Kushtetuta 14, 15)

1. Përfaqësuesit e shteteve anëtare do të mbledhen në kongres jo më vonë se katër vjet nga fundi i vitit në të cilin është mbledhur Kongresi i mëparshëm.

2. Çdo shtet anëtar do të përfaqësohet në Kongres nga një ose disa delegatë të cilët do të kenë kompetencat e nevojshme nga qeveria e tyre. Në rast nevojë, mund të bihet dakord për t'u përfaqësuar nga një shtet tjetër anëtar. Megjithatë, duhet të kuptohet që një delegacion nuk mund të përfaqësojë më shumë se një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti i tij.

3. Në parim, çdo kongres cakton vendin ku do të zhvillohet Kongresi i ardhshëm. Nëse kjo zgjidhje bëhet e pazbatueshme, këshilli drejtues është i autorizuar të caktojë vendin ku Kongresi do të mbajë mbledhjet e tij, por pasi të jetë konsultuar me vendin e papranuar më parë.

4. Në marrëveshje me Byronë Ndërkombëtare, qeveria pritëse cakton datën definitive dhe vendin e saktë ku do të zhvillohet Kongresi. Në parim, një vit para kësaj date, qeveria pritëse do t'i dërgojë një ftesë secilës prej qeverive të shteteve anëtare. Kjo ftesë mund të dërgohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose me ndërmjetësim të një qeverie tjetër, ose nëpërmjet drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare.

5. Kur nuk ka një shtet pritës për Kongresin, Byroja Ndërkombëtare, në marrëveshje me këshillin drejtues dhe pas konsultimit me qeverinë e Konfederatës së Zvicrës, do të marrë masat e nevojshme për thirrjen dhe organizimin e Kongresit në vendin ku ndodhet selia e Bashkimit.

³⁹ Për Protokollin e Parë Shtesë (Kongresi i Stambollit, 2016), shihni faqet 23–30 të këtij dokumenti.



Në këtë rast, Byroja Ndërkombëtare do të ushtrojë funksionet e qeverisë ftuese.

6. Vendi për mbledhjen e një Kongresi të Jashtëzakonshëm përcaktohet nga shtetet anëtare që kanë marrë iniciativën për këtë Kongres, pas konsultimit me Byronë Ndërkombëtare.

7. Dispozitat e parashikuara në pikat 2 deri në 5 do të jenë të zbatueshme për analogji dhe për kongreset e jashtëzakonshme.

Neni 102

E drejta e votës në Kongres

1. Çdo vend anëtar ka të drejtën e një vote, me përjashtim të sanksioneve të parashikuara në nenin 149.

Neni 103

Funksionet e Kongresit

1. Në bazë të propozimeve nga shtetet anëtare, Këshilli Drejtues dhe Këshilli i Operacioneve Postare, Kongresi:

1.1 të përcaktojë politikën e përgjithshme për përmbushjen e objektivave dhe qëllimit të Bashkimit të vendosur në preambulë dhe në nenin 1 të Kushtetutës;

1.2 të konsiderojë dhe miratojë, nëse është e përshtatshme, propozimet për amendimet e Kushtetutës, rregullores së përgjithshme, Konventën dhe marrëveshjet e paraqitura nga shtetet anëtare dhe këshillat, në përputhje me nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 138 të rregullores së përgjithshme;

1.3 të vendosë datën për hyrjen në fuqi të akteve;

1.4 të miratojë rregullat e tij të procedurës dhe amendimet e këtyre rregullave;

1.5 të konsiderojë raportet e përgjithshme mbi punën e Këshillit Drejtues, Këshillit të Operacioneve Postare dhe Komitetit Këshillimor, që mbulojnë periudhën nga Kongresi i mëparshëm, të paraqitur nga organet përkatëse në përputhje me nenin 111, 117 dhe 125, të rregullores së përgjithshme;

1.6 të miratojë strategjinë e Bashkimit;

1.6.bis të miratojë draftplanin katërvjeçar të biznesit të UPU-së;

1.7 të vendosë shumën maksimale të shpenzimeve të Bashkimit, në përputhje me nenin 121 të Kushtetutës;

1.8 të zgjedhë shtetet anëtare në Këshillin Drejtues dhe në Këshillin e Operacioneve Postare, në përputhje me, ndër të tjera, procedurat zgjedhore të përcaktuara në rezolutat e Kongresit që lidhen me këtë çështje;

1.9 të zgjedhë drejtorin e përgjithshëm dhe zëvendës-drejtorin e përgjithshëm;

1.10 të vendosë kufirin e kostove që ka Bashkimi për prodhimin e dokumenteve në gjuhën Kineze, Gjermane, Portugeze dhe Ruse.

2. Kongresi, si organ suprem i Bashkimit, do të kujdeset për të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me shërbimet postare.

Neni 104

Rregullat e procedurës së kongreseve (Kushtet. 14)

1. Për organizimin e punës së tij dhe zhvillimin e debateve, Kongresi duhet të zbatojë rregullat e procedurës.

2. Çdo kongres mund të ndryshojë rregullat e procedurës sipas kushteve të përcaktuara në rregulloret e procedurës.

3. Paragrafët 1 dhe 2, për analogji, do të zbatohen edhe për Kongreset e Jashtëzakonshme.

Neni 105

Vëzhguesit e organeve të Bashkimit

1. Subjektet e mëposhtme do të ftohen të marrin pjesë në seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve të Kongresit, Këshillit Administrativ dhe Këshillit të Operacioneve Postare si vëzhgues:

1.1 Kombet e Bashkuara;

1.2 sindikatat e bashkimit;

1.3 anëtarët e Komitetit Konsultativ;

1.4 subjektet e autorizuar për të marrë pjesë në mbledhjet e Bashkimit si vëzhgues në bazë të një rezolute apo vendimi të Kongresit.

2. Subjektet e mëposhtme, nëse janë caktuar sipas rregullit nga Këshilli i Administrimit, në përputhje me nenin 107.1.12, do të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e veçanta të Kongresit si vëzhgues të posaçëm:

2.1 agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërqeveritare;

2.2 çdo organ ndërkombëtar, çdo shoqatë ose ndërmarrje, ose çdo person i kualifikuar.



3. Përveç vëzhguesve të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Këshilli i Administrimit dhe Këshilli i Operacioneve Postare mund të caktojë vëzhgues të posaçëm për të marrë pjesë në mbledhjet e tyre, në pajtim me rregullat e tyre të procedurës, kur kjo është në interes të Bashkimit dhe organet të tij.

SEKSIONI 2 KËSHILLI ADMINISTRATIV (CA)

Neni 106 Përbërja dhe funksionimi i CA-së (Kushtet. 17)

1. Këshilli Administrativ përbëhet nga dyzetë e një anëtarë, të cilët ushtrojnë funksionet e tyre gjatë periudhës midis dy kongreseve të njëpasnjëshme.

2. Presidenca i njihet si e drejtë shtetit anëtar pritës të kongresit. Nëse ky shtet anëtar heq dorë nga kjo e drejtë, ai do të konsiderohet si anëtar *de jure*, dhe për rrjedhojë, grupi gjeografik në të cilin ai bën pjesë do të ketë në dispozicionin e tij një vend shtesë, ndaj të cilit nuk do të jenë të zbatueshme kufizimet e parashikuara në pikën 3. Në këtë rast, Këshilli Administrativ do të zgjedhë për presidencë një nga shtetet anëtare, pjesëtarë të grupit gjeografik në të cilin bën pjesë shteti anëtar pritës.

3. Të dyzetë (40) anëtarët e tjerë të Këshillit Administrativ do të zgjidhen nga Kongresi mbi bazën e një shpërndarje gjeografike të barabartë. Të paktën gjysma e anëtarëve do të rinovohet në çdo kongres; asnjë vend anëtar nuk mund të zgjidhet nga tre kongrese të njëpasnjëshme.

4. Çdo anëtar i Këshillit Administrativ cakton përfaqësuesin(t) e tij, i cili/të cilët duhet të jetë kompetent në kuadrin postar. Anëtarët e Këshillit Administrativ duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në punimet e tij.

5. Funksionet e anëtarit të Këshillit Administrativ nuk do të jenë të paguara. Shpenzimet për funksionimin e këtij Këshilli i ngarkohen Bashkimit.

6. Këshilli Administrativ do të përcaktojë, zyrtarizojë dhe/ose krijojë grupet e punës dhe task-forcat ose organe të tjera që do të ngrihen brenda strukturës së saj, duke pasur parasysh ngritjen e tyre për qëllime të strategjisë dhe planit të punës së Bashkimit, të miratuara nga Kongresi.

Neni 107 Funksionet e CA-së

1. CA-ja do të ketë kompetencat e mëposhtme:

1.1 mbikëqyrjen e të gjithë veprimtarive të Bashkimit midis kongreseve, duke siguruar përputhjen me vendimet e Kongresit, duke shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me politikat qeverisëse mbi çështjet postare dhe duke konsideruar zhvillimet rregullatore ndërkombëtare si ato që kanë të bëjnë me tregtinë e shërbimeve dhe të konkurrencës;

1.2 promovimin, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha formave të asistencës teknike postare brenda kuadrit të bashkëpunimit teknik ndërkombëtar;

1.3 Shqyrton draftplanin katërvjeçar të biznesit të UPU-së të miratuar nga Kongresi dhe e finalizon atë, duke përfshirë aktivitetet e përcaktuara në draftplanin për periudhën katërvjeçare, në përputhje me burimet aktuale të disponueshme. Plani duhet gjithashtu, nëse është e përshtatshme, të jetë në përputhje me rezultatet e procesit të prioritizimit të përcaktuara nga Kongresi. Versioni final i planit katërvjeçar të biznesit, i përfunduar dhe miratuar nga Këshilli Administrativ, do të krijojë bazat për përgatitjen e programit vjetor dhe buxhetit të UPU-së, si dhe për planet vjetore operacionale për t'u hartuar dhe zbatuar nga Këshilli Administrativ dhe Këshilli i Operacioneve Postare;

1.4 shqyrtimin dhe miratimin e programit dyvjeçar dhe buxhetit, dhe llogarive të Bashkimit, duke marrë parasysh versionin përfundimtar të planit të biznesit të UPU-së, siç përshkruhet në nenin 107.1.3;

1.5 autorizimin e tejkalimit të kufirit të shpenzimeve, nëse e kërkojnë rrethanat, në përputhje me nenin 145.3 deri në 5;

1.6 autorizimin e zgjedhjes së një klase kontributi më të ulët, nëse kjo kërkohet, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 150.6;

1.7 autorizimin e ndryshimit të grupit gjeografik, nëse kjo kërkohet nga një shtet anëtar, duke konsideruar mendimet e shprehura nga shtetet anëtare të cilat janë pjesëtarë të grupeve gjeografike në fjalë;

1.8 krijimin ose shkurtimin e vendeve të punës në Byronë Ndërkombëtare të financuara nga



buxheti, duke konsideruar kufizimet lidhur me tavanin e vendosur të shpenzimeve;

1.9 vendimin mbi kontaktet që duhet të vendosen me shtetet anëtare, me qëllim përmbushjen e funksioneve të tij;

1.10 pas konsultimit me Këshillin e Operacioneve Postare, vendos për marrëdhëniet që do të përcaktohen me organizatat të cilat nuk janë vëzhgues në kuptim të nenit 105.1 dhe 105.2.1;

1.11 shqyrton raportet e Byrosë Ndërkombëtare mbi marrëdhëniet e UPU-së me organizma të tjerë ndërkombëtarë, vendime të cilat i gjykon si të përshtatshme për të drejtuar këto marrëdhënie dhe veprimet që duhet të ndërmerren për to;

1.12 pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare dhe Sekretariatit e Përgjithshëm, të caktojë në kohën e duhur organizmat ndërkombëtare, shoqatat, sipërmarrjet dhe personat e specializuar të cilët duhet të ftohen në seancat shkencore të Kongresit dhe të komiteteve të tij, kur kjo është në interesin e Bashkimit ose të punimeve të Kongresit, dhe instruktimin e drejtorit të përgjithshëm të dërgojë ftesat e nevojshme;

1.13 autorizimin e ndryshimit të grupit gjeografik, nëse kjo kërkohet nga një shtet anëtar, duke konsideruar mendimet e shprehura nga shtetet anëtare të cilat janë pjesëtare të grupeve gjeografike në fjalë;

1.14 caktimin e shtetit anëtar ku do të mbahet Kongresi i ardhshëm në rastin e parashikuar në nenin 101.3;

1.15 caktimin, pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare dhe subjekt i miratimit të Kongresit, shtetet anëtare të përgatitura:

1.15.1 për të marrë përsipër nën kryesinë e Kongresit dhe të presidencës dhe të nënpresidencës së komiteteve, duke konsideruar sa më shumë që është e mundur shpërndarjen gjeografike të barabartë të shteteve anëtare;

1.15.2 për të mbikëqyrur komisionet e kufizuara të Kongresit;

1.16 caktimin e atyre anëtarëve të tij të cilët do të jenë anëtarë të Komitetit Këshillimor;

1.17 shqyrton dhe miraton, në kuadër të kompetencave të tij, çdo veprim që konsiderohet i nevojshëm për të ruajtur dhe rritur cilësinë edhe për të modernizuar shërbimin postar ndërkombëtar;

1.18 shqyrtimin, me kërkesë të Kongresit, të Këshillit të Operacioneve Postare ose të shteteve anëtare, probleme të llojit administrativ, legjislativ dhe juridik që kanë të bëjnë me Bashkimin ose shërbimin postar ndërkombëtar; i takon këshillit drejtues të vendosë për fushat e lartpërmendura, nëse është e dobishme të ndërmerren studimet e kërkuara nga shtetet anëtare midis kongreseve;

1.19 formulimin e propozimeve që do t'i nënshtrohen miratimit të Kongresit ose të shteteve anëtare në përputhje me nenin 140;

1.20 parashtron çështjet për studimin e Këshillit të Operacioneve Postare për ekzaminimin në përputhje me nenin 113.1.6;

1.21 vlerësimin dhe miratimin, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare, projektin e strategjisë që do të paraqitet në Kongres;

1.22 marrjen dhe diskutimin e raporteve dhe rekomandimeve të Komitetit Këshillimor dhe marrjen në konsideratë të rekomandimeve nga Komiteti Këshillimor për paraqitje në Kongres;

1.23 sigurimi i kontrollit mbi aktivitetet e Byrosë Ndërkombëtare;

1.24 miraton raportin vjetor mbi punën e Bashkimit dhe raportin vjetor operacional financiar të përgatitur nga Byroja Ndërkombëtare dhe nëse e përshtatshme, jep vërejtje mbi to;

1.25 krijon parimet, në rastin kur e gjykon të nevojshme, për Këshillin e Operacioneve Postare duke konsideruar gjatë shqyrtimit të çështjeve me pasoja financiare të rëndësishme (tarifa, detyrime të fazës përfundimtare, shpenzime tranziti, tarifa bazë të transportit ajror të postës dhe postimin jashtë shtetit për dërgesat e postës së letrave), ndjekjen nga afër të shqyrtimit të këtyre çështjeve dhe rishikimin dhe miratimin, për konformitet me parimet e lartpërmendura, propozimet e Këshillit të Operacioneve Postare në lidhje me këto çështje;

1.26 miratimin, brenda kuadrit të kompetencave të veta, të rekomandimeve të Këshillit të Operacioneve Postare në lidhje me njohjen, nëse është e nevojshme, të rregulloreve ose të një praktike të re duke pritur që Kongresi të vendosë mbi çështjen;

1.27 shqyrtimin e raportit vjetor mbi punën e unionit dhe raportin vjetor të përgatitur nga Këshilli i Operacioneve Postare dhe çdo propozim të paraqitur nga Këshilli;

1.28 miratimin e raportit katërvjeçar, të përgatitur nga Byroja Ndërkombëtare duke u



këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare, mbi performancën e shteteve anëtare, në lidhje me ekzekutimin e strategjisë së Bashkimit të miratuar nga Kongresi i mëparshëm, për t'u paraqitur në Kongresin e radhës;

1.29 krijimin e kuadrit për organizimin e Komitetit Këshillimor dhe kontribuimin në organizimin e Komitetit Këshillimor, në përputhje me dispozitat e nenit 122;

1.30 caktimin e kriterëve për anëtarësim në Komitetin Këshillimor dhe miratimin ose kundërshtimin e kërkesave për anëtarësim sipas këtyre kriterëve, duke u siguruar që veprimi me kërkesat është përmbushur me anë të një procedure të përshpejtuar ndërmjet mbledhjeve të këshillit drejtues;

1.31 formulimin e rregullores financiare të Bashkimit;

1.32 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin Rezervë;

1.33 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin Special;

1.34 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin e Veprimtarive;

1.35 formulimin e rregullave që dispijlojnë Fondin Vullnetar;

1.36 formulimin e rregullores së personelit dhe kushteve të shërbimit për funksionarët e zgjedhur;

1.37 formulimin e rregullores së Fondit Social;

1.38 ushtron, brenda kontekstit të nenit 152, mbikëqyrjen e përgjithshme të krijimit të organeve ndihmëse për përdoruesit – financuesit;

1.39 miraton rregullat e procedurave dhe ndryshimet në këto rregulla.

Neni 108

Organizimi i sesioneve të CA-së

1. Në mbledhjen e tij periodike, e cila do të thirret dhe hapet nga kryetari i Kongresit, CA-ja zgjedh, ndër anëtarët e tij, katër nënkryetarë dhe harton rregulloren e tij të procedurave. Kryetari dhe katër nënkryetarët janë nga shtetet anëtare, nga secili prej pesë grupeve gjeografike të Bashkimit.

2. I thirrur nga kryetari i tij, CA-ja do të mbledhet dy herë në vit, ose në bazë të kërkesave të jashtëzakonshme, në selinë e Bashkimit, në përputhje me procedurat përkatëse të përcaktuara në rregullat e procedurave.

3. Kryetari dhe nënkryetarët, dhe kryetari i Komitetit, bashkëkryetari dhe nënkryetari i CA-së do të përbëjnë Komitetin Drejtues. Ky komitet do të përgatisë dhe drejtojë punët në çdo mbledhje të CA-së. Ai miraton, në emër të CA-së, raportin vjetor të përpiluar nga Byroja Ndërkombëtare mbi punën e Bashkimit dhe merr përsipër çdo detyrë tjetër që CA-ja vendos t'ia besojë ose që lind gjatë procesit të planifikimit strategjik.

4. Kryetari i Këshillit të Operacioneve Postare do të përfaqësojë këtë organ në mbledhjet e CA-së në rendin e ditës të të cilave ka çështje të cilat janë me interes për Këshillin e Operacioneve Postare.

5. Kryetari i Komitetit Këshillimor do të përfaqësojë këtë organ në mbledhjet e CA-së në rendin e ditës të të cilave ka çështje të cilat janë me interes për Komitetin Këshillimor.

Neni 109

Vëzhguesit

1. Vëzhguesit

1.1 Me qëllim për të siguruar një lidhje efikase të punimeve të të dy organeve, Këshilli i Operacioneve Postare mund të caktojë disa përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Administrativ, me cilësinë e vëzhguesit.

1.2 Shtetet anëtare të Bashkimit, të cilat nuk janë anëtare të Këshillit, si vëzhguesit dhe vëzhguesit *ad hoc*, referuar nenit 105, mund të marrin pjesë në seancat plenare dhe mbledhjet e Komitetit të Këshillit të Administrimit, pa të drejtë vote.

2. Parimet

2.1 Për arsye logjistike, Këshilli Administrativ mund të limitojë numrin e pjesëmarrësve vëzhgues dhe vëzhgues *ad hoc* që marrin pjesë. Ai mund të kufizojë në të njëjtën mënyrë të drejtën e tyre të fjalës gjatë debateve.

2.2 Vëzhguesit dhe vëzhguesit *ad hoc* munden, me kërkesën e tyre, të lejohen të bashkëpunojnë në projektet e ndërmarra, duke respektuar kushtet që mund të vendosë Këshilli për të siguruar rendimentin dhe efikasitetin e punës së tij. Vëzhguesit gjithashtu mund të ftohen të drejtojnë disa grupe pune dhe task-forca, kur eksperiencia ose ekspertiza e tyre e justifikojnë këtë gjë. Pjesëmarrja e vëzhguesve dhe vëzhguesve *ad hoc* bëhet pa shpenzime shtesë për Bashkimin.

2.3 Në rrethana të jashtëzakonshme, anëtarët e Komitetit Konsultativ dhe vëzhguesit *ad hoc* mund



të përjashtohen nga një mbledhje ose nga një pjesë e një mbledhjeje, ose nga e drejta e tyre për të marrë dokumente të rezervuara nëse konfidencialiteti i subjektit të mbledhjes ose e dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti nga çdo organ i interesuar ose nga kryetari i tij. Situatat rast pas rasti duhet të raportohen te Këshilli Administrativ dhe te Këshilli i Operacioneve Postare, nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për këtë të fundit. Duhet e konsideron si të nevojshme, Këshilli Administrativ mund të rishqyrtojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare nëse e gjykon të arsyeshme.

Neni 110

Mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit

1. Shpenzimet e udhëtimit të përfaqësuesit të çdo anëtari të Këshillit Administrativ, pjesëmarrës në mbledhjet e këtij organi, do të mbulohen nga shteti i tij anëtar. Megjithatë, një përfaqësues i çdo shteti anëtar të klasifikuar, përkatësisht, si në zhvillim ose shtete më pak të zhvilluara nga Këshilli Administrativ dhe Kombet e Bashkuara, me përjashtim të mbledhjeve që janë mbajtur gjatë Kongresit, do të kenë të drejtën e rimbursimit të kostos së një bilete avioni vajtje-ardhje të klasit ekonomik ose të një bilete udhëtimi të klasit të parë me tren, ose të shpenzimeve të kryera për udhëtim me çdo mjet tjetër, me kusht që kjo shumë të mos tejkalojë vlerën e një biletë avioni vajtje-ardhje të klasit ekonomik. E njëjta e drejtë i jepet edhe përfaqësuesit të çdo anëtari të Komiteteve të tij ose organeve të tjera të tij kur këto të fundit mbledhen jashtë Kongresit dhe mbledhjeve të Këshillit.

Neni 111

Informacion mbi aktivitetet e CA-së

1. Pas çdo sesiioni, Këshilli Administrativ do të informojë shtetet anëtare të Bashkimit, operatorët e tyre të caktuar, Bashkimet e kufizuara dhe anëtarët e Komitetit Këshillimor, mbi veprimtaritë e veta duke ju dërguar, ndër të tjera, atyre një përmbledhje analitike për rezolutat dhe vendimet.

2. Këshilli Administrativ do të bëjë një raport për të gjithë aktivitetin e tij për Kongresin dhe ia dërgon atë shteteve anëtare, operatorëve të tyre të

caktuar dhe anëtarëve të Komitetit Këshillimor të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit.

SEKSIONI 3**KËSHILLI I OPERACIONEVE POSTARE (POC)**

Neni 112

Përbërja dhe funksionimi i Këshillit të Operacioneve Postare (POC)

1. Këshilli i Operacioneve Postare përbëhet nga dyzet e tetë anëtarë të cilët do të ushtrojnë funksionet e tyre gjatë periudhës që ndan dy kongrese të njëpasnjëshëm.

2. Anëtarët e Këshillit të Operacioneve Postare do të zgjidhen nga Kongresi sipas një ndarjeje specifike gjeografike. Të paktën një e treta e anëtarëve të çdo grupi gjeografik do të rinovohet në çdo Kongres.

3. Çdo anëtar i Këshillit të Operacioneve Postare cakton përfaqësuesin(t) e tij. Anëtarët e Këshillit të Operacioneve Postare duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në punimet e tij.

4. Shpenzimet për funksionimin e Këshillit të Operacioneve Postare do të mbulohen nga Bashkimi. Anëtarët e tij nuk marrin asnjë pagesë.

5. Këshilli i Operacioneve Postare do të përcaktojë, zyrtarizojë dhe/ose krijojë grupe pune, task-forca, organe ndihmëse të financuara nga përdoruesit ose organe të tjera që do të ngrihen brenda strukturës së tij, duke pasur parasysh ngritjen e tyre për qëllime të strategjisë dhe planit të punës së Bashkimit, të miratuara nga Kongresi.

Neni 113

Funksionet e POC-së

1. Kompetencat e Këshillit të Operacioneve Postare janë si më poshtë:

1.1 të koordinojë masat praktike për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve ndërkombëtare postare;

1.2 të ndërmarrë, pas miratimit të Këshillit Administrativ brenda kuadrit të kompetencave të këtij të fundit, çdo veprim të gjykuar të nevojshëm për të mbajtur rregullin dhe përforcuar cilësinë e shërbimit ndërkombëtar postar dhe për ta modernizuar atë;



1.3 të vendosë mbi kontaktet që duhet të krijohen me shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar, me qëllim përmbushjen e funksioneve të tij;

1.4 të marrë masat e nevojshme për shqyrtimin dhe reklamimin e eksperimenteve dhe progresit të arritur nga disa shtete anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar në fushën teknike, operacionale, ekonomike dhe të trajnimit profesional me interes për shtetet e tjera anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar;

1.5 merr, në konsultim me Këshillin Administrativ, hapat e duhur në fushën e bashkëpunimit teknik me të gjitha vendet anëtare të Bashkimit dhe operatorëve të tyre të caktuar, dhe në veçanti me vendet e reja në zhvillim dhe operatorët të tyre të caktuar;

1.6 shqyrton çdo pyetje tjetër të dorëzuar për të nga një anëtar i Këshillit të Operacioneve Postare, nga Këshilli Administrativ ose nga ndonjë vend anëtar ose operator i caktuar;

1.7 merr dhe diskuton raportet, si dhe rekomandimet e Komitetit Këshillimor, dhe, kur janë të përfshira çështje me interes për Këshillin e Operacioneve Postare, shqyrton dhe komenton rekomandimet e Komitetit Këshillimor që do të paraqiten në Kongres;

1.8 cakton ata anëtarë të tij që do të bëjnë pjesë në Komitetin Këshillimor;

1.9 të drejtojë shqyrtimin e problemeve më të rëndësishme operacionale, tregtare, teknike, ekonomike dhe të bashkëpunimit teknik, që paraqesin interes për të gjitha shtetet anëtare ose operatorët e tyre të caktuar, duke përfshirë çështjet që kanë pasoja financiare të rëndësishme (tarifat, shpenzimet përfundimtare, tarifa të tranzitit, tarifa të transportit ajror për postën, tarifat për koltë postare dhe postimin jashtë shtetit të artikujve të postës së letrave), dhe të përgatisë informacionin dhe rekomandimet për veprimin për to;

1.10 t'i sigurojë Këshillit Administrativ të dhëna për zhvillimin e drafut të strategjisë së Bashkimit dhe të planit katërvjeçar të biznesit që do të paraqitet në Kongres;

1.11 të studiojë problemet e edukimit dhe formimit profesional që i interesojnë shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar si e shteteve të reja dhe në zhvillim;

1.12 të shqyrtojë situatën aktuale dhe nevojat e shërbimit postar në shtetet e reja dhe ato në

zhvillim dhe të përpunojë rekomandimet e përshtatshme për mënyrat dhe mjetet për përmirësimin e shërbimeve të tyre postare në këto shtete;

1.13 të rishikojë rregulloret e Bashkimit brenda gjashtë muajve që pasojnë mbylljen e Kongresit, nëse Kongresi nuk vendos ndryshe; në rast të nevojave urgjente, Këshilli i Operacioneve Postare gjithashtu mund të ndryshojë rregulloret e sipërpërmendura në sesione të tjera; në të dyja rastet, Këshilli i Operacioneve do të jetë subjekt i direktivave të këshillit drejtues për sa i përket politikave dhe parimeve themelore;

1.14 të formulojë propozime që do t'i paraqiten për miratim Kongresit ose shteteve anëtare në përputhje me nenin 140; miratimi i këshillit drejtues kërkohet kur këto propozime kanë të bëjnë me çështje brenda kompetencave e këtij të fundit;

1.15 të shqyrtojë, me kërkesë të një shteti anëtar, çdo propozim që ky shtet anëtar i transmeton Byrosë Ndërkombëtare sipas nenit 139, të përgatisë vërejtjet për to dhe të instruktojë Byronë Ndërkombëtare për aneksimin e këtyre vërejtjeve me propozimet para se t'i paraqiten për miratim shteteve anëtare;

1.16 të rekomandojë, nëse është e nevojshme, dhe kur është e arsyeshme pas miratimit nga Këshilli Administrativ dhe këshillimit me të gjitha shtetet anëtare, miratimin përfundimtar të rregulloreve ose të një procedure të re deri në momentin që Kongresi të vendosë për këtë çështje;

1.17 të përpunojë dhe të paraqesë, në formë rekomandimesh, para shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar (ose si dispozita detyruese nëse aktet e Bashkimit e parashikojnë këtë), standarde për procese teknologjike, operacionale dhe procese të tjera në kompetencën e tij, ku është e domosdoshme një praktikë e njëtrajtshme; ai do të paraqesë në mënyrë të ngjashme, sipas kërkesave, amendamente për standardet që ka vendosur;

1.18 krijon strukturën për organizimin e organeve ndihmëse të përdorues-financuesve dhe bashkohet në organizimin e këtyre organeve në përputhje me dispozitat e nenit 152;

1.19 merr dhe diskuton raportet e organeve ndihmëse të përdorues-financuesve mbi baza vjetore;

1.20. miraton rregullat e procedurave dhe ndryshimet në këto rregulla.



Neni 114

Organizimi i sesioneve të POC-së

1. Në mbledhjen e tij të parë, e cila është thirrur dhe hapur nga kryetari i Kongresit, Këshilli i Operacioneve Postare do të zgjedhë, ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe katër nënkryetarë, dhe kryetarët/nënkryetarët/bashkëkryetarët e Komitetit dhe do të hartojnë rregullat e procedurës. Kryetari dhe katër nënkryetarët janë nga shtetet anëtare, nga secili prej pesë grupeve gjeografike të Bashkimit.

2. Në parim, Këshilli i Operacioneve Postare mbledhet dy herë në vit, ose në bazë të kërkesave të jashtëzakonshme, në selinë e Bashkimit, në përputhje me procedurat përkatëse të përcaktuara në rregulloren e procedurave.

3. Kryetari dhe nënkryetari, kryetarët e Komitetit, nënkryetarët dhe bashkëkryetarët e Këshillit të Operacioneve Postare do të përbëjnë Komitetin Drejtues. Ky Komitet përgatit dhe drejton punët e çdo mbledhje të Këshillit të Operacioneve Postare dhe mbulon të gjitha detyrat që ky i fundit vendos për të, ose për të cilat lind nevoja gjatë procesit për planifikim strategjik.

4. Bazuar në Strategjinë e Bashkimit të miratuar nga Kongresi dhe, në veçanti, të pjesës që lidhet me strategjitë e Organeve të Përhershme të Bashkimit, Këshilli i Operacioneve Postare, në sesionin e tij të parë pas Kongresit, do të përgatisë një program pune bazë që përmban një numër të caktuar takimesh me qëllim realizimin e strategjive. Ky program pune bazë, që do të përfshijë një numër të caktuar projektesh mbi subjekte kryesore dhe me interes të përbashkët, do të rishikohet çdo vit në funksion të realitetit dhe të prioriteteve të reja.

5. Kryetari i Komitetit Këshillimor përfaqëson atë organ në mbledhjet e Këshillit të Operacioneve Postare kur rendi i ditës përmban çështje që i interesojnë Komitetit Këshillimor

Neni 115

Vëzhguesit**1. Vëzhguesit**

1.1 Me qëllim për të siguruar një lidhje efektive të punimeve të të dy organeve, Këshilli i Operacioneve Postare mund të caktojë disa përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Administrativ, me cilësinë e vëzhguesit.

1.2 Shtetet anëtare të Bashkimit të cilat nuk janë anëtarë të Këshillit, si vëzhguesit dhe vëzhguesit *ad hoc*, referuar nenit 105, mund të marrin pjesë në seancat plenare dhe mbledhjet e Komitetit të Këshillit të Operacioneve Postare, pa të drejtë vote.

2. Parimet

2.1 Për arsye logjistike, Këshilli i Operacioneve Postare mund të limitojë numrin e pjesëmarrësve vëzhgues dhe vëzhgues *ad hoc* që marrin pjesë. Ai mund të kufizojë në të njëjtën mënyrë të drejtën e tyre të fjalës gjatë debateve.

2.2 Vëzhguesit dhe vëzhguesit *ad hoc* mundën, me kërkesën e tyre, të lejohen të bashkëpunojnë në projektet e ndërmarra, duke respektuar kushtet që mund të vendosë Këshilli për të siguruar rendimentin dhe efikasitetin e punës së tij. Vëzhguesit gjithashtu mund të ftohen të drejtojnë grupe pune dhe task-forca, kur eksperiencia ose ekspertiza e tyre e justifikojnë këtë gjë. Pjesëmarrja e vëzhguesve dhe vëzhguesve *ad hoc* bëhet pa shpenzime shtesë nga Bashkimi.

2.3 Në rrethana të jashtëzakonshme, anëtarët e Komitetit Konsultativ dhe vëzhguesit *ad hoc* mund të përjashtohen nga një mbledhje ose nga një pjesë e një mbledhjeje, ose nga e drejta e tyre për të marrë dokumente të rezervuara nëse konfidencialiteti i subjektit të mbledhjes ose e dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti nga çdo organ i interesuar ose nga kryetari i tij. Situatat rast pas rasti duhet të raportohen te Këshilli Administrativ dhe te Këshilli i Operacioneve Postare nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për këtë të fundit. Nëse e konsideron si të nevojshme, Këshilli Administrativ mund të rishqyrtojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare nëse e gjykon të arsyeshme.

Neni 116

Mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit

1. Shpenzimet e udhëtimit të përfaqësuesve të çdo shteti anëtar pjesëmarrës në Këshillin e Operacioneve Postare, do të mbulohen nga shteti anëtar që ky i fundit përfaqëson. Megjithatë, një përfaqësues i çdo shteti anëtar të klasifikuar si shtete më pak të zhvilluara, në përputhje me listën e hartuar nga Kombet e Bashkuara, me përjashtim të mbledhjeve që janë mbajtur gjatë Kongresit, do të kenë të drejtën e rimbursimit të kostos së një



bilete avioni vajtje-ardhje të klasit ekonomik ose të një bilete udhëtimi të klasit të parë me tren, ose të shpenzimeve të kryera për udhëtim me çdo mjet tjetër, me kusht që kjo shumë të mos tejkalojë vlerën e një bilete avioni vajtje-ardhje të klasit ekonomik. E njëjta e drejtë i jepet edhe përfaqësuesit të çdo anëtari të komisioneve të tij, të grupeve të tij të punës ose organeve të tjera të tij, kur këto të fundit mbledhen jashtë Kongresit dhe mbledhjeve të Këshillit.

Neni 117

Informacion mbi veprimtarinë e POC-së

1. Pas çdo sesioni, Këshilli i Operacioneve Postare do të njoftojë shtetet anëtare, operatorët e tyre të caktuar, sindikatat e kufizuara dhe anëtarët e Komitetit Këshillimor mbi veprimtarinë e tij duke i dërguar atyre, ndër të tjera, një përmbledhje analitike dhe rezolutat, dhe vendimet e tyre.

2. Këshilli i Operacioneve Postare do të përgatisë një raport vjetor mbi punën e tij për Këshillin Administrativ.

3. Këshilli i Operacioneve Postare përpilon, për Kongresin, një raport përmbledhës për punën e tij duke përfshirë raportet e organeve ndihmëse të përdorues-financuesve, siç është parashikuar në nenin 152 dhe ia dërgon shteteve anëtare, operatorëve të tyre të caktuar, si dhe anëtarëve të Komitetit Këshillimor të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit.

Neni 117.bis

Komiteti Koordinues për Organet e Përhershme të Bashkimit

1. Kryetari i Këshillit Administrativ, kryetari i Këshillit të Operacioneve Postare dhe drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare formojnë Komitetin Koordinues për Organet e Përhershme të Bashkimit (CCoord).

2. CCoord do të ketë atributet dhe funksionet e mëposhtme:

2.1 të kontribuojë në koordinimin e punës së organeve të përhershme të Bashkimit;

2.2 të takohet, kur është e nevojshme, për të diskutuar çështjet e rëndësishme në lidhje me Bashkimin dhe shërbimin postar dhe t'u japë organeve të Bashkimit një vlerësim të çështjeve në fjalë;

2.3 të sigurojë zbatimin e përshtatshëm të procesit të planifikimit strategjik, me qëllim që të gjitha vendimet mbi aktivitetet e Bashkimit të merren nga organet përkatëse, në përputhje me përgjegjësitë sipas specifikimeve në aktet e Bashkimit.

3. I thirrur nga kryetari i Këshillit Administrativ, CCoord do të mbledhet dy herë në vit, në selinë e Bashkimit. Data dhe vendi i takimeve do të caktohet nga kryetari i Këshillit Administrativ në marrëveshje me kryetarin e Këshillit të Operacioneve Postare dhe drejtorin e përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare.

SESIONI 4

KOMITETI KËSHILLIMOR (CC)

Neni 118

Qëllimi i Komitetit Këshillimor

1. Komiteti Këshillimor do të përfaqësojë interesat e sektorit ndërkombëtar postar në kuptimin e gjerë dhe ofrojë një kuadër për një dialog efikas ndërmjet grupeve të interesit.

Neni 119

Përbërja e Komitetit Këshillimor

1. Komiteti Këshillimor do të përbëhet nga:

1.1 organizata joqeveritare që përfaqësojnë konsumatorë, furnitorë të shërbimeve të shpërndarjes, organizata të punëtorëve, furnitorë të mallrave dhe të shërbimeve për sektorin dhe shërbimet postare, dhe disa organizma të ngjashëm të personave dhe shoqërive të cilat kanë interes në mbështetjen e misionit dhe objektivave të Bashkimit;

1.1.bis figura të nivelit të lartë nga sektori postar, të rekomanduara nga shtetet anëtare ose nga organet e Bashkimit në fjalë, përfshirë Komitetin Këshillimor;

1.1.ter organizatat e shoqërisë civile: organizata ndërkombëtare postare rajonale dhe joqeveritare, si dhe organizata standardizuese, financiare dhe zhvillimore, të cilat nuk parashikohen në paragrafin 1.1;

1.2 anëtarë të caktuar nga Këshilli Administrativ ndër anëtarët e tij;

1.3 anëtarë të caktuar nga Këshilli i Operacioneve Postare ndër anëtarët e tij.



1.bis Nëse ndonjë nga organizatat është e regjistruar, ato duhet të regjistrohen në një shtet anëtar të Bashkimit.

2. Kostot operationale të Komitetit Këshillimor do të ndahen ndërmjet Bashkimit dhe anëtarëve të Komitetit, sipas përcaktimeve të Këshillit Administrativ.

3. Anëtarët e Komitetit Këshillimor nuk do të paguhën ose përfitojnë çfarëdolloj shpërblimi.

Neni 120

Anëtarësimi në CC

1. Përveç anëtarëve të caktuar nga Këshilli Administrativ dhe Këshilli i Operacioneve Postare, pjesëmarrja në Komitetin Këshillimor do të përcaktohet me paraqitjen e kërkesës dhe të pranimit të kësaj të fundit, nga Këshilli Administrativ, dhe e realizuar në përputhje me nenin 107.1.30.

2. Çdo anëtar i Komitetit Këshillimor do të caktojë përfaqësuesin e tij.

Neni 121

Funksionet e Komitetit Këshillimor

1. Komiteti Këshillimor do të ketë këto funksione;

1.1 të shqyrtojë dokumente dhe raporte të Këshillit Administrativ dhe të Këshillit të Operacioneve Postare. Në rrethana të jashtëzakonshme, e drejta për të marrë disa dokumente mund të jetë e kufizuar nëse konfidencialiteti i çështjes së mbledhjes ose i dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti nga organi i interesuar ose kryetari i tij. Situatat rast pas rasti do të raportohen në Këshillin Administrativ, dhe në Këshillin e Operacioneve Postare nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për Këshillin e Operacioneve Postare. Nëse e gjykon të nevojshëm, Këshilli Administrativ mund të rishikojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare;

1.2 të drejtojë dhe kontribuojë në studimin dhe diskutimin e çështjeve të rëndësishme për anëtarët e Komitetit Këshillimor;

1.3 të shqyrtojë çështje që prekin sektorin e shërbimeve postare dhe të paraqesë raporte mbi këto çështje;

1.4 të sigurojë të dhëna për punët e Këshillit Administrativ dhe të Këshillit të Operacioneve Postare, duke përfshirë paraqitjen e raporteve dhe rekomandimeve, dhe të japë opinione me kërkesën e dy këshillave;

1.5 të bëjë rekomandime për Kongresin, subjekt i miratimit të Këshillit Administrativ dhe, kur janë të përfshira çështje që i interesojnë Këshillit të Operacioneve Postare, subjekt i shqyrtimit dhe komenteve të Këshillit të Operacioneve Postare.

Neni 122

Organizimi i Komitetit Këshillimor

1. Komiteti Këshillimor do të riorganizohet pas çdo Kongresi, në përputhje me kuadrin e përpiluar nga Këshilli Administrativ. Kryetari i Këshillit Administrativ drejton mbledhjen për organizimin e Komitetit Këshillimor, gjatë të cilës do të zgjidhet kryetari i Komitetit në fjalë.

2. Komiteti Këshillimor përcakton organizimin e vet të brendshëm dhe harton rregulloren e tij të brendshme, duke iu referuar parimeve bazë të Bashkimit dhe subjekt i miratimit të Këshillit Administrativ, pas këshillimit me Këshillin e Operacioneve Postare.

3. Komiteti Këshillimor do të mbledhet një herë në vit. Në parim, mbledhjet do të zhvillohen në selinë e Bashkimit, në të njëjtën kohë me sesionet e Këshillit Administrativ dhe të Këshillit të Operacioneve Postare. Data dhe vendi i çdo mbledhjeje do të vendosen nga kryetari i Komitetit Këshillimor, në marrëveshje me kryetarin e Këshillit Administrativ dhe të Këshillit të Operacioneve Postare dhe drejtorin e përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare.

Neni 123

Përfaqësues të Komitetit Konsultativ në Këshillin Administrativ, Këshillin e Operacioneve Postare dhe në Kongres

1. Me qëllim sigurimin e një lidhje ndërmjet organeve të Bashkimit, Komiteti Këshillimor mund të caktojë disa përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhjet e Kongresit, Këshillit Administrativ dhe Këshillit të Operacioneve Postare, dhe Komiteteve përkatëse të tyre, me cilësinë e vëzhguesit pa të drejtë vote.



2. Anëtarët e Komitetit Këshillimor janë të ftuar të marrin pjesë në sesionet plenare dhe mbledhjet e Komitetit të Këshillit Administrativ dhe Këshillit të Operacioneve Postare, në përputhje me nenin 105. Ata gjithashtu mund të marrin pjesë në punimet e grupeve të punës dhe task-forcës, sipas kushteve të vendosura nga nenet 109.2.2 dhe 115.2.2.

3. Kryetari i Këshillit Administrativ dhe kryetari i Këshillit të Operacioneve Postare do të përfaqësojnë këto organe në mbledhjet e Komitetit Këshillimor kur rendi i ditës së këtyre mbledhjeve përmban çështje që i interesojnë këtyre organeve.

Neni 124

Vëzhguesit e Komitetit Këshillimor

1. Shtete të tjera anëtare të Bashkimit, vëzhguesit dhe vëzhguesit *ad hoc*, referuar nenit 105, mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në seancat plenare dhe në mbledhjet e Komitetit Këshillimor.

2. Për arsye logjistike, Komiteti Këshillimor mund të limitojë numrin e pjesëmarrësve vëzhgues dhe vëzhgues *ad hoc* që marrin pjesë. Ai mund të kufizojë në të njëjtën mënyrë të drejtën e tyre të fjalës gjatë debateve.

3. Në rrethana të jashtëzakonshme, vëzhguesit dhe vëzhguesit *ad hoc* mund të përjashtohen nga një mbledhje ose nga një pjesë e një mbledhjeje, ose nga e drejta e tyre për të marrë dokumente të rezervuara nëse konfidencialiteti i subjektit të mbledhjes ose e dokumentit e kërkon këtë. Ky kufizim mund të vendoset rast pas rasti, nga çdo organ i interesuar ose nga kryetari i tij. Situatat rast pas rasti duhet të raportohen te Këshilli Administrativ dhe te Këshilli i Operacioneve Postare nëse bëhet fjalë për çështje me interes të veçantë për këtë të fundit. Kur e konsideron si të nevojshëm, Këshilli Administrativ mund të rishqyrtojë kufizimet, duke u këshilluar me Këshillin e Operacioneve Postare nëse e gjykon të arsyeshme.

Neni 125

Informacione mbi veprimtarinë e Komitetit Këshillimor

1. Pas çdo mbledhje, Komiteti Këshillimor njofton Këshillin Administrativ dhe Këshillin e Operacioneve Postare për veprimtarinë e tij duke i dërguar kryetarëve të këtyre organeve, ndër të tjera, Faqe | 9434

një përmbledhje analitike të mbledhjeve të tij, si dhe rekomandime dhe mendime.

2. Komiteti Këshillimor i bën Këshillit Administrativ një raport për veprimtarinë vjetore dhe i dërgon një kopje Këshillit të Operacioneve Postare. Ky raport do të përfshihet në dokumentacionin e Këshillit Administrativ që u shpërndahet shteteve anëtare të Bashkimit, operatorëve të tyre të caktuar dhe sindikatave të kufizuara, në përputhje me nenin 103.

3. Komiteti Këshillimor bën për Kongresin një raport mbi gjithë aktivitetin e tij dhe ia dërgon atë shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar, të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit.

KAPITULLI II

BYROJA NDËRKOMBËTARE

SEKSIONI 1

ZGJEDHJA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM DHE ZËVENDËSDREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË BYROSË NDËRKOMBËTARE

Neni 126

Zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare

1. Drejtori i përgjithshëm dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare zgjidhen nga Kongresi për periudhën që ndan dy kongrese të njëpasnjëshme, me kohëzgjatje minimale të mandatit të tyre prej katër vjetësh. Mandati i tyre është i përsëritshëm vetëm njëherë. Me përjashtim të vendimit të kundërt të Kongresit, data e fillimit të funksionit të tyre është caktuar 1 janari i vitit që vjen pas Kongresit.

2. Të paktën shtatë muaj para hapjes së Kongresit, drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare do t'i dërgojë një shkresë qeverive të shteteve anëtare duke i ftuar të paraqesin kandidaturat e mundshme për postin e drejtorit të përgjithshëm dhe të zëvendësdrejtorit të përgjithshëm, dhe duke treguar në të njëjtën kohë nëse drejtori i përgjithshëm ose zëvendësdrejtori i përgjithshëm në funksion janë të interesuar për rinovimin e mundshëm të mandatit të tyre të parë. Kandidaturat, të shoqëruara me një *curriculum vitae*,



duhet të mbërrijnë në zyrën e Byrosë Ndërkombëtare të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit. Kandidatët duhet të jenë shtetas të shteteve anëtare që i paraqesin. Byroja Ndërkombëtare do të përgatisë dokumentacionin e zgjedhjeve për Kongresin. Zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm dhe e zëvendës drejtorit të përgjithshëm bëhet me votim të fshehtë, duke u zgjedhur në fillim drejtori i përgjithshëm.

3. Nëse posti i drejtorit të përgjithshëm është vakant, zëvendës drejtori i përgjithshëm merr përsipër funksionet e drejtorit të përgjithshëm deri në fund të mandatit të parashikuar për atë vetë; ai do të jetë i zgjedhshëm në këtë post dhe do të pranohet automatikisht si kandidat, me kusht që afati fillestar i detyrës si zëvendës drejtor i përgjithshëm nuk është i rinovuar një herë nga Kongresi i mëparshëm dhe ai të deklarojë interesin e tij për t'u konsideruar si kandidat për postin e drejtorit të përgjithshëm.

4. Në rastin kur posti i drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendës drejtorit të përgjithshëm janë njëkohësisht vakantë, Këshilli Administrativ do të zgjedhë, mbi bazën e aplikimeve të marra pas njoftimit të posteve vakante, një zëvendës drejtor të përgjithshëm për periudhën deri në Kongresin e ardhshëm. Për sa i përket paraqitjes së aplikimeve, do të zbatohet për analogji paragrafi 2.

5. Nëse posti i zëvendës drejtorit të përgjithshëm është vakant, Këshilli Administrativ, me propozim të drejtorit të përgjithshëm, ngarkon një nga drejtorët e gradës D2 të Byrosë Ndërkombëtare, të marrë përsipër, deri në Kongresin e ardhshëm, funksionet e zëvendës drejtorit të përgjithshëm.

Neni 127

Funksionet e drejtorit të përgjithshëm

0.bis Drejtori i përgjithshëm është përfaqësuesi ligjor i Bashkimit të Përbotshëm Postar.

1. Drejtori i përgjithshëm organizon, administron dhe drejton Byronë Ndërkombëtare.

2. Lidhur me klasifikimin e posteve, emërimeve dhe rritjes në detyrë:

2.1 drejtori i përgjithshëm ka kompetencën për të renditur postet e gradës G1 deri në D2 dhe për të emëruar dhe rritur në detyrë funksionarët e këtyre gradave;

2.2 për emërimet e gradave P1 deri në D2, ai duhet të marrë në konsideratë kualifikimet

profesionale të kandidatëve të rekomanduar nga shtetet anëtare, shtetas të së cilëve ata janë ose në të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre profesional, duke konsideruar një ndarje të barabartë gjeografike për kontinentet dhe gjuhët. Postet e gradës D2 duhet, për sa është e mundur, të plotësohen nga kandidatë me prejardhje nga rajone të ndryshme nga ai i origjinës së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të përgjithshëm, duke pasur parasysh konsiderimin suprem të efikasitetit të Byrosë Ndërkombëtare. Në rastin e posteve që kërkojnë kualifikime speciale, drejtori i përgjithshëm mund të kërkojë aplikime në shtete të tjera;

2.3 në emërimin e një funksionari të ri, ai do të konsiderojë gjithashtu që, në parim, personat që zënë postet e gradave D2, D1 dhe P5 të jenë shtetas nga shtete të ndryshme të Bashkimit;

2.4 në rritjen në detyrë të një funksionari në gradat D2, D1 dhe P5, nuk do të jetë i detyruar të zbatojë të njëjtin parim si tek 2.3;

2.5 për më tepër, kërkesat e një shpërndarje të barabartë gjeografike dhe të gjuhëve do të renditen pas meritës në procesin e rekrutimit;

2.6 drejtori i përgjithshëm njofton Këshillin Administrativ një herë në vit për emërimet dhe rritjet në detyrë në gradat P4 deri në D2.

3. Drejtori i përgjithshëm ka kompetencat e mëposhtme:

3.1 të veprojë si depozitues i akteve të Bashkimit dhe si ndërmjetës në procedurën e miratimit dhe të pranimit, dhe të tërheqjes nga Bashkimi;

3.2 të njoftojë vendimet e marra nga Kongresi për të gjithë qeveritë e shteteve anëtare;

3.3 të njoftojë të gjithë shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar mbi rregulloret e shfuqizuara ose të rishikuara nga Këshilli i Operacioneve Postare;

3.4 të përgatisë projektin e buxhetit vjetor të Bashkimit në nivelin më të ulët të mundshëm, në pajtim me nevojat e Bashkimit dhe ta paraqesë në kohën e duhur për shqyrtim në Këshillin Administrativ; t'i paraqesë buxhetin shteteve anëtare të Bashkimit pas miratimit nga Këshilli Administrativ dhe ta realizojë atë;

3.5 të kryejë veprimtari të veçanta të kërkuara prej organeve të Bashkimit dhe ato që i janë caktuar me anë të akteve;

3.6 të marrë iniciativat për realizimin e objektivave të caktuara nga organet e Bashkimit,



brenda kuadrit të politikës së vendosur dhe të fondeve të disponueshme;

3.7 t'i japë sugjerime dhe propozime Këshillit Administrativ ose Këshillit të Operacioneve Postare;

3.8 të paraqesë, në Këshillin e Operacioneve Postare, pas mbylljes së Kongresit, propozimet që kanë të bëjnë me ndryshimet e rregulloreve sipas vendimeve të Kongresit, në përputhje me rregullat e procedurës së Këshillit të Operacioneve Postare;

3.9 të përgatisë, për Këshillin e Operacioneve Postare dhe mbi bazën e direktivave të dhëna nga Këshillat, projektstrategjinë dhe projektplanin katërvjeçar të biznesit të UPU-së që do të paraqitet në Kongres;

3.10 të përgatisë, për miratim nga Këshilli Administrativ, një raport katërvjeçar mbi performancën e shteteve anëtare mbi strategjinë e Bashkimit të miratuar nga Kongresi paraardhës, i cili do të paraqitet në Kongresin e radhës;

3.11 (fshirë);

3.12 të veprojë si ndërmjetës në marrëdhëniet midis:

3.12.1 UPU-së dhe sindikatave të kufizuara;

3.12.2 UPU-së dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara;

3.12.3 UPU-së dhe organizatave ndërkombëtare, veprimtaritë e të cilave paraqesin interes për Bashkimin;

3.12.4 UPU-së dhe organizmave ndërkombëtare, shoqatave ose sipërmarrjeve që organet e Bashkimit dëshirojnë t'i konsultojnë ose të bashkëpunojnë;

3.13 të marrë përsipër funksionin e sekretarit të përgjithshëm të organeve të Bashkimit, sipas dispozitave të posaçme të rregullores së përgjithshme, veçanërisht:

3.13.1 në përgatitjen dhe organizimin e punës së organeve të Bashkimit;

3.13.2 në shqyrtimin, prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve, raporteve dhe procesverbaleve;

3.13.3 në funksionimin e sekretariatit gjatë mbledhjeve të organeve të Bashkimit;

3.14 të ndihmojë në mbledhjet e organeve të Bashkimit dhe të marrë pjesë në diskutimet pa të drejtë vote, duke pasur mundësinë e përfaqësimit.

Neni 128

Funksionet e zëvendës drejtorit të përgjithshëm

1. Zëvendës drejtori i përgjithshëm do të asistojë drejtorin e përgjithshëm dhe është nën varësinë e tij.

2. Në rast se drejtori i përgjithshëm mungon ose nuk mund të ushtrojë detyrat e tij, funksionet e tij do të ushtrohen nga zëvendës drejtori i përgjithshëm. E njëjta gjë do të zbatohet në rastin kur posti i drejtorit të përgjithshëm është vakant sipas nenit 126.3.

SEKSIONI 2

SEKRETARIATI I ORGANEVE TË BASHKIMIT DHE KOMITETIT KËSHILLIMOR

Neni 129

Vërejtje të përgjithshme

1. Byroja Ndërkombëtare, nën përgjegjësinë e drejtorit të përgjithshëm, do të sigurojë sekretariatin e Bashkimit dhe të Komitetit Këshillimor.

Neni 130

Përgatitja dhe shpërndarja e dokumenteve të organeve të Bashkimit

1. Byroja Ndërkombëtare duhet të përgatisë dhe verë në dispozicion, përmes faqes së internetit të UPU-së, të gjitha dokumentet e publikuara në një nga gjuhët e specifikuar në nenin 155, në përputhje me rregullat e procedurës së Këshillit Administrativ dhe Këshillit të Operacioneve Postare. Byroja Ndërkombëtare duhet gjithashtu të shfaqë, për përfaqësuesit e shteteve anëtare në veçanti, publikimet e reja në formën e dokumentit elektronik në faqen zyrtare të UPU-së, ndërmjet mjeteve të një sistemi sinjalizimi efikas.

2. Gjithashtu, Byroja Ndërkombëtare duhet të shpërndajë fizikisht publikimet e Bashkimit, të tilla si qarkoret e Byrosë Ndërkombëtare dhe procesverbalet përmbledhëse të CA-së dhe POC-së, vetëm me kërkesë të një shteti anëtar individual.



Neni 131

**Lista e shteteve anëtare
(Kushtetuta 2)**

1. Byroja Ndërkombëtare përpilon dhe përditëson listën e shteteve anëtare të Bashkimit duke përcaktuar aty klasën e kontributit, grupin e tyre gjeografik dhe pozicionin e tyre në raport ndaj akteve të Bashkimit.

Neni 132

**Informacioni. Opinionet. Kërkesat për
shpjegim dhe amendim të akteve.
Reklamimet. Roli në likuidimin e llogarive
(Kushtetuta 20, rregullore e përgjithshme 139,
140, 143)**

1. Byroja Ndërkombëtare do të jetë në çdo kohë në dispozicion të Këshillit Administrativ, të Këshillit të Operacioneve Postare dhe të shteteve anëtare, dhe operatorëve të tyre të caktuar për qëllimet e dhënies së të gjithë informacionit të nevojshëm rreth çështjeve që kanë të bëjnë me shërbimin.

2. Në veçanti, kjo strukturë do të mbledhë, koordinojë, publikojë dhe shpërndajë informacionet e çdo natyre në interes të shërbimit ndërkombëtar postar, të japë, me kërkesën e palëve të përfshira, një mendim mbi çështje në konflikt, të veprojë për kërkesat për shpjegim dhe amendimin e akteve të Bashkimit dhe, në përgjithësi, të realizojë ato studime dhe punë dokumentare ose redaktuese që i caktohen nga aktet në fuqi ose siç mund t'i referohet në interes të Bashkimit.

3. Kjo strukturë vepron gjithashtu mbi anketimet që kërkohen nga shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar për përfitimin e pikëpamjeve të shteteve të tjera anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar mbi një çështje të caktuar. Rezultati i një ankete nuk merr karakterin e një vote dhe nuk do të jetë formalisht detyruese.

4. Kjo strukturë mund të veprojë si zyrë qendrore për likuidimin e llogarive të çdo lloji në lidhje me shërbimin postar.

5. Byroja Ndërkombëtare do të garantojë konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave komerciale të ofruara nga vendet anëtare dhe/ose operatorët e tyre të caktuar për kryerjen e detyrave të saj që rrjedhin nga aktet apo vendimet e Bashkimit.

Neni 133

**Bashkëpunimi teknik
(Kushtetuta 1)**

1. Byroja Ndërkombëtare do të zhvillojë asistencë teknike postare në të gjitha format e saj të mundshme, brenda kuadrit për bashkëpunim teknik ndërkombëtar.

Neni 134

**Formularë të dhënë nga Byroja
Ndërkombëtare
(Kushtetuta 20)**

1. Byroja Ndërkombëtare do të jetë përgjegjëse për prodhimin e kuponëve të përgjigjeve ndërkombëtare dhe të furnizimit, me çmim shitje, të shteteve anëtare ose operatorëve të tyre të caktuar që i kanë porositur ato.

Neni 135

**Aktet e sindikatave të kufizuara dhe
marrëveshjet e posaçme
(Kushtetuta 8)**

1. Dy kopje të akteve të sindikatave të kufizuara dhe marrëveshjeve të posaçme të realizuara, sipas nenit 8 të Kushtetutës, duhet që t'i transmetohen Byrosë Ndërkombëtare nëpërmjet zyrave të këtyre sindikatave ose, kur kjo nuk arrihet, nëpërmjet një pale kontraktuese.

2. Byroja Ndërkombëtare kujdeset që aktet e sindikatave të kufizuara dhe marrëveshjet e posaçme të mosparashikojnë kushte më pak të favorshme për publikun se ato që janë parashikuar në aktet e Bashkimit. Byroja Ndërkombëtare sinjalizon në Këshillin Administrativ për çdo parregullsi të konstatuar gjatë zbatimit të kësaj dispozite.

3. Byroja Ndërkombëtare duhet të informojë shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar për ekzistencën e këtyre sindikatave dhe të marrëveshjeve të posaçme të sipërpërmendura.

Neni 136

Botimet periodike të Bashkimit

1. Byroja Ndërkombëtare, me ndihmën e dokumenteve që i janë vënë në dispozicion, do të



botojë një revistë në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, gjermane, ruse dhe spanjolle.

Neni 137

**Raporti vjetor mbi punën e Bashkimit
(Kushtetuta 20, rreg. e përgjithshme
107.1.24)**

1. Byroja Ndërkombëtare do të realizojë një raport vjetor mbi veprimtarinë e Bashkimit i cili do të dërgohet, pas miratimit nga Komiteti Drejtues i Këshillit Administrativ, shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar, sindikatave të kufizuara dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

**KAPITULLI III
DORËZIMI, SHQYRTIMI I
PROPOZIMEVE, NJOFTIMI PËR
VENDIMET E MIRATUARA DHE HYRJA
NË FUQI E RREGULLOREVE DHE
VENDIMEVE TË TJERA TË MIRATUARA**

Neni 138

**Procedura e paraqitjes dhe shqyrtimit të
propozimeve**

1. Subjekt i përjashtimeve të parashikuara sipas paragrafëve 2 dhe 5, procedura e mëposhtme rregullon paraqitjen e propozimeve të çdo natyre në Kongres nga shtetet anëtare:

1.1 do të pranohen propozimet që mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare të paktën gjashtë muaj para datës së caktuar për Kongresin;

1.2 nuk do të pranohet asnjë propozim gjatë periudhës prej gjashtë muajsh para datës së caktuar për Kongresin;

1.3 nuk do të pranohen propozimet e përmbajtjes që mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare në intervalin ndërmjet gjashtë dhe katër muajve para datës së vendosur për Kongresin, me përjashtim të rastit kur mbështeten nga të paktën dy shtete anëtare;

1.4 nuk do të pranohen propozimet e përmbajtjes që mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare në intervalin ndërmjet katër dhe dy muaj para datës së vendosur për Kongresin, me përjashtim të rastit kur ato mbështeten nga të paktën tetë shtete anëtare; propozimet që mbërrijnë pas kësaj periudhe nuk do të pranohen;

1.5 deklaratat mbështetëse duhet të mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare brenda të njëjtës periudhë me propozimet të cilave i referohen.

2. Propozimet që kanë të bëjnë me Kushtetutën ose rregulloren e përgjithshme duhet të mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare të paktën gjashtë muaj para hapjes së Kongresit; propozimet që mbërrijnë pas kësaj date, por para hapjes së Kongresit, mund të merren në konsideratë vetëm nëse Kongresi vendos me shumicë prej dy të tretash të shteteve të përfaqësuara në Kongres dhe me përjashtim të rastit kur janë përmbushur kushtet e parashikuara sipas paragrafit 1.

3. Si rregull, çdo propozim duhet të ketë vetëm një qëllim dhe të përmbajë vetëm ndryshimet e justifikuar nga ky qëllim. Në të njëjtën mënyrë, çdo propozim që mund të sjellë kosto të mëdha për Bashkimin do të shoqërohet nga indikacione të ndikimit të tij financiar, të përgatitur nga shteti anëtar që paraqet propozimin në bashkëpunim me Byronë Ndërkombëtare, në mënyrë që të përcaktohen burimet financiare të nevojshme.

4. Hartimet e propozimeve do të titullohen “Draftpropozime” nga shtetet anëtare që i paraqesin dhe do të publikohen nga Byroja Ndërkombëtare me një numër të ndjekur nga shkronja R. Propozimet që nuk do të kenë këtë lloj shënimi por që, sipas mendimit të Byrosë Ndërkombëtare, prekin vetëm hartimin e pikave do të publikohen me një shënim të posaçëm; Byroja Ndërkombëtare do të përpilojë një listë të këtyre propozimeve për Kongresin.

5. Procedura e përshkruar në paragrafët 1 dhe 4 nuk do të zbatohet as për propozimet që kanë të bëjnë me rregullat e procedurës së Kongreseve, as për propozimet e paraqitura nga Këshilli Administrativ ose Këshilli i Operacioneve Postare.

Neni 138.bis

**Procedura për amendimin e propozimeve të
paraqitura në përputhje me nenin 138**

1. Amendamentet për propozime të bëra më parë, përjashtuar ato të paraqitura nga Këshilli Administrativ ose nga Këshilli i Operacioneve Postare, mund të vazhdojnë të paraqiten te Byroja Ndërkombëtare, në përputhje me dispozitat e rregullave të procedurës së Kongreseve.

2. Amendamentet për propozime të paraqitura nga Këshilli Administrativ ose nga Këshilli i



Operacioneve Postare do të merren nga Byroja Ndërkombëtare të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit. Pas kësaj pike, shtetet anëtare mund të paraqesin amendamentet e tyre në sesionet e Kongresit.

Neni 139

Procedura e paraqitjes së propozimeve që amendojnë Konventën ose marrëveshjet ndërmjet kongreseve

1. Çdo propozim në lidhje me Konventën ose marrëveshjet, i propozuar nga një shtet anëtar ndërmjet Kongreseve, që të merret në konsideratë duhet të mbështetet nga të paktën dy shtete të tjera anëtare. Këto propozime do të lihen mënjane nëse Byroja Ndërkombëtare nuk merr, në të njëjtën kohë, numrin e duhur të deklaratave të mbështetjes.

2. Këto propozime i dërgohen shteteve të tjera anëtare nëpërmjet Byrosë Ndërkombëtare.

Neni 140

Marrja në konsideratë e propozimeve për amendimin e Konventës ose marrëveshjeve ndërmjet Kongreseve

1. Çdo propozim në lidhje me Konventën, marrëveshjet dhe protokollet finale i nënshtrohet procedurës së mëposhtme: kur një shtet anëtar ka dërguar një propozim në Byronë Ndërkombëtare, kjo e fundit ia transmeton atë të gjitha shteteve anëtare për shqyrtim. Ata kanë në dispozicion një afat prej 45 ditësh për të shqyrtuar propozimet dhe, në rast nevojë, për të dërguar vërejtjet e tyre në Byronë Ndërkombëtare. Amendamentet nuk do të pranohen. Pas përfundimit të këtij afati prej 45 ditësh, Byroja Ndërkombëtare i transmeton shteteve anëtare gjithë vërejtjet që ka marrë dhe fton secilin prej shteteve anëtare me të drejtë vote të votojë pro ose kundër propozimit. Shtetet anëtare që nuk kanë dërguar votën e tyre brenda një afati prej 45 ditësh do të konsiderohen si abstenuese. Afatet e mësipërme do të fillojnë nga data e qarkoreve të Byrosë Ndërkombëtare.

2. Nëse propozimi ka të bëjë me një marrëveshje ose protokollin përfundimtar të saj, vetëm shtetet anëtare që janë palë e asaj marrëveshjeje mund të marrin pjesë në procedurën e përshkruar në paragrafin 1.

Neni 141

Procedura e paraqitjes së propozimeve që lidhen me përgatitjen e rregulloreve të reja, duke marrë parasysh vendimet e marra nga Kongresi në Këshillin e Operacioneve Postare

1. Rregullorja e Konventës Postare Universale dhe marrëveshja e shërbimeve të pagesës postare do të hartohen nga Këshilli i Operacioneve Postare, duke pasur parasysh vendimet e marra nga Kongresi.

2. Propozimet që rrjedhin nga amendamentet e propozuara në Konventës ose të Marrëveshjes së Shërbimeve të Pagesës Postare duhet t'i kalohen Byrosë Ndërkombëtare në të njëjtën kohë me propozimet e Kongresit me të cilat ato kanë lidhje. Ato mund të paraqiten nga një shtet anëtar pa mbështetjen e shteteve të tjera anëtare. Këto propozime duhet të shpërndahen në të gjithë vendet anëtare, jo më vonë se një muaj para Kongresit.

3. Propozimet e tjera që prekin rregulloret, për t'u shqyrtuar nga Këshilli i Operacioneve Postare për përpilimin e rregulloreve të reja brenda gjashtë muajve pas Kongresit duhet të paraqiten në Byrosë Ndërkombëtare të paktën dy muaj para Kongresit.

4. Propozimet për ndryshime në rregullore të kërkuara si rezultat i vendimeve të Kongresit, që janë paraqitur nga shtetet anëtare, duhet të mbërrijnë në Byronë Ndërkombëtare jo më vonë se dy muaj para hapjes së Këshillit të Operacioneve Postare. Këto propozime duhet t'i shpërndahen të gjithë shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar, jo më vonë se një muaj para hapjes së Këshillit të Operacioneve Postare.

Neni 142

Amendimi i rregulloreve nga Këshilli i Operacioneve Postare

1. Propozimet për amendimin e rregulloreve do të trajtohen nga Këshilli i Operacioneve Postare.

2. Do të kërkohet mbështetja e të paktën një shteti anëtar për dhënien e ndonjë propozimi për amendimin e rregulloreve.

3. (fshirë).



Neni 143

**Njoftimi i vendimeve të marra ndërmjet
Kongreseve
(Kusht. 29; rreg. e përgj. 139, 140, 142)**

1. Amendamentet për Konventën, marrëveshjet dhe protokollet përfundimtare të këtyre akteve do të sanksionohen nëpërmjet një njoftimi të drejtorit të përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare për qeveritë e shteteve anëtare.

2. Amendamentet e realizuara nga Këshilli i Operacioneve Postare në rregullore dhe në protokollet përfundimtare të tyre i njoftohen shteteve anëtare dhe operatorëve të tyre të caktuar nëpërmjet Byrosë Ndërkombëtare. E njëjta procedurë do të zbatohet në interpretimet e referuara në nenin 36.3.2 të Konventës dhe në dispozitat përkatëse të marrëveshjeve.

Neni 144

**Hyrja në fuqi e rregulloreve dhe e
vendimeve të tjera të miratuara midis
Kongreseve**

1. Rregulloret do të hyjnë në fuqi në të njëjtën datë dhe do të kenë të njëjtën kohëzgjatje si aktet e dala nga Kongresi.

2. Subjekt i paragrafin 1, vendimet për amendimin e akteve të Bashkimit që janë miratuar midis Kongreseve nuk do të kenë fuqi vepruese të paktën për tre muaj pas njoftimit të tyre. Megjithatë, ky afat kohor nuk do të zbatohet për ndryshimet në rregulloret të cilat janë miratuar pas hartimit të rregulloreve të reja por ende para hyrjes së tyre në fuqi, sipas paragrafit 1.

**KAPITULLI IV
FINANCA**

Neni 145

**Vendosja dhe rregullimi i shpenzimeve të
Bashkimit (Kusht. 22)**

1. Subjekt i dispozitave të paragrafëve 2 deri në 6, shpenzimet vjetore që lidhen me aktivitetet e organeve të Bashkimit nuk duhet të kalojnë shumat e mëposhtme 37,235,000 franga zvicerane për vitet 2017 deri më 2020-ën. Në rastin kur Kongresi i planifikuar për vitin 2020 shtyhet, e njëjta tarifë do të aplikohet edhe për periudhën pas vitit 2020.

2. Shpenzimet që lidhen me thirrjen e Kongresit të ardhshëm (shpenzime të transportit të sekretariatit, shpenzime të transportit, shpenzime të instalimit të pajisjeve të përkthimit simultan, kosto të riprodhimit të dokumentacionit gjatë Kongresit, etj.) nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 2,900,000 franga zvicerane.

3. Këshilli Administrativ është i autorizuar të tejkalojë kufirin e caktuar sipas paragrafëve 1 dhe 2, duke pasur parasysh rritjet e shkallëve të pagës, të kontributeve për pensionet apo shpërblimet, përfshirë aty dhe rregullimet e posteve, të miratuara nga Kombet e Bashkuara për zbatim ndaj personelit të tyre në Gjenevë.

4. Këshilli Administrativ do të jetë gjithashtu i autorizuar për të paguar, çdo vit, shumën e shpenzimeve të ndryshme nga ato të personelit, sipas indeksit zviceran të çmimit të konsumimit.

5. Pavarësisht paragrafit 1, Këshilli Administrativ, ose në rast urgjence ekstreme drejtori i përgjithshëm, mund të autorizojë tejkalimin e kufijve të caktuar për të përballuar kostot e riparimeve të rëndësishme dhe të paparashikuara të ndërtesës së Byrosë Ndërkombëtare, megjithatë me kusht që shuma e tejkalimit të mos tejkalojë shumën prej 125,000 franga zvicerane në vit.

6. Nëse krediti i parashikuar sipas paragrafëve 1 dhe 2 është i pamjaftueshëm për të siguruar funksionimin e mirë të Bashkimit, këto nivele mund të tejkalojnë me miratimin e shumicës së shteteve anëtare të Bashkimit. Çdo këshillim duhet të përfshijë një përshkrim të plotë të fakteve që justifikojnë këtë kërkesë.

Neni 146

**Rregullimi i kontributeve të vendeve
anëtare**

1. Shtetet që hyjnë në Bashkim ose që janë pranuar në cilësinë e anëtarit të Bashkimit, si dhe ato që dalin nga Bashkimi duhet të paguajnë kontributet e tyre për të gjithë vitin gjatë të cilit pranimi ose dalja në Bashkim bëhet efektiv.

2. Shtetet anëtare do të paguajnë parapagim pjesën e tyre të kontributeve për shpenzimet vjetore të Bashkimit, në bazë të buxhetit të hartuar nga Këshilli Administrativ. Këto kontribute duhet të jenë paguar jo më vonë se dita e parë e vitit financiar të cilit i referohet buxheti. Pas këtij afati,



shumat e detyruara do të ngarkohen me interes në favor të Bashkimit me normë 5% në vit duke filluar nga muaji i katërt.

3. Kur kontributet e prapambetura dhe të detyrueshme, pa përfshirë interesin, që një shtet anëtar i detyrohet Bashkimit, janë të barabarta ose më të larta se shuma e kontributeve të atij shteti anëtar për të dy vitet financiare të mëparshëm, ky shtet anëtar mund t'i transferojë në mënyrë të pakthyeshme Bashkimit të gjithë ose një pjesë të kredive të shteteve të tjera anëtare në zotërim të tij, në përputhje me marrëveshjet e caktuara nga Këshilli Administrativ. Kushtet e transferimit të kredive do të përcaktohen sipas një marrëveshje ndërmjet shtetit anëtar, debitorëve/kreditorëve të tij dhe Bashkimit.

4. Një shtet anëtar i cili, për arsye ligjore ose arsye të tjera, nuk mund të realizojnë këtë transferim, duhet të angazhohen të realizojnë një plan për amortizimin e llogarive të tij të prapambetura.

5. Me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, mbledhja e kontributeve të prapambetura të detyrueshme që i detyrohen Bashkimit nuk mund të shtrihen për më shumë se dhjetë vjet.

6. Në rrethana të jashtëzakonshme, Këshilli Administrativ mund të çlirojë një shtet anëtar nga e gjitha ose një pjesë e interesave që i detyrohet, nëse ai shtet ka shlyer tërësisht principalin e debitit të tij të prapambetur.

7. Një shtet anëtar gjithashtu mund të çlirohet, brenda kuadrit të një plani amortizimi për llogaritë e tij të prapambetura të miratuar nga Këshilli Administrativ, nga i gjithë ose një pjesë e interesave të akumuluar ose të grumbulluara; ky çlirim do të jetë, megjithatë, i varur nga realizimi i plotë dhe i përpiktë i planit të amortizimit në një afat të rënë dakord për një maksimum prej dhjetë vjetësh.

8. Dispozitat sipas paragrafëve 3–7 të zbatohen për analogji për kostot e përkthimit të faturuara nga Byroja Ndërkombëtare të vendeve anëtare që i përkasin grupeve gjuhësore.

9. Byroja Ndërkombëtare do t'u dërgojë fatura shteteve anëtare të paktën tre muaj para afatit të caktuar për shlyerje. Faturat origjinale do të dërgohen në adresën e saktë të dhënë nga shteti anëtar në fjalë. Kopjet elektronike të faturave do të dërgohen përmes postës elektronike si fatura paraprake ose njoftime.

10. Gjithashtu, Byroja Ndërkombëtare do t'u sigurojë shteteve anëtare informacion të qartë sa herë që u ngarkon atyre interes për pagesa të prapambetura të faturave të veçanta, në mënyrë që vendet anëtare të mund të verifikojnë lehtësisht se me cilat fatura korrespondojnë.

Neni 147

Mangësitë në financim

1. Për të mbuluar pamjaftueshmëritë në financat e Bashkimit, është krijuar një Fond Rezervë shuma e të cilit do të vendoset nga Këshilli Administrativ. Ky Fond do të mbahet kryesisht nga tepricat e buxhetit. Ai mund të përdoret gjithashtu edhe për të ekuilibruar buxhetin ose për të ulur shumën e kontributeve të shteteve anëtare.

2. Për sa i përket pamjaftueshmërisë së përkohshme të financave, qeveria e Konfederatës Zvicerane do të kryejë parapagimet e nevojshme afatshkurtra, sipas kushteve që do të caktohen me marrëveshje të përbashkët.

Neni 148

Mbikëqyrja e llogarive dhe mbajtja e librave financiarë

1. Qeveria e Konfederatës Zvicerane do të mbikëqyrë, pa tarifim, mbajtjen e librave financiare dhe llogarive të Byrosë Ndërkombëtare brenda kufijve të krediteve të përcaktuara nga Kongresi.

Neni 149

Sanksione automatike

1. Çdo shtet anëtar, duke qenë në pamundësinë për të kryer transfertën e parashikuar në nenin 128.9 dhe që nuk pranon për t'iu nënshtruar një plani amortizimi të propozuar nga Byroja Ndërkombëtare, sipas nenin 128.10, ose nuk e respekton atë, humb automatikisht të drejtën e tij të votës në Kongres dhe në mbledhjet e Këshillit Administrativ dhe të Këshillit të Operacioneve Postare dhe nuk është më i zgjedhshëm për anëtarësim në këto dy Këshilla.

2. Sanksionet automatike do të hiqen me vendim dhe me shkresë të menjëhershme sapo shteti anëtar në fjalë të ketë paguar të gjitha kontributet e detyrueshme të prapambetura për të cilat i detyrohet Bashkimit, në kapital dhe interes,



ose sapo ka rënë dakord me Bashkimin t'i nënshtrohet një plani amortizimi të llogarive të veta të prapambetura.

Neni 150

Klasat e kontributit (Kushtetuta 21; rreg. e përgjithshme 131, 145, 146, 147 dhe 148)

1. Shtetet anëtare kontribuojnë për mbulimin e shpenzimeve të Bashkimit sipas klasave të kontributeve të cilave i përkasin. Këto klasa janë si më poshtë:

klasë me 50 njësi;
klasë me 47 njësi;
klasë me 45 njësi;
klasë me 43 njësi;
klasë me 40 njësi;
klasë me 37 njësi;
klasë me 35 njësi;
klasë me 33 njësi;
klasë me 30 njësi;
klasë me 27 njësi;
klasë me 25 njësi;
klasë me 23 njësi;
klasë me 20 njësi;
klasë me 17 njësi;
klasë me 15 njësi;
klasë me 13 njësi;
klasë me 10 njësi;
klasë me 7 njësi;
klasë me 5 njësi;
klasë me 3 njësi;
klasë me 1 njësi;

klasë me 0.5 njësi, e rezervuar për shtetet më pak të përparura, siç janë renditur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe për shtete të tjera të caktuara nga Këshilli Administrativ;

klasë me 0.1 njësi, e rezervuar për shtetet të cilat janë njohur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara si shtete në zhvillim të përbëra nga ishuj të vegjël, me një popullsi nën 200,000 (sipas informacionit më të fundit statistikor të publikuar nga zyra përkatëse e Kombeve të Bashkuara).

2. Pavarësisht nga klasat e kontributeve të renditura në paragrafin 1, çdo shtet anëtar mund të zgjedhë të kontribuojë me një numër më të madh njësisht se ai që i korrespondon klasës së kontributit të cilës ai i përket, për një afat minimal të barabartë me periudhën midis kongreseve. Njoftimi i ndryshimit do të bëhet jo më vonë se në

Kongres. Në përfundim të periudhës midis kongreseve, shteti anëtar do të kthehet automatikisht në numrin fillestar të kontributeve të tij, me përjashtim të rastit kur ai vendos të mbajë kontributin e tij në një numër më të lartë njësisht. Pagesa e kontributeve shtesë do të rrisë shpenzimet në mënyrë proporcionale.

3. Shtetet anëtare do të jenë të përfshira në një nga klasat e kontributeve, si më sipër, në momentin e pranimit të tyre ose të pjesëmarrjes së tyre në Bashkim, sipas procedurës së caktuar në nenin 21.4 të Kushtetutës.

4. Shtetet anëtare mund të vendosen në një moment të dytë në një klasë më të ulët të kontributit, me kusht që kërkesa për këtë ndryshim të jetë dërguar në Byronë Ndërkombëtare të paktën dy muaj para hapjes së Kongresit. Kongresi do të japë një mendim jodetyrues mbi këto kërkesa për ndryshim në klasën e kontributeve. Shteti anëtar do të jetë i lirë të vendosë nëse do të ndjekë mendimin e Kongresit apo jo. Vendimi përfundimtar i shtetit anëtar do të transmetohet në Sekretariatit e Byrosë Ndërkombëtare para përfundimit të Kongresit. Kjo kërkesë për ndryshim do të bëhet efektive në datën e hyrjes në fuqi të dispozitave financiare të hartuara nga Kongresi. Shtetet anëtare të cilat nuk kanë bërë të ditur dëshirën e tyre për të ndryshuar klasën e kontributit brenda afateve të kërkuara, do të qëndrojnë në klasën e kontributit të cilës i përkisnin deri në atë kohë.

5. Shtetet anëtare nuk mund të insistojnë për t'u ulur më shumë se një klasë njëherësh.

6. Megjithatë, në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë katastrofat natyrore që kërkojnë programe të ndihmës ndërkombëtare, Këshilli Administrativ mund të autorizojë një reduktim të përkohshëm të klasës vetëm një herë midis dy kongreseve kur kjo kërkohet nga një shtet anëtar, nëse ky anëtar provon që nuk mund të mbajë kontributin e vet sipas klasës së zgjedhur fillimisht. Në të njëjtat rrethana, Këshilli Administrativ gjithashtu mund të autorizojë reduktimin, nga klasa me 1 njësi, në klasën me 0,5 njësi.

7. Në zbatimin e dispozitave të parashikuara sipas paragrafit 6, reduktimi i përkohshëm i klasës, mund të autorizohet nga Këshilli Administrativ për një periudhë maksimale prej dy vjetësh ose deri në Kongresin e ardhshëm, cilado nga të dyja të jetë e para. Me mbarimin e periudhës së caktuar, shteti në



fjalë rikthehet automatikisht në klasën e tij të mëparshme.

8. Pavarësisht nga paragrafët 4 dhe 5, ndryshimet në një klasë më të lartë nuk do të jenë subjekt i kufizimeve.

Neni 151

Pagesa e furnizimeve nga Byroja Ndërkombëtare (rreg. e përgj. 134)

1. Furnizimet e dhëna nga Byroja Ndërkombëtare për shtetet anëtare dhe operatorët e tyre të caktuar kundrejt pagesës duhet të paguhën brenda afatit më të shkurtër të mundshëm dhe jo më vonë se gjashtë muaj, duke filluar nga dita e parë e muajit që vjen pas muajit në të cilin llogaria është dërguar nga Byroja. Me kalimin e këtij afati, shumat që duhet të paguhën do të ngarkohen me interes në favor të Bashkimit me një normë prej 5 % në vit, të llogaritur nga dita e mbarimit të afatit të mësipërm.

Neni 152

Organizimi i organeve ndihmëse të përdorues-financuesve

1. Me miratimin e Këshillit Administrativ, Këshilli i Operacioneve Postare mund të krijojë një numër të organeve ndihmëse të përdorues-financuesve, të financuar me mjete vullnetare, me qëllim që të organizojnë aktivitetet operacionale, tregtare, teknike dhe ekonomike, të cilat përfshihen brenda kompetencave të parashikuara në nenin 18 të Kushtetutës, por që nuk mund të financohen nga buxheti.

2. Me krijimin e këtij organi, nën Këshillin e Operacioneve Postare, Këshilli i Operacioneve Postare duhet të vendosë mbi strukturën themelore të rregullave të procedurave të organit, duke marrë në konsideratë rregullat dhe parimet themelore të UPU-së, si një organizatë ndërqeveritare dhe duhet t'ia paraqesë për miratim Këshillit Administrativ. Struktura bazë duhet të përfshijë këto elemente:

2.1 mandatin;

2.2 procedurën e zgjedhjes, duke përfshirë kategoritë e anëtarëve pjesëmarrës;

2.3 rregullat e vendimmarrjes, duke përfshirë strukturën e tij të brendshme dhe marrëdhëniet me anëtarët e tjerë të UPU-së;

2.4 parimet e votimit dhe të përfaqësimit;

2.5 financimin (regjistrimi, tarifa e përdorimit, etj.);

2.6 përbërjen e sekretariatit dhe strukturën e administrimit.

3. Çdo organ ndihmës për përdorues-financuesit duhet të organizojë aktivitetet e tij në mënyrë të pavarur brenda strukturës themelore të vendosur nga Këshilli i Operacioneve Postare dhe të miratuar nga Këshilli Administrativ, si dhe duhet të përgatisë një raport vjetor mbi aktivitetet për t'u marrë në konsideratë nga Këshilli i Operacioneve Postare.

4. Këshilli Administrativ duhet të vendosë rregullat në lidhje me kostot mbështetëse që organet ndihmëse të përdorues-financuesve duhet të kontribuojnë për buxhetin dhe duhet t'i publikojnë në rregulloret financiare të UPU-së.

5. Drejtori i përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare duhet të administrojë sekretariatit e organeve ndihmëse të përdorues-financuesve, në përputhje me rregulloret e rregullat e stafit, të aplikueshme për stafin e rekrutuar për organet ndihmëse të përdorues-financuesve. Sekretariati i organeve ndihmëse duhet të jetë pjesë përbërëse e Byrosë Ndërkombëtare.

6. Informacioni në lidhje me organet ndihmëse të përdorues-financuesve, i themeluar sipas këtij neni, duhet t'i raportohet Kongresit në vijim të krijimit të tyre.

KAPITULLI V ARBITRAZHI

Neni 153

Procedurat e arbitrazhit (Kushtetuta - 32)

1. Nëse një mosmarrëveshje që të zgjidhet me arbitrazh, ndërmjet shteteve anëtare, secili shtet anëtar duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim për subjektin e mosmarrëveshjes dhe ta informojë me anë të një njoftimi për fillimin e arbitrazhit.

2. Nëse mosmarrëveshja lidhet me pyetje të natyrës operacionale apo teknike, çdo shtet anëtar mund t'i kërkojë operatorit të përcaktuar të tij për të vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në paragrafët e mëposhtëm dhe t'i delegojë një pushtet të tillë operatorit të tij. Shtetet anëtare në fjalë do të informohen për ecurinë e procedurës dhe të rezultatit. Shtetet anëtare



përkatëse ose operatorët e caktuar në tekstin e mëposhtëm do të quhen “palë në arbitrazh”.

3. Palët në çështje mund të bien dakord për të emëruar një arbitër ose tre arbitra.

4. Kur palët në arbitrazh zgjedhin për të emëruar tre arbitra, secila palë, në përputhje me paragrafin 2, do të zgjedhë një shtet anëtar ose operator të caktuar jo të lidhur drejtpërsëdrejti në mosmarrëveshje, për të vepruar si arbitër. Kur disa shtete anëtare dhe/ose operatorët e caktuar kane çështje të përbashkëta, ata do të llogariten si një grup i vetëm për qëllime të këtyre dispozitave.

5. Kur palët bien dakord për emërimin e tre arbitrave, arbitri i tretë duhet të ketë marrë pëlqimin e të gjitha palëve dhe nuk duhet të jetë nga një shtet anëtar ose operator caktuar.

6. Nëse një mosmarrëveshje ka të bëjë me një nga marrëveshjet, arbitrat mund të emërohen vetëm midis shteteve anëtare që janë palë e asaj marrëveshjeje.

7. Palët në arbitrazh mund të bien dakord së bashku për të caktuar një arbitër të vetëm, i cili nuk duhet të jetë nga një shtet anëtar ose operator i caktuar.

8. Nëse një ose të dyja palët në arbitrazh nuk e caktojnë arbitrin ose arbitrat brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e njoftimit për fillimin e arbitrazhit, Byroja Ndërkombëtare, nëse kërkohet, do të emërojë një arbitër ose do të caktojë vetë një të tillë automatikisht. Byroja Ndërkombëtare nuk do të përfshihet në vendimet, përveç kur kërkohet ndryshe reciprokisht nga palët.

9. Palët në arbitrazh mund të bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në çdo kohë para se një vendim të jetë dorëzuar nga arbitri ose arbitrat, Njoftimi i çdo tërheqjeje duhet të dorëzohet me shkrim pranë Byrosë Ndërkombëtare, brenda 10 ditëve pasi palët të kenë arritur një marrëveshje të tillë. Kur palët bien dakord që të tërhiqen nga procesi i arbitrazhit, arbitri ose arbitrat do të humbin autoritetin e tyre për të vendosur këtë çështje.

10. Arbitrit ose arbitrave do t'u kërkohet të marrin një vendim mbi mosmarrëveshjen e bazuar në fakte dhe provat para tyre. Të gjitha informacionet në lidhje me mosmarrëveshjen duhet të njoftohen për të dyja palët dhe për arbitrin ose arbitrat.

11. Vendimi i arbitrit ose arbitrave do të merret me shumicën e votave, dhe do t'i njoftohet Byrosë

Ndërkombëtare dhe palëve, brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit për fillimin e arbitrazhit.

12. Procedurat e arbitrazhit duhet të jenë konfidenciale, dhe vetëm një përshkrim i shkurtër i mosmarrëveshjes, dhe vendimi do të njoftohet me shkrim pranë Byrosë Ndërkombëtare brenda 10 ditëve nga data e vendimit, duke e dërguar te palët.

13. Vendimi i arbitrit ose arbitrave do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët dhe nuk do t'i nënshtrohet apelit.

14. Palët e arbitrazhit do të zbatojnë vendimin e arbitrit ose arbitrave pa vonesë. Kur një operatori të caktuar i delegohet pushteti nga shteti i tij anëtar për të filluar dhe marrë pjesë në procedurën e arbitrazhit, shteti anëtar do të jetë përgjegjës për të siguruar që operatori i caktuar zbaton vendimin e arbitrit ose arbitrave.

KAPITULLI VI PËRDORIMI I GJUHËVE BREDA BASHKIMIT

Neni 154

Gjuhët e punës së Byrosë Ndërkombëtare

1. Gjuhët e punës të Byrosë Ndërkombëtare janë gjuha frënge dhe gjuha angleze.

Neni 155

Gjuhët e përdorura për dokumentacionin, për debatet dhe korrespondencën zyrtare

1. Për dokumentacionin e Bashkimit do të përdoren gjuhët franceze, angleze, arabe dhe spanjolle. Përdoren gjithashtu gjuhët gjermane, kineze, portugeze dhe ruse, me kushtin që vetëm dokumentacioni më i rëndësishëm bazë të prodhohet në këto gjuhë. Mund të përdoren gjuhë të tjera, me kushtin që shtetet anëtare që kanë bërë kërkesën të mbulojnë të gjithë kostot e kësaj.

2. Shteti ose shtetet anëtare që kërkojnë një gjuhë të ndryshme nga ajo zyrtare formojnë një grup gjuhësor.

3. Dokumentacioni publikohet nga Byroja Ndërkombëtare në gjuhën zyrtare dhe në gjuhët e grupeve gjuhësore të formuara sipas rregullave, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrave rajonale të këtyre grupeve, në përputhje me procedurat e rena dakord me



Byronë Ndërkombëtare. Publikimi në gjuhë të ndryshme bëhet sipas një standardi të përbashkët.

4. Dokumentacioni i publikuar drejtpërdrejt nga Byroja Ndërkombëtare, për sa është e mundur, do të shpërndahet në të njëjtën kohë në gjuhët e ndryshme të kërkuara.

5. Korrespondencat midis shteteve anëtare ose operatorëve të tyre të caktuar dhe Byrosë Ndërkombëtare dhe midis kësaj të fundit, dhe të tretëve mund të shkëmbehen në çdo gjuhë për të cilën Byroja Ndërkombëtare disponon një shërbim përkthimi.

6. Shpenzimet e përkthimit në çfarëdo gjuhë, duke përfshirë edhe ato që rezultojnë nga zbatimi i paragrafit 5, do të mbulohen nga grupi gjuhësor që ka kërkuar për atë gjuhë. Shtetet anëtare që përdorin gjuhën zyrtare do të paguajnë, për qëllimet e përkthimit të dokumenteve jozyrtare, një kontribut, shuma e të cilit për njësi kontribuimi të jetë e barabartë me atë shumë që mbulohet nga shtetet anëtare, duke iu referuar gjuhës tjetër që përdoret nga Byroja Ndërkombëtare. Të gjitha shpenzimet e tjetra që kanë të bëjnë me dhënien e dokumenteve mbulohen nga Bashkimi. Tavan i shpenzimeve, që mbulohen nga Bashkimi për dokumentacionin në gjuhën kineze, gjermane, portugeze dhe ruse do të caktohet me një rezolutë të Kongresit.

7. Kostot që vijnë nga një grup gjuhësor do të ndahen midis anëtarëve të këtij grupi në proporcion me kontributin e tyre për shpenzimet e Bashkimit. Këto kosto mund të ndahen midis anëtarëve të grupit gjuhësor sipas një baze tjetër ndarjeje, me kusht që shtetet anëtare të interesuara të bien dakord për këtë dhe të informojnë Byronë Ndërkombëtare për vendimin e tyre me anë të ndërmjetësimit të zëdhënësit të grupit.

8. Byroja Ndërkombëtare do të zbatojë çdo ndryshim në zgjedhjen e gjuhës së kërkuar nga një shtet anëtar pas një afati që nuk duhet të kalojë dy vjet.

9. Për diskutimet në mbledhjet e organeve të Bashkimit, do të jenë të pranueshme gjuhët franceze, angleze dhe ruse, me kushtin e pranisë së një sistemi interpretimi - me ose pa pajisje elektronike - zgjedhja e të cilës është lënë në vlerësimin e organizatorëve të mbledhjes pas këshillimit me drejtorin e përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare dhe të shteteve anëtare të interesuara.

10. Për diskutimet dhe mbledhjet e përmendura në paragrafin 9 do të jenë të autorizuar edhe gjuhë të tjera.

11. Delegacionet që përdorin gjuhë të tjera sigurojnë përkthimin simultan në një nga gjuhët e përmendura në paragrafin 9, ose nëpërmjet sistemit të cituar në të njëjtin paragraf, kur mund të realizohen ndryshimet e nevojshme teknike, ose nga përkthyes të veçantë.

12. Kostot e shërbimeve të përkthimit do të ndahen midis shteteve anëtare që përdorin të njëjtën gjuhë në proporcion me kontributet e tyre për shpenzimet e Bashkimit. Megjithatë, shpenzimet e instalimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve teknike do të mbulohen nga Bashkimi.

13. Shtetet anëtare dhe/ose operatorët e caktuar të tyre mund të bien dakord mbi çështjen e gjuhës që do të përdoret në korrespondencat zyrtare në marrëdhëniet e tyre reciproke. Kur kjo lloj marrëveshje nuk arrihet, gjuha që do të përdoret do të jetë gjuha frënge.

KAPITULLI VII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 156

Kushtet për miratimin e propozimeve që kanë të bëjnë me rregulloren e përgjithshme

1. Që të bëhen efektive, propozimet e paraqitura në Kongres dhe që kanë të bëjnë me rregulloren e përgjithshme duhet të miratohen nga shumica e shteteve anëtare të përfaqësuara në Kongres, dhe që kanë të drejtë votë. Të paktën dy të tretat e shteteve anëtare të Bashkimit që kanë të drejtë votë duhet të jenë të pranishëm në momentin e votimit.

Neni 157

Propozime që kanë të bëjnë me marrëveshjet me Kombet e Bashkuara (Kushtetuta 9)

1. Kushtet e miratimit të paraqitura në nenin 133 zbatohen gjithashtu për propozimet që kanë si qëllim ndryshimin e marrëveshjeve midis Bashkimit të Përbotshëm Postar dhe Kombeve të Bashkuara, kur këto marrëveshje nuk parashikojnë kushtet për amendimin e dispozitave që ato përmbajnë.



Neni 158

Amendimi, hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e rregullores së përgjithshme

1. Amendamentet e miratuara nga Kongresi do të jenë subjekt i një protokolli shtesë dhe, me përjashtim të rastit kur Kongresi vendos ndryshe, do të hyjë në fuqinë të njëjtën kohë me aktet e tjera të përditësuara gjatë të njëjtë Kongres.

2. Rregullorja e përgjithshme do të jetë vënë në zbatim më 1 janar 2014 dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

Në dëshmi të sa më sipër, të plotfuqishmit e qeverive të shteteve anëtare kanë nënshkruar këtë rregullore të përgjithshme, në një kopje, e cila depozitohet pranë drejtorit të përgjithshëm të Byrosë ndërkombëtare. Një kopje e saj do t'i dorëzohet çdo pale nga Byroja Ndërkombëtare e Bashkimit të Përbotshëm Postar.

Realizuar në Doha, më 11 tetor 2012.

DEKRET**Nr. 13611, datë 10.5.2022****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 46/2022, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktet dhe dokumentet e Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, Stamboll 2016”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM**Nr. 35/2022****PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.
92/2017, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS ORGANIZATIVE,
ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË
PAGAVE TË PERSONELIT TË
KOLEGJIT TË POSAÇËM TË
APELIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës; neneve 18, pika 1, dhe 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Miratohen ndryshimet në strukturë, organikë dhe klasifikimin e pagave të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Struktura organizative është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. Këshilltari ligjor dhe ekonomik i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas rastit, përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë në punë. Pagesa vjetore e shtesës për shkak të vështirësisë është jo më shumë se 3 paga mujore dhe jepet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

V. Punonjësit administrativë të Kolegjit përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë pune në masën 10% të pagës për pozicion ose të pagës bazë për klasë. Punonjësit administrativë, të cilët sipas këtij vendimi përfitojnë shtesa të tjera të së njëjtës natyrë të përcaktuara në të, do të përfitojnë vetëm njëren prej shtesave, atë me vlerën më të madhe.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 12.5.2022.



Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJI TË POSAÇËM TË APELIMIT

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
I. KRYETAR	G3*	(2)
Sekretar		1
	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	1
II. KOLEGJI I GJYQITARËVE	G3*	(6)
Gjyqtarë		6
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(25)
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	14
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	11
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-a	1
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIEN DHE PUBLIKUN		(14)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III-b	5
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	III-b	2
Përkthyes	II-b	4
Koordinator për medien dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritjeje me popullin	III-b	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(9)
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	2
Specialist protokolli/arkivi ****	III-b	1
Magaznier	VI	1
Punonjës pastrimi	II	1
Shofer/korrier	V	1
TOTAL		57

* Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

** Kategoria e pagës për sekretarin e kryetarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.


*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

***** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore



STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT



VENDIM
Nr. 36/2022

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.
93/2017, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS ORGANIZATIVE,
ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË
PAGAVE TË PERSONELIT
TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË
KUALIFIKIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës; si dhe neneve 18, pika 1, dhe 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

VENDOSI:

I. Miratohen ndryshimet në strukturë, organikë dhe klasifikimin e pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Struktura organizative është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. Këshilltari ligjor dhe ekonomik i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas rastit, përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë në punë. Pagesa vjetore e shtesës për shkak të vështirësisë është jo më shumë se 3 paga mujore dhe jepet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të mbledhjes së anëtarëve të Komisionit.

V. Punonjësit administrativë të Komisionit përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë



pune në masën 10% të pagës për pozicion apo të pagës bazë për klasë. Punonjësit administrativë, të cilët sipas këtij vendimi përfitojnë shtesa të tjera të së njëjtës natyrë të përcaktuara në të, do të përfitojnë vetëm njëherë prej shtesave, atë me vlerën më të madhe.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar në datën 12.5.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri (2)
I. KRYETAR	G3*	1
Sekretar	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	1
II. KOMISIONERËT	G3*	(11)
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(36)
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	24
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	12
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-a	1
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIEN DHE PUBLIKUN		(15)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III-b	6
Specialist jurist	III-b	2
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	III-b	2
Përkthyes	II-b	2
Koordinator për medien dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritjeje me popullin	III-b	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(11)
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist financë/prokurime	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	1
Specialist protokolli/arkivi ****	III-b	2
Magaznier	VI	1
Punonjës pastrimi	II	2
Shofer/korrier	V	1
TOTAL		76



Sbënim:

* Sipas ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

** Kategoria e pagës për sekretarin e kryetarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.


*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

***** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.

Lidhja nr. 2

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT





**VENDIM
Nr. 37/2022**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KUVENDIT
NR. 94/2017 “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS ORGANIZATIVE,
ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË
PAGAVE TË PERSONELIT
TË KOMISIONERËVE PUBLIKË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe neneve 18, pika 1, dhe 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionerëve Publikë,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratohen ndryshimet në strukturë, organikë dhe klasifikimin e pagave të Komisionerëve Publikë.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Struktura organizative është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. Këshilltari ligjor dhe ekonomik i Komisionerëve Publikë, sipas rastit, përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë në punë. Pagesa vjetore e shtesës për shkak të vështirësisë është jo më shumë se 3 paga mujore dhe jepet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të mbledhjes së Komisionerëve Publikë.

V. Punonjësit administrativë të Komisionerëve Publikë përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë pune në masën 10% të pagës për pozicion apo të pagës bazë për klasë. Punonjësit administrativë, të cilët sipas këtij vendimi përfitojnë shtesa të tjera të së njëjtës natyrë të përcaktuara në të, do të përfitojnë vetëm njëherë prej shtesave, atë me vlerën më të madhe.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 12.5.2022.

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
I. KOMISIONERI PUBLIK		(4)
Komisionerë Publikë	G3*	2
Sekretarë	Sekretar në kabinetin e ministrit**	2
II. KANCELAR	I-a	(1)
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(10)
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	6
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	4
IV. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIEN DHE PUBLIKUN		(7)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie	III-b	2
Specialist redaktor gjuhësor	III-b	1




Përkthyes	II-b	1
Koordinator për medien dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritjeje me popullin	III-b	1

V. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE**MBËSHTETËSE**

(8)

Drejtore	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT***	III-b	1
Specialist protokoll/arkivi****	III-b	1
Magaziner	VI	1
Punonjës pastrimi	II	1
Shofer/korrier	V	1

TOTAL**30***Sbënim:*** Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".**** Kategoria e pagës për pozicionin e sekretarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.***** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.****** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.******* Përfitimet për kushte të vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.**Lidhja nr. 2***STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMISIONERËVE PUBLIKË**

**DEKRET**

Nr. 13617, datë 13.5.2022

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, e 20, dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Luçiano Vesel Kajsia
2. Fatbardha Hazis Geiger (Dilo)
3. Klaudio Vesel Kajsia
4. Lumturie Sokol Roth (Dakaj)
5. Arijan Naser Smajli
6. Eliona Angjelin Söllner (Palushaj)
7. Et-leva Fane Gjoka
8. Edlir Avni Myrte
9. Vjollca Haqif Ajroja (Kaceli)
10. Manuela Nuri Bineri (Avdullari)
11. Marissa Mehmet Bineri
12. Martina Nuri Zogu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 289, datë 11.5.2022

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË TIRANË, PËR NJËSINË
ADMINISTRATIVE TIRANË, TË
PASURIVE NR. 6/119, ZONA
KADASTRALE 8350, NR. 3/576, ZONA
KADASTRALE 8130, NR. 7/155, ZONA
KADASTRALE 8380, NR. 7/87, ZONA
KADASTRALE 8330, DHE NR. 6/459,
ZONA KADASTRALE 8180**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, për njësinë administrative Tiranë, të pasurive nr. 6/119, zona kadastrale 8350, nr. 3/576, zona kadastrale 8130, nr. 7/155, zona kadastrale 8380, nr. 7/87, zona kadastrale 8330, dhe nr. 6/459, zona kadastrale 8180, sipas lidhjes 1, formularëve, gjithsej, 2 (dy) fletë, dhe planrilevimeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në fushën zhvillimit urban, shërbimeve dhe sportit.

2. Pasuritë e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohen listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të Qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Tiranë

Lidhje 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
12, 16, 22	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e infrastrukturës (rrugë, sheshe, trotuar).	Në pronësi
7	Prona që përdoren për kryerjen e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
23	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e infrastrukturës (troje të lira).	Në pronësi

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Identifikoi: Albana Hoxha (përgjegjës sektori) Ralf Haidin (Specialist)
Ervin Nikolla Drejtor
Supervizori: Alban Dokushi Drejtor (Kategoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licënsimit)

Aprovoi: Erion Veliaj (Kryetar)

Bashkia : Tiranë

Fusha e përdorimit të Pronës Infrastruktura

Nr. Rend.	A		B		C			Te dhena te tjera		
	Zona	Nr. Pasurisë	Emri i Pronës	Adresa	Sip. Totale e Pronës (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
12	8350	6/119	Shesh	Ndërmarrja e Shërbimeve material Poligrafike	60.36		Sherbim	Bashkia		shtet v.15 fq 79
22	8130	3/576	shesh	Ndërmarrja e Shërbimeve Funerale	199.7		Sherbim	Bashkia	Nd Shërb Fun	shtet v. 20 fq 161
7	8380	7/155	Trulli + Ndërtëse	Fusha e Tenisit Rr. R. Çollaku	4393.9	118	Aktivitet Sportiv	Bashkia	Kl. Sp. Tirana	shtet v.12 fq 35, Ne seks "D" ka regjistrime aktive ka kontr geraje



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Identifikoi: Albana Hoxha (përgjegjës sektori) ;Ratit Halidini (Specialist)

Ervin Nikolla Drejtor

Supervizoi: Alban Dokushi, Drejtor përgjithshme Juridike e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit

Aprovoi: Erion Veliaj (Kryetar)

Bashkia : Tiranë

Fusha e përdorimit të Pronës Infrastruktura

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës	Sip. Totale e Pronës (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shënimet e veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
16	8330 L,M-11	7/87	rruge	Rr. "S. Kosturi"	1547.4		Zhvillim urban	Bashkia	Bashkia	Shtet-v.18, fq 107
23	8180 N-17	6/459	Truall	Rr. "A. Demi"	24		Zhvillim urban	Bashkia	Bashkia	Shtet-v.25, fq 233 Kjo pasuri është e okupuar Ka ndërtim pa leje
24	8180 M-17	6/64	Truall	Rr. "A. Demi"	328		Zhvillim urban	Bashkia	Bashkia	Shtet-v.25, fq 151 Kjo pasuri është e okupuar Ka ndërtim pa leje



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: SHTET		DATE 02.02.2021		QELIMI: TRANSFERIM		
VENDNDODHJA BASHKIA: TIRANE		DVASHK/ZVASHK : TIRANË JUG		ZONA KADASTRALE: 8180		NUMRI PASURISE: 6/459
TE DHENAT E PASURISE		SIP.PASURISE= 24.00 M ²		SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= _____ m		NUMRI KATEVE _____
LLOJI PASURISE: TRUALL				NUMRI PEMEVE _____		
X= 487241.01 Y= 4577671.37		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE				X= 487336.95 Y= 4577671.37
X= 487241.01 Y= 4577593.97		SH 1:500 SISTEMI KORDINATIV SIPAS K.RR.GJ.SH 2010				X= 487336.95 Y= 4577593.97
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1				VERE: PAS. 6/63		
2				LINDJE: PAS. 6/63		
3				JUG: PAS. 6/282		
4				PERENDIM: PAS. 6/446		
REALIZOI PER BASHKINE TIRANE EMRI: RAIF HALIDINI SPECIALIST ING. TOPOGRAF REALIZOI PER ASHK KONFRMOI TEKNOLOGJIA E MATJEVE: ORTOFTOTO E MATJE DISTANCASH PERCAKTIMI KUFIRIT: SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET						



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE					
PRONARI: SHTET		DATE 02.02.2021		QELIMI: TRANSFERIM	
VENDNDODHJA BASHKIA: TIRANË		DVASHK/ZVASHK : TIRANË VERI		ZONA KADASTRALE: 8350	
TE DHENAT E PASURISE		NUMRI PASURISE: 6/119		INDEX HARTE: TR-N-11	
LLOJ PASURISE: SHESH		SIP.PASURISE= 60.36 M ²		SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= _____m	
		NUMRI KATEVE _____		NUMRI PEMEVE _____	
X= 484560.11 Y= 4577470.26		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE		X= 484656.05 Y= 4577470.26	
X= 484560.11 Y= 4577392.86		SH 1:500		X= 484656.05 Y= 4577392.86	
SISTEMI KORDINATIV SIPAS K.RR.GJ.SH 2010					
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1				VERE: PAS. 6/110, 321	
2				LINDJE: PAS. 6/110	
3				JUG: PAS. 6/268	
4				PERENDIM: PAS. 6/155	
REALIZOI PER BASHKINE TIRANË EMRI: RAIF HALIDINI SPECIALIST ING. TOPOGRAF REALIZOI PER ASHK KONFIRMOI TEKNOLOGJIA E MATJEVE: ORTOFTOTO E MATJE DISTANCASH PERCAKTIMI KUFIRIT: SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET					



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: SHTET		DATE 02.02.2021		QELLIMI: TRANSFERIM		
VENDNDODHJA		DVASHK/ZVASHK : TIRANË VERI		ZONA KADASTRALE: 8130		NUMRI PASURISE: 3/576
BASHKIA: TIRANË		TE DHENAT E PASURISE		INDEX HARTE: TR-1-15		SIPASURISE= 199.70 M²
LLOJI PASURISE: SHESH		SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= _____ m		NUMRI KATEVE _____		NUMRI PEMEVE _____
X= 486555.91		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE			X= 486551.84	
Y= 4578842.36					Y= 4578842.36	
X= 486555.91		SH 1:500			X= 486551.84	
Y= 4578766.06		SISTEMI KORDINATIV SIPAS K.RR.GJ.SH 2010			Y= 4578766.06	
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1				VERI: PAS. 3/360, 356		
2				LINDJE: PAS. 3/402		
3				JUG: PAS. 3/557, 558		
4				PERENDIM: PAS. 3/359		
REALIZOI PER BASHKINË TIRANË EMRI: RAIK HALIDINI SPECIALIST ING. TOPOGRAF <i>[Signature]</i> REALIZOI PER ASHK KONFIRMOI				TEKNOLOGJIA E MATJEVE: ORTOFOTO E MATJE DISTANCASH PERCAKTIMI KUFIRIT: SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFTARET		





PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: SHTET		DATE 02.02.2021		QELLIMI: TRANSFERIM		
VENDNDODHJA BASHKIA: TIRANE DVASHK/ZVASHK : TIRANË VERI ZONA KADASTRALE: 8330 NUMRI PASURISE: 7/87 INDEX HARTE: TR-L,M-11						
TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: RRUGË SIP.PASURISE= 1547.4 M ² SIPERFAQE GIJRMES NDERTIMIT= _____m NUMRI KATEVE _____ NUMRI PEMEVE _____						
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE						
X= 484398.93 Y= 4678214.68				X= 484626.41 Y= 4678214.68		
X= 484398.93 Y= 4677876.42		SH 1:1250 SISTEMI KORDINATIV SIPAS KRR.G.J.SH 2010		X= 484626.41 Y= 4677876.42		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1			VERI PAS. 6/643			
2			LINDJE PAS. 7/313, 338, 426, 85			
3			RUG PAS. 2/263, 1/289			
4			PERENDIM PAS. 7/291, 335, 336			
REALIZOI PER BASHKINË TIRANË EMRI: RAIF HALIDINI SPECIALIST ING. TOPOGRAF			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: ORTOFTOTO E MATJE DISTANCASH PERCAKTIMI KUFIRIT: SHENIME TE VECANTA:			
REALIZOI PER ASHK KONFIRMOI			PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET			





PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: SHTET		DATE 02.02.2021		QELLIMI: TRANSFERIM		
VENDNDODHJA BASHKIA: TIRANË DVASHK/ZVASHK : TIRANË VERI ZONA KADASTRALE: 8380 NUMRI PASURISE: 7/155 INDEX HARTE: TR-Q-10, 11						
TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: TR+ND SIP.PASURISE= 4393.90 M ² SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= 118.00 m ² NUMRI KATEVE _____ NUMRI PEMEVE _____						
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE						
X= 484349.79 Y= 4576687.11				X= 484578.04 Y= 4576687.11		
X= 484349.79 Y= 4576471.35		SH 1:1000 		SISTEMI KORDINATIV SIPAS K.R.R.G.J.SH 2010 X= 484578.04 Y= 4576471.35		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1				VERI: PAS. 7/90		
2				LINDJE: PAS. 7/90		
3				JUG: PAS. 7/379, 7/171, 7/169		
4				PERENDIM: PAS. 7/157		
REALIZOI PER BASHKINË TIRANË EMRI: RAIF HALIDINI SPECIALIST ING. TOPOGRAF REALIZOI PER ASHK KONFIRMOI				TEKNOLOGJIA E MATJEVE: ORTOFTOTO E MATJE DISTANCASH PERCAKTIMI KUFIRIT: SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET		



VENDIM

Nr. 301, datë 11.5.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE,
PËR NJOHJEN E NDËRSJELLË TË
LEJEVE TË DREJTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
MBRETËRISË TË ARABISË SAUDITE
MBI NJOHJEN E NDËRSJELLË
TË LEJEVE TË DREJTIMIT**

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Arabisë Saudite (më poshtë të quajtura “Palët”);

në mbështetje të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të tyre miqësore;

me dëshirën për të vendosur një bashkëpunim të frytshëm dhe afatgjatë në reciprocitetin e lejeve të drejtimit; dhe

duke kuptuar përfitimet e ndërsjella që vijnë nga ky bashkëpunim,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Secila palë njihet lejet e drejtimit të vlefshme dhe jo të përkohshme, të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palës tjetër për shtetasit e tyre, në pajtim me legjislacionin dhe rregulloret e tyre të zbatueshme. Kjo njohje përfshin përdorimin dhe shkëmbimin e këtyre lejeve drejtimi.

Neni 2

1. Çdo person, mbajtës i një leje drejtimi, të lëshuar nga autoritetet kompetente në vendin e tij, i jepet një leje drejtimi e barasvlershme, e lëshuar nga autoritetet kompetente në vendin tjetër, pa iu nënshtruar provimeve teorike dhe praktike. Megjithatë, kjo leje drejtimi duhet të jetë e vlefshme sipas ligjeve të zbatueshme të Palës që ka lëshuar lejen e drejtimit për personat që kanë një vizë pune. Pala tjetër duhet të njoftohet për lëshimin e kësaj leje drejtimi.

2. Një shtetas i cilësdo Palë, që ka marrë një vizë hyrjeje në vendin e Palës tjetër, do të lejohet të drejtojë mjete private, me kusht që ai të ketë një leje të vlefshme drejtimi të lëshuar nga autoriteti kompetent në vendin e tij. Bëjnë përjashtim nga kjo lejet e përkohshme të drejtimit. Leja e drejtimit mbetet e vlefshme deri në datën e saj të skadimit ose deri në datën e skadimit të lejes së qëndrimit, cilado qoftë më parë, me kusht që periudha e përgjithshme të mos kalojë një vit nga data e hyrjes në vend.

3. Çdo anëtar i një misioni diplomatik mund t'i lëshohet leje drejtimi, pa pasur nevojë të japin një provim, duke paraqitur një kërkesë me shkrim për Ministrinë e Jashtme të Palës tjetër. Çdo anëtar, i cili nuk ka një leje drejtimi duhet të japë provimet e nevojshme të administruar nga autoriteti kompetent për marrjen e një leje drejtimi.

Neni 3

Drejtuesit e mjeteve mund të drejtojnë vetëm mjetet për të cilat kanë leje drejtimi sipas ligjeve të zbatueshme të autoritetit kompetent që ka lëshuar lejen e drejtimit.



Neni 4

Në rast se drejtuesi i mjetit shkel ligjet e trafikut kombëtar, ai do t'i nënshtrohet ligjeve të vendit ku ndodh shkelja.

Neni 5

Në rast se ndonjëra nga Palët, dyshon për vlefshmërinë dhe vërtetësinë e lejes së drejtimit, ajo do të kryejë një provim praktike ose do të kërkojë të konfirmojë vërtetësinë dhe vlefshmërinë e lejes së drejtimit duke kërkuar informacion nga Pala tjetër përmes kanaleve diplomatike. Pala së cilës i drejtohet kërkesa do t'i përgjigjet kërkesës brenda një periudhe jo më të gjatë se 60 ditë nga data e marrjes së saj.

Neni 6

Autoritetet kompetente të Palës përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshje, janë:

Për Republikën e Shqipërisë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, rruga “Muhedin Llagani”, nr. 10.

Për Mbretërinë e Arabisë Saudite:

Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Publike/Departamenti i Trafikut).

Neni 7

Autoritetet kompetente të Palëve, të referuara në nenin 6, shkëmbejnë modelet e lejeve të drejtimit dhe një tabelë konvertimi për llojet e lejeve të drejtimit në të dyja vendet, si dhe çdo amendim të tyre.

Neni 8

1. Autoritetet kompetente të Palëve, kurdo që është e nevojshme, organizojnë takime me specialistët e tyre që të shkëmbejnë njohuritë në fushat që mbulohen nga kjo Marrëveshje.

2. Palët shkëmbejnë rregullore, publikime dhe studime që kanë lidhje me trafikun.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet

me anë të konsultimeve të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve kompetente të të dyja vendeve. Në rast se autoritetet kompetente nuk arrijnë të gjejnë një zgjidhje, mosmarrëveshja do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 10

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohen me miratim të Palëve përmes negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve kompetente në përputhje me procedurat e tyre të zbatueshme.

Neni 11

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim të shkëmbyer midis Palëve përmes kanaleve diplomatike që konfirmon se palët kanë përmbushur të gjitha procedurat e brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.

Neni 12

1. Kjo Marrëveshje do të ketë një kohëzgjatje me afat të papërcaktuar.

2. Secila palë mund të kërkojë zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër kontraktuese, përmes kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të zgjidhet gjashtë muaj nga data e marrjes së këtij njoftimi. Kjo nuk do të ndikojë te kërkesat e dërguara gjatë periudhës së vlefshmërisë së Marrëveshjes.

Bërë në qytetin e Riadit, më 7.3.2022.....G, që i korrespondon datës 4.8.1443 Hijri, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë:

Olta Xhaçka

Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme

Për Qeverinë e Mbretërisë së Arabisë Saudite:
Abdulaziz bin'Saud bin Naif bin Abdulaziz
Ministër i Brendshëm



VENDIM
Nr. 304, datë 11.5.2022

**PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE
PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR
KRIMINALITETIT, PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 103, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 32, të nenit 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2022, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë t’ia përcjellë menjëherë rekomandimet prioritare Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe t’ua bëjë ato të njohura drejtuesve të prokurorisë të të gjitha shkallëve dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në një mbledhje të përbashkët, jo më vonë se 1 (një) muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të ndjekë, në vazhdimësi, mënyrën e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**REKOMANDIME PRIORITARE
NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT
PËR VITIN 2022
TIRANË, PRILL 2022**

Lufta pa kompromis kundër kriminalitetit ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet kyçe të qeverisë shqiptare, e artikuluar në shumë dokumente politike dhe strategjike dhe e materializuar në masa për ashpërsimin e legjislacionit ndëshkues dhe përf forcimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së institucioneve ligjzbatuese. Në këtë kuadër,

Ministria e Drejtësisë, bazuar në detyrimet e ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka përgatitur rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022.

Rekomandimet janë fokusuar në 5 (pesë) drejtime kryesore:

- a) Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit;
- b) Lufta kundër korrupsionit;
- c) Lufta kundër krimit të organizuar;
- ç) Respektimi i të drejtave të njeriut;
- d) Bashkëpunimi ndërinstitucional.

Thelbi i rekomandimeve bazohet në vizionin, politikat, prioritetet dhe objektivat e programit qeverisës 2021-2025⁴⁰; Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe të planit të saj të veprimit⁴¹; Planit Kombëtar për Integrimin European 2021-2023⁴²; Rekomandimet e progresraportit për Shqipërinë të Komisionit Evropian për vitin 2021; Planit të veprimit 2015-2023 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit⁴³; Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe planit të veprimit 2021-2022⁴⁴; raportet e organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë joqeveritarë⁴⁵ lidhur me monitorimet për çështjet e

⁴⁰ Publikuar në faqen zyrtare:

https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverisës_2021-2025.pdf

⁴¹ Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 823 datë 24.12.2021, Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 205, datë 30.12.2021.

⁴² Plan i Kombëtar për Integrimin Evropian nuk është miratuar ende nga Këshilli i Ministrave, pasi është në fazën e projektvendimit.

⁴³ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 1.7.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 7.7.2020.

⁴⁴ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1140, datë 24.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, datë 12.1.2021.

⁴⁵ Progres Raporti për Shqipërinë i Komisionit Evropian i vitit 2021, publikuar në “Report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2020 Communication on EU Enlargement Policy”
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en; Indeksi vjetor i



korupsionit, krimit të organizuar dhe trafikut të lëndëve narkotike, si dhe dokumente të tjera më rëndësi strategjike. Gjithashtu, pjesë e përmbajtjes së rekomandimeve janë edhe masat e propozuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes si dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të cilat kanë në përbërje të tyre personel me funksionet e policisë gjyqësore. Rekomandimet janë mbështetur në analizën e të dhënave statistikore të dërguara nga organi i prokurorisë, kjo me qëllim evidentimin e trend-eve si në llojin dhe formën e veprimtarive kriminale ashtu edhe në numër pjesëmarrjeje në to, përgjatë vitit 2021⁴⁶.

korupsionit i Transparency International, Corruption perception Index 2021, publikuar në faqen zyrtare: <https://www.transparency.org/en/cpi/2021/index/nzl>; World Justice project “Indeksi i sundimit të ligjit 2021, raport vjetor, përgatitur nga një grup ekspertësh vendas dhe të huaj, ka paraqitur të dhënat e administruara nga perspektiva e publikut të zakonshëm në lidhje me zbatimin e ligjit. Publikuar në faqen web: <https://worldjusticeproject.org/our-work/wjp-rule-law-index/wjp-rule-law-index-2021>.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit- International Narcotics Control Strategy Report Volume 1- Drug and Chemical Control, publikuar në 1 mars 2022 në faqen zyrtare: [2022 INCSR Vol 1 Final for Printing-Rev. 2-24 1.35pm \(state.gov\)](https://www.state.gov/2022-INCSR-Vol-1-Final-for-Printing-Rev-2-24-1.35pm) dhe Volume 2- Money Laundering and Financial Crimes, publikuar në 1 mars 2022 në faqen zyrtare [2022 INCSR-Volume II: Money Laundering \(As submitted to Congress\) - United States Department of State](https://www.state.gov/2022-INCSR-Volume-II-Money-Laundering-As-submitted-to-Congress)

⁴⁶Ministria e Drejtësisë ka kërkuar me shkresën nr. 114/2 prot., datë 31.1.2022 kontribut nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes si dhe Ministria e Mjedisit. Ministria e Brendshme ka përcjellë kontribut në rrugë elektronike me shkresën e tyre nr. 1096/3 prot., datë 6.4.2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka përcjellë kontribut me shkresat nr. 1281/1 prot., datë 11.2.2022, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 114/4 prot., datë 14.2.2022 dhe shkresën nr. 112 prot., datë 9.2.2022, protokolluar me nr. 114/3 prot., datë 10.2.2022 të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve; Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcjellë kontribut me shkresat nr. 1895/1 prot., datë 11.2.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 114/5 prot., datë 14.2.2022, dhe shkresën nr. 1895/2 prot., datë 17.2.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 114/6 prot., datë 18.2.2022, Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 566/5 prot., datë 24.2.2022, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1207 prot., datë 24.2.2022. Gjithashtu me shkresën nr. 114/1 prot., datë 31.1.2022 ka kërkuar Faqe| 9464

Po kështu, vijimësisht është ndjekur nga Ministria e Drejtësisë implementimi i rekomandimeve të dhëna për vitin 2021, duke analizuar dhe vlerësuar përmbushjen e tyre, ndërsa problematikat e evidentuara kanë shërbyer si bazë për të adresuar rekomandime konkrete për vitin 2022.⁴⁷

Duhet theksuar se tashmë ndjekja penale ka marrë dimensione të reja, pasi ka filluar funksionimin e saj Byroja Kombëtare e Hetimit, procesi i rivlerësimit kalimtar të prokurorëve (*vetting*) ka dhënë efektin e pritshëm në ndryshimin e besimit të publikut te drejtësia, ka ndryshuar qasja e bashkëpunimit dhe ndërveprimit institucional brenda dhe jashtë vendit drejt forcimit e intensifikimit, duke sjellë, për rrjedhojë, rezultate të prekshme dhe të ndjeshme në konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Rekomandimet prioritare që Këshilli i Ministrave adreson për t'u ndjekur nga organi i prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022 janë:

1. Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit

Roli i prokurorit në procedurën penale përbën faktor të rëndësishëm në përmbushjen me sukses të politikave penale të shtetit të së drejtës dhe në forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Rekomandimi për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit bazohet në forcimin e elementeve të tilla, si profesionalizmi, përgjegjshmëria, integriteti dhe besimi. Strukturat, mekanizmat dhe rregullat materiale dhe procedurale në organizimin dhe funksionimin e prokurorisë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin dhe konsolidimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit. Funksionimi me kapacitet të plotë dhe me efektshmëri i institucioneve të reja ligjzbatuese të drejtësisë

statistikat për vitin 2021 nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme (SPAK).

⁴⁷Ministria e Drejtësisë me shkresat e saj nr. 3249/1 prot., datë 5.11.2021 dhe nr. 114 prot., datë 11.1.2022 i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të Rekomandimeve për vitin 2021. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar me shkresat e saj nr. 942/24, datë 6.1.2022 protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 3249/2 prot., datë 7.1.2022 dhe shkresën nr. 942/44 prot., datë 2.3.2022, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1207/1 prot., datë 3.3.2022.



krijonë premisa të sigurta për suksesin e hetimit dhe ndjekjes penale.

Prokurori i Përgjithshëm luan rol kyç në garantimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë së prokurorisë dhe në sigurimin e pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit në marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit të detyrës. Në kuadër të reformës në drejtësi është ngritur një arkitekturë e re gjithëpërfshirëse institucionale për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e quajtur Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) e përbërë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁴⁸ dhe Byroja Kombëtare e Hetimit⁴⁹ për hetimin e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Veprat penale të cilat përfshihen në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme (SPAK), të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe legjislacioni i posaçëm⁵⁰, janë vepra penale me një rëndësi të veçantë, për shkak të kategorisë së veprës penale ose/dhe subjektit nga i cili ato kryhen⁵¹.

⁴⁸ Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka 17 prokurorë të caktuar në mënyrë të përhershme. Ligji ka përcaktuar një numër prej 15 prokurorësh. Por me vendimin e Kuvendit nr. 6/2021 “Për përcaktimin e numrit të Prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme” është miratuar kërkesa e iniciuar nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për rritjen e numrit të prokurorëve nga 15 në 20 prokurorë.

⁴⁹ Byroja Kombëtare e Hetimit më datë 8.9.2020 ka shpallur thirrjen për përzgjedhjen e 60 hetuesve të BKH-së dhe pasi kanë kaluar të gjitha fazat e përzgjedhjes janë emëruar në detyrë më datë 7.5.2021, 32 hetues të BKH-së. Procesi po vijon për plotësimin e 28 pozicioneve si hetues të paplotësuar.

⁵⁰ Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

⁵¹ Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale: *Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafi 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal;*

b) çdo veprë penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë,

Gjatë vitit 2021 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁵², ka pasur një rol mjaft aktiv. Institucioni ka ardhur duke u konsoliduar në mënyrë të vazhdueshme dhe duke dhënë rezultate konkrete, të dukshme në ushtrimin e ndjekjes penale kundër korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, abuzimit me fondet publike dhe hetimeve pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale. Janë marrë masat për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, për shtimin e hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit në mënyrë që të rritet efektiviteti i ushtrimit të ndjekjes penale, duke garantuar dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në kuadër të ushtrimit me efektivitet të ndjekjes penale brenda kompetencave ka forcuar bashkëpunimin me Prokurorinë e Përgjithshme dhe institucionet e tjera ligjzbatuese brenda vendit: Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, ky institucion ka forcuar bashkëpunimin me autoritetet e huaja në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe terrorizmit, si dhe me organizmat ndërkombëtarë, si EUROJUST dhe EUROPOL, si rezultat i të cilave janë regjistruar procedime, janë kryer hetime dhe aksione të përbashkëta kundër aktivitetit kriminal të organizuar dhe me shtrirje ndërkombëtare.

Konkretisht, për periudhën e vitit 2021 rezulton se⁵³ nga organi i Prokurorisë së Posaçme janë paraqitur të dhëna statistikore në lidhje me veprat

Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

⁵² Referuar Raportit Vjetor për vitin 2021 mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

⁵³ Raporti Vjetor 2021 mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.



penale që ka në kompetencë lëndore, ku janë hetuar gjithsej 715⁵⁴ procedime penale, nga të cilat 352 procedime penale janë mbartur nga viti 2020, ndërsa 363 procedime penale janë regjistruar nga Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2021 si procedime penale të reja. Nga 363 procedime penale të reja të filluara në vitin 2021, 70 procedime penale janë dërguar për kompetencë nga prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe 18 procedime penale janë regjistruar kryesisht nga Prokuroria e Posaçme. Për 40 procedime penale është vendosur bashkimi i çështjes, duke shkuar në 675 procedime penale, me 519 persona nën hetim. Krahasuar me të dhënat e pasqyruara në raportin e vitit 2020, rezulton një rritje e numrit të procedimeve të hetuara me 127 procedime më tepër, por vihet re një ulje e lehtë e numrit të personave nën hetim me 227⁵⁵ persona më pak, ndërsa numri i procedimeve të regjistruara kryesisht vijon të mbetet në të njëjtat shifra, rreth 2,5% e totalit të procedimeve të hetuara.

Në lidhje me rekomandimin për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit, nga të dhënat e përcjella nga organi i prokurorisë⁵⁶ lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2021 në zbatim të Rezolutës së Kuvendit datë 14.6.2021, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë një sërë udhëzimesh për zbatim nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Konkretisht, janë miratuar: udhëzimi nr.4, datë 9.7.2021, “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe urdhri nr.79, datë 9.7.2021, “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”.

Gjithashtu, me synimin për të garantuar pavarësinë e prokurorit, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr.10, datë 30.12.2021, “Për ushtrimin e funksionimit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe

bashkërendimi me institucionet kushtetuese e ligjore”, në bashkëpunim me ekspertët e EURALIUS V; urdhrin nr.61, datë 2.6.2021, në zbatim të të cilit ka ngritur grupe pune për inspektimin e veprimtarisë administrative dhe procedurale të oficerëve të policisë gjyqësore në prokurorinë e një rrethi gjyqësor; si dhe urdhrin nr.92, datë 30.7.2021, “Për përdorimin e regjistrat elektronik dhe përfitimin e statistikave për çështje të pastrimit të parave në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”, për implementimin e sistemit elektronik e-tracking PRESTO, i përgatitur me mbështetjen e projektit Euralius V.

Këto akte nënligjore, të publikuara në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, u janë shpërndarë të gjithë prokurorëve, si dhe janë udhëzuar drejtuesit e prokurorive që në zbatim të kompetencave të tyre ligjore të marrin masa me qëllim garantimin e pavarësisë së prokurorit në ushtrimin e funksionit dhe për të siguruar efikasitetin, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorive të cilat drejtojnë.

Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të forcimit të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit, me synim rritjen e bashkëpunimit me institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me nr.248, datë 5.2.2021, “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magistratëve/prokurorëve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”. Në kuadrin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, Prokuroria e Përgjithshme ka informuar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë se përgjatë vitit 2020 dhe në vijim ka evidentuar disa problematika për të cilat ka kërkuar kryerjen e inspektimeve tematike në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër dhe Vlorë. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka evidentuar tri raste shkeljesh individuale të konstatuara nga prokurorë (në një rast drejtues) të cilat i janë dërguar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për iniciim të procesit të hetimit/inspektimit.

Gjatë vitit 2021⁵⁷ Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka pasur

⁵⁴ Për vitin 2020 kanë qenë regjistruar 588 procedime penale, ku 384 procedime kanë qenë të regjistruara nga vetë Prokuroria e Posaçme dhe nga ku 18 kanë qenë regjistruar kryesisht.

⁵⁵ Për vitin 2020 kanë qenë 746 persona nën hetim.

⁵⁶ Me shkresat e tyre nr. 942/44 prot., datë 2.3.2022 dhe nr. 942/43 prot., datë 2.3.2022 protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1207/1 prot., datë 3.3.2022 dhe nr. 1341 prot., datë 3.3.2022.

Faqe | 9466

⁵⁷ Referuar Raportit Vjetor për vitin 2021 të veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.



një bashkëpunim mjaft efektiv me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Ky bashkëpunim ka konsistuar në ndihmën që u jep Prokuroria e Posaçme këtyre institucioneve nëpërmjet dhënies në kohë reale të informacioneve të kërkuara e që lidhen me verifikimin e subjekteve për të cilat kryhen verifikime për shkelje të natyrës disiplinore.

Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të rritjes së rolit aktiv të prokurorit, ka normuar masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake dhe kryerjen e hetimeve proaktive nëpërmjet udhëzimit nr.4, datë 9.7.2021, të lartpërmendur, ku si rezultat në vitin 2021 është rritur numri i hetimeve proaktive dhe me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në kuadrin e 655 procedimeve penale, e cila rezulton me një rritje prej 3.9% të numrit të procedimeve proaktive, proces i finalizuar me arrestimin në flagrancë/ndalimin e 640 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorëve pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka planifikuar për të ardhmen përgatitjen e një projektudhëzimi të përgjithshëm “Për rritjen e rolit të prokurorisë në fillimin e hetimit kryesisht dhe hetimin penal proaktiv”, si dhe rritjen e eficiencës në bashkërendimin, koordinimin dhe monitorimin sipas ligjit me agjencitë ligjzbatuese përkatëse, me qëllim rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimeve të rënda e sensitive nëpërmjet hetimeve kriminale dhe financiare proaktive dhe të bazuara në inteligjencë.

Me qëllim rritjen e efektivitetit dhe të llogaridhënies së strukturave të policisë gjyqësore janë nxjerrë akte nënligjore nga Prokurori i Përgjithshëm dhe akte të përbashkëta me institucionet e tjera. Në udhëzimin e përgjithshëm nr. 4/2021 të sipërpërmendur janë normuar masa administrative dhe procedurale për nxitjen e rolit aktiv të prokurorëve dhe drejtuesve për ushtrimin e kontrollit efektiv të prokurorit, si dhe të rolit të prokurorëve për ushtrimin sistematik të kontrollit të oficerëve të Policisë Gjyqësore në ecurinë e hetimit të procedimeve lidhur me ligjshmërinë, objektivitetin, plotshmërinë dhe respektimin e afateve procedurale dhe vlefshmërinë e akteve.

Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr. 61, datë 2.6.2021 të sipërpërmendur ka ngritur grupe pune për inspektimin e veprimtarisë administrative

dhe procedurale të oficerëve të policisë gjyqësore në prokurorinë e një rrethi gjyqësor. Grupi i punës i Prokurorisë së Përgjithshme, në bashkëpunim me ekspertët e projektit EURALIUS V, kanë përgatitur udhëzimin e përgjithshëm, të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, me nr. 10, datë 30.12.2021, “Për ushtrimin e funksionimit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimi me institucionet kushtetuese e ligjore”, i cili synon unifikimin e mënyrës së ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse/verifikuese nga strukturat/autoritetet e monitorimit në sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, iniciimin e inspektimeve tematike individuale të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve policore, në bashkëpunim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Komisionin e Policisë Gjyqësore.

Për shkeljet disiplinore të oficerëve të policisë gjyqësore, Prokurori i Përgjithshëm i është drejtuar Komisionit të Policisë Gjyqësore për 4 raste, e konkretisht:

i. mbi bazën e një akti kontrolli të realizuar në seksionin e policisë gjyqësore pranë një prokurorie të rrethit gjyqësor, është propozuar fillimi i hetimeve disiplinore për dy oficerë të policisë gjyqësore;

ii. mbi rekomandimin e Avokatit të Popullit, pas verifikimeve të kryera, është propozuar fillimi i hetimeve për një oficer policie gjyqësore pranë komisarariatit të policisë për shkelje procedurale;

iii. është propozuar fillimi i hetimit për shkelje disiplinore për dy oficerë të seksionit të policisë gjyqësore pranë një prokurorie;

iv. për një oficer të policisë gjyqësore pranë një prokurorie rrethi gjyqësor, ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit arrest në burg si i dyshuar për kryerjen e një veprë penale, është kërkuar pezullimi nga detyra.

Në lidhje me strukturat e policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Posaçme (SPAK), nga të dhënat e pasqyruara në raportin e vitit 2021 rezulton se:

- Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), përgjatë vitit 2021 shpalli njoftimin për konkursin për hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit, për 32 (tridhjetë e dy) vende vakante për hetues, në mbështetje të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe



krimin e organizuar”, në të cilin aplikuan 572 aplikantë.

- Në përfundim të këtij procesi, i cili u bë i mundur në sajë të mbështetjes së Komisionit Ndërkombëtar të Rishikimit, i përbërë nga ekspertë të caktuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë, u arritën të kualifikoheshin dhe të përzgjidheshin 32 (tridhjetë e dy) kandidatë për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Këta kandidatë iu nënshtruan kontrollit të figurës dhe pasurisë nga Komisioni i Vettingut, i përbërë nga dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe një gjyqtar i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë dhe i janë nënshtruar trajnimit.

Në kuadër të garantimit të paanshmërisë dhe shmangies nga çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve në zbatim të urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 164, datë 18.12.2020, “Për miratimin e rregullores standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm”, hyrë në fuqi më 1 janar 2021, drejtuesit e prokurorive përkatëse kanë miratuar rregulloret standard për organizimin dhe funksionimin e prokurorive që drejtojnë, me synimin për të siguruar eficientë dhe efikasitetin në veprimtarinë administrative dhe për të siguruar efikasitet në organizimin, drejtimin, koordinimin, mbikëqyrjen/monitorimin e punës në çdo prokurori, duke garantuar paanshmërinë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme, në bashkëpunim me projektin EURALIUS V, ka përgatitur projektudhëzimin e përgjithshëm “Për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit” me synim unifikimin e qëndrimeve dhe sjelljeve ligjore të prokurorit për shmangien e çdo paanshmërie, papajtueshmërie ose konflikti i interesit në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Prokuroria e Përgjithshme, rekomandimin mbi marrjen e masave për rritjen e kapaciteteve profesionale e ka trajtuar me prioritet si në aktet nënligjore të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm, po ashtu dhe nëpërmjet bashkërendimit me Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës dhe me misionet/projektet ndërkombëtare që asistojnë

në fushën e drejtësisë penale. Në kuadrin e trajnimit vazhdues të magjistratëve, përgjatë vitit 2021 në Shkollën e Magjistraturës janë organizuar dhe zhvilluar 76 aktivitete ku kanë marrë pjesë 563 prokurorë. Prokuroria e Përgjithshme, në bashkëpunim me PAMECA V, në janar 2021 ka organizuar trajnime të përbashkëta, në dy module “Mbi pastrimin e parave dhe hetimin financiar e pasuror” dhe “Mbi veprat penale që lidhen me detyrën” ku kanë marrë pjesë prokurorë të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve, përfshirë edhe agjencitë e zbatimit të ligjit (Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave, Kontrolli i Lartë i Shtetit) gjithsej 148 persona.

Lidhur me rekomandimin për mirëfunksionimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në prokurori (sistemi CAMS), Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar punën e nisur nga grupi i punës me mbështetjen e projektit EURALIUS V, për identifikimin e problemeve në sistemin e menaxhimit të çështjeve (CAMS) i cili nuk është funksional, si dhe janë hedhur hapat e parë për një sistem të integruar të menaxhimit të çështjeve, proces që drejtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar bashkëpunimin me ekspertët e projektit EURALIUS V, me qëllim përmirësimin dhe funksionimin e sistemit statistikor, sistemit të analizës dhe digjitalizimit të regjistrave në prokurori. Në pamundësi për të vënë në funksion sistemin CAMS, i cili nuk është më funksional, si dhe në zbatim të planit të veprimit ICRG/FATF-Shqipëri, Prokuroria e Përgjithshme, me mbështetjen e projektit EURALIUS V, ka vijuar punën për hartimin e një programi statistikor, duke përgatitur sistemin elektronik e-tracking PRESTO, për implementimin e të cilit Prokurori i Përgjithshëm nxorri urdhrin nr.92, datë 30.7.2021, “Për përdorimin e regjistrat elektronik dhe përfitimin e statistikave për çështje të pastrimit të parave në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”. Në kushtet kur programi EURALIUS V është drejt përfundimit, programi PRESTO do mbetet pa realizuar, pasi zhvillimi i mëtejshëm i këtij programi kërkon



angazhime dhe negociata të mëtejshme në të ardhmen. Gjithashtu, në kushtet kur pranë Ministrisë së Drejtësisë është ngritur një sistem i centralizuar i marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe vendase, i quajtur M-File, Prokuroria e Përgjithshme i ka dhënë akses të drejtpërdrejtë dy përdoruesve të saj në këtë sistem si një zgjidhje e përkohshme, deri në përmirësimin e sistemit të saj IMPRO, proces për të cilin po punon, me qëllim realizimin e ndërlidhjes ndërmjet dy sistemeve M-File dhe IMPRO.

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, referuar raportit vjetor për vitin 2021 shprehet se si institucion i pavarur nga Prokuroria e Përgjithshme nuk është pjesë e “sistemit të menaxhimit të çështjeve” (CAMS), por gjatë vitit 2021 është punuar dhe vazhdohet të punohet për një sistem që do të shërbejë në funksion të menaxhimit të çështjeve të Prokurorisë së Posaçme.

Ndërsa në kuadër të rekomandimit për marrjen e masave për zbatimin e dispozitave të reja të Kodit Penal në praktikë, lidhur me situatën e pandemisë së COVID-19 dhe dhunën në familje, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është kërkuar bashkëpunimi i prokurorëve bazuar në problematika dhe mangësitë evidentuara në praktikën e veprimtarisë së tyre, me qëllim vlerësimin e temave dhe përfshirjen në kalendarin e trajnimeve. Pas sugjerimeve të temave përkatëse nga prokurorët, temat që duhen përfshirë në kalendarin e trajnimit vazhdues i janë dërguar Shkollës së Magjistraturës.

Gjatë vitit 2021⁵⁸, në kuadër të rritjes së kapaciteteve profesionale, janë zhvilluar një sërë trajnimesh për prokurorët dhe hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme, Shkollën e Magjistraturës dhe mbështetjen e institucioneve dhe agjencive ndërkombëtare, si Euralius, PAMECA V, OKB, UNODC, IOM, Projekti EU4FOCAL i Bashkimit Evropian, Drejtorinë Hetimore Antimafia (DIA), projektin italian CSMAICS, Qendrën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, si dhe janë zhvilluar një sërë aktiviteteve të përbashkëta trajnuese në kuadër të

veprave penale në kompetencë lëndore si: korrupsioni, krimi i organizuar dhe financiar, trafikimi, terrorizmi, si dhe aspekte të ndryshme të lidhura me hetimin e këtyre veprave. Konkretisht:

- Aktivitete të zhvilluara nga misioni OPDAT dhe Programi Ndërkombëtar i Ndihmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal (ICITAP) për përzgjedhjen dhe trajnimin e kandidatëve të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

- Aktivitete të zhvilluara nga misioni PAMECA si on-line dhe në vizita studimore në Romë, Itali, ku kanë marrë pjesë 27 oficerë të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe 3 prokurorë.

- Vizitë e organizuar nga Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar, Mbretëria e Holandës në tetor 2021, të një delegacioni shqiptar nga Prokuroria e Posaçme (SPAK) dhe Prokuroria e Përgjithshme në Eurojust, për të përfunduar Zyrën e Prokurorit Shqiptar Ndërlidhës pranë këtij institucioni. Në kuadër të këtij projekti është nënshkrimi i marrëveshjes trepalëshe për dhënie të së drejtës së qasjes në sistemin elektronik “SIENA - Aplikim i sigurt i rrjetit të shkëmbimit të informacionit”, “EUROPOL”, midis Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Sa më sipër, pavarësisht arritjeve pozitive dhe adresimit të sfidave në vlerësim të prioriteteve të BE-së, politikave në fushën e së drejtës, me qëllim garantimin e pavarësisë së prokurorit, **Këshilli i Ministrave rekomandon:**

1. Vijimin e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, rekomandim, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve, të filluara kryesisht;

2. Vijimin e nxitjes së prokurorëve që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e oficerëve të Policisë Gjyqësore, si dhe evidentimin e rasteve që duhen proceduar në rrugë disiplinore për shkak të zvarritjeve dhe mungesës së dilijencës në përmbytjen e detyrave që u ngarkon ligji;

3. Marrjen e masave për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdolloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve; si dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit;

4. Marrjen e masave për rritjen profesionale dhe organizimin e trajnimeve kryesisht për oficerët e policisë gjyqësore, si dhe vijimin e trajnimeve të

⁵⁸ Referuar Raportit Vjetor për vitin 2021 të veprimtarisë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.



prokurorëve në fusha specifike, sipas ndarjes së tyre në seksione brenda prokurorisë, dhe në kuadër të politikave penale;

5. Marrjen e masave me qëllim rishikimin dhe mirëfunksionimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), për sa i përket mënyrës së disponimit për çështje konkrete, gjykimet e posaçme, pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin cams në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrollin e vazhdueshëm mbi hedhjen dhe administrimin e këtyre të dhënave.

Lufta kundër korrupsionit

Pa dyshim që fokusi bazë i çdo vizioni strategjik dhe politik është një drejtësi me integritet, e pakorruptuar dhe e vlerësuar. Për këtë qëllim edhe rekomandimet në luftën kundër korrupsionit synojnë konsolidimin, përmirësimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave ligjzbatuese si Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, Byroja Kombëtare e Hetimit, si dhe agjencitë e tjera të specializuara ligjzbatuese, me qëllim identifikimin, evidentimin dhe ndjekjen deri në ndëshkim të fenomeneve të korrupsionit, veçanërisht ndaj punonjësve të institucioneve shtetërore që detyrimin parësor kanë shërbimin cilësor dhe me profesionalizëm ndaj qytetarit.

Këshilli i Ministrave, vitet e fundit ashtu si dhe gjatë vitit 2021, ka rritur fokusin e saj në luftën kundër korrupsionit dhe ka ndërmarrë një sërë masash në lidhje me luftimin e aktiviteteve korruptive në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Antikorrupsion 2015-2023⁵⁹. Në kuadër të kësaj strategjie, me vendimin nr. 606, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe

luftën kundër korrupsionit.⁶⁰ Me vendimin nr. 618, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, ndryshoi nga pikëpamja e organizimit dhe funksionimit, Rrjeti i Koordinatorëve kundër Korrupsionit. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, u zgjeruan jo vetëm kompetencat dhe fusha e veprimtarisë ku do të veprojnë rrjeti, por u shtuan edhe institucionet në të cilat ky rrjet do të shtrihet. Rrjeti i koordinatorëve në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618/2021 shtrihet në 44 institucione në nivel qendror dhe në çdo drejtori vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe spitalet rajonale, në nivel rajonal (në total 78 koordinatorë). Referuar të dhënave statistikore⁶¹ janë propozuar në total 85 masa administrative⁶², 11 masa administrative me gjobë⁶³ si dhe 12 kallëzime për ndjekje penale⁶⁴.

Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet e pavarura të drejtësisë dhe me mbështetjen e misionit EURALIUS V, hartoi Strategjinë e re

⁶⁰ Miratuar me vendimin nr. 606, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave, miratuar në Fletoren Zyrtare nr. 164, datë 22.10.2021.

⁶¹Të dhënat statistikore për periudhën janar-dhjetor 2021 nga Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion

⁶² përkatësisht: 7 masa administrative për nëpunës të Inspektoratit Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit; 12 masa administrative për nëpunës të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile; 8 masa administrative për nëpunës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; 27 masa administrative për nëpunës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; 8 masa administrative për nëpunës të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; 1 masë administrative për nëpunës të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore; 3 masa administrative për nëpunës të Agjencisë Kombëtare të Ushqimit; 19 masa administrative për nëpunës të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

⁶³ 7 masa administrative gjobë për nëpunës të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit; 4 masa administrative gjobë për Agjencitë Doganore.

⁶⁴ 8 kallëzime për ndjekje penale për punonjës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; 1 kallëzim për ndjekje penale për punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; 1 kallëzim për ndjekje penale për Drejtorinë së Përgjithshme të Doganave; 1 kallëzim për ndjekje penale për Agjencinë Kombëtare të Ushqimit. 1 kallëzim për ndjekje penale për agjenci doganore.

⁵⁹ Miratuar me vendimin nr. 516, datë 1.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.3.2015 të Këshillit të Ministrave «Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020» dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 të Pasaportës së Indikatorëve», botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 7.7.2020.



Ndërsektorale të Drejtësisë 2021-2025 (SND 2021-2025), miratuar me vendimin nr.823, datë 24.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë 2021–2025 dhe planit të veprimit”. Prokuroria e Përgjithshme është një nga institucionet e përfshira në këtë strategji me masa dhe tregues rezultati të matshëm, me qëllim rritjen e cilësisë dhe efektshmërisë në hetimin dhe ushtrimin e suksesshëm në ndjekjen penale të kriminalitetit dhe prioritetëve në luftën kundër tij.

Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me të gjitha institucionet publike të përfshira në strategjinë kundër korrupsionit dhe me asistencën teknike të Bashkimit Evropian ka hartuar planin e veprimit për periudhën 2019-2023⁶⁵. Po kështu, në lidhje me zbatimin e planit të veprimit kundër korrupsionit 2020-2023, është hartuar Raporti Vjetor i Monitorimit për vitin 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektorale kundër Korrupsionit 2015-2023, i cili është miratuar me vendimin nr.7, datë 13.4.2022, të ministrit të Drejtësisë, ku ka rezultuar se: Prokuroria e Përgjithshme është institucion i përfshirë, përgjegjës dhe zbatues i Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023, në pjesën e objektivave të lidhur me kompetencën e këtij institucioni: “Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit”; “Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit”; “Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar”; si dhe “Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit”.

Duhet theksuar që roli dhe përfshirja e Prokurorisë së Përgjithshme në këtë strategji ka ardhur duke u kufizuar që prej ngritjes dhe funksionimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), duke qenë se lufta dhe ndëshkimi i krimit të korrupsionit është tashmë nën përgjegjësinë e këtij institucioni.

Pavarësisht këtij ndryshimi të kompetencës hetimore, plani i veprimit në zbatim të Strategjisë, për vitin 2021, ka të parashikuara disa masa për zbatim nga Prokuroria e Përgjithshme, lidhur me bashkëpunimin institucional dhe operativ midis prokurorëve të juridiksionit të zakonshëm dhe Prokurorisë së Posaçme (SPAK) në fushën e krimit të korrupsionit, ngritja e skuadrave të përbashkëta hetimore, aksesit në bazat e të dhënave në përdorim të autoriteteve shtetërore, vëmendje e shtuar në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, bashkëpunimin në ngritjen dhe konsolidimin e Zyrës së Rekuperimit të Aseteve, si dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve.

Referuar monitorimit dhe vlerësimit të progresit të bërë për zbatimin e angazhimeve në këtë plan veprimi të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023, për vitin 2021, rezulton ndër të tjera se:

-Janë krijuar seksionet e posaçme për hetimin e pastrimit të parave dhe krimit ekonomik në 7 prokurori të juridiksionit të përgjithshëm me përbërje drejtues seksioni dhe prokurorë dhe në 15 prokuroritë e tjera u caktua një prokuror për ndjekjen e këtyre çështjeve. Janë, gjithsej, 41 prokurorë të ngarkuar me ndjekjen penale të pastrimit të parave dhe krimit ekonomik.

-Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve “Për dhënien e së drejtës së aksesit prokurorisë në bazën e të dhënave të menaxhimit të informacionit të sistemit penitenciar”. Kjo databazë është e aksesueshme tashmë nga prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore.

Nga raportimet e institucioneve ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit, rezulton se:

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, i publikuar në mars 2022, “Volumi 1-Kontrolli i narkotikëve dhe lëndëve kimike”,⁶⁶ dhe “Volumi 2-Pastrimi i parave dhe krimet financiare”⁶⁷, ndër të

⁶⁵Planit i veprimit 2019-2023 është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë: <http://drejtesia.gov.al/newsroom/njoftime/ministria-e-drejtesise-koordinatori-kombetar-kunder-korrupsionit-perfundoj-procesin-e-rishikimit-te-planit-te-veprimit-2019-2023-ne-zbatim-te-strategjise-ndersektorale-kunder-korrupsionit/>

⁶⁶ 2022 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 1 drug and Chemical Control, publikuar në datën 1 mars 2022 në faqen [2022 INCSR Vol 1 Final for Printing-Rev. 2-24 1.35pm \(state.gov\)](https://www.incsr.org/2022/03/01/2022-INCSR-Vol-1-Final-for-Printing-Rev-2-24-1-35pm-state.gov)

⁶⁷2022 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 2 Money Laundering and financial crimes, publikuar në datën 1 mars 2022 në faqen zyrtare: [2022 INCSR Vol 2 Final for Printing-Rev. 2-24 1.35pm \(state.gov\)](https://www.incsr.org/2022/03/01/2022-INCSR-Vol-2-Final-for-Printing-Rev-2-24-1-35pm-state.gov)



tjera, përmend se: “Qeveria e Shqipërisë ka bërë progres drejt pengimit të pastrimit të parave në vitin 2021, por megjithatë mbetet shumë më tepër për të bërë. Shqipëria mbetet e pambrojtur ndaj pastrimit të parave për shkak të korrupsionit, pranisë së rrjeteve të krimit të organizuar, boshllëqeve në legjislacion dhe mbikëqyrjes. Shqipëria vazhdon të përdorë ligjin e saj të konfiskimit antimafia për të kapur kompanitë e lidhura me trafikun e drogës dhe korrupsionin.

Reformat e vazhdueshme gjyqësore kanë përmirësuar perspektivat e Shqipërisë për trajtimin e pastrimit të parave. Megjithatë, këto përpjekje ende pengohen nga sfidat e kapaciteteve, mbikëqyrja e pamjaftueshme e sektorëve të caktuar dhe nevoja për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit dhe atyre mbikëqyrëse. Krimet kryesore që gjenerojnë të ardhura në Shqipëri përfshijnë trafikun e drogës dhe njerëzve, evazionin fiskal dhe kontrabandën e mallrave dhe njerëzve. Vendndodhja e Shqipërisë në Evropë dhe prania e rrjeteve shqiptare në krimin e organizuar në Evropën Perëndimore dhe Amerikën e Jugut rrisin dobësitë. Legjislacioni i Shqipërisë kundër pasurimit të paligjshëm i jep Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Policisë së Shtetit Shqiptar autoritet për sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve dhe kufizon aktivitetin ekonomik dhe lëvizjen e lirë të kriminelëve. Shqipëria duhet të zbatojë në mënyrë efektive ligjet ekzistuese, të ushtrijë funksione efektive mbikëqyrëse, të përmirësojë bashkëpunimin mbikëqyrës dhe ligjzbatues dhe të vazhdojë të zhvillojë kapacitetet e policisë dhe prokurorëve të saj për t’u fokusuar në korrupsionin, pastrimin e parave dhe krimet ekonomike.

Progresraporti për Shqipërinë 2021⁶⁸ për luftën kundër korrupsionit konstaton se: Shqipëria ka bërë njëfarë progresi në forcimin e luftës kundër korrupsionit. Zbatimi i Strategjisë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit në përgjithësi është në rrugën e duhur. Vettingu i anëtarëve të drejtësisë po sjell rezultate në luftën kundër korrupsionit. Task- Forca kundër Korrupsionit gjatë vitit të kaluar ka qenë më pak efektive dhe duhet të riaktivizohet. Përpjekjet dhe vullneti politik duhet të rriten në drejtim të konsolidimit të historikut të sekuestrimit dhe konfiskimit të asetëve kriminale, si dhe krijimit të një historie solide në luftën kundër korrupsionit. Struktura e Posaçme Kundër

Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) kontribuoi në përmirësimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të asetëve kriminale në rastet e lidhura me korrupsionin. Strukturat e specializuara kundër korrupsionit (SPAK dhe Gjykatat Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar) duhet të forcojnë ndjeshëm kapacitetin e përgjithshëm të vendit për të hetuar dhe ndjekur penalisht korrupsionin. Dënimet në rastet që përfshijnë zyrtarë të nivelit të lartë mbeten të kufizuara, duke nxitur ende një kulturë të mosndëshkimit brenda niveleve më të larta të shtetit. Në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit dhe mbetet një çështje shqetësuese serioze.

Sipas indeksit të perceptimit të korrupsionit të Transparency International për vitin 2021⁶⁹, Shqipëria ka pësuar një rritje në renditjen e shteteve për sa i përket korrupsionit në sektorin publik, duke u rankuar në vendin e 110, nga vendi i 104 që ka qenë në vitin 2020.

Lidhur me problemin e korrupsionit të sistemit gjyqësor, ai vazhdon të perceptohet se është i lartë. Sipas dokumentit “Indeksi i sundimit të ligjit 2021 i World Justice Project⁷⁰, i cili paraqet një pasqyrë të sundimit të ligjit në 139 vende duke dhënë rezultatet dhe renditjen sipas vlerësimit nga 0 në 1. Në lidhje me vlerësimin sipas secilit faktor, për faktorin sistemi i drejtësisë penale, si një aspekt thelbësor për sundimin e ligjit, i cili përfshin të gjithë sistemin penal, Shqipëria është vlerësuar me 0.31 duke u renditur në vendin e 123-të në listë. Në lidhje me faktorin e dytë të vlerësimit - matja e mungesës së korrupsionit, Shqipëria ka një vlerësim prej 0.3 dhe renditet në vendin e 127-të dhe në lidhje me nënkriteret për këtë faktor rezultojnë një vlerësim mjaft i ulët 0.42 për mungesën e korrupsionit në gjyqësor”.

Raporti i Moneyval për vitin 2021⁷¹ në lidhje me pastrimin e parave konstaton se: Shqipëria nuk ka përmirësuar ndjeshëm masat për të luftuar pastrimin e

⁶⁹Publikuar në faqen zyrtare të Transparency International:

https://www.transparency.org/whatwedo/publication/corruption_perceptions_index_2021.

⁷⁰World Justice project “Indeksi i sundimit të ligjit 2021, raport vjetor, përgatitur nga një grup ekspertësh vendas dhe të huaj, ka paraqitur të dhënat e administruara nga perspektiva e publikut të zakonshëm në lidhje me zbatimin e ligjit. Publikuar në faqen web: <https://worldjusticeproject.org/our-work/wjp-rule-law-index/wjp-rule-law-index-2021>.

⁷¹<https://rm.coe.int/moneyval-2021-2-fur-albania/1680a2982c> “Anti-money laundering and counter-terrorist financing measures” publikuar në maj 2021.



parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me rekomandimet e FATF. Shtigjet e korrupsionit vijnë të mbeten aktive kryesisht si pasojë e mungesës së transparencës në vendimmarrje, si dhe pamundësisë për mbikëqyrje të institucioneve financiare dhe aktivitetit të bizneseve. Iniciativat e ndërmarra nga Shqipëria për të përmbushur rekomandimet e dhëna më herët kanë qenë të kufizuara dhe të pamjaftueshme për të adresuar problematikat e evidentuara.

Raporti i të Drejtave të Njeriut për vitin 2021 për Shqipërinë⁷² është i përbërë në 7 seksione. Ndër të tjera, në lidhje me luftën kundër korrupsionit ky raport parashikon se:

“Çështjet kryesore lidhur me të drejtat e njeriut në Shqipëri gjatë vitit 2021 ishin ‘problemet me pavarësinë e gjyqësorit ndërsa vazhdonte procesi i vetingut; kufizimet e lirisë së shprehjes dhe shtypit; dhe korrupsioni i përhapur në të gjitha degët e qeverisë dhe institucionet lokale’. Mosndëshkimi mbeti problem, megjithëse organi i specializuar antikorrupsion dhe gjykatat kundër korrupsionit bënë përparim të rëndësishëm gjatë vitit në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e zyrtarëve të lartë dhe kriminit të organizuar.

Qeveria nuk e zbatoi në mënyrë efektive legjislacionin që parashikon dënime penale për korrupsion nga zyrtarët publikë dhe ndalon individët me dënime penale të shërbejnë si kryetarë bashkie, deputetë ose në poste qeveritare ose shtetërore. Megjithëse disa agjenci qeveritare hetuan rastet e korrupsionit, burimet e kufizuara, rrjedhjet hetimore, presioni real dhe i perceptuar politik dhe një sistem emërimi i paorganizuar mirë, i penguan hetimet. Ndërsa prokurorët bënë përparim të rëndësishëm në ndjekjen e rasteve të korrupsionit publik të nivelit të ulët dhe të mesëm, shkalla e ndjekjes penale për zyrtarët e rangut të lartë mbeti e ulët.

Organizatat vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në përgjithësi vepronin pa kufizime nga qeveria, duke hetuar dhe publikuar gjetjet e tyre mbi rastet e të drejtave të njeriut. Zyrtarët qeveritarë në përgjithësi ishin bashkëpunues dhe të përgjegjshëm ndaj pikëpamjeve të tyre. Megjithëse Kushtetuta parashikon një gjyqësor të pavarur, presioni politik, frikësimi, korrupsioni dhe burimet e kufizuara e penguan gjyqësorin të funksiononte plotësisht, në mënyrë të pavarur dhe efikase. Seancat gjyqësore ishin përgjithësisht të hapura për publikun, përveç nëse kufizimet e COVID-19 nuk i lejonin gazetarët ose publikun të hynin në ambientet e

gjykatës. Qeveria vazhdoi procesin e monitoruar ndërkombëtarisht për verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për shkarkimin e personave me pasuri të pajustificueshme ose lidhje me krimin e organizuar. Politizimi i emërimeve të kaluara në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese herë pas here kërkoi të minonte pavarësinë dhe integritetin e këtyre institucioneve.

Departamenti nënvizon se edhe korrupsioni në polici vazhdoi të përbënte problem: *Policia nuk e ka zbatuar gjithmonë ligjin në mënyrë të barabartë. Lidhjet personale, politike ose kriminale, infrastruktura e mangët, mungesa e pajisjeve dhe mbikëqyrja e pamjaftueshme shpesh patën pasojë në zbatimin e ligjit.*

Fillimi i funksionimit dhe efektiviteti i Prokurorisë së Posaçme përbën një rol të padiskutueshëm në fushën e ndëshkimit të korrupsionit të zyrtarëve të lartë dhe në gjyqësor, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave me origjinë kriminale, aseteve kriminale apo pasurive të pajustificuara të vëna nga korrupsioni zyrtar, parandalimin e korrupsionit në strukturat shtetërore për rikthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Gjithashtu, krijimi dhe funksionimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit përbën një hallkë të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit, si një njësi e posaçme dhe e specializuar për hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, e cila vepron pranë Prokurorisë së Posaçme.

Në të dhënat e paraqitura, Prokuroria e Përgjithshme përmend vijimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel vendor dhe qendror për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale, për veprat në detyrë, përfshirë dhe veprat në fushën e korrupsionit, me Prokurorinë e Posaçme në zbatim të Aktit të Koordinimit Institucional (nënshkruar datë 15.12.2020) “Për rritjen e efikasitetit nëpërmjet bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstitucionale duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj” si dhe në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe të vitit 2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Kontrollit të Lartë të Shtetit, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave.

⁷² Raporti i të Drejtave të Njeriut për vitin 2021 publikuar në faqen e Departamentit Amerikan të Shtetit në linkun: <https://www.state.gov/reports/2021-country-reports-on-human-rights-practices/albania>



Lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit me ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Penale⁷³ i kanë kaluar Prokurorisë së Posaçme (SPAK) për kompetencë lëndore nenet: 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal, dispozita të cilat më herët kanë qenë në kompetencën e Prokurorisë së Përgjithshme. Gjithashtu, në lidhje me veprat penale në fushën elektorale, nëpërmjet ndryshimeve me ligjin nr.147/2020, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme (SPAK) kanë kaluar përkatësisht nenet 328 “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe 328/b “Korrupsioni pasiv në zgjedhje” të Kodit Penal.

Nga ana tjetër, Prokuroria e Përgjithshme në informacionin e përcjellë parashtron se me ndryshimet e bëra në Kodin Penal me ligjin nr.43/2021, si dhe në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr.41/2021, kompetenca lëndore për veprat penale të parashikuara nga nenet 244/1, 245/1, 245/3, 258/1, 259/1, 259/3 i ka kaluar sërish prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm⁷⁴.

Nga të dhënat e sjella nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)⁷⁵, rezulton se nga ky organ janë hetuar

⁷³Ndryshuar me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

⁷⁴ Referuar të dhënavë statistikore dhe veprave penale të mbetura në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme, pavarësisht faktit që nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është thënë se kompetenca lëndore për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 ka kaluar prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, nga ana jonë referuar edhe veprave penale që në vitin 2020 ishin në kompetencë të prokurorive të juridiksionit të zakonshëm krahasimi është bërë vetëm për 5 veprat penale të mbetura në kompetencë të tyre dhe konkretisht neni 164/a, 164/b, 248, 256, 257/a, 257/b.

⁷⁵ Referuar Raportit Vjetor për vitin 2021 mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

gjithsej 715 procedime penale, nga të cilat 352 procedime penale janë mbartur nga viti 2020, ndërsa 363 procedime penale janë regjistruar nga Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2021 si procedime penale të reja. Nga 363 procedime penale të reja të filluara në vitin 2021, 70 procedime penale janë dërguar për kompetencë nga prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe 18 procedime penale janë regjistruar kryesisht nga Prokuroria e Posaçme. Nga 715 procedime penale të hetuara për vitin 2021, për 40 procedime penale është vendosur bashkimi i çështjes, duke pasur në hetim për këtë periudhë kohore gjithsej 675 procedime penale në hetim, me 519 persona nën hetim. Krahasuar me të dhënat e paraqitura në raportin vjetor të 2020, rezultojnë 21 procedime më pak të regjistruara, 227 persona nën hetim më pak⁷⁶, ndërsa mbetemi në të njëjtat shifra për procedimet penale të regjistruara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

Gjatë vitit 2021 Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ka regjistruar 339⁷⁷ procedime penale në fushën e korrupsionit ose rreth 50.2% e veprave penale të regjistruara i përkasin grupit të veprave në fushën e korrupsionit, shifër kjo që shënon rritje nga viti i kaluar me 101 procedime më tepër. Numrin më të lartë të procedimeve penale të regjistruara e ka neni 258 i Kodit Penal “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” me 90 procedime penale të regjistruara dhe neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”⁷⁸ me 83 procedime penale të regjistruara, ku rezulton një ulje prej 15 procedimesh më pak. Në lidhje me çështjet e regjistruara rezulton se janë dërguar për gjykim 33 çështje, 24 çështje janë pushuar, 9 çështje janë pezulluar, 38 çështje të transferuara dhe 235 çështje rezultojnë të mbetura në hetim. Krahasuar me vitin e kaluar rezultojnë 17 çështje më pak të dërguara për gjykim, 2 çështje më tepër të pushuara, 5 çështje më tepër të pezulluara dhe 10 çështje më tepër të transferuara.

⁷⁶ Për vitin 2020 ishin regjistruar 384 procedim të reja me 746 persona nën hetim.

⁷⁷ Për vitin 2020 ishin regjistruar 238 procedime penale, ose 42.2% e veprave penale.

⁷⁸ Vitin e kaluar kjo vepër ka patur numrin më të lartë të procedimeve me 98 procedime.



Ndërkohë, rezultojnë më tepër çështje të mbetura në hetim krahasur me vjet me 101 çështje më tepër⁷⁹.

Nga 33 çështjet e dërguara për gjykim për vitin 2021⁸⁰, të cilët zënë rreth 9.74% të çështjeve të hetuara në fushën e korrupsionit, rezultojnë se numri i të hetuarve/pandehurve ka qenë 96 persona. Nga këto çështje për 32 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest me burg” (një rritje 4 herë më tepër nga viti 2020), për 16 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” (një më pak se vitin e kaluar) dhe për 6 persona është caktuar masa e sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” (një rënie e ndjeshme me 27 persona më pak se vitin e kaluar). Referuar këtyre të dhënave konstatohet një ashpërsim i politikës penale për këtë kategori veprash⁸¹. Gjithashtu, numrin më të lartë të çështjeve të dërguara për gjykim e ka neni 258 i Kodit Penal “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, me 7 çështje të dërguara për gjykim dhe neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, me 6 çështje të dërguara për gjykim⁸².

Për vitin 2021 rezultojnë se ka përfunduar gjykimi i themelit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 52 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit me një numër prej 136 të pandehurish. Krahasuar me vitin 2020 rezultojnë një rritje e numrit të çështjeve të përfunduara me 32 çështje më tepër dhe një rritje e ndjeshme e numrit të të pandehurve me 107 të pandehur më tepër⁸³. Gjatë vitit 2021 janë përcjellë të dhëna dhe për gjykimet në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vitin 2021 ka përfunduar gjykimi për 22 çështje penale me një numër prej 44 të pandehurish, për veprat penale kundër korrupsionit dhe vepra të tjera

penale (pa përfshirë vepra penale të krimit të organizuar).

Ndërkohë, vijon të mbetet i ulët roli i prokurorisë për sa i përket hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale të korrupsionit, pasi në total për të gjitha veprat penale rezultojnë se janë regjistruar vetëm 18 procedime penale kryesisht nga organi i Prokurorisë së Posaçme. Në vitin 2022, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar rezultojnë të ketë të mbartura për hetim 449 procedime penale me 187 persona nën hetim ose 101 procedime më tepër dhe 25 persona nën hetim më pak se viti 2020⁸⁴. Nga këto hetime të mbartura rezultojnë se numri prej 235 procedimesh penale me 64 persona nën hetim që janë të regjistruar për vepra penale të korrupsionit ose rreth 52.3% e çështjeve të mbartura për hetim. Krahasuar me vitin 2020 rezultojnë 101 çështje më tepër dhe 10 persona nën hetim më tepër⁸⁵. Gjithashtu, lidhur me përdorimin e metodave speciale të hetimit rezultojnë se përgjatë vitit 2021, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përdorur metodën e përgjimit për 129 procedime penale⁸⁶ ose 38 më tepër se vitin e kaluar, ku pjesën më të madhe të procedimeve penale ku është kërkuar përgjimi, e kryesojnë ato çështje të hetuara për veprat penale të korrupsionit⁸⁷, me 67 procedime penale (18 procedime më tepër se në 2020) dhe 850 pajisje fundore (ose 482 pajisje më tepër se viti 2020⁸⁸).

Lidhur me zbatimin e ligjit antimafia⁸⁹, nga Prokuroria e Posaçme për periudhën janar – dhjetor 2021 janë hetuar gjithsej 316 hetime pasurore (ose 3 më tepër se në 2020), nga të cilat 245 hetime janë mbartur nga viti 2020 dhe 71

⁷⁹ Për vitin 2020 rezultojnë 50 çështje dërguar për gjykim, 22 të pushuara, 4 të pezulluara, 28 të transferuara dhe 134 të mbetura në hetim.

⁸⁰ Për vitin 2020 ishin dërguar për gjykim 50 çështje ose 21.01% të çështjeve me nr. të pandehurish 95 persona.

⁸¹ Për vitin 2020 rezultojnë: 8 persona “arrest në burg”, 17 arrest në shtëpi dhe 33 persona detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore.

⁸² Gjatë vitit 2020 numrin më të madhe kishte vepra penale parashikuar nga neni 244

⁸³ Për vitin 2020 ka përfunduar gjykimi për 20 çështje me një numër prej 29 të pandehurish.

⁸⁴ Për vitin 2020 rezultojnë të ketë të mbartura në hetim 348 procedime me 212 persona nën hetim.

⁸⁵ Për vitin 2020 janë 134 procedime penale për korrupsion me 54 persona nën hetim.

⁸⁶ Për vitin 2020 janë regjistruar 91 procedime penale për metodën e përgjimit

⁸⁷ Konkretisht nenet 244, 245, 245/1, 258, 259, 319, dhe 319/ç, 328 të Kodit Penal.

⁸⁸ Për vitin 2020 janë 49 procedime penale, 368 pajisje fundore.

⁸⁹ Ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.



hetime janë regjistruar në vitin 2021 (ose 56 më tepër se në vitin 2020⁹⁰).

Nga Prokuroria e Posaçme, për periudhën janar – dhjetor 2021, janë paraqitur në gjykatë 14 kërkesa për sekuestrim ose 8 kërkesa më tepër se në vitin 2020, për vlera të hollash, subjektsh tregtare, pasurish të luajtshme dhe të paluajtshme të pranuar nga gjykata me 14 vendime sekuestrimi me pranim kërkesë. Ndërkohë janë paraqitur në gjykatë 4 kërkesa për konfiskimin e pasurive të sekuestruara, të cilat janë pranuar, ku vihet re një përgjysmim krahasuar me vitin e kaluar⁹¹.

Në zbatim të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”⁹², nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Operacioni Forca e Ligjit (njohur si OFL), në vijim të informacionit të përcjellë vitin e kaluar, ku ishin referuar gjithsej 251 materiale për të cilat nga Prokuroria e Posaçme (SPAK) janë paraqitur në gjykatë 145 kërkesa për sekuestrim pasurie, për 56 prej tyre ka përfunduar gjykimi me vendim të formës së prerë dhe për 89 prej tyre vazhdon gjykimi. Prokuroria e Posaçme, gjatë vitit 2021 ka paraqitur në gjykatë 25 kërkesa për sekuestrim pasurie, ndërkohë që janë dhënë nga gjykata 28 vendime sekuestrimi me pranim kërkesë⁹³. Në vazhdim të procesit gjyqësor, gjatë vitit 2021 janë paraqitur nga Prokuroria e Posaçme në gjykatë 72 kërkesa për konfiskim pasurie. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka marrë 42 vendime me objekt konfiskimi, deri në datën 31.12.2021. Nga 42 vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 41 vendime është pranuar kërkesa për konfiskim pasurie dhe vetëm në 1 rast është vendosur kthimi i pasurisë. Nga Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dhënë 21 vendime

ku është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë⁹⁴.

Gjatë vitit 2021, janë marrë 6 vendime për sekuestrim në procesin penal, përkatësisht 5 vendime të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 1 vendim i marrë nga prokurorët me një total prej 44 pasurish të sekuestruara⁹⁵.

Referuar analizës për vitin 2021 që Ministria e Drejtësisë ka kryer në bazë të të dhënave statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme⁹⁶, rezulton se:

- Lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit, të cilat janë aktualisht në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se për shkak të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, ka ndryshuar numri i veprave penale në kompetencën lëndore të kësaj prokurorie. Gjatë vitit 2021, janë hetuar 1792 çështje penale për veprat penale në fushën e korrupsionit⁹⁷, me një numër total prej 321 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 169 persona. Rezulton se ka një rritje të numrit të hetimeve për veprat penale të korrupsionit në krahasim me vitin 2020, me 41 çështje më shumë, rritje të numrit të personave nën

⁹⁴ Lloji i pasurive të sekuestruara janë -17 pasuri të paluajtshme; 43 pasuri të luajtshme; 1 subjekt tregtare

⁹⁵ Lloji i pasurive të sekuestruara janë: - 25 pasuri të paluajtshme, - 5 pasuri të luajtshme, - 7 subjekte/aktivitete tregtare, - 7 llogari bankare.

⁹⁶ Me shkresën nr. 942/43 prot., datë 2.3.2022, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1341 prot., datë 3.3.2022.

⁹⁷ Bazuar në 5 veprat penale në fushën e korrupsionit që kishin mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme (nenet 164/a, 164/b, 248, 256 dhe 257/a të Kodit Penal), nga 22 vepra që janë analizuar në vijueshmëri deri në fund të vitit 2019 kur ka filluar funksionimin Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Referuar ndryshimeve ligjore në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, krahas 5 veprave të mësipërme, në kompetencën e Prokurorisë së Përgjithshme janë shtuar sërish edhe veprat penale të parashikuara nga nenet 244 paragrafi 1; 245/1 paragrafët 1 dhe 3; dhe neni 259 paragrafi 1. Referuar totalit të çështjeve të hetuara përfshirë edhe 3 nenet e reja pra nenet 164/a, 164/b, 248, 256, 257/a, 244/1, 254/1 paragrafët 1 dhe 3 si dhe neni 259 paragrafi 1, numri i çështjeve të hetuara është 1892 me 345 persona nën hetim dhe 227 persona të pandehur. Referuar statistikave vetëm për 3 veprat e reja (244/1, 245/1 paragrafi 1 dhe 3 si dhe neni 259/1) kemi 100 çështje në hetim me 24 persona të pandehur dhe 58 persona në hetim.

⁹⁰ Për vitin 2020 janë hetuar 313 materiale dhe 15 procedime janë regjistruar nga SPAK

⁹¹ Për vitin 2020 janë paraqitur në gjykatë 6 kërkesa për sekuestrim dhe 8 kërkesa për konfiskim të pasurive të sekuestruara.

⁹² Miratuar me ligjin nr. 18/2020, datë 5.3.2020.

⁹³ Lloji i pasurive të sekuestruara janë -120 pasuri të paluajtshme; 47 pasuri të luajtshme; 4 subjekte tregtare
Faqe| 9476



hetim me 11 persona më shumë nën hetim dhe një ulje të lehtë me 3 persona më pak të marrë si të pandehur, krahasuar me të dhënat e vitit të kaluar⁹⁸. Por pavarësisht kësaj, rastet që dërgohen për gjykim mbeten përsëri të ulëta krahasuar me numrin total prej 556 çështjesh të regjistruara.

Për vitin 2021 janë dërguar për gjykim vetëm 67 procedime penale ose rreth 3.7% të çështjeve të hetuara, me 142 të pandehur. Krahasuar me vitin 2020⁹⁹, konstatohet një rënie e lehtë e numrit të çështjeve me 13 çështje më pak dhe 21 të pandehur më pak. Për vitin 2021 ka përfunduar gjykimi për 51 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit me një numër prej 85 të pandehurish, nga të cilët janë dënuar 57 persona krahasuar me vitin 2020¹⁰⁰, pra rezulton se ka një rënie të lehtë me 4 çështje më pak, një rënie të numrit me 21 persona të pandehur më pak dhe 24 të dënuar më pak.

- Nga ana tjetër, nëse i referohemi hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme, konkretisht në vitin 2021, numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe kallëzuara është 41541¹⁰¹, nga të cilat vetëm 125¹⁰² janë vepra penale të filluara kryesisht nga Prokurori, ose rreth 0,3% e numrit të përgjithshëm. Krahasuar me numrin e çështjeve të regjistruara kryesisht në 2021 për të njëjtat vepra penale konstatohet një rritje e dukshme me 66 çështje më tepër¹⁰³. Nga 125 çështje penale të filluara kryesisht nga prokurori, vetëm 18 janë të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit të mbetura në

kompetencë¹⁰⁴ ose rreth 14.4% e numrit të çështjeve kryesisht, ku të vetmet çështje të regjistruara janë për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me 18 çështje. Duhet theksuar se pas ndryshimeve të kompetencës lëndore në Kodin e Procedurës Penale, rezultojnë edhe 2 çështje të regjistruara kryesisht për veprën penale të parashikuar nga neni 244 paragrafi 1 i Kodit Penal. Nëse i krahasojmë me vitin 2021 për të njëjtat vepra penale në fushën e korrupsionit, rezulton një rritje e lehtë e numrit të çështjeve të filluara kryesisht në fushën e korrupsionit, me 14 çështje më tepër¹⁰⁵ pavarësisht rekomandimeve¹⁰⁶.

- Rezulton një rritje e numrit të çështjeve për veprat penale në fushën e pastrimit të parave regjistruar pranë Prokurorisë së Përgjithshme (rreth 5,2% më tepër) krahasuar me të dhënat e vitit 2020. Ndërsa, në total numri i çështjeve të regjistruara (kryesisht dhe me referim) për veprat penale të pastrimit të parave¹⁰⁷ është 301 çështje, me një numër total prej 48 personash nën hetim nga të cilët vetëm 8 prej tyre janë marrë si të pandehur. Krahasuar me të dhënat për vitin 2020¹⁰⁸, rezulton se ka një rritje prej 15 çështjesh të regjistruara më shumë, por ulje e numrit të personave nën hetim me 11 më pak dhe të numrit të të pandehurve me 15 të pandehur më pak.

- Ndërsa, nga të dhënat statistikore të dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton se nga totali i çështjeve të filluara kryesisht, për veprën penale të pastrimit të parave rezultojnë vetëm 3 çështje¹⁰⁹, nga të cilat është regjistruar vetëm 1 çështje për veprën penale “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, neni 287/b i Kodit Penal, dhe 2 çështje për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, neni 287 i Kodit Penal. Pavarësisht

⁹⁸Në 2020 për 5 veprat penale në fushën e korrupsionit të mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se ishin 1751 çështje në hetim me 310 persona nën hetim dhe 172 të pandehur.

⁹⁹Në vitin 2020 numri i çështjeve të dërguara për gjykim për këto 5 vepra penale të mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme ka qënë 80 (4.6% e rasteve) me 163 të pandehur.

¹⁰⁰Në vitin 2020 për 5 veprat penale të mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme kishin përfunduar gjykimin 55 çështje penale me 106 të pandehur, nga të cilët janë dënuar 81 persona.

¹⁰¹Një rritje prej 2051 referimesh krahasuar me vitin 2020, ku ishin në total 39490 referime.

¹⁰²Një rritje prej 66 çështje më shumë krahasuar me vitin 2020.

¹⁰³Në vitin 2020 kanë qënë 59 çështje të filluara kryesisht.

¹⁰⁴Krahasimi është bërë vetëm për 5 veprat penale (164/a, 164/b, 248, 256, 257/1/a, 257/1/b)

¹⁰⁵Në vitin 2020 kanë qënë vetëm 4 çështje të filluara kryesisht në fushën e korrupsionit

¹⁰⁶Në vitin 2020 janë 4 çështje të regjistruara kryesisht për 5 veprat penale në fushën e korrupsionit të mbetura në kompetencë.

¹⁰⁷Nenet 287, 287/a dhe 287/b të Kodit Penal

¹⁰⁸Në vitin 2020 për këto tre vepra penale janë regjistruar 286 çështje me 59 persona nën hetim dhe 23 të pandehur.

¹⁰⁹Ka një rritje me 2 çështje krahasuar me vitin 2020.



rekomandimeve, numri i çështjeve kryesisht për këtë kategori vijon të mbetet shumë i ulët.

- Lidhur me hetimet proaktive në veprat e korrupsionit, duke mbajtur në konsideratë se pjesa më e madhe e veprave të korrupsionit janë në kompetencë të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar – SPAK, Prokuroria e Përgjithshme në zbatim të udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021 rezulton se për vitin 2021 ka rritur rolin aktiv në kryerjen e hetimeve proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit dhe ka paraqitur të dhëna konkrete, sipas të cilave janë regjistruar 59 procedime penale për veprat penale të korrupsionit dhe që lidhen me detyrën, janë arrestuar/ ndaluar 40 persona të dyshuar dhe 5 procedime për vepra korruptive janë referuar/transferuar nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në Prokurorinë e Posaçme.

Në kuadër të bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme për sa i përket hetimeve proaktive pasurore dhe financiare, për rastet që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit në nivele të larta të politikës dhe administratës publike, referuar të dhënave statistikore, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë transferuar 11 procedime/transfere penale në Prokurorinë e Posaçme vetëm për vepra penale në fushën e korrupsionit.

- Në kuadër të ndjekjes me përparësi të kallëzimeve penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme në bashkëpunim me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe Prokurorinë e Posaçme (SPAK), është miratuar udhëzimi i përgjithshëm nr.2, datë 31.3.2021, “Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.3, datë 21.6.2019, “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe paszgjedhore”, për të harmonizuar ndryshimet e reja ligjore të Kodit Zgjedhor me ligjin nr.118/2020, si dhe me ndryshimet e bëra me ligjin nr.184/2020, në ligjin nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu, me urdhrin nr.37, datë 31.3.2021, është ngritur struktura përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme si pikë kontakti me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për dhënie informacioni për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Po kështu, në zbatim të udhëzimit të

përgjithshëm nr.3/2019, i ndryshuar me udhëzimin nr.37/2021, datë 31.3.2021, është miratuar qarkorja nr.571/11, datë 28.4.2021, për rritjen e dinamikës së hetimeve dhe masave procedurale për ushtrimin e ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të veprave penale të tjera që dëmtojnë procesin zgjedhor, si dhe forcimin e bashkëpunimit me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar të dhënave statistikore për vitin 2021, evidentohen se janë regjistruar 47 procedime penale për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, 7 çështje penale me 52 të pandehur janë dërguar për gjykim¹¹⁰.

Duke mbajtur në konsideratë problematikat sa më sipër të evidentuara, prioritetet e përbashkëta, **Këshilli i Ministrave për forcimin e luftës kundër korrupsionit rekomandon:**

1. Forcimin e cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit, referuar kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit për aq sa është e mundur, vijimin e rritjes së numrit të hetimeve për këto grup veprash penale, numrit të personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërtimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave;

2. Vijimin e rritjes së numrit të hetimeve proaktive (çështje të filluara kryesisht) si dhe përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit, me qëllim vazhdimin e përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së hetimeve të veprave kundër korrupsionit referuar kompetencës lëndore;

3. Rritjen e numrit të hetimeve sistematike pasurore dhe hetimit për veprat penale që gjenerojnë produkte/të ardhura, si dhe shtimin e aseteve të sekuestruara/konfiskuara;

4. Vijimin e zhvillimit të kapaciteteve profesionale të prokurorëve nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit me agjencitë e zbatimit të ligjit, si dhe

¹¹⁰Veprat penale të cilat janë analizuar në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme janë nenet 325, 326, 327, 327/a të Kodit Penal.



rritjen e numrit të trajnimeve për oficerët e policisë gjyqësore;

5. Vijimin e bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme për sa i përket hetimeve proaktive pasurore dhe financiare, për rastet që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit në nivele të larta të politikës dhe administratës publike.

Lufta kundër krimit të organizuar

Rekomandimet në luftën kundër krimit të organizuar janë bazuar në nevojën për forcimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit të brendshëm dhe ndërkombëtar, për efektivitetin në cilësi dhe në kohë të transmetimit të të dhënave të sigurta dhe të bazuara në konsolidimin e profesionalizimit të institucioneve ligjzbatuese. Mbetet prioritet konsolidimi i ndërveprimit mes agjencive ligjzbatuese rajonale dhe më gjerë, me qëllim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve të përbashkëta.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, i publikuar në mars 2022, “Volumi 1-Kontrolli i narkotikëve dhe lëndëve kimike”,¹¹¹ dhe “Volumi 2- Pastrimi i parave dhe krimet financiare”,¹¹² vë theksin te zbatimi me efektivitet i ligjit dhe reformës në drejtësi, nevojës së rritjes së hetimit dhe ndjekjes penale, dënimit të rasteve të veprave penale për trafikim të lëndëve narkotike (droga të forta), hetimi i pastrimit të parave të krimit të organizuar në pasuri të paluajtshme si dhe sekuestrimi/konfiskimi i tyre, ushtrimi i funksioneve efektive mbikëqyrëse. Konkretisht, në këtë raport theksohet se: “Shqipëria është një vend burim i kanabisit dhe një bazë lokale për grupet e krimit të organizuar që lëvizin drogat e paligjshme nga vendet e origjinës në tregjet evropiane. “Shqipëria mbetet e pambrojtur ndaj pastrimit të parave për shkak të korrupsionit, pranisë së rrjeteve të krimit të organizuar dhe boshllëqeve në legjislacion dhe mbikëqyrje”. Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet për reformën në drejtësi, të forcojë rregulloret dhe mbikëqyrjen kundër pastrimit të parave dhe të punojë për të

gërryer ndikimin e krimit të organizuar në të gjithë qeverisjen dhe shoqërinë”. Zbatimi i ndryshimeve të fundit ligjore dhe të politikave ka qenë jokonsistent. Legjislacioni në fuqi “është efektiv në sekuestrimin fillestar të pasurisë”, por “përmeshja e kërkesave të provave për sekuestrimin përfundimtar të pasurisë mbetet sfiduese”. Krimet kryesore që gjenerojnë të ardhura në Shqipëri përfshijnë trafikun e drogës dhe njerëzve, evazionin fiskal, kontrabandën e mallrave dhe trafikimin e njerëzve. Në përgjithësi, zbatimi i Strategjisë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit është në rrugën e duhur. Edhe pse vettingu i subjekteve të drejtësisë është një proces administrativ, po jep rezultate në luftën kundër korrupsionit pasi gjyqtarët dhe prokurorët e shkarkuar, si rezultat i vettingut, dalin para drejtësisë. Shqipëria ka bërë përpjekje të mëtejshme për të krijuar një histori solide në luftën kundër korrupsionit, megjithëse mbetet një objektivi që kërkon vullnet politik dhe veprime të mëtejshme të strukturuar dhe të qëndrueshme”.

Progresraporti 2021¹¹³ në lidhje me pastrimin e parave konstaton se: “Për sa i përket luftës kundër pastrimit të parave, Shqipëria vazhdon përpjekjet e saj për të adresuar mangësitë në përputhshmërinë teknike të identifikuar në raportin e vlerësimit të ndërsjellë të Moneyval për Shqipërinë 2018. Shqipëria është në listën e Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF) të juridiksioneve nën monitorim të shtuar që nga shkurti 2020. Shqipëria mori një angazhim politik të nivelit të lartë për të zbatuar planin e veprimit të FATF, i cili do të lejojë heqjen e Shqipërisë nga kjo listë. Plani i veprimit mbulon ndër të tjera identifikimin e rreziqeve të pastrimit të parave, regjistrimin e pronave, transparencën e pronësive përfituese dhe rritjen e dënimeve dhe konfiskimet. Ndryshimet në ligjin për pastrimin e parave për të harmonizuar legjislacionin për pastrimin e parave me *acquis* të BE-së janë përgatitur nga Këshilli i Ministrave.

Shqipëria po punon për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të saj me *acquis* të BE-së për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Shqipëria vazhdon të zbatojë “Paketën Moneyval” e cila mbulon i) parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ii) masat kundër financimit të terrorizmit, iii) procedurat tatimore dhe iv) Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe miratimi i një

¹¹¹ 2022 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 1 drug and Chemical Control, publikuar në datën 1 mars 2022 në faqen [2022 INCSR Vol 1 Final for Printing-Rev. 2-24 1.35pm \(state.gov\)](https://www.state.gov/2022-INCSR-Vol-1-Final-for-Printing-Rev-2-24-1.35pm).

¹¹² 2022 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 2 Money Laundering and financial crimes, publikuar në datën 1 mars 2022 në faqen zyrtare: [2022 INCSR-Volume II: Money Laundering \(As submitted to Congress\) - United States Department of State](https://www.state.gov/2022-INCSR-Volume-II-Money-Laundering-As-submitted-to-Congress).

¹¹³ “Albania 2021 Report, Acompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2021 Communication on EU Enlargement Policy” publikuar në datën 19.10.2021 në faqen: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2021.pdf.



ligji të ri për administrimin e pasurive të sekuestruara. Një ligj i ri për masat kufizuese ndërkombëtare u miratua në nëntor 2020”.

Referuar analizës për vitin 2021 që Ministria e Drejtësisë ka kryer rezulton se:

Lidhur me veprat penale në fushën e krimit të organizuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, është përcaktuar se Struktura Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka kompetencë hetimi për çdo veprë penale të kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, (neni 75/a gërma “b” e Kodit të Procedurës Penale) ose nga subjekte të posaçme sipas parashikimeve të nenit 75/a, shkronjat “c” dhe “ç” të Kodit të Procedurës Penale). Ndërkohë që vepra penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, sipas parashikimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale i përket prokurorive të juridiksionit të zakonshëm.

Në raportin vjetor 2021 mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar rezulton se gjatë vitit 2021, kjo strukturë ka regjistruar 164 procedime penale në fushën e krimit të organizuar, në numër të njëjtë me vitin e kaluar ose rreth 24.3% e veprave penale të regjistruara i përkasin grupit të veprave në fushën e krimit të organizuar. Numrin më të lartë të procedimeve penale të regjistruara, sikurse vitin e kaluar, e ka grupi i veprave penale të neneve (283/a “Trafikimi i narkotikëve”, 333/a “Grupi i strukturuar kriminal”, 334 “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”) me 50 procedime penale të regjistruara¹¹⁴. Rezulton një rënie e numrit të procedimeve të regjistruara për këto vepra me 14 procedime më pak. Në lidhje me çështjet e regjistruara rezulton se janë dërguar për gjykim 14 çështje, 2 çështje janë pushuar, 22 çështje janë pezulluar, 8 çështje të transferuara dhe 118 çështje rezultojnë të mbetura në hetim. Referuar shifrave të vitit të kaluar rezulton një ulje me 2 çështje dërguar për gjykim, 8 çështje më tepër të pezulluara, 13 çështje më pak të transferuara dhe 7 çështje më tepër të mbetura në gjykim¹¹⁵.

¹¹⁴ Për vitin 2020 për këtë grup veprash kanë qenë të regjistruara 64 procedime penale.

¹¹⁵ Për vitin 2020 janë regjistruar 164 procedime penale, nga të cilat 64 procedime për krimin e organizuar rezulton Faqe| 9480

Nga 14 çështjet e dërguara për gjykim për vitin 2021, të cilët zënë rreth 8.54% të çështjeve të hetuara në fushën e krimit të organizuar, rezulton se numri i të hetuarve/pandehurve ka qenë 84 persona ose 29 persona më pak se vjet. Numrin më të lartë të çështjeve të dërguara për gjykim e ka grupi i veprave penale të neneve (78/2 “Vrasja e kryer për interes apo hakmarrje”; 109/3 “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit ose e të miturit nën moshën 14 vjeç”; 278 “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”; 303 “Fshehja ose asgjësimi i kufomës”; 333/a “Grupi i strukturuar kriminal”, 334 “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”) me 4 çështje të dërguara për gjykim. Nga këto çështje për 64 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest me burg” (ose 42 persona më pak se vjet), për 3 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” (shifër e njëjtë me vjet) dhe për 1 person është caktuar masa e sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” (një më pak se vjet)¹¹⁶.

Për vitin 2021 rezulton se ka përfunduar gjykimi i themelit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 23 çështje penale për veprat penale në fushën e krimit të organizuar me një numër prej 94 të pandehurish ose krahasuar me vjet me një rritje prej 11 çështjesh më tepër dhe 31 të pandehur më tepër¹¹⁷. Për vitin 2021 janë përcjellë të dhëna edhe për gjykimet në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku rezulton se ka përfunduar gjykimi për 19 çështje penale me një numër prej 71 të pandehurish, për veprat penale në fushën e krimit të organizuar.

Lidhur me përdorimin e metodave speciale të hetimit rezulton se përgjatë vitit 2021, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përdorur metodën e përgjimit për 129 procedime penale (ose 38 më tepër se vitin e kaluar), ku për çështjet penale të hetuara për veprën

se janë dërguar për gjykim 16 çështje, 2 pushuar, 14 pezulluar, 21 transferuar dhe 111 në hetim.

¹¹⁶ Për vitin 2020 kanë qenë 113 persona të hetuar të pandehur, nga të cilët për 106 është caktuar arrest në burg, për 3 persona arrest në shtëpi, për 2 persona detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore.

¹¹⁷ Për vitin 2020 ka përfunduar gjykimi për 12 çështje me 63 të pandehur.



penale të grupit të strukturuar kriminal në trafikimin e lëndëve narkotike (283/a/2, 333/a, 334) me 45 procedime penale (ose 9 më tepër se vjet) dhe 928 pajisje fundore (ose 7 më pak se vitin kaluar¹¹⁸)

Ndërkohë vijon të mbetet i ulët roli i prokurorisë për sa i përket hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale të krimit të organizuar, pasi në total për të gjitha veprat penale rezulton se janë regjistruar vetëm 18 procedime penale kryesisht nga organi i Prokurorisë së Posaçme.

Në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme¹¹⁹ për zbatimin e rekomandimeve prioritare rezulton se:

- Në kuadër të “Hetimeve efektive nëpërmjet përdorimit të metodave speciale të hetimit dhe rritja e hetimeve proaktive” gjatë vitit 2021, në zbatim të kërkesave dhe procedurave ligjore, janë kryer hetime proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit, në kuadrin e 331 procedimeve për veprat penale kundër trafikëve të paligjshme (narkotikëve, personave, armëve/municioneve), përfshi edhe veprat penale kundër narkotikëve, pastrimit të parave dhe krimeve të rënda në kompetencë lëndore të prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm. Krahasuar me vitin e kaluar rezulton një ulje me rreth 2 herë më pak të procedimeve penale.

- Prokurorët kanë pasur rol aktiv si në regjistrimin e procedimeve, dhënien e autorizimeve ose kur mbi kërkesën e tyre me vendime gjyqësore është autorizuar përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit, ashtu dhe nëpërmjet lënies së detyrave oficerëve të policisë gjyqësore dhe kontrollit / mbikëqyrjes për zbatimin e tyre. Ky proces i ka shërbyer si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu edhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 418 personave të dyshuar në kompetencë të prokurorëve pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

- Gjithashtu, me rëndësi vijon të mbetet zbatimi i kuadrit ligjor mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e

të ardhurave kriminale¹²⁰ me qëllim ndërprerjen e të ardhurave të grupeve kriminale, e mundësive për të ndërvepruar në terren apo për t’i shpëtuar drejtësisë. Lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, përgjatë vitit 2021, në prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” është bërë konfiskim pasurie në 2 raste dhe janë kryer sekuestrime pasurie mbi kërkesën e prokurorëve me vendimet gjyqësore, në kuadrin e 6 procedimeve penale, ku krahasuar me vitin 2020 rezulton se kemi rritje me 1 sekuestrim dhe 2 konfiskime më tepër. Gjatë po kësaj periudhe në zbatim të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, në kuadrin e hetimit pasuror, prokurorët kanë kërkuar për 3 procedime sekuestrimin e pasurisë dhe në 1 rast konfiskimin e pasurisë, kërkesa këto të pranuar nga gjykata, nga ku rezulton se në krahasim me vitin 2020 ku nuk ka pasur asnjë konfiskim, në vitin 2021 ka pasur një rast konfiskimi.

- Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar ndaj luftës kundër krimit të organizuar, Zyra e Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë pranë Eurojust në Hagë po luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin dhe unifikimin e veprimeve institucionale ndaj kërcënimit serioz të krimit të organizuar transnacional dhe si rezultat i këtij bashkëpunimi janë regjistruar 20 çështje të reja me kërkesën e autoriteteve shqiptare dhe janë lidhur 3 marrëveshje të skuadrave të përbashkëta hetimore. Gjithashtu, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit 62 praktika të ardhura nga autoritetet gjyqësore të huaja për kryerjen e verifikimeve paraprake lidhur me pasuritë e subjekteve, ku janë përfunduar 19 prej tyre.

- Në kuadrin e marrëdhënieve me autoritetet gjyqësore rajonale, nga tetori 2021 Prokuroria e Përgjithshme është pjesë e projektit “THB Balkans

¹¹⁸ Për vitin 2020 janë përdorur metodat për 91 procedime penale, ku për çështjet penale të trafikimit për 36 procedime me 935 pajisje fundore.

¹¹⁹Me shkresën nr. 942/44 prot., datë 2.3.2022 protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1207/1 prot., datë 3.3.2022.

¹²⁰ Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.



Gender and Translation Crime Virtual Programme” financuar nga Republika Federale e Gjermanisë, me objekt rritjen e kapaciteteve hetimore të agjencive ligjzbatuese të vendeve të Ballkanit si dhe fuqizimin e bashkëpunimit rajonal kundër trafikimit të qenieve njerëzore në periudhën 2021-2023.

- Në kuadër të luftës ndaj krimit të organizuar, me qëllim pasurimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave, Prokuroria e Përgjithshme bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë lidhur me procesin e raportimit të të dhënave të harmonizuara për strukturat e BE-së, si dhe bashkëpunon me INSTAT-in për ngritjen e Nomenklaturës Ndërkombëtare të Krimeve për qëllime statistikore.

- Nga analiza e të dhënave statistikore lidhur me veprat penale të trafikimit¹²¹, për vitin 2021 rezulton se janë regjistruar 247 çështje penale me 37 persona në hetim, nga të cilët vetëm 25 janë marrë si të pandehur. Nga këto çështje janë dërguar për gjykim 37 çështje me 52 të pandehur ose rreth 15% e çështjeve të regjistruara. Numrin më të madh të çështjeve të regjistruara e zë vepra penale “Trafikimi i mjeteve motorike” parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal me 167 çështje.

- Rezulton një ulje e numrit¹²² të çështjeve të regjistruara me 7 çështje më pak dhe rënien e numrit të personave nën hetim me 10 persona më pak, si dhe ulje e personave të marrë si të pandehur me 4 persona më pak. Lidhur me numrin e çështjeve të dërguara për gjykim për vitin 2021, numri i tyre është ulur me 1 çështje më pak, po ashtu edhe numri i të pandehurve në gjykim është ulur me 12 persona më pak krahasuar me vitin 2020¹²³.

- Për veprat penale kundër narkotikëve konstatohet se në vitin 2021 janë hetuar më shumë çështje penale se në vitin 2020 (me 488 çështje më tepër). Lidhur me veprat penale në fushën e lëndëve narkotike¹²⁴, në vitin 2021 janë hetuar 3490 çështje penale ose 488 çështje penale më tepër se viti 2020. Rezulton se janë hetuar 1533 persona dhe

janë marrë të pandehur 1293 persona. Krahasuar me vitin 2020¹²⁵ rezultojnë 278 persona më shumë të hetuar dhe 327 më shumë të pandehur. Janë dërguar për gjykim 703 çështje ose 20% e çështjeve, me 1016 të pandehur, nga ku rezulton një rritje krahasuar me vitin 2020 me 197 çështje me tepër të dërguara për gjykim dhe 219 të pandehur më shumë¹²⁶. Numrin më të lartë të çështjeve në hetim e zë vepra penale: “Prodhihi dhe shitja e narkotikëve” neni 283 Kodit Penal me 1711 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 470 çështje.

- Konstatohet se vijon të mbetet i ulët numri i veprave penale kundër terrorizmit pavarësisht kompleksitetit dhe vështirësisë që kanë në hetim këto vepra, me ulje 0.75 të numrit të procedimeve të regjistruara. Lidhur me këtë kategori veprash penale¹²⁷, rezulton se janë regjistruar në total 9 çështje për vitin 2021 me 3 persona nën hetim dhe 2 persona të marrë si të pandehur. Në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim për këtë kategori veprash për vitin 2021, ndryshe nga viti i kaluar, rezultojnë vetëm 3 çështje të dërguara për gjykim, me 3 persona të pandehur. Në krahasim me vitin 2020¹²⁸, vihet re një ulje e numrit të çështjeve të regjistruara me 3 çështje më pak, por në ndryshim nga 2020 kemi 1 person nën hetim më shumë dhe të njëjtin numër prej 2 personash të marrë si të pandehur.

- Lidhur me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura¹²⁹ për vitin 2021 janë regjistruar 7 çështje penale për veprën penale “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve”, parashikuar nga neni 265 i Kodit Penal, dhe 1 çështje penale për veprën penale “Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj”, parashikuar nga neni 265/a i Kodit Penal, me 4 persona nën hetim dhe 1 të pandehur. Rezulton një rritje e numrit të çështjeve me 1 çështje më shumë krahasuar me vitin 2020¹³⁰, por ndryshe nga viti

¹²⁵ Në vitin 2020 kanë qenë 3002 çështje të hetuara me 1255 persona nën hetim dhe 966 të pandehur.

¹²⁶ Në vitin 2020 janë dërguar për gjykim 506 çështje me 797 persona të pandehur.

¹²⁷ Nenet 230-232/b të Kodit Penal.

¹²⁸ Në vitin 2020 ishin regjistruar 12 çështje penale, me 2 persona nën hetim dhe 2 të pandehur.

¹²⁹ Nenet 265- 265/c të Kodit Penal.

¹³⁰ Në vitin 2020 janë regjistruar 6 çështje penale, me 1 person të marrë nën hetim dhe 4 të pandehur.

¹²¹ Nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a dhe 282/a të Kodit Penal.

¹²² Në vitin 2020 ishin regjistruar 254 çështje penale me 47 persona në hetim, nga të cilët 29 janë marrë si të pandehur.

¹²³ Në vitin 2020 ishin dërguar për gjykim 38 çështje me 64 të pandehur për këtë kategori veprash penale.

¹²⁴ Ku janë përfshirë nenet 283-286/a të Kodit Penal.



2020¹³¹ rezultojnë 3 çështje të dërguara për gjykim-një rritje prej 2 çështjesh, me 3 të pandehur ose 1 i pandehur më pak se në vitin 2020.

Sa më sipër, Këshilli i Ministrave me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar rekomandon:

1. Rritjen e numrit të procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim dhe cilësisë së hetimit për veprat penale në fushën e narkotikëve, trafikëve dhe terrorizmit;

2. Vijimin e rritjes së numrit dhe cilësisë së hetimeve financiare për veprat penale të pastrimit të parave dhe produkteve të veprës penale dhe atë në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim;

3. Rritjen e rasteve të përdorimit të teknikave speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore;

4. Ashpërsimin e politikës penale për veprat penale në fushën e narkotikëve lidhur me masat e sigurimit personal dhe dënimin e tyre;

5. Vijimin e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave të prokurorisë së juridiksioneve të përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetërore, për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike;

6. Rritjen e kapaciteteve profesionale për prokurorët nëpërmjet trajnimeve në këtë fushë, duke përfshirë edhe trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore;

7. Vijimin e zbatimit të masave për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval për pastrimin e parave/luftimin e financimit të terrorizmit, të bashkëpunimit me Eurojust si dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore;

8. Përditësimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave për të siguruar një bazë të besueshme për reforma të mëtejshme për të rritur numrin e procedimeve penale dhe dënimeve për veprat penale të pastrimit të parave.

Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut

Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut mbetet prioritet kyç në adresimin e rekomandimeve për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022. Trajtimi me dinjitet dhe sipas nevojave specifike të individëve të dyshuar si autor të veprave penale, si dhe të viktimave dhe dëshmitarëve mbetet sfida për çdo institucion ligjzbatues, përfshirë edhe organet e hetimit penal.

Referuar analizës për vitin 2021 që Ministria e Drejtësisë ka kryer rezultojnë se:

Nga të dhënat e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2021 në prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, numri i çështjeve të përfunduara në zbatim të instituteve të reja procedurale penale¹³² është për 1071 çështje, me 1096 të pandehur, shifra që zënë 11.27% të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim. Në lidhje me këto institute të reja procedurale, rezultojnë se për 264 çështje kundërvajtje penale është kërkuar miratimi i urdhrit penal me 269 të pandehur, ku krahasuar me 2020 rezultojnë me ulje 35.6% të çështjeve, për 520 çështje me 537 të pandehur është kërkuar miratimi marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ku rezultojnë me 29.07% të çështjeve të krahasuara me vitin 2020, për 287 çështje me 290 të pandehur është kërkuar gjykim i drejtpërdrejtë, një rritje me 27.5% e çështjeve krahasuar me vitin 2020.

Nga të dhënat statistikore të sipërpërmendura rezultojnë se gjykimi i drejtpërdrejtë ka pësuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2020, ndërsa urdhri penal dhe marrëveshja për pranimin e fajësisë kanë pësuar ulje.

- Në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës¹³³ rezultojnë se për vitin 2021 janë regjistruar 1491 çështje penale me 401 persona nën hetim dhe janë marrë 873 të pandehur. Krahasuar me vitin 2020¹³⁴ rezultojnë 133 çështje më shumë të regjistruara; 11 persona më shumë nën hetim dhe 88 të pandehur më shumë. Në lidhje me këtë kategori veprash rezultojnë se për vitin 2021 janë dërguar për gjykim 1080 çështje me 1163 të

¹³²Referuar shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme nr. 924/44 prot., datë 2.3.2022, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1207/1 prot., datë 3.3.2022.

¹³³ Seksioni IX, nenet 124- 130/a të Kodit Penal.

¹³⁴ Në vitin 2020 ishin regjistruar 1358 çështje me 390 persona nën hetim dhe 785 të pandehur.

¹³¹ Në vitin 2020 ishte vetëm 1 çështje e dërguar për gjykim me 4 të pandehur.



pandehur. Krahasuar me një vit më parë¹³⁵ ka një rritje prej 126 çështjesh më shumë të dërguara për gjykim dhe 134 të pandehur më shumë.

- Në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, për vitin 2021, janë regjistruar 1406 çështje penale ose rreth 3.4% e të gjitha çështjeve penale të regjistruara¹³⁶, me 388 persona nën hetim dhe janë marrë në cilësinë e të pandehurit 846 persona. Krahasuar me vitin 2020¹³⁷ konstatohet një rritje e numrit të çështjeve të regjistruara me 155 çështje më shumë, 30 persona nën hetim më shumë dhe 90 të pandehur më shumë.

- Rezulton se në vitin 2021 për veprën penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal janë dërguar për gjykim 1037 çështje për këtë vepër penale me total prej 1119 të pandehurish, çka përbën një rritje prej 123 çështjesh dhe 140 të pandehurish më shumë krahasuar me vitin 2020¹³⁸. Numri i çështjeve të dërguara për gjykim për këtë vepër përbën rreth 9.9% të numrit total të çështjeve të dërguara për gjykim gjatë vitit 2021¹³⁹. Nga këto çështje për vitin 2021 janë gjykuar 774 çështje me 823 të pandehur, duke pësuar një rritje me 152 çështje më shumë dhe 167 të pandehur më shumë se në vitin 2020¹⁴⁰.

- Lidhur me politikën e dënimit të ndjekur gjatë gjyimit, Prokuroria e Përgjithshme është shprehur se 56.1% e kërkesave janë kërkesa për caktimin e dënimit me burg dhe 43.9% kërkesave për dënim alternativ. Në lidhje me dënimin ka ulje prej 10% të kërkesave për dënim në minimum; një rritje prej 21.32% të kërkesave për dënimin mesatar dhe rritje të lehtë të dënimit minimal; ndërkohë nga analiza e të dhënave statistikore, ka rezultuar se: në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria për veprën penale “Dhunë në familje” rezulton se është kërkuar në 2 raste dënim maksimal i parashikuar

nga paragrafi përkatës¹⁴¹. Gjithashtu, krahasuar me vitin 2020 rezulton se : i) në asnjë rast nuk është kërkuar dënim me gjobë¹⁴²; ii) për asnjë rast nuk është kërkuar dënim sa periudha e paraburgimit¹⁴³; iii) për 162 të pandehur është kërkuar dënim minimal i parashikuar nga dispozita¹⁴⁴; iv) për 330 të pandehur është kërkuar dënim mesatar¹⁴⁵; v) për 1 të pandehur është kërkuar ulje në minimumin e parashikuar nga dispozita¹⁴⁶; vi) për 388 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit¹⁴⁷; vii) për 1 rast është kërkuar tërheqja e akteve¹⁴⁸; viii) për 1 rast është kërkuar pushimi i akuzës¹⁴⁹; ix) për 4 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes¹⁵⁰; dhe x) për 1 rast është kërkuar pafajësi¹⁵¹. Për sa më sipër kemi ulje të numrit me 1 rast më pak lidhur me tërheqjen e akteve, pushimin e çështjes dhe pafajësinë, si dhe një ulje e lehtë e numrit të të pandehurve me 3 më pak lidhur me pushimin e çështjes. Krahasuar me vitin 2020, referuar të dhënave lidhur me politikën penale rezulton se kemi: i) rritje të lehtë të numrit me 1 rast më shumë për sa i përket dënimit maksimal; ii) rritje të numrit të të pandehurve me 53 më shumë lidhur me dënimin mesatar; iii) ulje me 17 të pandehur më pak lidhur me dënimin minimal si dhe iv) për pezullimin e ekzekutimit kemi rritje me 128 të pandehur më shumë. Në tërësi nga krahasimi i mësipërm nuk rezulton ashpërsim i ndjeshëm i politikës penale për këtë vepër.

- Nga të dhënat statistikore¹⁵² rezulton se në çështjet penale të regjistruara gjatë vitit 2021, janë

¹⁴¹ Në vitin 2020 dënim maksimal është kërkuar vetëm në një rast

¹⁴² Në vitin 2020 dënim me gjobë nuk është kërkuar në asnjë rast

¹⁴³ Në vitin 2020 është kërkuar në një rast

¹⁴⁴ Në vitin 2020 ky dënim është kërkuar për 179 të pandehur

¹⁴⁵ Në vitin 2020 ky dënim është kërkuar për 277 të pandehur

¹⁴⁶ Në vitin 2020 ky dënim është kërkuar në 3 raste

¹⁴⁷ Në vitin 2020 pezullimi i ekzekutimit është kërkuar në 260 raste.

¹⁴⁸ Në vitin 2020 tërheqja e akteve nuk është kërkuar në asnjë rast.

¹⁴⁹ Në vitin 2020 pushimi i akuzës nuk është kërkuar në asnjë rast.

¹⁵⁰ Në vitin 2020 për 7 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes.

¹⁵¹ Në vitin 2020 pafajësia nuk është kërkuar në asnjë rast.

¹⁵² Të paraqitura në shkresën nr. 942/44 prot., datë 2.3.2022 të Prokurorisë së Përgjithshme.

¹³⁵ Në vitin 2020 ishin dërguar për gjykim 954 çështje me 1029 të pandehur.

¹³⁶ Për vitin 2021 janë regjistruar në total 41541 çështje.

¹³⁷ Për vitin 2020 janë regjistruar 1251 çështje me 358 persona nën hetim dhe 756 persona në cilësinë e të pandehurit gjatë hetimeve.

¹³⁸ Në vitin 2020 janë dërguar për gjykim 914 çështje me 979 të pandehur.

¹³⁹ Numri total i çështjeve të dërguara në gjyq në vitin 2021 është 10497 çështje.

¹⁴⁰ Në vitin 2020 janë gjykuar 622 çështje me 656 të pandehur.



regjistruar 313 procedime/çështje me 358 viktime të mitura ku prej të cilëve 175 janë meshkuj dhe 183 femra. Nga të dhënat e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme për të miturit në konflikt me ligjin për vitin 2021, janë regjistruar 702¹⁵³ procedime, me një rritje prej 46.84% të numrit të procedimeve krahasuar me vitin 2020, me 743¹⁵⁴ të mitur në konflikt me ligjin të regjistruar si të pandehur ku, krahasuar me vitin 2020, rezultojnë një rritje prej 41.52% të numrit të të pandehurve. Referuar analizës së statistikave të përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme rezultojnë se për vitin 2021 janë regjistruar në total 17 të pandehur të mitur të moshës 14-18 vjeç, nga ku 17 meshkuj dhe asnjë femër, ku krahasuar me vitin 2020 në total kanë qenë 15 të pandehur të mitur të moshës 14-18 vjeç. Për vitin 2021 kemi 2 të pandehur të mitur më shumë se në vitin 2020, rritje me 4 të pandehur të mitur meshkuj më shumë dhe ulje me 2 të pandehur të mitura femra më pak. Lidhur me të miturit viktime të moshës deri në 18 vjeç rezultojnë se për vitin 2021 kemi në total 21 viktime të mitur të moshës deri në 18 vjeç, nga ku 7 janë meshkuj dhe 14 femra. Për vitin 2020 rezultojnë se kanë qenë në total 16 të mitur të moshës deri në 18 vjeç nga ku 8 kanë qenë meshkuj dhe 8 femra. Krahasuar me vitin 2021 kemi një rritje me 5 viktime të mitur më shumë, nga ku 1 mashkull më pak dhe 6 femra më shumë.

- Gjithashtu për të miturit në konflikt me ligjin rezultojnë se për vitin 2021 janë dërguar 210 çështje për gjykim, duke shënuar një rritje me 64 procedime më shumë krahasuar me vitin 2020¹⁵⁵, është vendosur mosfillimi i procedimit për 464 raste¹⁵⁶ duke shënuar rritje me 371 raste më shumë krahasuar me vitin 2020, si dhe për 302 raste¹⁵⁷ është vendosur pushimi i çështjes, duke shënuar rritje me 103 raste më shumë se në vitin 2020. Sa i përket aplikimit të masës alternative të shmangies, nga të dhënat statistikore për vitin 2021 rezultojnë se në kuadrin e 766 procedimeve të mosfilluara/ të

pushuara në 324 raste është aplikuar masa alternative e shmangies.

- Në lidhje me veprën penale “Krimet seksuale” janë regjistruar 158 procedime penale, me rritje prej 13.92% të numrit të procedimeve penale dhe me 107 të pandehur ose me rritje prej 2.8% të numrit të të pandehurve të regjistruar, krahasuar me vitin 2020. Gjithashtu, janë dërguar për gjykim 83 procedime me 93 të pandehur, ku rezultojnë me rritje prej 48.45% të numrit të procedimeve për gjykim dhe me 52.45% të numrit të të pandehurve krahasuar me vitin 2020.

- Lidhur me masat e sigurimit personal për veprën penale “Krimet seksuale”, rezultojnë ashpërsim i masave, ku 98.6% janë kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg” dhe vetëm 1.4% janë kërkesa me detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, ku krahasuar me vitin 2020 ky raport është me rritje 4.1%. Gjithashtu, ka rritje të kërkesave për caktimin e dënimit me burg, ku konkretisht janë 81.9% kërkesa për caktimin e dënimit me burg, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 80.4%, si dhe ka ulje të dënimit alternativ, ku janë 18.4% të kërkesave për dënim alternativ, krahasuar me vitin 2020 kur ky raport ka qenë 19.6%.

- Për sa i përket politikës penale për veprën penale “Krimet seksuale”, mbetet e ashpër, ku 100% e rasteve është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg”, ndërsa për sa i përket caktimit të dënimit rezultojnë 67% e kërkesave dënim me burg dhe 33% dënime alternative.

- Në lidhje me veprat penale në fushën e mjedisit¹⁵⁸, nga të dhënat statistikore në vitin 2021 janë regjistruar 314 çështje penale, ose 1.1% e totalit të çështjeve të regjistruara në këtë vit, me 79 persona nën hetim dhe 53 të pandehur. Në krahasim me vitin 2020¹⁵⁹, rezultojnë një rënie e lehtë e numrit të çështjeve me 17 çështje më pak, me 9 persona nën hetim më pak dhe një rënie e lehtë me 3 të pandehur më pak, ose me ulje 5% të numrit të procedimeve dhe ulje me 10% e numrit të personave nën hetim krahasuar me ata të regjistruar për vitin 2020. Numri më i madh i çështjeve penale vijon të jetë i regjistruar për veprën penale “Prerja e

¹⁵³ Në vitin 2020 kanë qenë 473 procedime të regjistruara.

¹⁵⁴ Në vitin 2020 kanë qenë 525 të mitur të pandehur.

¹⁵⁵ Në vitin 2020 janë regjistruar 146 çështje të dërguar për gjykim.

¹⁵⁶ Në vitin 2020 është vendosur mosfillimi i procedimit për 93 raste.

¹⁵⁷ Në vitin 2020 është vendosur pushimi i çështjes për 199 raste.

¹⁵⁸ Nenet 201-207, nenet 207/a, 207/b, 207/c dhe 207/ç të Kodit Penal, përfshirë ndryshimet e reja të vitit 2021.

¹⁵⁹ Në vitin 2020 ishin regjistruar 331 çështje penale me 88 persona në hetim dhe 56 të pandehur.



paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal, me 148 çështje të regjistruara.

- Në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim për këtë grup veprash rezultoi se për vitin 2021 janë dërguar për gjykim 80 çështje me 89 të pandehur, ku krahasuar me vitin 2020¹⁶⁰ rezultoi një rritje me 16 çështje më shumë dërguar për gjykim dhe me 19 të pandehur më shumë.

- Lidhur me të dhënat statistikore për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve të cilat janë referuar edhe në rekomandimin nr. II, krahas të dhënave për procedimet e regjistruara dhe për procedimet e dërguara për gjykim, janë paraqitur të dhëna lidhur me politikën penale për këtë kategori veprash ku kërkesat e prokurorit në lidhje me dënimet janë 28.57% e kërkesave për caktimin e dënimit me burg dhe 71.42% të kërkesave janë për caktimin e dënimeve alternative, ku sipas Prokurorisë së Përgjithshme përbën ashpërsim të kërkesave për llojin e dënimit krahasuar me vitin 2020.

- Nga analiza e të dhënave statistikore në lidhje me politikën e dënimit për këtë kategori veprash¹⁶¹, rezultoi se: i) ka vetëm 1 rast dënimi minimal të parashikuar nga dispozita; ii) në 5 raste është kërkuar dënimi mesatar; iii) për 50 të pandehur është pezulluar ekzekutimi i dënimit; si dhe nuk ka asnjë rast tjetër dënimi të parashikuar. Ndërkohë, në lidhje me kërkesat e tjera të prokurorit, rezultoi se vetëm në dy raste është kërkuar pushimi i akuzës dhe nuk ka asnjë rast tërheqjeje aktesh, kërkesë për pushim çështjeje apo kërkesë për pafajësi.

Këshilli i Ministrave me qëllim forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut rekomandon:

1. Vijimin e aplikimit të masave alternative shmangies të parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur tek të miturit;

2. Shtimin e numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve lehtësuese penale (marrëveshje, urdhri penal) dhe rritja e rasteve të gjyqimit të drejtpërdrejtë, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin,

rrezikshmërinë e veprës, si dhe duke ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve;

3. Nxitjen e aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore;

4. Vijimin e ashpërsimit të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve;

5. Rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ashpërsimin e politikës penale për autorët e veprës penale të dhunës në familje;

6. Rritjen e vëmendjes në hetimin dhe dërgimin për gjykim të veprave penale në fushën e mjedisit;

7. Rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe veçanërisht të oficerëve të policisë gjyqësore, nëpërmjet trajnimeve veçanërisht për veprat penale me bazë gjinore, seksuale dhe përfshirjen e të miturve.

Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional

Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe konsolidimi i ndërveprimit ndërmjet agjencive ligjzbatuese të brendshme por edhe me ato ndërkombëtare përbën thelbin e rekomandimeve në këtë drejtim.

Në kuadër të marrjes së masave për forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ndjekjes penale, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme përmendet nënshkrimi i Aktit të Koordinimit Institucional “Për rritjen e eficiencës nëpërmjet bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstitucionale duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj”, i cili po vijon bashkëpunimin.

Gjatë vitit 2021, nga Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë trajtuar në total 91 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja (nga të cilat 77 kanë

¹⁶⁰Në vitin 2020 ishin dërguar për gjykim 64 çështje me 70 të pandehur.

¹⁶¹ Për veprat penale 325, 326, 326/a, 327, 327/a, 328/b, 329, 330, 330/a, 331, 331/a, 332, 332/a të Kodit Penal.



ardhur në vitin 2021), ku krahasuar me vitin 2020¹⁶² rezultoi rritje prej 22 kërkesash më tepër se vitin e kaluar.

Nga totali janë ekzekutuar 41 letërporosi dhe për vitin 2020 – 2021, vijon ende procedura për ekzekutim për 50 letërporosi. Këto kërkesa janë drejtuar nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja për kryerjen e veprimeve në Republikën e Shqipërisë.

Nga numri total i 91 kërkesave, numrin më të madh të kërkesave që janë 29 prej tyre, ose 31,8%, e zënë kërkesat që kanë të bëjnë me hetime në fushën “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të shoqëruara dhe me veprat penale në fushën e “Trafikimit të narkotikëve”, në formën e bashkëpunimit të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar si vepra penale nga Kodi Penal Shqiptar në nenet 287, 283/a, 333/a të tij.

Gjatë vitit 2021 nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë përcjellë 51 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike, drejtuar autoriteteve të huaja, ose 10 më tepër se vjet¹⁶³. Kësaj shifre i shtohen edhe 16 kërkesa të mbartura nga viti 2020, për të cilat nuk është kryer ende ekzekutimi.

Nga numri total i 51 i kërkesave të paraqitura për ndihmë të ndërsjellë juridike ka rezultuar se numrin më të lartë, 20 prej tyre ose 39.21% e zënë kërkesat që kanë të bëjnë me hetime në fushën e veprave penale të “Trafikimit të personave të rritur”, “Trafikimit të të miturve”, “Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, të kryera në formën e bashkëpunimit asaj të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 110/a, 128, 298, 333/a të Kodit Penal.

Nga totali prej 51 kërkesash janë ekzekutuar 17, ndërsa pjesa tjetër është në pritje të përgjigjes nga autoritetet e huaja për ekzekutimin. Gjithashtu, nga letërporositë e mbajtura nga 2020, janë ekzekutuar 4 letërporosi në vitin 2021.

Krahas kërkesave për ndihmë juridike që lidhen me hetime të autoriteteve të huaja, lidhur me hetimet e Prokurorisë së Posaçme është e nevojshme kryerja e veprimeve hetimore apo verifikimeve jashtë Shqipërisë. Për këtë qëllim janë

krijuar Skuadrat e Përbashkëta Hetimore. Konkretisht, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është duke ndjekur hetime me 10 skuadra të përbashkëta hetimore me autoritetet e drejtësisë të Italisë. Këto skuadra janë krijuar për veprat penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Trafikimit të narkotikëve”, në formën e bashkëpunimit me atë të “Grupit të strukturor kriminal”, “Mashtrimi kompjuterik”, në formën e bashkëpunimit me atë të “Grupit të strukturor kriminal” dhe “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, në formën e bashkëpunimit me atë të “Grupit të strukturuar kriminal”.

Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2021 ka plotësuar praktikat për 17 kërkesa për ekstradim nga jashtë vendit në Shqipëri.

Një tjetër aspekt i punës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, ka qenë vijimi i nënshkrimit të marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe vendeve fqinje. Konkretisht, janë nënshkruar:

- Në datën 2.6.2021, memorandumit i mirëkuptimit për bashkëpunimin në fushën penale me prokurorin e shtetit të Republikës së Kosovës;

- Në datën 2.6.2021, memorandumit i mirëkuptimit me Prokurorinë Bazë në Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2021 në drejtim të bashkëpunimit ndërinstitucional, nga organi i prokurorisë rezulton:

- Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme¹⁶⁴ në lidhje me rritjen e cilësisë dhe eficiencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme të kriminalitetit është konsideruar domosdoshmëri një qasje e përbashkët dhe e unifikuar ndërmjet institucioneve ligjzbatuese. Për këtë qëllim, Prokuroria e Përgjithshme i ka kushtuar vëmendje si bashkëpunimit praktik vendor në punën e përditshme të drejtuesve, prokurorëve, oficerëve të

¹⁶² Për vitin 2020 janë trajtuar 69 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike.

¹⁶³ Për vitin 2020 janë 41 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja nga Prokuroria e Posaçme.

¹⁶⁴ Me shkresën nr. 942/44 prot., datë 2.3.2022, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1207/1 prot., datë 3.3.2022.



policisë gjyqësore, ashtu edhe marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror.

- Shkëmbimi i të dhënave me agjencitë ligjzbatuese për marrjen e aksesit në databaza shtetërore, ku është kërkuar dhe është në pritje të marrjes së aksesit në bazat e të dhënave: “regjistrin e pronarëve përfitues”, “regjistrin qendror të llogarive bankare”, bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, bazën e të dhënave në Sistemin Elektronik të çështjeve të Përmbartimit Gjyqësor dhe bazën e të dhënave shtetërore të Shërbimit/Regjistrat Noterial Shqiptar, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

- Në këtë kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional ka vijuar bashkëpunimi me Strukturën e Posaçme Antikorrupsion dhe Krimin të Organizuar nëpërmjet Aktit të Koordinimit Institucional datë 15.12.2020, si dhe ka vijuar zbatimi i memorandumit të bashkëpunimit ndërinstitucional, në datën 15 korrik 2020, ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, dhe Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Gjithashtu, vijon zbatimi i marrëveshjeve dypalëshe të vitit 2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Inspektoratin e Lartë të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me synim rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen dhe me veprat penale të fushës së krimeve financiare, shpërdorimit të fondeve publike, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore si dhe për veprat penale të fushës së krimeve të rënda që mund të lidhen me format e veçanta të bashkëpunimit.

- Krijimi i vakancave për shkak të rivlerësimit kalimtar për 73 prokurorë në prokuroritë e të gjitha niveleve me juridiksion të përgjithshëm, krahas masave për plotësimin e vendeve vakante me prokurorë, kërkon marrjen e masave emergjente për shtimin e numrit organik të oficerëve të policisë gjyqësore në seksionet pranë prokurorive të

juridiksionit të përgjithshëm me 250 oficerë, për të lehtësuar veprimtarinë e prokurorëve në përballimin e volumit të punës në rritje në seksionet pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Kjo kërkesë për plotësimin e organikës me 250 oficerë të policisë gjyqësore u miratua nga Komisioni i Policisë Gjyqësore, në datën 29.9.2021.

- Gjithashtu, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në bazë të kërkesave të Prokurorisë së Përgjithshme ka emëruar 13 oficerë të policisë gjyqësore pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në muajin maj 2021 dhe 12 oficerë të policisë gjyqësore në muajt nëntor-dhjetor 2021.

- Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, gjatë vitit 2021 nga sistemi IMPRO janë paraqitur këto të dhëna:

Për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve” ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit 52 praktika; ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë 19 praktika; letërporosi nga jashtë 55 praktika; letërporosi për jashtë 35 praktika.

Për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale” janë trajtuar kërkesat: ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit 5 praktika; ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë 1 praktikë; letërporosi nga jashtë 29 praktika; letërporosi për jashtë 153 praktika.

Për veprën penale “Financimi i terrorizmit” janë trajtuar kërkesat: letërporosi nga jashtë 2 praktika; letërporosi për jashtë 3 praktika.

Për veprën penale “Trafikimi i qenieve njerëzore” janë trajtuar kërkesat: ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit 1 praktikë; letërporosi nga jashtë 4 praktika.

- Po kështu, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2021 në kuadër të letërkërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike janë kryer: ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit 133 praktika; ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë 111 praktika; urdhërarreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare 287 praktika; letërporosi nga jashtë 600 praktika; letërporosi për jashtë 654 praktika; shpallja e shtetasve shqiptarë ose të huaj në kërkim ndërkombëtar 172 praktika; heqje e shtetasve shqiptarë nga kërkimi ndërkombëtar 133 praktika; transferime të dënuarish nga jashtë 2 praktika;



transferime të dënuarish për jashtë 7 praktika; transferime procedimi nga jashtë drejt Shqipërisë 11 praktika; transferim procedimi nga Shqipëria për jashtë 14 praktika; njohjet e vendimeve penale të ardhura nga jashtë 36 praktika; njohjet e vendimeve penale shqiptare të dërguara jashtë vendit 14 praktika.

- Në lidhje me zbatimin e rekomandimit për organizimin e trajnimeve të përbashkëta është përmendur sërish bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për të organizuar aktivitete të përbashkëta trajnuese të zhvilluara me tema që lidhen me hetimet financiare, evazionin fiskal dhe krimin kibernetik. Gjithashtu, janë përmendur sërish aktivitetet e zhvilluara në kuadër të projektit PROCEEDS-2 të Këshillit të Evropës, prezencës së OSBE-së, si dhe numri i prokurorëve pjesëmarrës në to.

- Ka vijuar zbatimi i memorandumit të bashkëpunimit ndërinstitucional të nënshkruar në datën 15.7.2020 dhe në korrik 2021 është miratuar urdhri i përbashkët “Për ngritjen e Sekretariatit Teknik në Prokurorinë e Përgjithshme për zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit” me qëllim rritjen e efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal dhe ndaj nëpunësve publikë të administratës tatimore dhe doganore.

- Gjatë vitit 2021, për veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet¹⁶⁵ rezultojnë se janë regjistruar 316 procedime penale me 78 të pandehur për veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet, me rritje prej 5.33% të numrit të procedimeve të regjistruara krahasuar me vitin 2020. Janë dërguar për gjykim 94 çështje penale me ulje prej 12.14% të numrit të procedimeve krahasuar me vitin 2020, si dhe me 143 të pandehur të dërguar për gjykim, ku krahasuar me vitin 2020 ka një rritje prej 5.14% të numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim. Ndërsa për veprën penale “Moskryerja e detyrave nga organet tatimore”, të parashikuar nga neni 181/a i Kodit Penal, nuk rezultojnë të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

- Për sa i përket politikës penale në veprat penale lidhur me taksat dhe tatimet, referuar statistikave rezultojnë ashpërsim i kërkesave të prokurorit lidhur me masat e sigurimit për personat që kanë kryer këtë vepër ku 60.71% janë kërkesa

për masë sigurimi me arrest në burg, me rritje prej 19.01% krahasuar me vitin 2020. Në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, rezultojnë se 22.7% e kërkesave janë të dënimit me burgim, 54.6% për dënim alternativ dhe 22.7% dënimit me gjobë. Ndërkohë nga analiza e të dhënave statistikore për këtë grup veprash ka rezultuar se: i) në 23 raste është kërkuar dënim me gjobë; ii) për 19 të pandehur është kërkuar dënim në minimum; iii) për 4 të pandehur është kërkuar dënim mesatar; iv) për 55 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit; si dhe nuk ka raste të kërkesave për masa të tjera dënimi. Gjithashtu, nuk ka kërkesa të tjera të prokurorit si për pushim çështje apo akuze, tërheqje aktesh apo pafajësi. Ndërkohë nga analiza e statistikave të prokurorisë për vitin 2021 konstatohet se numri më i madh i referimeve ka ardhur nga policia e shtetit me 33.216 çështje të referuara, ndërkohë që referimet e policive të tjera janë si vijon: 38 çështje të referuara nga policia e ndërtimit; 15 çështje të referuara nga policia financiare; 5 çështje të referuara nga policia pyjore; 50 çështje të referuara nga policia elektrike; dhe 338 çështje të referuara nga policitë e tjera. Krahasuar me vitin 2020¹⁶⁶, konstatohet se kemi një rritje të referimeve nga Policia e Shtetit me 1081 raste më shumë, rritje të referimeve nga policia elektrike me 31 raste më shumë dhe nga policitë e tjera me 56 raste më shumë. Nga ana tjetër, për policinë financiare rezultojnë se kemi 2 raste më pak të referuara, për policinë pyjore kemi 11 raste më pak të referuara dhe për policinë e ndërtimit 11 raste më pak të referuara, krahasuar me vitin 2020.

Nga vlerësimi i rekomandimeve të propozuara nga ministrinë e linjës që kanë në përgjegjësi agjencitë ligjzbatuese që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, evidentohet progres i arritur dhe forcimi i bashkëpunimit me organin e prokurorisë. Me qëllim përmirësimit të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi nga këto institucione janë propozuar si vijon:

¹⁶⁶ Të dhënat për vitin 2020 kanë qenë: 31415 referime nga policia e shtetit; 17 referime nga policia financiare; 49 referime nga policia e ndërtimit; 16 referime nga policia pyjore; dhe 338 referime nga policitë e tjera, ndërsa nga policia elektrike janë referuar 19 raste.

¹⁶⁵ Referuar neneve 180-182/a të Kodit Penal.



Ministria e Brendshme¹⁶⁷ në përputhje me prioritetet e përcaktuara në programin e qeverisë dhe në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me prokurorinë, ka fokusuar sugjerimet e saj në dy drejtime: i) rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit; si dhe ii) parandalimin dhe goditjen e veprës penale të pastrimit të parave dhe dobësimin e financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar.

Konkretisht Ministria e Brendshme sugjeron:

i) Zhvillimin e hetimeve pasurore paralelisht me hetimin penal referuarligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, veçanërisht në hetimet e grupeve të strukturuar kriminale, si dhe sekuestrimin/konfiskimin e asetëve kriminale prej fazës fillestare të hetimeve;

ii) Rritjen e vëmendjes ndaj veprave penale financiare, terrorizmit, korrupsionit, dhe veprave penale kibernetike si dhe rritjen e përdorimit të metodave speciale të hetimit për këto vepra;

iii) Zhvillimin e analizave ndërinstucionale me policinë dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese me qëllim evidentimin, adresimin dhe zgjidhjen e problematikave, si dhe shkëmbimin e informacionit për zhvillimin e hetimeve;

iv) Vijimin e punës për koordinimin e sistemeve të menaxhimit të çështjeve në Prokurori dhe në Policinë e Shtetit, i cili do të shërbejë për administrimin e të dhënave të konsoliduara (*track-recorde* veçanërisht) për veprat penale në fushën e krimit të organizuar, sipas standardeve ndërkombëtare.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë¹⁶⁸ dhe konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Doganave shpreh se ka pasur një bashkëpunim të mirë si me Prokurorinë e Përgjithshme ashtu edhe me prokuroritë e rretheve në lidhje me kërkesat e këtyre të fundit për verifikime të kryerjes së procedurave të import/eksportit apo çdo veprim tjetër të kryer nga individë/subjekte, për nevoja të

procedimeve penale si dhe kërkesave bazuar në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Është theksuar se referimet e dërguara në organin e prokurorisë, gjatë vitit 2021 janë regjistruar si procedime penale nga organi i prokurorisë, u janë deleguar oficerëve të policisë gjyqësore dhe janë dërguar për gjykim.

Drejtoria e Hetimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ka paraqitur disa problematika që ka hasur gjatë vitit 2021, që lidhen me:

i. rastet e flagrancës apo të kallëzimeve për veprat penale të shpërdorimit të detyrës për personelin doganor, të referuara nga institucione të tjera, si Policia Kufitare, Drejtoria e Policive të Qarqeve, për të cilat nuk marrin dijeni në lidhje me ecurinë e mëtejshme të hetimit nga prokuroritë e rretheve;

ii. mungesën e njoftimit të vendimeve përfundimtare të çështjeve, duke e konsideruar këtë fakt si detyrim ligjor dhe duke e konsideruar Drejtorinë e Doganave si kallëzues/ankues.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit rekomandon:

i. forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, i cili të konsistojë në shkëmbimin e informacioneve dhe dhënien e ekspertizës nga ana e saj;

ii. rritjen e hetimeve proaktive jo vetëm të veprave penale në fushën e lojërave të fatit, por edhe në vepra penale të lidhura me to si pastrimi i produkteve të veprës penale, mitëmarrja, shpërdorimi i detyrës, evazioni fiskal si dhe

iii. rritjen e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim për këtë kategori veprash penale me qëllim reduktimin e këtij fenomeni.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (DPPPP)¹⁶⁹ paraqet të njëjtat sugjerime:

i. nevojitet një rritje në tërësi e numrit të rasteve të dërguara në gjykatë për veprën penale të parashikuar nga neni 287 “Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”, të Kodit Penal, duke përdorur në mënyrë sistematike edhe

¹⁶⁷ Kërkuar informacion me shkresën nr. 114/2, datë 31.1.2022, ardhur përgjigje në mënyrë elektronike me shkresën nr. 1096/3 prot., datë 6.4.2022.

¹⁶⁸ Kërkuar informacion me shkresën nr. 114/2, datë 31.1.2022, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 1895/1 prot., datë 11.2.2022, protokolluar pranë nesh me nr. 114/5 prot., datë 14.2.2022.

¹⁶⁹ Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1895/2 prot., datë 17.2.2022 protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 114/6 prot., datë 18.2.2022.



provat rrethanore, me fokus të veçantë në rastet kur pasuria me prejardhje kriminale buron nga pasuri kriminale të krijuara jashtë vendit apo nga raste korrupsioni brenda vendit;

ii. nevojitet rritje në tërësi e numrit të rasteve të dërguara në gjykatë për të cilat kërkohet konfiskimi i pasurisë kriminale (për çdo vepër të aplikueshme), përfshirë pasurinë indirekte dhe atë të prejardhur nga pasuria fillestare kriminale;

iii. vëmendje e veçantë duhet për rastet e hetuara dhe gjykuara sipas nenit 287 të Kodit Penal, kur kjo vepër penale kryhet nga persona të tretë, familjarë, lidhje të ngushta shoqërore apo profesionistë;

iv. qartësim dhe unifikim i qëndrimit të prokurorive të rretheve gjyqësore për autonominë e veprës penale të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal, pasi ka pasur raste kur vendimmarrja nuk ka qenë në përputhje me parashikimin ligjor; si dhe

v. të shihet mundësia e miratimit të procedurave bazë dhe standarde hetimore, të detyrueshme, për veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/b, 179/a, 230/a të Kodit Penal.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve¹⁷⁰, shprehet se:

i. në zbatim të memorandumit të bashkëpunimit nr. 1079, datë 15.7.2020, janë marrë angazhime për rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim rritjen e efektivitetit të hetimit të veprave penale në fushën e pastrimit të parave, krimeve financiare, e hetimeve pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale;

ii. kërkohet një vëmendje e shtuar dhe prioritet më i lartë në sektorët e identifikimit me risk si sektori i ndërtimit, juridiksionet *offshore*;

iii. forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për kryerjen e analizave të përbashkëta dhe shkëmbimin e informacioneve me qëllim evidentimin e saktë të faktit penal dhe sekuestrimin e aseteve kriminale.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit¹⁷¹ shprehet se:

i. për vitin 2021 Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) nuk ka pasur asnjë kallëzim penal, pasi

fusha e saj e përgjegjësisë janë kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit dhe ujërave;

ii. Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB), gjatë vitit 2021 ka pasur një kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; si dhe

iii. është përmendur bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme për raportimin e krimit mjedisor në Komisaratin Digital. Në lidhje me këto raportime nëpërmjet aplikacionit, të dhënat e paraqitura janë për periudhën dhjetor 2021-6.2.2022, ku rezultojnë 419 raportime krimi mjedisor, si ndotjet akustike, ndotjet e ujit dhe ndotjet nga mbetjet inerte, nga të cilat 150 raportime janë në proces verifikimi.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ndër të tjera rekomandon:

i. bashkëpunimin më të ngushtë midis strukturave të fushës së turizmit dhe mjedisit në nivel qendror dhe vendor me prokuroritë e rretheve, për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe referim të saktë të kundërvajtjes/veprës penale në fushën e mjedisit, mbledhjen e provave të sakta, si dhe bashkëpunim midis strukturave përkatëse për gjetjen e autorëve;

ii. zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta midis punonjësve në fushat e turizmit dhe mjedisit dhe prokurorëve të rretheve gjyqësore;

iii. forcimin e masave ndëshkuese nga ana e prokurorisë për kundërvajtjet penale në fushën e mjedisit, me qëllim shmangien e katastrofave mjedisore;

iv. krijimin e një komunikimi periodik për të diskutuar lidhur me ecurinë e punëve kundërt dëmtimit në turizëm dhe mjedis, si dhe problematikat që hasen në procedurat për ndjekjet penale.

Agjencia e Menaxhimit të Pyjeve¹⁷² në cilësinë e institucionit përgjegjës për mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, bën me dije se ky institucion si dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila zhvillon inspektime mjedisore, nuk kanë në organikën e tyre oficerë të policisë gjyqësore ose inspektorë, të cilët të kenë këtë status. Në kuadër të përafrimit të legjislacionit penal me aktet e Bashkimit Evropian në luftën kundër krimit

¹⁷⁰ Kërkuar informacion me shkresën nr. 114/2, datë 31.1.2022, ardhur përgjigje në mënyrë elektronike me shkresën nr. 4699 prot., datë 24.3.2022.

¹⁷¹ Kërkuar informacion me shkresën nr. 114/2, datë 31.1.2022, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 1281/2 prot., datë 11.2.2022, protokolluar pranë nesh me nr. 114/4 prot., datë 14.2.2022.

¹⁷² Kërkuar informacion me shkresën nr. 114/2 prot., datë 31.1.2022, ardhur informacion me shkresën e tyre nr. 112 prot., datë 9.2.2022, protokolluar pranë nesh me nr. 114/3 prot., datë 10.2.2022.



mjedisor, ky institucion paraqet rekomandimin për trajtimin me prioritet të veprave penale në fushën e mjedisit, dhe vlerësimin e mundësisë për krijimin e një njësie të specializuar në prokurori, me prokurorë të kualifikuar e profilizuar për krimet kundër mjedisit. Ky rekomandim mbështetet dhe në faktin që gjatë viteve të fundit me mbështetjen e partnerëve të huaj si Komisioni Evropian dhe Ambasada e SHBA-së, në kuadër të projekteve të ndryshme, janë trajnuar prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore për veprat penale në fushën e mjedisit.

Ministria e Mbrojtjes¹⁷³ në lidhje me bashkëpunimin me prokurorinë, ka sugjeruar:

i. të hartohet një plan trajnimi bazë (filleshtar) dhe i vazhdueshëm, i përditësuar për oficerët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve të Policisë Gjyqësore;

ii. të hartohet një udhëzim i posaçëm për përcaktimin e marrëdhënieve midis prokurorive dhe shërbimeve të Policisë Gjyqësore Ushtarake;

iii. dhënien prioritet delegimit të dosjeve penale ushtarake shërbimit të Policisë Gjyqësore pranë Policisë Ushtarake;

iv. bashkëpunimin për përfundimin e dosjeve të parashkruara;

v. komunikimin e prokurorisë me Policinë Ushtarake, me qëllim unifikimin dhe standardizimin e veprimeve hetimore për veprat penale të shpërdorimit të detyrës në Forcat e Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes,

vi. mundësinë për dhënien e aksesit në sistemin TIMS dhe ADAMS (opsionale) shërbimeve të Policisë Gjyqësore.

Ministria e Mbrojtjes ka parashtruar një problematikë që lidhet me faktin se referuar legjislacionit në fuqi Forca Detare/Roja Bregdetare gëzon statusin e Oficerit të Policisë Gjyqësore, por aktualisht këto attribute, të përcaktuara në ligj, nuk ushtrohen nga ky institucion. Në lidhje me këtë problematikë, sugjerohet bashkëpunimi i mëtejshëm me qëllim përmbushjen e kuadrit rregullator dhe bërjen efektive të dispozitave ligjore për ushtrimin e detyrës së oficerit të Policisë Gjyqësore (OPGJ) në aktivitetin e Rojës Bregdetare.

Sa më sipër, Këshilli i Ministrave, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional rekomandon:

1. Forcimin e luftës kundër informalitetit, duke rritur numrin e çështjeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim, për grupveprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, si dhe rritjen e numrit të hetimeve paralele financiare;

2. Vijimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse dhe rritjen e efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal dhe ndaj nëpunësve publikë të administratës tatimore dhe doganore;

3. Vijimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e cilësisë dhe eficiencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme të kriminalitetit, shkëmbimin e të dhënave në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm të grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe hetimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e krimeve financiare, shpërdorimit të fondeve publike, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore si dhe për veprat penale të fushës së krimeve të rënda që mund të lidhen me format e veçanta të bashkëpunimit;

4. Vijimin e forcimit të kapaciteteve të seksioneve të posaçme pranë prokurorive me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprat penale në kompetencë të këtyre seksioneve;

5. Rritjen e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre, në respektim të parimit për të caktuar si Oficer të Policisë Gjyqësore, oficerin e strukturës referuese;

6. Shtimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me oficerët e policive gjyqësore në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve hetimore dhe vlerës së provave veçanërisht në rastet e hetimeve financiare, evazionit fiskal dhe krimit kibernetik.

¹⁷³ Kërkuar informacion me shkresën nr. 114/2 prot., datë 31.1.2022. ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 566/5 prot., datë 24.2.2022, protokolluar pranë nesh me nr. 1207 prot., datë 24.2.2022.



URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 227, datë 28.4.2022

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS
SË VITIT SHKOLLOR 2022–2023
NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJMË:

Struktura e vitit shkollor 2022–2023 të jetë, si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:

a) Mësimet fillojnë më 12 shtator 2022 dhe mbarojnë më 14 qershor 2023.

b) Pushimet fillojnë më 26 dhjetor 2022 dhe mbarojnë më 4 janar 2023.

c) Pushimet fillojnë më 3 prill 2023 dhe mbarojnë më 9 prill 2023.

ç) Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 15–30 qershor 2023.

2. Në arsimin e mesëm të lartë:

a) Mësimet fillojnë më 12 shtator 2022 dhe mbarojnë më 14 qershor 2023.

b) Për maturat, mësimet fillojnë më 12 shtator 2022 dhe mbarojnë më 31 maj 2023.

c) Pushimet fillojnë më 26 dhjetor 2022 dhe mbarojnë më 4 janar 2023.

ç) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 1–30 qershor 2023.

3. Në arsimin profesional:

a) Mësimet fillojnë më 12 shtator 2022.

b) Nxënësit e klasave të 10-ta, për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta, për strukturën 2+2, si dhe nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 4-vjeçare mbarojnë mësimet më 14 qershor 2023.

c) Nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta, për strukturën 2+1+1, dhe nxënësit e klasave të 11-ta, për strukturën 2+2, mbarojnë mësimet më 31 maj 2023.

ç) Për të gjithë nxënësit maturantë, viti shkollor mbaron më 19 maj 2023.

d) Pushimet fillojnë më 26 dhjetor 2022 dhe mbarojnë më 4 janar 2023.

dh) Provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të nivelit II dhe III të KSHK-së zhvillohen në periudhën 1–15 qershor 2023.

e) Provimet përfundimtare të praktikës profesionale të kualifikimeve profesionale të nivelit IV të KSHK-së zhvillohen në periudhën 25–31 maj 2023.

ë) Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen në periudhën 1–30 qershor 2023.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCIVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

URDHËR
Nr. 189, datë 4.5.2022

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE
PËRMBAJTJES SË DEKLARATËS TIP TË
NËNSHKRUAR PREJ PËRKTHYESIT
ZYRTAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe të nenit 6, pika 4, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”,



URDHËROJ:

1. Miratimin e formës dhe përmbajtjes së deklaratës tip të nënshkruar prej përkthyesit zyrtar sipas shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Deklarata e përkthyesit zyrtar plotësohet në formë manuale, me shkrim dhe me shkronja kapitale, në gjuhën shqipe, nënshkruhet nga përkthyesi zyrtar dhe vulolet me vulën e tij.

3. Ngarkohen përkthyesit zyrtarë, Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira dhe Drejtoria

për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCË
DEKLARATA E PËRKTHYESIT ZYRTAR

Data ____.

Unë, _____, përkthyes zyrtar për gjuhën _____, i certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. _____ datë ____.

_____, dhe regjistruar në Regjistrin Elektronik të Përkthyesve Zyrtarë me nr. _____, deklaroj se, kam përkthyer:

_____, nga gjuha e burimit _____ në gjuhën _____, me saktësi, kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore, duke ruajtur plotësisht kuptimin e fjalisë dhe përmbajtjen e tij/saj.

Emri, mbiemri dhe nënshkrimi

Vula

Adresa postare: _____

Adresa elektronike: _____

Numri i kontaktit: _____

¹⁷⁴ Vendoset emërtesa e plotë dhe të dhëna të tjera për identifikimin e tekstit, dokumentit zyrtar, aktit normativ të miratuar në Republikën e Shqipërisë, marrëveshjes ndërkombëtare ose normave të nxjerra nga organizata ndërkombëtare.

**URDHËR****Nr. 190, datë 4.5.2022****PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
GJUHËVE TË HUAJA, TË CILAT
PËRFSHIHEN NË SHËRBIMIN E
PËRKTHIMIT ZYRTAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 12, pika 1, shkronja “ë”, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e listës së gjuhëve të huaja, të cilat përfshihen në shërbimin e përkthimit zyrtar sipas listës që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira dhe Drejtoria për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË**Ulsi Manja****LISTA E GJUHËVE TË HUAJA, TË CILAT
PËRFSHIHEN NË SHËRBIMIN E
PËRKTHIMIT ZYRTAR**

1. Gjuha angleze
2. Gjuha italiane
3. Gjuha gjermane
4. Gjuha frënge
5. Gjuha greke
6. Gjuha spanjolle
7. Gjuha turke
8. Gjuha polake
9. Gjuha ruse
10. Gjuha rumune

11. Gjuha maqedonase
12. Gjuha serbe, kroate, malazeze e boshnjake
13. Gjuha bullgare
14. Gjuha holandeze
15. Gjuha arabe
16. Gjuha portugeze
17. Gjuha hungareze
18. Gjuha kineze
19. Gjuha çeke
20. Gjuha norvegjeze, suedeze e daneze
21. Gjuha perse
22. Gjuha rome
23. Gjuha vllahe
24. Gjuha slovene
25. Gjuha koreane
26. Gjuha japoneze

URDHËR**Nr. 191, datë 4.5.2022****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR MBAJTJEN E ADRESËS SË POSTËS
ELEKTRONIKE PËR PËRKTHYESIN
ZYRTAR DHE INTERPRETIN E
GJUHËS SË SHENJAVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 24, shkronja “ë”, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”,

URDHËROJ:

1. Përkthyesi zyrtar dhe interpreti i gjuhës së shenjave është i detyruar të mbajë një adresë zyrtare të postës elektronike dhe të sigurojë funksionimin e rregullt të saj.

2. Adresa zyrtare e postës elektronike mund të përdoret nga Ministria e Drejtësisë, autoritetet e tjera publike dhe organet proceduese për komunikimin me përkthyesin zyrtar dhe interpretin e gjuhës së shenjave.

3. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave, ose kur përkthyesit janë të organizuar në zyra përkthimi, zyra e përkthimit, e regjistron këtë të dhënë dhe çdo ndryshim të saj në regjistrin



tregtar, sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës.

4. Kur Ministria e Drejtësisë, autoritetet e tjera publike dhe organet proceduese dërgojnë njoftime ose çdo lloj komunikimi në adresën zyrtare të postës elektronike të njoftuar, konsiderohet se njoftimi ose komunikimi është kryer.

5. Çdo ndryshim i adresës zyrtare të postës elektronike i njoftohet strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, me shkresë dhe në rrugë elektronike, brenda dy ditëve nga kryerja e këtij ndryshimi.

6. Në rast se përkthyesi zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave nuk njofton ndryshimin e adresës zyrtare të postës elektronike, sipas parashikimit të pikës 5 të këtij urdhri, çdo njoftim ose komunikim që kryhet në adresën e njoftuar më parë prej tij, konsiderohet si i kryer, kur është dërguar në adresën e mëparshme.

7. Çdo përkthyes zyrtar dhe interpret i gjuhës së shenjave, merr masa për zbatimin e këtij urdhri dhe njofton në Ministrinë e Drejtësisë, me shkresë dhe në rrugë elektronike, adresën zyrtare të postës elektronike, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

8. Ngarkohen përkthyesit zyrtarë, interpretët e gjuhës së shenjave, Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira dhe Drejtoria për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

9. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR
Nr. 192, datë 4.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
MË TË HOLLËSISHME PËR KRITERET,
PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN E
PËRFAQËSUESVE DHE
FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE
TË POSAÇME, TARIFAT PËR
PJESËMARRJE, ORGANIZIMIN E
ZHVILLIMIN E PROVIMIT TË
KUALIFIKIMIT PËR PËRKTHYES
ZYRTAR DHE PËR INTERPRET TË
GJUHËS SË SHENJAVE, SI DHE PËR
PROCEDURËN E MËNYRËN E
VLERËSIMIT TË PROVIMEVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe të nenit 16, pika 8, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”,

URDHËROJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky urdhër ka për qëllim përcaktimin e rregullave më të hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, organizimin e zhvillimit të provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, tarifatat për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, si dhe për procedurën e mënyrën e vlerësimit të provimeve.

Neni 2
Organizimi i provimit të kualifikimit

1. Provimi i kualifikimit për përkthyes zyrtar për çdo gjuhë dhe provimi i kualifikimit për interpret të gjuhës së shenjave shqipe organizohet sipas afateve



të përcaktuar në ligjin nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar.

2. Provimi i kualifikimit për përkthyes zyrtar për një ose disa gjuhë të caktuara dhe provimi i kualifikimit për interpret të gjuhës së shenjave shqipe, në raste përjashtimore, mund të organizohet përpara afatit 2-vjeçar, kur:

a) për një ose disa gjuhë të caktuara, çmohet që numri i akteve ose dokumenteve që parashikohen për t’u përkthyer deri në datën e organizimit të provimit të ardhshëm për përkthyes zyrtar, nuk mund të mbulohet nga numri i përkthyesve të licencuar, të regjistruar në regjistër;

b) në regjistrin elektronik të përkthyesve zyrtarë ka jo më shumë se 6 përkthyes zyrtarë të certifikuar për gjuhën përkatëse ose jo më shumë se 9 interpret të gjuhës së shenjave;

c) kur konstatohet nevoja e ngutshme për përkthim në një gjuhë e cila nuk është përfshirë në listën e gjuhëve të huaja, të miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 3

Tarifa e provimit të kualifikimit

Tarifa për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit për përkthyes zyrtar për një gjuhë dhe tarifa për pjesëmarrjen në provimin e kualifikimit për interpret të gjuhës së shenjave është 10.000 lekë.

KREU II

PËRZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KOMISIONET E POSAÇME

Neni 4

Kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e përfaqësuesve

Përfaqësuesi në komisionet e posaçëm për provimin e kualifikimit për përkthyes zyrtar për çdo gjuhë të huaj dhe përfaqësuesi në komisionin e posaçëm për provimin e kualifikimit për interpret të gjuhës së shenjave, duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme të mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës, ose të

zotërojë një diplomë të të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;

c) të mos jetë i dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale;

ç) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës, funksionit publik ose nga puna në pozicione të tjera pranë personave juridikë privatë për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur kjo masë disiplinore është shuar dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi në çastin e paraqitjes së shprehjes së interesit;

d) të mos jetë kandidat për përkthyes zyrtar të gjuhës për të cilën njëkohësisht kandidon për të qenë anëtar i komisionit të posaçëm ose kandidat për interpret të gjuhës së shenjave shqipe.

Neni 5

Kriteret e posaçme për përzgjedhjen e përfaqësuesve

1. Përfaqësuesi në komisionet e posaçëm për provimin e kualifikimit për përkthyes zyrtar për çdo gjuhë të huaj, duhet të plotësojë kriteret e veçanta të mëposhtme:

a) për përfaqësuesit nga Ministria e Drejtësisë dhe ministria përgjegjëse për arsimin:

i. të ketë statusin e nëpunësit civil;

ii. të ketë jo më pak se 3 vjet përvojë pune si jurist;

b) për përfaqësuesin nga institucionet publike të arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në gjuhë të huaja:

i. të jetë pjesë e personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë, i angazhuar me kohë të plotë, i kategorisë lektor ose profesor;

ii. të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë profesionale në mësimdhënie në gjuhën përkatëse ose të ngjashme me të apo që lidhet me fushën e përkthimit.

2. Përfaqësuesi në komisionin e posaçëm për provimin e kualifikimit për interpret të gjuhës së shenjave shqipe, duhet të plotësojë kriteret e veçanta të mëposhtme:

a) për përfaqësuesit nga Ministria e Drejtësisë dhe nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale:

i. të ketë statusin e nëpunësit civil;



ii. të ketë jo më pak se 3 vjet përvojë pune si jurist;

b) për përfaqësuesin nga radhët e interpretëve të gjuhës së shenjave shqipe:

i. të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë profesionale në interpretimin e gjuhës së shenjave shqipe, ose;

ii. të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë profesionale si trajnues i certifikuar i programit të interpretëve të gjuhës së shenjave shqipe.

3. Përfaqësuesit nga radhët e ministrive nuk mund të jenë anëtarë të më shumë se 2 (dy) komisioneve të posaçëm.

Neni 6

Publikimi i thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit

1. Thirrja për paraqitjen e shprehjeve të interesit për anëtarë të komisioneve të posaçme për provimin e kualifikimit për çdo gjuhë të huaj dhe për anëtar të komisionit të posaçëm për provimin e kualifikimit për interpret të gjuhës së shenjave shqipe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë 90 ditë përpara datës së provimit të kualifikimit të përcaktuar në urdhrin e ministrit të Drejtësisë.

2. Kur provimi i kualifikimit zhvillohet përpara afatit 2-vjeçar, thirrja për paraqitjen e shprehjeve të interesit publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe qëndron e hapur për 60 ditë nga data e publikimit.

Neni 7

Afati për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Kandidati për anëtar i komisionit të posaçëm paraqet pranë Ministrisë së Drejtësisë shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues brenda 30 ditëve nga data e publikimit të thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit.

2. Shprehja e interesit nga kandidati përmban këto të dhëna:

a) emrin, mbiemrin, atësinë, datëlindjen, vendlindjen, numrin personal të identifikimit;

b) adresën e vendbanimit dhe adresën elektronike, si dhe numrin telefonik të kontaktit të kandidatit;

c) përcaktimin se për cilët nga komisionet e posaçme kandidon për të qenë anëtar.

Neni 8

Dokumentacioni shoqërues

1. Kandidati për anëtar i komisionit të posaçëm, për të provuar përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, paraqet dokumentacionin shoqërues si vijon:

a) kopje të mjetit të identifikimit;

b) jetëshkrimin;

c) kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës së ciklit të dytë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës, ose diplomën e të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njehsuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;

ç) vërtetim nga institucionet dhe personat juridikë privatë ku ka ushtruar detyrën ose funksionin publik apo me të cilat ka lidhur marrëdhënien e punës se ndaj tij nuk është dhënë masa disiplinore e shkarkimit për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, ose nëse është dhënë kjo masë, vërtetim që kjo masë disiplinore është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) kopje të njehsuar me origjinalin të librezës së punës;

dh) vërtetim nga institucioni ku punon kandidati;

e) kopje të njehsuar me origjinalin të librezës së punës;

ë) formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të plotësuar dhe nënshkruar.

3. Kandidati për anëtar i komisionit të posaçëm për provimin e kualifikimit, për të provuar përmbushjen e kriterëve të posaçme, paraqet dokumentacionin shoqërues si vijon:

a) përfaqësuesi nga ministra e Drejtësisë, ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale paraqesin vërtetime nga ministria përkatëse mbi zotërimin e statusit të nëpunësit civil;

b) përfaqësuesi nga institucionet publike të arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në gjuhë të huaja paraqesin vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë që vërtetojnë se kandidati është



pjesë e personelit akademik të tij, i angazhuar me kohë të plotë, i kategorisë lektor ose profesor, me përvojë profesionale në mësimdhënie jo më pak se 5 vjet, në gjuhën përkatëse ose të ngjashme me të, ose që lidhet me fushën e përkthimit;

c) përfaqësuesit nga radhët e interpreteve paraqesin:

i. vërtetime dhe çdo dokumentacion tjetër që provon se kandidati ka jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë profesionale në interpretimin e gjuhës së shenjave shqipe, ose;

ii. vërtetime dhe çdo dokumentacion tjetër që provon se kandidati ka jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë profesionale si trajnues i certifikuar i programit të interpreteve të gjuhës së shenjave shqipe, shoqëruar me dokumentacionin që provon certifikimin e tij.

Neni 9

Verifikimi paraprak

1. Struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë administron shprehjet e interesit dhe dokumentacionin shoqërues të kandidatit për anëtar të komisioneve të posaçme dhe brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e tyre, kryen veprimet e mëposhtme:

a) kur shprehja e interesit dhe dokumentacioni shoqërues përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij urdhri, njofton kandidatin me shkrim mbi vazhdimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore;

b) kur shprehja e interesit dhe dokumentacioni shoqërues nuk përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij urdhri, njofton kandidatin për plotësimin e të metave brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit. Në këtë rast struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë ndihmon në mënyrë aktive palën për plotësimin e të metave të konstatuara. Mosplotësimi i të metave brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës.

2. Në çdo rast struktura përgjegjëse i njofton kandidatit i njofton numrin unik të identifikimit i cili do të përdoret për qëllime të publikimit të listave të kandidatëve të kualifikuar dhe të skualifikuar.

Neni 10

Verifikimi i kritereve

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi mbi vazhdimin e procedurës së verifikimit ose përfundimit të afatit për plotësimin e të metave, struktura përgjegjëse verifikon nëse kandidatët plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë urdhër, në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kritereve, nuk është i plotë, i saktë ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga çdo organ publik apo persona të tjerë juridikë, vendas ose të huaj.

3. Për verifikimin e kriterit të mos qenies i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë kryen vetë kontrollin në sistemin elektronik përkatës ose, kur është e nevojshme, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve informacionin mbi dënimin ose jo të kandidatit. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dërgon informacionin brenda 3 ditëve nga marrja e kërkesës.

4. Në përfundim verifikimit mbi plotësimin kritereve ligjore, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë harton relacionin shpjegues për secilin kandidat ku pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe arsyet mbi propozimin për pranimin ose refuzimin e shprehjes së interesit, si dhe njoftimin përkatës mbi rezultatet e verifikimit të kritereve.

Neni 11

Anëtarët zëvendësues

1. Për çdo përfaqësues të komisioneve të posaçme nga radhët e ministrive, nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe nga radhët e interpreteve zgjidhet edhe një anëtar zëvendësues sipas të njëjtave kritere dhe të njëjtës procedurës të përcaktuar për kandidatët për anëtarë të komisioneve.



2. Anëtari zëvendësues, zëvendëson anëtarin e zgjedhur në rast se ky i fundit e ka të pamundur të marrë pjesë në zhvillimin e provimit të kualifikimit.

Neni 12

Publikimi i listës paraprake

Lista paraprake me numrin unik të identifikimit të kandidatëve të kualifikuar për të qenë anëtarë të komisioneve të posaçme dhe të kandidatëve të skualifikuar publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Kandidatët e skualifikuar njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit.

Neni 13

Ankimi ndaj skualifikimit të kandidatit për anëtar të komisionit të posaçëm

1. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankohen pranë ministrit të Drejtësisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit, duke bashkëlidhur argumentet dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kriterëve.

2. Grupi i punës i ngritur me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë shqyrton ankimin e paraqitur dhe i propozon ministrit të Drejtësisë përfshirjen në listën e kandidatëve të kualifikuar, në rastet kur provohet përmbushja e kriterëve kualifikues për të qenë anëtarë të komisioneve të posaçme ose skualifikimin përfundimtar të tij. Ministri i Drejtësisë nxjerr urdhrin përkatës jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së ankimit.

3. Struktura përgjegjëse përgatit edhe urdhrin e ministrit për skualifikimin e çdo kandidati, të renditur në listën paraprake të kandidatëve të skualifikuar dhe që nuk kanë paraqitur një ankim.

4. Urdhri i ministrit për skualifikimin e çdo kandidati i njoftohet kandidatëve të skualifikuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 14

Publikimi i listës përfundimtare

Lista përfundimtare me numrin unik të identifikimit të kandidatëve të zgjedhur si anëtarë të komisioneve të posaçme, si dhe të kandidatëve të

zgjedhur si anëtarë zëvendësues publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

KREU III

KOMISIONET E POSAÇME

Neni 15

Ngritja dhe funksionimi i komisioneve të posaçme

1. Komisionet e posaçme për provimet e kualifikimit për përkthyes zyrtar për çdo gjuhë, si dhe komisioni i posaçëm për provimin e kualifikimit për interpret të gjuhës së shenjave shqipe ngrihen me urdhër të ministrit të Drejtësisë. Për çdo komision të posaçëm caktohet një kryetar i cili është një nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, që ka përvojë më të gjatë profesionale dhe në rast se të dy përfaqësuesit kanë të njëjtën përvojë profesionale, kryetar caktohet përfaqësuesi më i vjetër në moshë.

2. Komisionet e posaçme kanë mandat të kufizuar që fillon nga data e ngritjes së tyre me urdhër të ministrit të Drejtësisë dhe përfundon në datën e publikimit të listës përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar me sukses provimin e kualifikimit.

3. Përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë urdhër, në veprimtarinë e komisioneve të posaçme zbatohen për aq sa gjejnë zbatim dispozitat e legjislacionit në fuqi për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.

Neni 16

Përgjegjësitë e komisioneve të posaçëm

Komisionet janë përgjegjës, për:

a) hartimin e tezave të testeve me shkrim dhe me gojë dhe përgjigjeve të tyre;

b) identifikimin e kandidatëve pjesëmarrës në provim, shpërndarjen në mënyrë rastësore të tyre në mjediset ku do të zhvillohet testimi, përzgjedhjen dhe shpërndarjen e tezave, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e provimit, zhvillimin e provimit me gojë të kandidatëve pas përfundimit të procedurës së provimit me shkrim dhe hartimin e listës emërore të personave që morën pjesë në të dy fazat e provimit;



c) vlerësimin me pikë të përgjigjeve në testin me shkrim dhe me gojë të dhëna nga kandidatët në raport me përgjigjet e parapërgatitura të bankës së pyetjeve;

ç) shqyrtimin e ankimeve nga kandidatët ndaj rezultateve të publikuara;

d) shpalljen e rezultateve përfundimtare të provimit të kualifikimit;

dh) mbajtjen dhe evidentimin e gjithë dokumentacionit që lidhet me provimin e kualifikimit.

Neni 17

Deklarata e konfliktit të interesit

1. Pas njohjes me listat e kandidatëve të kualifikuar, anëtarët e çdo komisioni të posaçëm nënshkruajnë një deklaratë personale se nuk ndodhen në rastet e pengesave ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurës Administrative, me kandidatët për përkthyes zyrtar dhe/ose interpret të gjuhës së shenjave, që marrin pjesë në provim.

2. Kur anëtari gjendet në një nga këto raste, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative për përjashtimin dhe zëvendësimin e tij.

KREU IV PËRMBAJTJA, ZHVILLIMI DHE VLERËSIMI I PROVIMEVE TË KUALIFIKIMIT

Neni 18

Provimi i kualifikimit për përkthyes zyrtar

1. Pyetjet e provimit i referohen gjuhës përkatëse për të cilën kandidati ka paraqitur shprehjen e interesit për përkthyes zyrtar duke synuar testimin e njohurive e të aftësive në kuptimin dhe përdorimin e gjuhës përkatëse në lexim, dëgjim, shkrim dhe komunikim. Provimi bëhet me shkrim dhe me gojë.

2. Provimi me shkrim përbëhet nga seksioni i:

a) dëgjimit, në të cilin testohen aftësitë e të kuptuarit të gjuhës përkatëse të folur;

b) shkrimit, në të cilin testohen aftësitë e kandidatit në të shkruar.

3. Provimi me gojë teston njohuritë dhe aftësitë e kandidatëve për të lexuar dhe komunikuar në

gjuhën përkatëse dhe aftësitë për të kryer përkthime me gojë duke simuluar situata praktike.

Neni 19

Provimi i kualifikimit për interpret të gjuhës shqipe

1. Provimi i kualifikimit për interpret të gjuhës së shenjave shqipe bëhet me shkrim dhe me gojë.

2. Provimi me shkrim synon testimin e njohurive e të aftësive të kandidatit në kuptimin dhe në përdorimin e gjuhës së shenjave shqip në lexim dhe në gramatikë. Provimi me gojë, synon testimin e njohurive dhe aftësive të kandidatëve për të komunikuar në gjuhën e shenjave dhe aftësitë për të kryer interpretime duke simuluar situata praktike.

Neni 20

Vlerësimi me pikë

Vlerësimi i provimit të kualifikimit bëhet me maksimumin e mundshëm 100 (njëqind) pikë, nga të cilat kontrolli i njohurive me shkrim përbën 70% të numrit të përgjithshëm të pikëve (70 pikë) dhe kontrolli i njohurive me gojë përbën 30% të numrit total të pikëve (30 pikë).

Seksioni I Provimi me shkrim

Neni 21

Pyetjet e provimit me shkrim

Provimi me shkrim përmban pyetje me alternativa ose me zhvillim të cilat kanë si qëllim të masin aftësitë e kandidatëve për të shkruar në gjuhën e huaj.

Neni 22

Përgatitja e pyetjeve të testit me shkrim dhe zgjedhja e tezës

1. Pyetjet e testit me shkrim dhe përgjigjet e tyre përgatiten nga komisioni jo më herët se 1 (një) ditë para datës së zhvillimit të testit me shkrim dhe nuk u bëhen të ditura personave të tjerë.

2. Pyetjet hartohen në disa teza të ndryshme dhe futen në zarfe të ndryshëm prej të cilëve zgjidhet njëri nga zarfet për t'u përdorur në testin me



shkrim. Të gjithë zarfet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për zarfet në të cilat ndodhen përgjigjet e tezave përkatëse.

3. Zgjedhja e zarfit do të bëhet me short, ditën që do të zhvillohet testi me shkrim dhe në prani të kandidatëve. Zarfi duhet të jetë i mbyllur dhe i nënshkruar, në të kundërtën, teza në të është e pavlefshme dhe zëvendësohet me një zarf tjetër të mbyllur.

4. Pas përzgjedhjes, zarfi hapet nga komisioni dhe teza e përzgjedhur u bëhet e ditur publikisht kandidatëve nga kryetari i komisionit.

Neni 23

Paraqitja dhe identifikimi i kandidatëve

1. Hyrja për në mjediset e brendshme të zhvillimit të testimit bëhet 1 (një) orë përpara orarit të njoftuar për zhvillimin e testimit dhe identifikimi i kandidatëve bëhet në bazë të një dokumenti identifikimi personal të vlefshëm dhe me fotografi, i cili mund të jetë letërnjoftim ose pasaportë.

2. Kandidatët, që nuk kanë mjet identifikimi të vlefshëm dhe/ose nuk paraqesin dokumentin mbi pagesën e tarifës së provimit përkatës, përjashtohen nga pjesëmarrja në testin me shkrim.

3. Pasi është kryer identifikimi, kandidatët udhëzohen të deklarojnë nëse janë apo jo të pajisur me mjete të tilla, si: çantë, dosje, laps ose stilolaps, mjete elektronike ose telefonike, të cilat nuk lejohen në sallën e testimit. Nëse kandidatët janë të pajisur me mjete të tilla, i dorëzojnë për ruajtje të gjitha këto sende pranë punonjësve të caktuar për këtë qëllim.

Neni 24

Procedura përpara zhvillimit të provimit me shkrim

1. Kandidatët ftohen të zënë vendet sipas një përzgjedhjeje rastësore të caktuar nga anëtarët e komisionit dhe për asnjë arsye nuk lejohen të ndryshojnë vendin e caktuar ose të dalin jashtë.

2. Asnjë person i paautorizuar nuk lejohet të futet në sallën e testimit, përfshirë këtu edhe kandidatët të cilët janë paraqitur jashtë afatit të përcaktuar për hyrjen në sallë.

3. Kandidatëve u shpërndahen baza materiale e nevojshme për kryerjen e testit dhe kopje të

parapërgatitura të testit, të cilat kanë në çdo fletë nënshkrimin e kryetarit të komisionit, si dhe kodin e provimit. Kodi i provimit do të jetë një numër me dy ose më tepër shifra dhe unik për çdo kopje të testit dhe për çdo kandidat, i cili do të përdoret gjatë gjithë procesit të zhvillimit të provimit të kualifikimit.

4. Pas shpërndarjes së provimit, kandidatëve u kalohet një listë me emrat e tyre dhe secili shënon kodin përbri emrit të vet. Pas përfundimit të shënimit të kodeve nga të gjithë kandidatët, lista mbyllet në një zarf të veçantë.

Neni 25

Rregullat e sjelljes gjatë zhvillimit të testit me shkrim

1. Përpara fillimit të testimit, kandidatët udhëzohen që:

a) të respektojnë kohën brenda së cilës duhet të përfundojnë dhënien e përgjigjeve, e cila gjendet e përcaktuar në provim;

b) të mos komunikojnë mes tyre ose me persona jashtë mjedisit ku zhvillohet testimi;

c) të mos shënojnë ose lënë emrin, të bëjnë shenja sado të vogla, shprehje apo citime në tezë apo në fletët e përgjigjeve, të cilat mund ta bëjnë kandidatin të identifikueshëm;

ç) të mbajnë qetësi;

d) të mos konsultohen me libra ose materiale të tjera të shkruara dhe të mos përdorin baza të tjera materiale, veç atyre të vëna në dispozicion komisioni;

dh) të komunikojnë me anëtarët e komisionit, në rast nevojë, e cila duhet të jetë me zë të ulët dhe duke e thirrur në vendin e zhvillimit të testimit;

e) të njihen me përzgjedhjen e zarfit të tezës me zgjedhje rastësore përpara auditorit;

ë) të ndjekin udhëzime e sqarime të tjera të rastit, e vihen në dijeni për pasojat, në rast se nuk i respektojnë kërkesat e parashtruara.

2. Pas këtij njoftimi, çdo kandidat ftohet të plotësojë një deklaratë me shkrim, se u njoh me rregullat dhe i pranon ato, si dhe se është i ndërgjegjshëm se shkelja e tyre përbën shkak për skualifikimin e menjëhershëm nga provimi. Refuzimi për nënshkrimin e deklaramit, apo kundërshtimi i përmbajtjes së tij, sjell humbjen e menjëhershme të së drejtës për të kryer provimin.



Neni 26

Skualifikimi për mosrespektim të udhëzimeve

1. Kandidati që gjatë testimit nuk respekton udhëzimet e dhëna njoftohet pa paralajmërim të ndërpresë testimin dhe të lërë menjëherë sallën, duke iu komunikuar edhe skualifikimi nga procedura e provimit.

2. Kandidati i skualifikuar, sipas pikës 1, barazohet me kandidatët që nuk e kanë marrë minimumin e nevojshëm të pikëve për t'u kualifikuar. Në këtë rast, përkrah emrit të personit bëhet shënimi "Skualifikohet", vihet në dijeni kryetari i komisionit dhe bëhet pasqyrimi në procesverbalin e provimit, ku shënohet nxjerrja jashtë procesit të vlerësimit të tezës së kandidatit të skualifikuar, si dhe shkaqet që kanë çuar në skualifikimin e kandidatit.

3. Procesverbali i provimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe bëhet pjesë e dosjes mbi procedurat e zhvilluara duke i bashkëlidhur edhe testet dhe përgjigjet e kandidatëve të skualifikuar.

Neni 27

Procedura pas përfundimit të testit me shkrim

1. Pas përfundimit të kohës së caktuar për testimin, bëhet mbledhja e përgjigjeve të testit të kandidatëve, si dhe të gjitha materialet e tjera të përdorura në testim dhe nëse është rasti, bëhen shënimet përkatëse sipas parashikimeve të mësipërme.

2. Të gjitha fletët e përgjigjeve të testit me shkrim vulojnë në pjesën e pasme.

3. Pasi të gjithë kandidatët dorëzojnë përgjigjet e testit për vlerësimin automatik, hapet zarfi ku ndodhen dy kopje me përgjigjet e tezës.

4. Komisioni administron njërin nga kopjet e përgjigjeve, ndërsa kopja tjetër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 28

Korrigjimi i testeve me shkrim dhe vlerësimi me pikë

1. Komisioni korrigjon testet me shkrim jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të provimit.

Secili prej anëtarëve të Komisionit kryen vlerësimin e pavarur të çdo testi, dhe në fund, përllogariten pikët mesatare të të gjithë anëtarëve për çdo pyetje. Në fund të korrigjimit, komisioni përllogarit shumën totale të pikëve të fituara nga çdo kandidat gjatë kontrollit të njohurive me shkrim.

2. Administrimi i rezultateve të përfituara nga korrigjimi dokumentohet me procesverbal nga një prej anëtarëve të komisionit, që zgjidhet nga kryetari. Anëtarët e komisionit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve në mbledhje.

3. Vlerësimi i testeve dhe përgjigjja e pyetjes me shkrim nënshkruhen në çdo fletë nga të gjithë anëtarët e komisionit. Rezultatet e vlerësimit pasqyrohen në një listë, e cila përmban kodin dhe përbri pikët vlerësuese, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

4. Pas nënshkrimit të listës me kodet dhe pikët e vlerësimit për të gjitha testet e korrigjuara, hapet zarfi me emrat dhe kodet e kandidatëve dhe përbri emrit dhe kodit të çdo kandidati shënohen pikët e fituara.

Neni 29

Publikimi i rezultateve të testit me shkrim

Lista me emrat, kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Një kopje e saj, e cila përmban vetëm kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët, publikohet brenda ditës në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Për efekt ankimi, publikimi është i barasvlershëm me njoftimin e çdo kandidati.

Neni 30

Ankimi ndaj rezultateve të testit me shkrim

Kandidatët, që kanë vërejtje për vlerësimin e përgjigjes për pyetjen me shkrim, kanë të drejtë të ankohen brenda 3 (tri) ditëve nga dita e afishimit të listës. Komisioni shqyrton ankimet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas kalimit të këtij afati dhe vë në dijeni ankuesin mbi shqyrtimin e ankimit.



Neni 31

Kufiri i pikëve për kalimin në testin me gojë

Kandidati që vlerësohet me të paktën 50 (pesëdhjetë) pikë në testin me shkrim kalon në testin e kontrollit të njohurive me gojë.

**Seksioni II
Testi me gojë**

Neni 32

Zhvillimi i testit me gojë

1. Testimi me gojë, i cili është i hapur për publikun, zhvillohet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankimeve, sipas nenit 30, të këtij urdhri.

2. Rregullat për paraqitjen dhe identifikimin e kandidatëve gjatë zhvillimit të testit me shkrim zbatohen edhe gjatë zhvillimit të testit me gojë.

3. Testi me gojë regjistrohet nëpërmjet mjeteve audio ose audiovizive, përveç rasteve kur kandidatët shprehimisht kërkojnë që testi me gojë të mos jetë i regjistruar.

Neni 33

Pyetjet e testit me gojë

1. Testi me gojë përmban pyetje për të testuar aftësitë e kandidatit për t'u shprehur dhe përkthyer në gjuhën përkatëse.

2. Testimi zhvillohet duke kryer një dialog, duke simuluar një situatë përkthimi dhe duke iu përgjigjur një pyetje me shtjellim.

3. Për përgatitjen e pyetjeve të testit me gojë, zgjedhjen e tezës, si dhe për paraqitjen dhe identifikimin e kandidatëve zbatohen të njëjtat rregullat të përcaktuara për testin me shkrim.

Neni 34

Procedura përpara zhvillimit të testit me gojë

1. Të gjithë kandidatët ftohen të hyjnë dhe zënë vend në ambientin e pritjes për t'u futur në sallën ku do të zhvillohet testimi dhe ndodhet komisioni.

2. Asnjë person i paautorizuar nuk lejohet të futet në ambientin e pritjes apo sallën e testimit, përfshirë këtu edhe kandidatët të cilët janë

paraqitur jashtë afatit të përcaktuar për hyrjen në sallë.

3. Pasi zënë vend, kandidatët udhëzohen që:

a) të respektojnë kohën brenda së cilës duhet të përfundojnë dhënien e përgjigjeve;

b) të mos komunikojnë mes tyre ose me persona jashtë ambientit të pritjes ku zhvillohet testimi;

c) të mos bëjnë shenja, shprehje apo citime përpara ose gjatë zhvillimit të testimit, të cilat mund ta bëjnë kandidatin të identifikueshëm;

ç) të mbajnë qetësi;

d) të mos konsultohen me libra ose materiale të tjera të shkruara;

dh) të komunikojnë me anëtarin e komisionit, vetëm përpara hyrjes në sallën e provimit dhe në rast nevojë, si dhe me zë të ulët;

e) të njihen me përzgjedhjen e zarfit të tezës me zgjedhje rastësore përpara auditorit;

ë) të largohen nga salla e testimit dhe ambientet e pritjes menjëherë pas përfundimit të testit;

f) të ndjekin udhëzime e sqarime të tjera të rastit, e vihen në dijeni për pasojat, në rast se nuk i respektojnë kërkesat e parashtruara.

4. Për nënshkrimin e deklaratës me shkrim dhe skualifikimin për mosrespektim të udhëzimeve zbatohen të njëjtat rregullat të përcaktuara për testin me shkrim.

5. Njëri nga anëtarët e komisionit fton në sallën e testimit me radhë kandidatët bazuar në kodet përkatëse të provimit, të renditur në rend rritës, si dhe e shoqëron atë në dalje nga ambientet ku zhvillohet testimi.

Neni 35

Vlerësimi i njohurive me gojë

1. Menjëherë pas përfundimit të testit me gojë, anëtarët e komisionit japin vlerësimin e tyre në lidhje me rezultatet e secilit kandidat në mbledhje me dyer të mbyllura.

2. Anëtarët e komisionit votojnë për vlerësimin me pikë dhe janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve dhe të votimit në mbledhje.

3. Lista me emrat, kodet, pikët e fituara, si dhe shënimin mbi regjistrimin e testit me gojë për secilin kandidat nënshkruhet nga të gjithë anëtarët dhe i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur nga komisioni.



Neni 36

Llogaritja e pikëve

1. Pas vlerësimit me pikë për testin me gojë, komisioni përllogarit shumën totale të pikëve të fituara nga kontrolli i njohurive me shkrim dhe me gojë dhe i shënon ato në listën përkatëse.

2. Për marrjen e vendimit për përllogaritjen e pikëve të përgjithshme për çdo kandidat, mbahet procesverbal nga një prej anëtarëve të komisionit, që zgjidhet nga kryetari dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, përfshirë edhe ata që nuk pajtohen me vendimin.

3. Anëtari, që nuk pajtohet me qëndrimin e shumicës, e nënshkruan procesverbalin me shënimin “Nuk pajtohem me vendimin. Bashkëlidhur paraqes mendimin tim”. Anëtari në pakicë paraqet veçmas, me shkrim, mendimin e tij dhe pasi nënshkruhet nga hartuesi, i bashkëlidhet procesverbalit. Në rast se anëtari i komisionit, i cili ka mendim të kundërt me shumicën, nuk përgatit mendimin e tij me shkrim si më lart, kundërshtimi i tij konsiderohet i paqenë.

Neni 37

Shpallja e fituesve

1. Kandidati që ka kaluar testimin me shkrim dhe që në testimin me gojë vlerësohet me jo më pak se 30 pikë, konsiderohet fitues. Kandidatët që kalojnë me sukses provimin e kualifikimit, renditen në përputhje me rezultatet e arritura.

2. Lista me kodet dhe pikët e fituara për secilin kandidat publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 38

Ankimi ndaj vlerësimit të rezultateve të testit me gojë

1. Kandidatët që kanë vërejtje për vlerësimin dhe që kanë kërkuar regjistrimin me mjete elektronike të testit me gojë, kanë të drejtën e ankimit brenda 3 (tri) ditëve nga marrja dijeni për rezultatet e testimit. Ankimi shqyrtohet nga komisioni brenda 5 (pesë) ditëve.

2. Pas shqyrtimit të ankimeve dhe njoftimit të kandidatëve që kanë paraqitur ankimet, komisioni përgatit listën me emrat, kodet dhe pikët e fituara

për secilin kandidat, e cila nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij.

3. Lista i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur nga komisioni. Një kopje e listës përfundimtare me kodet dhe me pikët e fituara për secilin kandidat publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 39

Dokumentimi i procesit

Procesverbalet, përgjigjet e testeve të dhëna nga kandidatët, testet e skualifikuar, si dhe gjithë dokumentacioni tjetër që krijohet dhe i përket procesit të organizimit dhe zhvillimit të provimit, shpalljes së rezultateve dhe të kandidatëve që kalojnë me sukses provimin, ruhen në arkivin e Ministrisë së Drejtësisë, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 40

Strukturat e ngarkuara për zbatim

1. Ngarkohet struktura përgjegjëse për përkthimin zyrtar në Ministrinë e Drejtësisë dhe komisionet e posaçme përkatëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

2. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.

Neni 41

Hyrja në fuqi

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË

Ulsi Manja



URDHËR
Nr. 200, datë 10.5.2022

**PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË
ANKESAVE NDAJ PËRKTHYESVE
ZYRTARË DHE INTERPRETËVE TË
GJUHËS SË SHENJAVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 29, pika 7, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”,

URDHËROJ

1. Miratimin e formularit të ankesave ndaj përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhës së

**FORMULAR ANKESE NDAJ PËRKTHYESVE ZYRTARË DHE INTERPRETËVE TË
GJUHËS SË SHENJAVE**

Dërgimi i ankesës elektronikisht, me postë ose dorazi duhet të shoqërohet me një kopje të kartës së identitetit.

Data _____

Identifikimi i ankuesit
Emri:
Mbiemri:
Adresa:
Qyteti:
Telefon:
E-mail:

Identifikimi i palës ndaj së cilës drejtohet ankesa
Përkthyesi/interpreti:

Objekti i ankesës (Veprimi apo mosveprimi i kundërshtuar dhe data e kryerjes së veprimit apo mosveprimit):

shenjave, sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij.

2. Formulari i ankesës ndaj përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhës së shenjave publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njofimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja



Shpjegimi i qartë i fakteve rreth të cilave bëhet ankesa dhe nëse veprimi apo mosveprimi i kundërshtuar ka ndodhur për herë të parë:

Dokumentet që i bashkëngjiten ankesës (lista e dokumenteve të mundshme në të cilat mbështeten pretendimet për veprimin apo mosveprimin e kundërshtuar):

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____

Firma e ankuesit

Shënim. Ankesat e panënshkruara nuk do të pranohen. Informacioni në këtë format dhe të dhënat personale do të përpunohen në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

**URDHËR****Nr. 311, datë 17.5.2022****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Joana Duro, Sekretar i Përgjithshëm:

a) të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjyqimit, duke përfshirë: kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjyqimit të kësaj çështjeje, si dhe t'i nënshkruajnë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga znj. Joana Duro, Sekretar i Përgjithshëm, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit;

b) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

c) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat e koncesioneve dhe partneritetin publik privat me fonde buxhetore, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

d) autorizimet për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë qendrës së punës, brenda

vendit të punës në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

e) të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

f) të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht ministrit;

g) të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga znj. Joana Duro, Sekretar i Përgjithshëm, duke filluar nga data 18.5.2022.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

4. Urdhri nr. 368, datë 2.5.2019, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet znj. Joana Duro, Sekretar i Përgjithshëm, dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR**Nr. 47, datë 16.5.2022****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”; si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJME:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Procedurat e Prokurimit



në Institucionin e Komisionerëve Publikë, kancelarit, znj. Alketa Çeli.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, kancelari i Institucionit të Komisionerëve Publikë.

4. Urdhri i Komisionerëve Publikë nr. 10, datë 4.6.2018, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi në datën 16.5.2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERËT PUBLIKË
Florian Ballhysa, Irena Nino

NJOFTIM
Nr. 6539, datë 13.5.2022

MBI HYRJEN NË FUQI TË
KONVENTËS SË ILO-s PËR DHUNËN
DHE NGACMIMIN, 2019 (C190)

Konventa për Dhunën dhe Ngacmimin e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), C190, hyn në fuqi më 6 maj 2023.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 163, datë 20.1.2022, vendosi shpalljen e vdekjes së shtetasit Aleksander Gjinaj, i datëlindjes 5.4.1950, si dhe caktimin si kujdestare për administrimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme në emër të shtetasit Aleksander Gjinaj, motrën e tij, shtetasen Svjetllana Marku Gjinaj.

KËRKESE

Shtetasja Tefta Arapi, e lindur më 20.7.1939, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë shpalljen të vdekur të shtetasit Meleq Arapi, i lindur më 30.12.1967 në Vlorë.

KËRKUES
Tefta Arapi

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 656 lekë